

GJENDJA
AKTUALE
DHE SFIDAT
NË EDUKIMIN
DHE ARSIMIN
PARASHKOLLOR
NË REPUBLIKËN
E MAQEDONISË



Botues:

Byroja e zhvillimit të arsimit

Për botuesin, Zeqirija Hasipi, u.d drejtor

Ekipi hulumtues:

Rizvan Bela, u.d drejtor në BZHA

Vanço Petrushevski, u.d zëvendësdrejtor në BZHA

Liljana Samarxhiska – Panova, udhëheqëse sektori në BZHA

Dr. Gabriella Durçevska – Georgieva, këshilltare në BZHA

Ajshe Ajrullai, udhëheqëse sektori në BZHA

Pjesëmarrësit hulumtimit në terren:

Liljana Samarxhiska – Panova, udhëheqës sektori në BZHA

Dr. Gabriella Durçevska – Georgieva, këshilltare në BZHA

Mr. Mirjançe Milloshevska, udhëheqëse njësie në BZHA

Danica Talimixhioska, udhëheqëse njësie në BZHA

Antoaneta Shmit - Tanevska, udhëheqëse njësie në BZHA

Mr. Emilija Velanoska, këshilltare në BZHA

Vesna Popova, këshilltare në BZHA

Aleksandar Jolevski, bashkëpunëtor në BZHA

Ekipi i përpilimit të raportit:

Rizvan Bela, drejtor në BZHA

Vanço Petrushevski, u.d. zëvendësdrejtor në BZHA

Liljana Samarxhiska – Panova, udhëheqëse sektori në BZHA

Dr. Gabriella Durçevska – Georgieva, këshilltare në BZHA

Ajshe Ajrullai, udhëheqëse sektori në BZHA

Konsultues profesional:

prof.dr. Lena Damovska, Universiteti „Shën Cirili dhe Metodi“. Fakulteti filozofik – Instituti i Pedagogjisë,
Shkup

Prof. dr. Florina Shehu, Fakulteti Pedagogjik „Shën Klimenti i Ohrit“- Shkup

Përktheu dhe lekturoi:

Mivedete Mahmuti

Lumnije Ajdari

Shtypi:

Shoqata për prodhime grafike dhe shërbime BRANKO GAPO SHPKNJP Shkup

Tirazh:

100 kopje

Shkup, viti 2018

CIP – Katalogizimi në publikim

Biblioteka Nacionale dhe Universitare „Shën. Klimenti i Ohrit“, Shkup

373.2(497.7)(047.31)

SAMARXHISKA - Panova, Lilana

Gjendja aktuale dhe sfidat në edukimin dhe arsimin parashkollor në Republikën e Maqedonisë: (Projekt shkencor-hulumtues) / [Ekipi i përpilimit të raportit: Lilana Samarxhiska-Panova, Gabriella Durçevska-Georgieva, Ajshe Ajrullai]. - Shkup: Byroja e zhvillimit të arsimit, 2019. - 191 fq. : Ilustr. ; 30 cm

Bibliografia: fq. 163-164. - Përmban edhe: Shtojca

ISBN 978-608-206-035-4

1. Gabriella Durçevska-Georgieva, [autor] 2. Ajshe Ajrullai [autor]

PËRMBAJTJA

HYRJE	7
--------------------	----------

PJESA I

KORNIZA TEORIKE E HULUMTIMIT	9
---	----------

1. Rëndësia e mësimi të hershëm dhe zhvillimi te fëmijët prej moshës 0 deri më 6 vjet.....	11
2. Zhvillimi i nënsistemit të edukimit dhe arsimit parashkollor në Republikën e Maqedonisë.....	17
3. Gjendja aktuale në edukimin dhe arsimin fillor parashkollor në Maqedoni	20
Analiza e arsimit dhe edukimit parashkollor në Republikën e Maqedonisë	20
3.1. Organizimi dhe udhëheqja	20
3.2. Financimi	20
3.3. Përfshirja e fëmijëve në institucionet e edukimit dhe arsimit parashkollor	21
4. Edukimi dhe arsimit parashkollor në kontekstin arsimor evropian dhe botëror	25

PJESA II

METODOLOGJIA E HULUMTIMIT	33
--	-----------

1. Lëndë e hulumtimit	35
2. Definimi i nocioneve themelore të përfshira në lëndën e hulumtimit	38
3. Qëllimi dhe karakteri i hulumtimit	39
4. Detyrat e hulumtimit	40
5. Hipotezat e hulumtimit	41
6. Variablat e hulumtimit.....	42
7. Metodot, teknikat dhe instrumentet e hulumtimit	43
8. Ekzemplarë i hulumtimit	45
9. Përpilimi i të dhënave nga hulumtimi	50
10. Organizimi dhe vijimi i hulumtimit	51

PJESA III

ANALIZA DHE INTERPRETIMI I REZULTATEVE NGA HULUMTIMIT 53

1. Rregullimin me ligj për edukim në arsimin parashkollor në Republikën e Maqedonisë	55
2. Analiza e qëllimeve në programin për mësim dhe zhvillim të hershëm (gjuha, komunikimi dhe zhvillimi i shkrim - leximit, zhvillimi kognitiv dhe arritja e njohurive të përgjithshme, arti) dhe qëllimet në programet mësimore në matematikë, shkenca natyrore, art figurativ dhe arsim muzikor për klasën e I në arsimin fillor nëntëvjeçarë	58
3. Të dhëna të marra përmes anketimit të edukatorëve në kopshtet e fëmijëve në Republikën e Maqedonisë.....	84
4. Të dhëna të marra përmes anketimit të pedagogëve në kopshtet e fëmijëve në Republikën e Maqedonisë	96
5. Të dhëna të marra me fokus grupet me edukatorët në kopshtet për fëmijë në Republikën e Maqedonisë	105
6. Të dhëna të marra përmes anketimit të pedagogëve në shkollat fillore në Republikën e Maqedonisë	114
7. Të dhëna të marra përmes anketimit të mësimdhënësve klasor në shkollat fillore të Republikës së Maqedonisë.....	119
8. Të dhëna të marra përmes anketimit të prindërve të fëmijëve në kopshtet shkollore	126

PJESA IV

SHQYRTIMET PËRFUNDIMTARE DHE REKOMANDIMET 135

1. Shqyrtimet përfundimtare	137
2. Rekomandimet për implementimin e rezultateve nga hulumtimi.....	153

PJESA V

LITERATURA E SHFRYTËZUAR..... 157

PJESA VI

SHTOJCAT 161

Shtojca 1: Fletë anketuese për pedagogë	163
Shtojca 2: Fletë anketuese për edukatorë.....	168
Shtojca 3: Fletë anketuese për prindër.....	174
Shtojca 4: Pyetësor për fokus grupin e edukatorëve	178
Shtojca 5: Fletë anketuese për pedagogët në shkollë fillore	179
Shtojca 6: Fletë anketuese për mësimdhënësit klasor	184



HYRJE

Qëllimi i këtij hulumtimi është mbikëqyrja e gjendjes aktuale në edukimin dhe arsimin parashkollor në Republikën e Maqedonisë dhe në vendet tjera evropiane, që të merren njohuri të argumentuara për anët e mira dhe nxitjet në edukimin dhe arsimin parashkollor. Rezultatet e hulumtimit do të shfrytëzohen për marrjen e hapave konkrete për ndryshimet sistematike cilësore në punën edukative – arsimore me fëmijët e moshës gjashtëvjeçare si dhe për ndërlikohen funksionale të parashkollores me edukimin dhe arsimin fillor. Për këtë qëllim theks të veçantë është vënë në:

- ▲ zhvillimin e vetëdijes për rëndësinë e mësimimit të hershëm si dhe zhvillimi dhe roli kryesor i arsimit dhe edukimit parashkollor në ofrimin e mundësive dhe përkrahjes së barabartë për secilin fëmijë;
- ▲ të kuptuarit e funksioneve të ndryshme të edukimit dhe arsimit parashkollor (duke përfshirë socialen, ekonomiken dhe arsimoren);
- ▲ rishqyrtimi, të kuptuarit dhe ndryshimi i disa prej qëndrimeve ekzistuese që kanë të bëjnë me rregullimin e veprimtarisë, organizimin dhe udhëheqjen me edukimin dhe arsimin parashkollor në Republikën e Maqedonisë;
- ▲ kuptimi i rëndësisë për programin cilësor të edukimit dhe arsimit parashkollor, niveli i kompetencave të gjithë njerëzve profesional të cilët punojnë në institucionet parashkollore (jo vetëm edukatorë) dhe aftësimi i tyre i vazhdueshëm profesional;
- ▲ përfshirja e fëmijëve me edukimin dhe aftësimin profesional si dhe numri i fëmijëve sipas grupeve edukuese;
- ▲ Standardet e mësimimit të hershëm dhe zhvillimit;
- ▲ Programi për mësim dhe zhvillim të hershëm si dhe aktivitetet e detyrueshme projektuese;
- ▲ Planifikimi i punës edukative – arsimore me fëmijët e moshës parashkollore;
- ▲ Evidenca pedagogjike dhe dokumentacioni;
- ▲ Trajnimet e zhvillimit profesional të edukatorëve dhe pedagogëve në kopshtet për fëmijë.

Në fund të hulumtimit janë dhënë njohuri përfundimtare, si dhe rekomandimet që kanë për qëllim t’ju ndihmojnë institucioneve në zbatimin e ndryshimeve sistematike cilësore dhe përpërimin e punës edukative – arsimore me fëmijët e moshës parashkollore.

...the first of these is the fact that the ...

...the second of these is the fact that the ...

...the third of these is the fact that the ...

...the fourth of these is the fact that the ...

...the fifth of these is the fact that the ...

...the sixth of these is the fact that the ...

...the seventh of these is the fact that the ...

...the eighth of these is the fact that the ...

...the ninth of these is the fact that the ...

...the tenth of these is the fact that the ...

...the eleventh of these is the fact that the ...

...the twelfth of these is the fact that the ...

...the thirteenth of these is the fact that the ...

...the fourteenth of these is the fact that the ...

...the fifteenth of these is the fact that the ...

...the sixteenth of these is the fact that the ...

...the seventeenth of these is the fact that the ...

...the eighteenth of these is the fact that the ...

PJESA 1

Korniza teorike e problemit të hulumtimit

...the ...

...the ...

...the ...

...the ...

...the ...

...the ...

...the ...

...the ...

...the ...

1

RËNDËSIA E MËSIMIT TË HERSHËM DHE ZHVILLIMI TE FËMIJËT PREJ MOSHËS 0 - 6 VJEÇ

„Para se të ndërtoni shtëpi, është e domosdoshme të vini themele të cilat do ta mbajnë atë. Fëmija para se të regjistrohet në shkollë fillore, duhet të vihen themelet e ngjashme. Arsimi i suksesshëm i mëtejshëm i fëmijës në shkallë të madhe varet nga themelet që janë vendosur gjatë periudhës parashkollore “.

(Grupi konsultues i UNESKO-s, për kujdesin e hershëm dhe zhvillimin e fëmijëve, në vitin 1993.)

Cilësia e përvojave të cilat fëmija i arrin në vitet e para të jetës janë me rëndësi kruciale, meqë më vonë ajo reflektohet (pozitivisht apo negativisht) përmes periudhës jetësore. Xhejms Hekman, nobelist i njohur dhe profesor universitar në Çikago, ka thënë se në investimin e zhvillimit të hershëm të fëmijës nga lindja e fëmijës deri në moshën pesëvjeçare gjendet zgjidhja për arsim, shëndetësi më të mirë dhe prosperitet më të madh ekonomik.

Për zhvillimin psikik të drejtë të fëmijës me rëndësi janë: pjekuria e dispozitave trashëguese, mjedisi ku jeton dhe aktiviteti (mësimi) i fëmijës në atë mjedis. Sipas teorisë së zhvillimit kulturorë – historik të funksioneve psikike (Vigotski), funksionet e larta psikike (mbamendja logjike, vëmendja e qëllimshme, e folmja, mendimi dhe ndjenjat e ndërlikuara) në radhë të parë janë me natyrë sociale. Gjatë zhvillimit filogjenetik të njeriut si dhe në zhvillimin ontogjenetik të fëmijës ata gjithnjë e më shumë zhvillohen meqë aty është ndërtuar shenja (fjala është shenjë e cila e prezanton realitetin). Me zhvillimin e sistemit të shenjave dhe rëndësinë e tyre (më saktë me zhvillimin e gjuhës dhe e tëra që është krijuar me ndihmën e saj: mitologjia, religjioni, arti, shkenca dhe e tëra që quhet kulturë e një populli) funksionet e larta psikike gjithnjë e më tepër zhvillohen. Analoge në këtë zhvillim filogjenetik edhe

fëmija që në zhvillimin e tij i përvetëson gjuhën dhe realitetin e tij simbolik përmes interiorizimit, në të cilën rol të rëndësishëm luan mësimi, i kuptuar si aktivitet i fëmijës në mjedisin ku jeton. Kjo nënkupton se duhet parapri pjekurisë dhe në atë mënyrë ta nxisë shkakton zhvillimin e funksioneve psikike. Nocioni mësim kuptohet si mësim i funksioneve të njohurive, socializimit, të arriturat e motiveve të reja, formimi i tipareve të karakterit, emocionet e reja dhe sistemi bashkëkohorë i vlerave. Në atë kuptim është e domosdoshme që hapësira e mësimi – lokali argëtues të jetë mjedis i pasur me stimuluese për zhvillimin psikik të fëmijës. Saktë thënë ajo duhet të jetë hapësirë e planifikuar me vëmendje e cila fëmijëve do t’ju jep mundësi për përvojë të llojllojshme senzore, motorike dhe manipuluese e cila do ta stimulojë përvojën simbolike, gjuhën dhe operacionet logjike – matematikore përfundimisht të jetë mjedis i cili do t’i nxisë fëmijët të hulumtojnë, iniciojnë dhe krijojnë. Adaptimi, gjithashtu duhet kuptuar si gjendje e harmonisë ndërmjet mjedisit individual dhe të saj me çka fëmija kuptohet si një sistem i hapur i cili e asimilon realitetin dhe e integron në bazë të një procesi të ndryshimit të pandërprerë. Duke shikuar në atë mënyrë fëmija nuk është përmbledhje kushtesh që duhet të ndërliiden në tërësi, por individ i cili mëson, dëshiron, reagon sipas sistemit të ritmit individual, i cili nuk

është i determinuar vetëm nga përvojat paraprake dhe të arriturat, por edhe nga pjekuria biologjike. Duke e pasur parasysh atë që se çka thotë Pijazhe, pjekuria e sistemit nervor apo jep mundësi apo përkohësisht i kufizon madje në atë kuptim mësimi duhet edhe ta përcjell zhvillimin.

Koncepti humanist-ekzistencial për zhvillimin e personalitetit insiston që të merren parasysh dallimet individuale dhe e drejta e ritmit individual të zhvillimit të secilit fëmijë. Më saktë, zhvillimi nxitet edhe ashtu që përcillet secili fëmijë konkret përmes rrugës së tij individuale ndërsa analog me atë duhet të zhvillohet strategjia edukative – arsimore e cila do të nisët nga ai fëmijë konkret si realitet ndërsa vetëm nga ndonjë fotografi ideale për fëmijën e moshës së caktuar. Hulumentimet e shumta në botë dhe te ne tregojnë se gjuha, niveli i kulturës, kushtet e përgjithshme për jetesë dhe mënyra specifike e edukimit dhe arsimit të fëmijës në periudhën parashkollore kanë ndikim të madh mbi jetën psikike të fëmijës dhe zhvillimin e aftësive të nevojshme për shkuarjen në shkollë.

Në vitin 2012 Byroja e Zhvillimit të Arsimit realizoi hulumtim me temë: „Ndikimet pozitive në punën edukative arsimore në kopshtet e fëmijëve mbi suksesin e nxënësve në përvetësimin e programeve mësimore në klasën e parë” ku kanë qenë të përfshirë edukatorë nga kopshtet shkollore dhe mësimdhënës klasor nga shkollat fillore të Republikës së Maqedonisë. Mbikëqyrjet përfundimtare treguan se fëmijët të cilët kanë ndjekur kopshte para fillimit në shkolla kanë mjaft njohuri paraprake, socializohen dhe adaptohen shpejtë në klasën e parë, kanë shkathtësi të arritura komunikimi kanë fjalorë të pasur etj.

Në atë drejtim mësimi i hershëm dhe zhvillimi i fëmijëve sot në të gjithë vendet e botës është ngritur në nivelin e prioritetit kombëtar ndërsa të arriturat e reja shkencore dhe mbikëqyrjet praktike në pedagogji vërtetojnë se „edukimi dhe arsimit parashkollor ka një trajtim më ndryshe dhe rëndësi me nënsistemet tjera”.¹


Me rëndësi të veçantë është që puna e organizuar edukative – arsimore për mësimin e hershëm dhe zhvillimin e të gjithë fëmijëve me çka nuk neglizhohet rëndësia dhe roli i prindërve dhe mjedisi familjar por përkundrazi insistohet në mësimin e përbashkët dhe komplementar të fëmijëve. Megjithatë kjo që i ofrohet fëmijës me Programin për mësimin e hershëm dhe zhvillimin përmes punës së organizuar edukative – arsimore në kopshte nuk mundet të merret në familje dhe e kundërta.

Hulumtimet më të reja vërtetojnë se qëndrimi i fëmijës në kopshte përderisa prindërit janë në punë nuk ka ndikim negativ në zhvillimin e fëmijës, nëse programi për mësimin e hershëm është adekuat dhe me cilësi ndërsa institucionet parashkollore janë të rregulluara dhe të kontrolluara me ligj.

Edukimi dhe arsimit i organizuar parashkollor mund të ketë funksion të njëpasnjëshëm për zhvillimin e shoqërisë së tërësishme edhe atë:

1 Programi nacional për zhvillimin e arsimit në Republikën e Maqedonisë 2005 – 2015 me dokumente programore të të bashkëngjitura. (2006) Shkup: Ministria e Arsimit dhe Shkencës K.(1994). Nga abetare në universitet. Shkup: Prosvetno dello, faqe. 132

**PARAQITJA SKEMATIKE 1:
FUNKSIONET E EDUKIMIT DHE
ARSIMIT TË ORGANIZUAR
PARASHKOLLOR**



- ▲ **Pedagogjik:** Edukimi dhe arsimi i organizuar parashkollor i fëmijëve ju mundëson mundësi për zhvillimin, lojën dhe mësimin në atmosferë të sigurt. Funkzioni pedagogjik i edukimit dhe arsimit parashkollor mundëson përkrahje të edukimit familjarë, i avancoon shkathtësitë dhe njohuritë e prindërve në lidhje me edukimin familjar dhe ndikimin e drejtpërdrejtë të mësimin në familje.
- ▲ **Shoqëror:** Edukimi dhe arsimi parashkollor përmes krijimit të barabartë dhe mundësive të njëjta për secilin fëmijë, jep kontribut të integritit shoqëror dhe kohezion më të madh. Mësimi i hershëm mundëson fillim të njëjtë në shkollë, e përshpejton adaptimin e fëmijës në shkollë, e zvogëlon shmangien e fëmijëve në shkollën e mëtejshme të arsimit ndërsa arrijtjet e fëmijëve të cilët kanë ndjek kopshte dhe qëndrimet e tyre për mësimin janë në nivel më të lartë krahasuar me të arriturat e fëmijëve, të cilët nuk kanë qenë të përfshirë në edukimin dhe arsimin parashkollor.
- ▲ **Ekonomik:** Edukimi dhe arsimi parashkollor ju mundëson prindërve të punësohen apo ta vazhdojnë arsimin e tyre, duke e ditur se fëmijët e tyre janë të sigurt dhe nën kujdes. Në edukimin dhe arsimin parashkollor punojnë njerëz profesional të profileve të ndryshme. Investimi në zhvillimin e hershëm të fëmijës është investim më i paguar në zhvillimin e kapitalit njerëzor, me kapacitet të kontribuojë kah përparimi i arsimit dhe statusi socio-ekonomik i secilit individ, madje edhe me një kthesë të madhe të investimit. Kështu që investimi në edukimin dhe arsimin parashkollor imponohet si qëllim prioritar për zhvillimin afatgjatë të secilës shoqëri.

Politikat dhe programet e ndërlidhura me mësimin e hershëm dhe zhvillimin e fëmijëve janë shumë komplekse. Në Republikën e Maqedonisë investimi në zhvillimin e hershëm të fëmijës është ende shumë nivel i ulët. Vendosja e cilësisë në nënsistemin e edukimit dhe arsimit parashkollor në Republikën e Maqedonisë në mënyrë plotësuese është vështirësuar, për shkak të ndarjes së kompetencave ndërmjet tre ministrive (Ministria e Punës dhe Politikës Sociale, Ministria e Arsimit dhe Shkencës si dhe Ministria e Shëndetësisë). Një ndarje e këtillë shpie kah përzjerja e ingerencave dhe përgjegjësia e një ministrie në tjetrën, gjithashtu rezulton me uljen e cilësisë për mësimin e hershëm dhe zhvillimin e fëmijëve.


Dëshmitë shkencore për zhvillimin e trurit dhe rëndësia e mëimit dhe zhvillimit

Shkencërisht është e dëshmuar se zhvillimi i trurit zhvillohet gradualisht. Fillon ende në periudhën paranatale dhe vazhdon deri në pjekuri. Megjithatë, hulumtimet më të reja vërtetojnë se zhvillimi më intensiv i trurit ndodh në pesë vitet e ardhshme në jetën e fëmijës. Në këtë periudhë formohen 700 lidhje të reja nervore secilën sekondë. Kjo nuk nënkupton se fëmijët më vonë nuk mund të mësojnë apo të zhvillojnë, por efektet janë më larg më të vogla meqë pas kësaj periudhe numri i lidhjeve që formohen në tru bie në mënyrë drastike. Nevojitet që të theksohet se aftësitë intelektuale varen nga lidhja ndërmjet qelive nervore dhe trurit p.s. sinapset. Ata gjenden në koren e trurit të madh të detyruara për aftësitë kognitive. Aktivitetet e fëmijës ndikojnë mbi rritjen e numrit të sinapseve, të cilat kanë ndikim të fuqishëm mbi zhvillimin e përgjithshëm të fëmijës. Rreth 75% të sinapseve formohen para moshës shtatë vjeçe, ndërmjet viteve 12 -

14 nga jeta e fëmijës janë të formuara diku rreth 95% të sinapseve.

PARAQITJA SKEMATIKE 2:

FORMIMI I LIDHJEVE NERVORE NË TRU




Nga paraqitja skematike mund të vërehet se së pari formohen lidhjet nervore më të zakonshme të cilat më vonë bëhen më të ndërlikuara. Si dhe sa lidhje nervore do të formohen në masë të madhe varet nga gjeneza por edhe nga përvojat të cilat fëmija i arrin në moshën e hershme.

Cilësia e përvojave të cilat fëmija i arrin në pesë vitet e para kanë ndikim të fuqishëm në zhvillimin dhe funksionet e trurit. Fotografitë e marra përmes skenimit të kokës e tregojnë qartë dallimin në strukturën dhe funksionet e trurit të fëmijës i cili rritet në mjedis të

shëndoshë, të sigurt dhe stimulues dhe fëmijë që rritet në mjedis i cili nuk është i përshtatshëm për zhvillimin e tij. Në bazë të hulumtimeve të tilla dhe ngjashëm të bëra dekada mbrapa mund të vërtetohet se efektet janë më të mëdha dhe më afatgjate kur stimulimi është aplikuar në kohë. Secili stimulim i vonuar kryesisht

jo në kohë mund të shkaktojë probleme në mësim, në sjelljen si dhe në shëndetin fizik dhe mental të fëmijës. Për këtë arsye sot më të fuqishëm bëhen argumentet se investimi në mësim dhe zhvillimin e fëmijës veçanërisht prej lindjes deri në moshën pesë vjeçe është bazë e shoqërisë së prosperuar dhe të qëndrueshme.

PARAQITJA SKEMATIKE 3:
PASQYRË SKEMIKE 3: ZHVILLIMI
I TRURIT DHE FUNKSIONET E
TRURIT²



Zhvillimi kognitiv, fizik, emocional dhe social janë të pandashëm gjatë jetës së njeriut në tërësi, bashkërisht ata janë „tulla” dhe „llaç” të cilët e përbëjnë bazën e zhvillimit të njeriut. Stimulimi adekuat i shëndetit emocional dhe fizik, shkathtësitë sociale dhe kapacitetet kognitive – linguistike në vitet e hershme të jetës së fëmijës

paraqesin parakusht të rëndësishëm për suksesin në shkollë ndërsa më vonë edhe në vendin e punës.

Janë të arsyeshme pritjet e ekspertëve, personave profesional dhe praktikant në Republikën e Maqedonisë, të cilët merren me problematikën e mësimin të hershëm dhe zhvillimit të fëmijëve, në periudhën që vijon të vihet theks i veçantë në zhvillimin dhe edukimin parashkollor së pari përmes miratimit të ligjit për edukimin dhe arsimin parashkollor, përhapjen e rrjetit të institucioneve parashkollore me

² Prirucnik za diversifikaciju programa predškolskog vaspitanja i obrazovanja, (2013), Ministarstvo prosvete, nauke i tehnološkog razvoja Republike Srbije. (Doracak për diversifikimin e programit të arsimit parashkollor, (2013), Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Zhvillimit Teknologjik të Republikës së Serbisë)

qëllim rritjen e përfshirjes së fëmijëve dhe gjithashtu hedhjen e kompetencave në arsimin dhe edukimin parashkollor në kuadër të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës. Hulumtimi ynë i sistemit arsimor në Evropë dhe në Botë tregon se edukimi dhe arsimit parashkollor së pari dhe nënsistem më i rëndësishëm, paraqet pjesë integrale të sistemit të tërësishëm në edukimin dhe arsimin parashkollor me ingerenca të tërësishme në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës.



E RËNDËSISHME

- ▲ Parimet themelore të neurologjisë tregojnë se intervenimi i hershëm preventiv është më efikas dhe shpie në rezultate të volitshme, sesa sanimi i vonshëm në jetë.
- ▲ Qasja e balancuar kah zhvillimi emocional, social, kognitiv, motorik dhe zhvillimi i të folurit më mirë do t'i përgatitë fëmijët për suksesin në shkollë, ndërsa më vonë edhe në vendin e punës si dhe në bashkësi.
- ▲ Lidhjet socio - emocionale dhe përvojat pozitive për mësim fillojnë të zhvillohen në familje por gjithashtu vazhdojnë të zhvillohen në kopshte.
- ▲ Që truri i foshnjave të mundet të zhvillohet drejtë, nevojitet raport i kujdesit, stabil, interaktiv me të rriturit.
- ▲ Shkenca tregon qartë se në situatat kur fëmija shmanget nga rritja normale dhe zhvillimi, intervenimet ende nga moshë e hershme janë me rëndësi kryesore për të arriturat e rezultateve më të mira.
- ▲ Te fëmija i moshës parashkollore së pari formohen lidhjet më të zakonshme të nervave të cilët më vonë bëhen më të ndërlikuara. Cilësia e përvojave që fëmija i arrin në moshën e re dhe cilësia e programit për edukimin dhe arsimin parashkollor janë kryesore për mësimin e mëtejshëm dhe suksesin e fëmijës në shkollë, madje edhe në punën.

2 ZHVILLIMI I NËNSISTEMIT TË EDUKIMIT DHE ARSIMIT PARASHKOLLOR NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË

Edukimi dhe arsimiti parashkollor në Republikën e Maqedonisë ka traditën e vetë. Format e para të organizuara janë paraqitur në gjysmën e dytë të shekullit XIX, por deri te çlirimi i Maqedonisë (në vitin 1945) ata nuk kanë qenë mjaft të zhvilluara dhe janë zhvilluar në kushte jo adekuate.

Në periudhën ndërmjet dy luftërave botërore, foshnjoret kanë qenë forma e vetme e organizuar e edukimit dhe arsimit parashkollor në Republikën e Maqedonisë dhe aty ishin të përfshirë fëmijët në vitin para fillimit në shkollë. „Në vitin shkollor 1939/40 në Maqedoni janë përfshirë vetëm 1611 fëmijë edhe atë në 31 grupe të foshnjoreve të vendosura kryesisht, në qytetet më të mëdha në përbërjen e shkollës fillore“.³

Pas çlirimit të Maqedonisë në vitin 1945 gradualisht krijohen kushtet e zhvillimit të edukimit dhe arsimit parashkollor. Ajo mbetet pjesë përbërëse e sistemit global edukativo arsimor, me statusin e edukimit dhe arsimit jo të detyrueshëm. Karakteristikë kryesore në këtë zhvillim fillestar është ajo që kopshtet e fëmijëve janë trajtuar si institucione sociale dhe kanë qenë të dedikuara vetëm për fëmijët prindërit e të cilëve kanë qenë të detyruar. Për dallim prej tyre foshnjoret kanë pasur status të institucioneve për edukimin

dhe arsimin parashkollor të fëmijëve e cila detyrë themelore ka qenë socializimi i tyre dhe përgatitja për në shkollë. „Aty qasja ka qenë vullnetare dhe e lirë për të gjithë fëmijët të cilët anë pasur dëshirë t'i vizitojnë“.⁴

Kjo nënkupton se në këtë periudhë ekziston veprim në përcaktimin e statutit të institucioneve parashkollore, që do të përfshijë deri në fund të viteve të gjashtëdhjeta dhe në mënyrë të llojit të vetë do të reflektohet mbi zhvillimin e tyre. Kontribut të rëndësishëm në zgjerimin e rrjetit dhe përhapjen e interesit për institucionet parashkollore në vitet e pesëdhjeta kanë edhe kopshtet sezonale për fëmijë. Megjithatë me emërimin e mënyrës së financimit (nga financimi buxhetor në vetëfinancim), dhe me këtë edhe përfshirja e fëmijëve.

Në prill të vitit 1950 nga ministri, për arsimin e popullit është miratuar akti i normativit të parë të rëndësishëm në sferën e edukimit dhe arsimit parashkollor me titull *Rregullorja për organizimin dhe punën e kopshtit shkollor* i cili mbetet në fuqi deri në miratimin e Ligjit për edukimin dhe arsimin parashkollor. Kopshtet e fëmijëve e mbajnë karakterin social (aty munden të pranohen vetëm fëmijë të

³ Kamberski, K.(1994). *Nga abetare në Universitet*. Shkup: „Prosvetno dello“, faqe.132

⁴ Instituti i Pedagogjisë (2000). *Edukimi dhe arsimiti parashkollor në Republikën e Maqedonisë (zhvillimi, gjendja dhe perspektiva)*. Shkup: Fakulteti Filozofik, faqe 11

nënave të cilat shkojnë në punë) dhe definohej si „institucione për edukim dhe mbikëqyrjen e fëmijëve të shëndoshë nga tre vite të plota deri në shkuarjen në shkollë”⁵

Me rregulloren e njëjtë janë sanksionuar disa parime të punës edukative arsimore:

- ▲ puna edukative në kopshtet e fëmijëve realizohet në gjuhën amtare;
- ▲ ajo realizohet përmes grupeve edukative;
- ▲ secili grup edukativ duhet të ketë nga dy edukatorë me përgatitje profesionale adekuate;
- ▲ duhet të mbahet llogari për zhvillimin individual të secilit fëmijë dhe sipas aftësive të tyre të përfshihet në grupin adekuat edukativ. Reformat në shkolla në vitin 1958 do ta shënojnë fillimin e fazës së re cilësore të edukimit dhe arsimit fillor parashkollor në Republikën e Maqedonisë”.⁶

Në vitin 1959 është miratuar *Ligji i parë për institucionet e edukimit parashkollor*. Pas miratimit të tij fillon zhvillimi më intensiv i edukimit dhe arsimit parashkollor, ashtu që të dhënat tregojnë se në „vitin 1960 kanë punuar 45 institucione parashkollore me 4179 fëmijë”.⁷

Në vitin 1968 edhe në Republikën Socialiste të Maqedonisë flitet për rëndësinë e periudhës parashkollore në zhvillimin e mëtejshëm të personalitetit të fëmijës. E tërë kjo hap perspektiva në zhvillimin dhe përhapjen e rrjetit të institucioneve parashkollore.

5 Njëjtë, faqe. 12

6 Njëjtë, faqe. 12

7 Instituti i Pedagogjisë.(2000). *Edukimi dhe arsimit parashkollor në Republikën e Maqedonisë (zhvillimi, gjendja dhe perseptiva)*. Shkup: Fakulteti Filozofik, faqe.13

Me Ligjin për edukimin dhe arsimin e fëmijëve të moshës parashkollore miratuar në vitin 1974, edukimi dhe arsimit parashkollor në Republikën e Maqedonisë ballafaqohet me ndryshime esenciale, kryesisht bëhet pjesë përbërëse e sistemit global edukativo – arsimor, ndryshohet trajtimi i grupeve të çerdheve (edukimi i fëmijëve deri në moshën 2 vjeçare hyn në përbërjen e institucioneve parashkollore).

Me këtë ligj për herë të parë në Republikën e Maqedonisë rregullohet edukimi dhe arsimit i fëmijëve të moshës parashkollore me aftësi të kufizuara.

Edukimi dhe arsimit parashkollor shënon procese të reja dhe ndryshime në vitet e tetëdhjeta. Nga fillimi i viteve të tetëdhjeta janë miratuar dy ligje të veçanta me të cilët rregullohet edukimi dhe arsimit parashkollor: Ligji për mbrojtjen e fëmijëve (1981) dhe Ligji për edukimin dhe arsimin fillor (1983). Rëndësi të veçantë i jepet zgjerimit të rrjetit dhe zmadhimit të përfshirjes së fëmijëve, si dhe në aftësimin e kuadrove profesionale. Në vitin 1983 është përpunuar dokument i ri programor për punën edukative arsimore me fëmijët e arsimit parashkollor.

Në fillimin e viteve të nëntëdhjeta nën ndikimin e ndryshimeve shoqërore – politike si dhe ekonomike, vjen në ndërprerjen e SIZ – it, ndërsa me atë edhe në ndryshimet e dokumenteve të caktuara ligjore, çka në fund do të rezultojnë me ndryshimin e statusit të institucioneve parashkollore. Më konkret, Ministria e Punës dhe e Politikës Sociale e ndërmerr kompetencën mbi ata. Mirëpo përcjellja e punës edukative – arsimore, përpilimi i dokumenteve programore për punën edukative arsimore dhe profesionale të kuadrit edukativo – arsimor në kopshtet e fëmijëve dhe më tutje mbetet në kompetencat e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës.

Në nëntor të vitit 2000 është miratuar Ligji për mbrojtjen e fëmijëve. Puna e organizuar edukative – arsimore në vitin para shkuarjes në shkollë, për fëmijët e moshës 5 deri më 7 vjeç, në pajtim me rregulloren ligjore u realizua në grupet e mëdha në kopshtet shkollore (rreth 20 % e popullatës së fëmijëve të përfshirë me këtë formë të edukimit dhe arsimit parashkollor) dhe në grupet e foshnjoreve në shkollat fillore me qëndrim gjysmë ditor apo programe të shkurtuara (rreth 80% të popullatës së fëmijëve të përfshirë). Me rritjen e numrit të fëmijëve në 83% prej moshës 5 deri në 7 vjeç të përfshirë në ndonjë prej formave të edukimit dhe arsimit parashkollor në vitin para shkuarjes në shkollë janë krijuar kushte që Ministria e Arsimit dhe e Shkencës në vitin 2004 të miratojë ligjin me të cilin rregullohet viti i detyruar përgatitor për fëmijët e moshës 5 – 7 vjeç. Në bazë të rregullores ligjore Byroja e Zhvillimit të Arsimit (përmes komisioneve të përbëra nga profesorët universitar, këshilltarë të edukimit dhe arsimit parashkollor dhe praktikantët e kopshteve dhe grupet e foshnjoreve pranë shkollave fillore) në prill të vitit 2004 përpiloi dokument „Bazat e programit për punën edukative arsimore në vitin përgatitor”, i cili është miratuar nga ministri i arsimit dhe shkencës me vendimin nr. 10-746/25 prej 27.04.2005.

Ndryshime të reja të rëndësishme në kuadër të nënsistemit të edukimit dhe arsimit parashkollor krijohen me ngritjen e iniciativës në vitin 2006 për fillim të aplikimit arsimit nëntëvjeçarë i detyrueshëm në Republikën e Maqedonisë.

Me këtë iniciativë, sipas Konceptit të edukimit dhe arsimit nëntëvjeçarë botuar nga Byroja e zhvillimit të arsimit në gusht të vitit 2007, është paraparë përfshirje e detyrueshme e fëmijëve të moshës

gjashtëvjeçare⁸ në klasën e parë. Kopshtet e fëmijëve e humbin popullatën e fëmijëve të moshës prej 6 deri në 7 vjeç për shkak se „në shkollat fillore regjistrohen fëmijë të cilët do të mbushin 6 vjet në fund të vitit kalendarik, kur regjistrohen në shkollë“.⁹

Byroja e Zhvillimit të Arsimit (përmes komisioneve të përbëra nga profesorë universitarë, këshilltarë të edukimit dhe arsimit parashkollor si dhe praktikantë të kopshteve dhe shkollave fillore) në shkurt të vitit 2007 e përpiloi versionin e fundit të Bazave të programit për punën edukative arsimore me fëmijët e moshës parashkollore në kopshtet publike të fëmijëve. Me vendimin nr. 11-3-853/1 prej 08.10.2007 ky dokument programor është miratuar nga Ministri i Punës dhe Politikës sociale.

Ligji i fundit për mbrojtjen e fëmijëve miratuar në shkurt të vitit 2013 dhe deri më sot ka pësuar disa ndryshime. Kështu që sipas Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijëve (teksti i konsoliduar në korrik 2016) përfshirja e fëmijëve parashkollor në kopshte, veprim i cili është kujdesi dhe edukimi i fëmijëve deri në moshën 6 vjeçare ndërsa më tutje është i detyrueshëm.

8 Programi nacional për zhvillimin e arsimit në Republikën e Maqedonisë 2005-2015 me dokumente të bashkangjitura programore. (2006). Shkup: Ministria e Arsimit dhe Shkencës në Republikën e Maqedonisë faqe. 75

9 Koncepti për edukimin dhe arsimin fillor nëntëvjeçarë (2007). Shkup: Byroja e Zhvillimit të Arsimit, faqe.77

3

GJENDJA AKTUALE NË EDUKIMIN DHE ARSIMIN PARASHKOLLOR NË MAQEDONI

**Analiza e edukimit dhe
arsimit parashkollor në
Republikën e Maqedonisë**

3.1. Organizimi dhe udhëheqja

Edukimi dhe arsimit parashkollor në Republikën e Maqedonisë është jo i detyrueshëm dhe rregullohet me ligjin për mbrojtjen e fëmijëve, në pajtim me atë „Kujdesi dhe edukimi i fëmijëve të moshës parashkollore është formë e mbrojtjes së fëmijëve e cila si veprimtari organizohet për kujdesin, qëndrimin, të ushqyerit, edukativo – arsimor, sportive – rekreative, aktivitetet kulturore – zbavitëse, masat dhe aktivitetet për përmirësimin dhe ruajtjen e shëndetit si dhe për nxitjen e zhvillimit intelektual, emocional, fizik, mental dhe social të fëmijës deri në moshën gjashtë vjeçe përkatësisht deri në përfshirjen në arsimin fillor”.¹⁰ Veprimtaria, përkujdesi dhe edukimi realizohet në kopshtin shkollor (kopshtin shkollor publik dhe kopshtin për fëmijë në pronësinë private), qendrën për zhvillimin e hershëm të fëmijëve, si njësi organizative në përbërjen e personave juridik, në përbërjen e institucionit të lartë arsimor dhe në përbërjen e shkollës private. Kopshti publik komunal i fëmijëve, pas mendimit të marrë paraprak nga Ministria e Punës dhe Politikës Sociale, bazohet si institucion publik nga ana e këshillit të komunës, Këshilli i Qytetit të Shkupit. Me propozimin e Ministrisë si themelues i kopshtit publik për fëmijë

mund të paraqitet edhe Qeveria e Republikës së Maqedonisë. Kopshti i fëmijëve në pronësi private bazohet nga personi vendor apo i huaj juridik.

Puna edukative – arsimore në kopshtin e fëmijëve, përkatësisht Qendra për zhvillimin e hershëm të fëmijëve realizohet sipas Programit për mësimin dhe zhvillimin e hershëm, bazuar në Standardet e mësimin dhe zhvillimit të hershëm, që është i përpiluar në Byronë e zhvillimit të arsimit ndërsa e miratuar nga ministri i Punës dhe Politikës Sociale. Ajo është në pajtim me nevojat, interesat, moshën dhe karakteristikat zhvillimore të fëmijëve të moshës parashkollore dhe është e orientuar kah zhvillimi holistik i secilit fëmijë.

3.2. Financimi

Obligimet e financimit të veprimtarisë janë në pajtim me Vetëqeverisjen lokale e cila paraqitet si themelues i kopshtit, shtetit dhe prindërve të fëmijëve. Nga burimet e shtetit veçohen mjetet dedikuese për pagat e të punësuarve, shpenzimet materiale dhe të regjisë 75% e shpenzimeve që i ka kopshti për ushqim dhe kujdes të fëmijëve, ndërsa pjesa tjetër – 25%, e mbulojnë prindërit fëmijët e të cilëve shkojnë në kopsht.

¹⁰ MPPS. Ligji për mbrojtjen e fëmijëve. Teksti i konsoliduar

3.3. Përfshirja e fëmijëve në institucione për edukimin dhe arsimin parashkollor

Në këtë drejtim Republika e Maqedonisë të përgjigjet me sukses në teorinë bashkëkohore dhe në praktikë. Ministria e Arsimit dhe Shkencës në vitin 2004 formoi grup punues i cili hartoi Programin Nacional për Zhvillimin e Arsimit në Republikën e Maqedonisë 2005 – 2015 me dokumente të bashkëngjitura programore.

Misioni i arsimit dhe edukimit parashkollor në Republikën e Maqedonisë në këtë dokument strategjik është orientuar ndaj: „qasjes së barabartë dhe përfshirjes maksimale të fëmijëve të moshës parashkollore me forma më ndryshe dhe programe, të dizajnuara sipas rrjedhave bashkëkohore dhe njohuritë më të reja shkencore nga lëmi i zhvillimit të fëmijëve”.¹¹

Qëllimet themelore të edukimit dhe arsimit parashkollor në Republikën e Maqedonisë që dalin nga Programi nacional për zhvillimin e arsimit në Republikën e Maqedonisë, me tendencë për ofrimin në vendet e Unionit Evropian, kryesisht kanë të bëjnë me:

- ▲ „Përmirësimin maksimal dhe ofrimin e cilësisë së edukimit parashkollor;
- ▲ Rritja e përfshirjes së fëmijëve prej moshës parashkollore me theks të fëmijës prej moshës 3 deri 6 vjeçare;
- ▲ Rritja e cilësisë së trajnimit iniciues të bashkëpunëtorëve profesional dhe edukatorëve;
- ▲ Përmirësimi i pajisjes së tërësishme të kopshteve (mobilet, mjetet didaktike, mjetet teknike etj.);
- ▲ Hapja e kopshteve ndaj familjeve dhe bashkësisë lokale;

11 Programi nacional për zhvillimin e arsimit në Republikën e Maqedonisë 2005-2015 me dokumentet programore të bashkëngjitura (2006). Shkup: Ministria e Arsimit dhe Shkencës së Republikës së Maqedonisë, faqe. 69

- ▲ Përfshirja e fëmijëve me aftësi të kufizuara;
- ▲ Vendosija e sistemit për aftësimin e vazhdueshëm profesional të kuadrit;
- ▲ Licencimi dhe certifikimi i institucionit edukative – arsimore dhe i kuadrit edukativo - arsimor”.¹²

Me qëllim që shteti ta vazhdojë trendin e rritjes së përfshirjes së fëmijëve në kopshte, në vitin 2013 është miratuar Ligji i ri për mbrojtjen e fëmijëve, ku qëndron: „Veprimtaria që kryhet në kuadër të kujdesit dhe edukimit të fëmijëve të moshës parashkollore mund të realizohet edhe në Qendrën për zhvillimin e hershëm të fëmijëve. Qendra për zhvillimin e hershëm të fëmijëve realizon program për mësimin e hershëm dhe zhvillimin e fëmijëve të moshës parashkollore prej tre deri në gjashtë vjet, përkatësisht deri në shkuarjen në shkollë fillore”.¹³ Kjo mundësi ligjore për hapjen e qendrave për zhvillimin e hershëm të fëmijëve, drejtpërdrejtë ndikonte mbi zmadhimin e përfshirjes në kuadër të sistemit për kujdesin dhe edukimin e fëmijëve të moshës parashkollore, me theks të veçantë të përfshirjes së fëmijëve prej moshës 3 deri në moshën 6 vjeçare.

Trendi i rritjes së përfshirjes së fëmijëve në institucionet për fëmijë në Republikën e Maqedonisë vazhdon edhe në vitet vijuese. Sipas të dhënave të Entit shtetëror të statistikës në vitin 2016 (gjendja në 30 shtator) në 96 institucione për kujdesin dhe edukimin e fëmijëve – kopshteve shkollore/ qendrave për zhvillimin e hershëm të fëmijëve, numri i përgjithshëm i fëmijëve të përfshirë në edukimin dhe arsimin parashkollor është 34 386, që paraqet

12 Programi nacional për zhvillimin e arsimit në Republikën e Maqedonisë 2005-2015 me dokumentet e bashkëngjitura programore (2006). Shkup: Ministria e Arsimit dhe Shkencës e Republikës së Maqedonisë, faqe 76

13 Ligji për mbrojtjen e fëmijëve. (2013). Shkup: „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë”, nr. 23

rritjen për 5,3% sa i përket 2015, që ka të bëjë me rritjen e kapaciteteve për edukimin dhe arsimin parashkollor për 17,1% në krahasim me vitin 2015.

Si rezultat i disa analiza të bëra të cilat kanë të bëjnë me rrjedhat bashkëkohore në edukimin dhe arsimin parashkollor në vendet e botës, si dhe me qëllim afrimin në rekomandimet e Komisionit Evropian për arsim, e cila tendencë është përfshirja

e fëmijëve në edukimin dhe arsimin parashkollor deri në vitin 2010 të arrijë 95%, ndërsa në bazë të vlerësimeve të bëra për gjendjen momentale të edukimit dhe arsimit parashkollor në vendin tonë, është shqyrtuar nevoja e vazhdimit të këtij trendi pozitiv të rritjes të përfshirjes së fëmijëve në edukimin dhe arsimin fillor parashkollor në Republikën e Maqedonisë.

TABELA 1: NUMRI I FËMIJËVE DHE INSTITUCIONEVE PËR KUJDESIN DHE EDUKIMIN E FËMIJËVE – KOPSHTET SHKOLLORE/QENDRAT PËR ZHVILLIMIN E HERSHËM TË FËMIJËVE - 2016

*Burim: Enti Shtetëror për Statistikë në Republikën e Maqedonisë

	2015		2016		2016 ----- 2015	
	Institucione	Fëmijë	Institucione	Fëmijë	Institucione	Fëmijë
Institucionet publike për kujdesin e fëmijëve - kopshtet e fëmijëve	60	31 874	64	33 238	106,7	104,3
Institucionet private për kujdesin dhe edukimin e fëmijëve - kopshtet e fëmijëve	16	554	19	719	118,8	129,8
Kopshtet shkollore në përbërjen e shkollave private të cilët kanë cilësinë e personit juridik	3	87	4	136	133,3	156,3
Qendrat për zhvillimin e hershëm të fëmijës si subjekte juridike publike	-	-	1	10	-	-
Qendrat për zhvillimin e hershëm të fëmijës si subjekte juridike private	2	139	6	240	300,0	172,7
Kopshtet e fëmijëve në përbërjen e personave juridik për nevojat e të punësuarve në pronën shtetërore	-	-	1	32	-	-
Kopshtet e fëmijëve në përbërjen e personave juridik për nevojat e të punësuarve në pronësinë private	1	6	1	11	100,0	183,3

**TABELA 2: NUMRI I FËMIJËVE NË INSTITUCIONET
PËR KUJDESIN DHE EDUKIMIN – KOPSHTET/
QENDRAT E FËMIJËVE PËR ZHVILLIMIN E
HERSHËM, SIPAS MOSHËS - 2016**

*Burimi: Enti Shtetëror i Statistikës në
Republikën e Maqedonisë

	Gjithsej fëmijë	Fëmijë sipas moshës							
		Deri në 1 vjet	1 vjet	2 vjet	3 vjet	4 vjet	5 vjet	6 vjet	mbi 6 vjet
2015	32 660	628	1 786	3 801	5 912	6 498	8 477	5 508	50
2016	34 386	683	2 593	4 642	7 135	8 266	9 112	1 955	-
2016 ----- 2015	105,3	108,8	145,2	122,1	120,7	127,2	107,5	35,5	-
Fëmijë në periudhën zhvillimore deri në moshën 2 vjeçare	4 620	674	2 554	1 392	-	-	-	-	-
Fëmijë në periudhën 2 vjeçare deri në shkuarjen në shkollë	27 827	-	-	3 145	6 688	7 620	8 489	1 885	-
Grupe të kombinuara	1 149	9	39	86	286	355	342	32	-
Fëmijë me aftësi të kufizuara	174	-	-	19	27	50	60	18	-
Grupe të fëmijëve - Qendra për zhvillimin e hershëm të fëmijëve në përbërjen e kopshteve të fëmijëve	430	-	-	-	88	171	171	-	-
Grupe të pilot - programeve	123	-	-	-	46	48	29	-	-
Grupe për format jashtë institucionale për aktivitetin	63	-	-	-	-	22	21	20	-
Grupe tjera (qëndrimi dhe të ushqyerit)	791	-	-	-	-	-	1	542	248

TABELA 3: PËRFSHIRJA E FËMIJËVE NË INSTITUCIONET PARASHKOLLORE

*Burimi: Ministria e Punës dhe Politikës Sociale

Viti	Institucionet publike	Institucionet private	Qendrat për zhvillim të hershëm të fëmijëve	Gjithsej
2008	22,343	/	/	22,343
2009	22,832	/	/	22,832
2010	23,083	/	800	23,883
2011	25,527	152	790	26,469
2012	27,308	152	1,549	29,999
2013	29,752	437	2059	32,248
2014	30,329	878	2585	33,747
2015	31,998	1362	2959	36,319
2016	34,597	1442	453+1962 publike	38,454

TABELA 4: PËRFSHIRJA E GJENERATAVE (2008-2015)

*Burimi: Ministria e Punës dhe Politikës Sociale

Viti	Fëmijë të moshës prej 0 deri 6 vjeç	Përfshirë fëmijë të moshës prej 0 deri 6 vjeç	%	Fëmijë të moshës prej 3 deri 6 vjeç	Përfshirë fëmijë të moshës prej 3 deri 6 vjeç	%
2008	159,485	22,343	14 %	92,350	14,621	15,5 %
2009	139,455	22,832	16 %	70,560	15,778	22 %
2010	136,155	23,883	17 %	68,500	16,372	24 %
2011	137,213	26,469	19 %	69,700	18,024	26 %
2012	139,959	29,999	21 %	69,884	19,140	27 %
2013	139,951	32,248	23 %	68,2018	24,118	35 %
2014	140,597	33,747	26 %	70,740	24,131	34 %
2015	141,052	36,319	26 %	70,302	24,472	34,5 %
2016	140,443	38,454	27 %	69,809	27,752	40 %

4

EDUKIMI DHE ARSIMI PARASHKOLLOR NË KONTEKSTIN ARSIMOR

EVROPIAN DHE BOTËROR

Vendosja strukturore dhe sistematike

Ndryshimet shoqërore, arritjet e vazhdueshme shkencore, njohuritë e akumuluar nga lëmi i shërbimit pedagogjik – psikologjik dhe teoria e zhvillimit të trurit, nga njëra anë, si dhe tendenca e Republikës së Maqedonisë për pjesëmarrje aktive në proceset globale interaktive, nga ana tjetër, detyrimisht e paraqesin nevojën e përgjegjësisë për rishqyrtimin e politikave globale në sferën e edukimit dhe arsimit parashkollor.

Një numër i madh i dëshmimeve nga hulumtimet e ndryshme shkojnë në bashkëngjitje të faktit se edukimi dhe arsimit cilësor i hershëm është i rëndësishëm për zhvillimin e fëmijëve. Me hulumtimin longitudinal, në kuadër të projektit realizuar në Britaninë e Madhe me temë: „Ndikimi efektiv i edukimit dhe arsimit parashkollor” (Sylva, K., ...2010) kanë ardhur në përfundim se:

- ▲ Përvoja parashkollore, si asnjë tjetër e përmirëson zhvillimin e fëmijës;
- ▲ Në institucionet që e kanë integruar kujdesin me edukimin dhe arsimin parashkollor (sistemi i tërësishëm i edukimit dhe arsimit të fëmijëve) cilësia e edukimit dhe arsimit parashkollor ka qenë më e lartë;

- ▲ Fëmijët janë grupe të ndjeshme që kanë dobi të madhe nga edukimi dhe arsimit cilësor parashkollor, veçanërisht kur janë në grup me fëmijë të kulturave të ndryshme;
- ▲ Edukimi dhe arsimit parashkollor që është me cilësi të lartë kontribuon për zhvillimin më të mirë intelektual dhe social të fëmijëve;
- ▲ Në mjediset ku të punësuarit në kopshte kanë kualifikime më të larta fëmijët përparojnë më tepër ndërsa në mjediset ku zhvillimi arsimor dhe social konsiderohen si komplementare dhe me rëndësi të veçantë, fëmijët më mirë përparojnë për të gjithë aspektet e zhvillimit.

Për shkak të rëndësisë së cilësisë së hershme të edukimit dhe arsimit për zhvillimin e fëmijët në kuadër të sistemit edukativo – arsimor, në 20 vitet e fundit në disa vende të botës edukimi dhe arsimit parashkollor është ngritur në nivelin e prioritetit nacional. Kështu që, pa përjashtim secili vend në Evropë ka parashtruar sistemin e vet të edukimit dhe arsimit parashkollor.

Në pajtim me standardet Ndërkombëtare për kualifikimet e arsimit (ISCED 2011), „Mësimi i hershëm dhe zhvillimi i fëmijëve janë të shënuara me nivelin 0 ISCED 0 që

është i ndarë në dy nën nivele 01 dhe 02. Kryesisht, 01 – zhvillimi dhe arsimit i hershëm i fëmijëve, ku arsimit është i dizajnuar për përkrahjen e zhvillimit të hershëm në përgatitjen e pjesëmarrjes së fëmijëve në shkolla dhe në shoqëri. Programet janë të dizajnuar për fëmijët e moshës nën tre vjeç. Nën nivelin 02 – edukimi apo arsimit parashkollor është i dizajnuar për përkrahjen e mësimin të hershëm dhe zhvillimit në përgatitjen për pjesëmarrjen e fëmijëve në shkollë dhe shoqëri. Programet janë të dizajnuara për fëmijët e moshës 3 vjeçe deri në shkuarjen në shkollën fillore¹⁴.

Në disa shtete evropiane dhe të zhvilluara tjera në botë struktura e edukimit dhe arsimit parashkollor është ndryshe edhe atë është e përshtatur në pajtim me kushtet, nevojat dhe mundësitë e tyre. Shpeshherë nën sistemi i edukimit dhe arsimit parashkollor është i ndarë në dy faza të veçanta varësisht nga mosha e fëmijëve:

- ▲ sistemi unitar apo faza e vetme;
- ▲ sistem i ndarë në dy faza të posaçme.

Sistemi unitar organizohet në një fazë dhe i përfshinë të gjithë fëmijët e moshës parashkollore. Një sistem i tillë është karakteristik për Kroacinë, Slloveninë, Serbinë, Malin e Zi, Bosnjën dhe Hercegovinën dhe disa vende nordike dhe baltike. I tërë kujdesi dhe arsimit konsiderohen si pjesë e „Arsimit të hershëm“, ndërsa Ministria e Arsimit dhe Shkencës për udhëheqjen, rregullimin dhe financimin e saj.

Sistemi i ndarë në dy faza e strukturon edukimin dhe arsimin parashkollor sipas moshës së fëmijëve. Një dallim i tillë është


14 UNESCO Institute for Statistics, *International Classification of Education ISCED 2011*: Montreal, Canada, 2012, p.63

i kushtëzuar nga ndarja ndërmjet kujdesit dhe edukimit, që është karakteristike për fazën e parë dhe arsimin e hershëm të fëmijëve, që e karakterizon fazën e dytë të fëmijëve. Zakonisht tranzicioni prej një periudhe në tjetrën zhvillohet në moshën rreth tre vjeçare, edhe pse jo shpesh paraqitet edhe në moshën prej 2,5 madje në moshën 4 vjeçe në disa vende. Në një sistem të tillë përgjegjësia e udhëheqjes, rregullimi dhe financimi është i ndarë ndërmjet autoriteteve të ndryshme. Ministria e Shëndetësisë, mirëqenies dhe punëve familjare është shpesh herë përgjegjës për pjesën (fazën) e parë, ndërsa Ministria e Arsimit në secilin vend është pa përjashtim përgjegjëse për pjesën (fazën) e parë.

Sipas të dhënave nga Komisioni Evropian/ EACEA/Eurydice/Eurostat, 2014¹⁵ tetë shtete evropiane (Danimarka, Gjermania, Estonia, Malta, Sllovenia, Suedia dhe Norvegjia) garantojnë të drejtë ligjore të edukimit dhe arsimit parashkollor të secilit fëmijë pas lindjes, shpeshherë pas mbarimit të pushimit të lindjes të prindit.

Nga ana tjetër, pothuajse një e treta e sistemit të ri arsimor evropian (tre bashkësi në Belgjikë, Irlandë, Spanjë, Francë, Luksemburg, Hungari, Portugali dhe të gjithë pjesët e Kombeve të Bashkuara) të drejtë ligjore të programit të subvencionuar për edukimin dhe arsimin parashkollor nga mjetet publike kur fëmijët do të mbushin 3 vjet. Zakonisht fëmijët kanë të drejtë për programe pa pagesë për edukimin dhe arsimin parashkollor. Kohëzgjatje e këtyre programeve

15 Evropska komisija/EACEA/Eurydice/Eurostat, 2014. *Ključni podaci o predškolskom odgoju i obrazovanju u Evropi*, Izdanje 2014. g. Izvješće Eurydice i Eurostata. Luksemburg: Ured zapublikacije Evropske unije, str. 12 (Komisioni Evropian / EACEA / Eurydice / Eurostat, 2014. Të dhëna kryesore për arsimin parashkollor dhe edukimin në Evropë, Edition 2014. Raportet Eurydice dhe Eurostat. Luksemburg: Zyra e publikimeve e Bashkimit Evropian, f. 12)



përshtatet me kohëzgjatjen e një dite të zakonshme shkollore, përveç në Irlandë dhe në Kombet e Bashkuara ku të drejtë ligjore të shërbimeve pa pagesë në institucionet parashkollore është përfshirë për 10-15 orë javore.

Sipas burimit të njëjtë, në nëntë shtete janë të obliguar që në dy vitet e fundit në arsimin dhe edukimin parashkollor (Bullgari, Greqi, Qipro, Lituani, Luksemburg, Hungari, Austri, Polaki dhe Zvicër). Ngjashëm me këtë, në Republikën e Çekisë

dhe Sllovakisë dhe në Lihtenshtajn fëmijët kanë të drejtë ligjore të edukimit dhe arsimit parashkollor një apo dy vite para shkuarjes në shkollë. Kohëzgjatja minimale e edukimit dhe arsimit parashkollor në vitin para shkuarjes në shkollë lëviz prej 16 orë deri në 27,5 në javë (Qipro).

Sipas të dhënave të Komisionit evropian/ EACEA/Eurydice/Eurostat, 2014,¹⁶ rezultatet e hulumtimit të PIRLS 2011 tregojnë se fëmijët të cilët gjatë kohë kanë përcjellë programe për edukimin dhe arsimin parashkollor kanë rezultatet më të mira në lexim.

Në Republikën e Serbisë në vitin 2012 është miratuar „Programi përgatitor parashkollor, në Bosnjë dhe Hercegovinë është miratuar „Programi i detyrueshëm për fëmijët në vitet para shkuarjes në shkollë“, që përmban njësi të punës edukative- arsimore, detyra të definuara dhe përmbajtje, ndërsa në Mal të Zi në vitin 2011 Enti i arsimit zbaton „Program të shkurtër për njësitë e aktiviteteve në edukimin dhe arsimin parashkollor – puna me fëmijë në vitin para shkuarjes në shkollë“.

Edukimi dhe arsimit parashkollor në vitin para shkuarjes në shkollë është i detyrueshëm në Kanada, Japoni, Hong Kong dhe Australi.

Dr. Kristina Stiven në publikimin: „Insajti 28, Arsimit në moshën e hershme: Perspektivat e fituara me pasqyrimin e literaturës ndërkombëtare“ (Dr. **Christine Stephen**, 2006) komenton se në bazën e të gjithë programeve për edukimin dhe arsimin fillor parashkollor në Evropë dhe Amerikën Veriore si dhe qasjet e ndryshme pedagogjike kah edukimi dhe arsimit parashkollor gjenden disa vlera dhe parime të përbashkëta:

- ▲ Baraspesha ndërmjet mësimit që e inicion vetë fëmijën dhe udhëheqjen e edukatorit;
- ▲ Mundësitë që fëmijët të bëjnë zgjedhje me kuptim në kuadër të aktiviteteve të ofruara;

- ▲ Mundësitë e hulumtimit përmes pjesëmarrjes aktive;
- ▲ Ndryshimi i aktiviteteve në grupe të vogla, grupi në përgjithësi dhe aktiviteteve individuale;
- ▲ Loja si mënyrë primare (por jo edhe veçantë) për mësim;
- ▲ Të rriturit tregojnë, pyesin, formësojnë, propozojnë alternativa dhe nxisin rikontrollim;
- ▲ Vëzhgimi sistematik i mësimit dhe sjelljes së fëmijëve;
- ▲ Mësimi aktiv apo mësimi me përvojë;
- ▲ Respektimi i aftësive të fëmijëve të udhëheqin me procesin individual të mësimit dhe raportet e ndërgjegjshme ndërmjet fëmijëve dhe të moshuarve si vlerë esenciale e mësimit.

Njëherë, karakteristikë për të gjithë shtetet evropiane është ajo që veprimtaria e edukimit dhe arsimit parashkollor është rregulluar sipas ligjit për edukimin dhe arsimin parashkollor edhe kjo paraqet pjesë integrale të sistemit në përgjithësi të edukimit dhe arsimit. Ministria e Arsimit është e vetmja kompetencë për udhëheqje, rregullim dhe financim. Në atë mënyrë në vendet evropiane sigurohet ndërlidhje funksionale e parashkollorës me edukimin dhe arsimin parashkollor.

¹⁶ Evropska komisija/EACEA/Eurydice/Eurostat, 2014. Ključni podaci o predškolskom odgoju i obrazovanju u Evropi, Izdanje 2014. g. Izvješće Eurydice i Eurostata. Luksemburg: Ured za publikacije Europske unije, str.13 (

**TABELA 5: VENDET NË TË CILËT EKZISTON
RREGULLATIVA LIGJORE PËR EDUKIMIN DHE
ARSIMIN E DETYRUESHËM PARASHKOLLOR**

Finlanda	Edukimi dhe arsimi parashkollor i detyrueshëm është aplikuar prej vitit 2013.
Malta	Edukimi dhe arsimi parashkollor i detyrueshëm është aplikuar prej vitit 2013.
Polonia	Edukimi dhe arsimi parashkollor i detyrueshëm është aplikuar prej vitit 2013.
Hungaria	Edukimi dhe arsimi parashkollor i detyrueshëm për fëmijët e moshës 4 vjeç.
Suedia	Edukimi dhe arsimi parashkollor i detyrueshëm në kohëzgjatje prej 525 orësh.
Zvicra	Në 19 kantone në kohëzgjatje prej një deri në dy vjet fëmijët detyrimisht vizitojnë edukimin dhe arsimin parashkollor, ndërsa në shtatë kantone tjera ku arsimi parashkollor nuk është i detyrueshëm, fëmijët e moshës prej 4 deri në 5 vjet kanë vend të garantuar në kopsht.
Bullgaria	Arsim të detyrueshëm parashkollor për fëmijët e moshës 4 deri në 6 vjet. (Fëmijë të moshës 4 vjeçe 20 orë në javë, fëmijë të moshës 5 vjeçe 25 orë në javë)
Austria	Edukimi dhe arsimi parashkollor. (Numri i javëve të detyrueshme lëviz nga komuna në komunë.)
Kroacia	Edukimi dhe arsimi parashkollor i detyrueshëm për fëmijët e moshës 5 vjeç.

STANDARDET E SIGURIMIT TË CILËSISË

Njëra nga çështjet kryesore për sigurimin e cilësisë së punës edukative – arsimore me fëmijët e moshës parashkollore është edhe numri i fëmijëve në grupet edukative, përkatësisht raporti fëmijë – i rritur.

Në vendet evropiane shpesh herë numri maksimal i fëmijëve sipas personit të rritur është 1:8 për fëmijët deri në 18 muaj; 1:10 për fëmijët e moshës 3 vjeçare, ndërsa për fëmijët mbi moshën 3 vjeçe zakonisht ky numër dyfishohet (Çekia deri në 28 fëmijë në grup, Qiproja numri maksimal i fëmijëve është 24, përkatësisht 28 fëmijë me një edukator për fëmijët e moshës prej 3 – 4

vjeç, në Zvicër numri maksimal i fëmijëve në grupe është 24). Edukatorët zakonisht kanë orarin e punës prej 40 orë në javë, prej të cilëve në punën e drejtpërdrejtë me fëmijët kalojnë 35 orë, ndërsa tjerët 5 orë i përdorin, prej të cilëve në punën e drejtpërdrejtë me fëmijët kalojnë 35 orë, ndërsa tjerët 5 orë i përdorin për refleksionin dhe planifikimin kolaborativ.

Në Republikën e Maqedonisë numri maksimum i fëmijëve sipas grupeve edukative është i rregulluar me Ligjin e mbrojtjes së fëmijëve.

TABELA 6: NUMRI MAKSIMAL I FËMIJËVE SIPAS GRUPEVE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË NË PAJTIM ME LIGJIN PËR MBROJTJEN E FËMIJËVE

Mosha	Numri i fëmijëve
Deri në 12 muaj	Prej 6 deri në 8 fëmijë
Mbi 12 deri më 18 muaj	Prej 6 deri në 8 fëmijë
Mbi 18 muaj në 2 vjeç	Prej 8 deri në 10 fëmijë
Prej 2 deri në 3 vjeç	Prej 10 deri në 12 fëmijë
Prej 3 deri në 4 vjeç	Prej 12 deri në 15 fëmijë
Prej 4 deri në 5 vjeç	Prej 18 deri 20 fëmijë
Mbi 5 deri në 6 vjeç	Prej 20 deri më 25 fëmijë

Puna në kopshtet e fëmijëve mund të organizohet edhe në *grup heterogjen* edhe atë: deri në dy vjet prej 10 deri në 12 fëmijë; si dhe prej dy vitesh deri në shkuarjen në shkollë prej 18 deri në 20 fëmijë. Më tutje, në *grupin e kombinuar*–prej 12 muajsh deri në shkuarjen në shkollë fillore prej 15 deri më 20 fëmijë; grupi i fëmijëve me pengesa në zhvillim prej 5 deri më 8 fëmijë dhe grupi i fëmijëve me pengesa në zhvillim, përkatësisht nga shkuarja në shkollën fillore deri më dhjetë vite prej 20 deri më 30 fëmijë.

Edhe pse ekziston Rregullativa për numrin maksimum të fëmijëve sipas grupeve të edukatorëve, megjithatë hulumtimi ynë tregon se ajo nuk respektohet në praktikë. Shpeshherë numri i fëmijëve sipas grupeve edukative është dy deri më tre herë më i madh nga dispozitat ligjore. Kjo, gjithashtu ka ndikim mbi uljen e cilësisë së punës edukative – arsimore me fëmijët e moshës parashkollore. Orari i punës së edukatorëve në Republikën e Maqedonisë është 40 orë në javë, prej të cilëve 30 orë kalojnë në punën e drejtpërdrejtë me fëmijët. 10 orët tjera shfrytëzohen për planifikimin dhe përgatitjen e punës edukative- arsimore.

Sa i përket nënsistemit të edukimit dhe arsimit parashkollor karakteristikë është ajo që Republika e Maqedonisë është vendi i vetëm ku nuk ekziston ligj i edukimit dhe arsimit parashkollor. Në këtë moment veprimtaria është e rregulluar me Ligjin për mbrojtjen e fëmijëve dhe edukimi si

dhe kujdesi parashkollor është jo i obliguar, ndërsa përfshirja e fëmijëve krahasuar me përfshirjen e vendeve tjera të Evropës ende është në nivelin më të ulët (edhe pse në vitet e fundit shënohet rritje e vogël). Një vendosje e tillë e sistemit të edukimit dhe arsimit parashkollor në Republikën e Maqedonisë rezulton me lënien pas dore të arsimit të hershëm të fëmijët e moshës parashkollore dhe dominimi absolut i kujdesit dhe edukimit.

Me qëllim ngritjen e cilësisë së arsimit të hershëm deri në moshën 6 vjeçare, në periudhën që vijon domosdo është miratimi i ligjit për edukimin dhe arsimin parashkollor, aplikimi i vitit të detyrueshëm përgatitor për fëmijët e moshës 4 deri më 6 vjeçare dhe mundësia e transferit të kompetencave ndaj Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës.

...the first of these is the fact that the ...

...the second of these is the fact that the ...

...the third of these is the fact that the ...

...the fourth of these is the fact that the ...

...the fifth of these is the fact that the ...

...the sixth of these is the fact that the ...

...the seventh of these is the fact that the ...

...the eighth of these is the fact that the ...

...the ninth of these is the fact that the ...

...the tenth of these is the fact that the ...

...the eleventh of these is the fact that the ...

...the twelfth of these is the fact that the ...

...the thirteenth of these is the fact that the ...

...the fourteenth of these is the fact that the ...

...the fifteenth of these is the fact that the ...

...the sixteenth of these is the fact that the ...

...the seventeenth of these is the fact that the ...

...the eighteenth of these is the fact that the ...

PJESA II

METODOLOGJIA E HULUMTIMIT

1. Lënda
2. Nocionet themelore
3. Qëllimet dhe karakteri i hulumtimit
4. Detyrat
5. Hipotezat
6. Variablat
7. Metodot, teknikat dhe instrumentet
8. Ekzemplari
9. Përpilimi i të dhënave
10. Organizimi dhe vijimi i hulumtimit

... the ...

... the ...

... the ...

... the ...

... the ...

... the ...

... the ...

... the ...

... the ...

... the ...

... the ...

... the ...

1

LËNDA E HULUMTIMIT

Ndërhyrjet e shumta reformuese të cilat vitet e fundit janë realizuar në edukimin dhe arsimin parashkollor në Republikën e Maqedonisë e imponoj nevojën e këtij hulumtimi. Qëllimi është të shqyrtohet gjendja aktuale dhe sfidat bashkëkohore të shikuara përmes prizmit të praktikës pedagogjike në entet parashkollore (kopshtet e fëmijëve/Qendrat për zhvillimin e hershëm të fëmijëve) që të ndërmerren hapa konkret për ndryshime kualitative sistemore në edukimin dhe arsimin parashkollor të fëmijëve të moshës prej 4 deri në 6 vjeç. Gjithashtu, duke i pasur parasysh aktivitetet e ndërmarra nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë për hapjen e kopshteve të reja publike, përkrahjen për hapje të kopshteve private dhe formave të tjera të kujdesit, edukimit dhe arsimit të fëmijëve të moshës parashkollore.

Interesi shkencor është i orientuar drejt fitimit të një pasqyre reale për gjendjen në entet parashkollore, më konkretisht: mënyrën se si aplikohen dhe respektohen aktet normative ligjore dhe shkencore me të cilat rregullohet puna në entet parashkollore, cilësia e planifikimit të aktiviteteve edukativo-arsimore me fëmijët e moshës prej 4 deri në 6 vjeç; qëndrimet dhe mendimet e pedagogëve dhe edukatorëve në lidhje me: Standardet

për mësim dhe zhvillim të hershëm të fëmijëve prej 0 deri në 6 vjeç (të aprovuar në vitin 2009); qëndrimet dhe mendimet e edukatorëve në lidhje me realizimin e Programit për mësim dhe zhvillim të hershëm si dokument oficial për veprimtarinë edukativo-arsimore në edukimin dhe arsimin parashkollor; cilësia e planifikimit të punës edukativo-arsimore i përputhur me nevojat individuale, mundësit dhe aftësitë e fëmijëve të moshës prej 4 deri në 6 vjeç; qëndrimet dhe mendimet e pedagogëve dhe edukatorëve në lidhje me evidencën dhe dokumentacionin pedagogjik që mbahet në entet parashkollore; qëndrimet dhe mendimet e edukatorëve në lidhje me kompetencat e tyre dhe nevojave për zhvillim profesional në entet parashkollore.

Hulumtimi i këtij problemi, konform nevojave të edukimit dhe arsimit në vend dhe transparent dhe konkurrent në suaza ndërkombëtare, ka rëndësi të madhe për përcaktimin e nevojës për avancimin e cilësisë së edukimit dhe arsimit përmes avancimit të programit për punën edukativo-arsimore me fëmijët e moshës parashkollore, me theks të veçantë të fëmijët e moshës prej 4 deri në 6 vjeç dhe përforcimin e lidhjes funksionale përmes edukimit dhe arsimit parashkollor të fëmijëve prej 4 deri në 6 vjeç dhe edukimit dhe arsimit fillor.

Puna në entet parashkollore është e rregulluar me Strategjinë për zhvillimin e arsimit 2005-2015, Projekt-versionin e Strategjisë për zhvillimin e arsimit 2017-2020, Ligjin për mbrojtjen e fëmijëve, Ligjin e Byrosë së Zhvillimit të Arsimit dhe Ligjit për Inspektoratin Arsimor.

Ky hulumtim ka tendencë ta tregoj situatën reale në praktikën edukativo-arsimore në entet parashkollore dhe të jep përgjigje të mundshme për atë se në çfarë drejtimi në të ardhmen duhet të zhvillohen strategjitë ligjore, bazat programore për punë në entet parashkollore me qëllim të avancimit dhe përforsimit të lidhjes funksionale në mes edukimit dhe arsimit parashkollor të fëmijëve të moshës prej 4 - 6 vjeç dhe edukimit dhe arsimit në shkollimin fillor, në pajtim me trendet evropiane dhe botërore.

Prej këtu lëndë e hulumtimit është të vërtetohet si planifikohet dhe realizohet puna edukativo-arsimore në entet parashkollore (analiza e Standardeve për mësim dhe zhvillim të hershëm si dhe Programit për mësim dhe zhvillim të hershëm), cilat janë dobësitë dhe sfidat eventuale dhe të jepen rekomandime për ndryshimet e nevojshme për përmirësimin e cilësisë së Standardeve për mësim dhe zhvillim të fëmijët prej 0 deri në 6 vjeç, Programit për mësim dhe zhvillim të hershëm të fëmijët e moshës parashkollore, me theks të veçantë të fëmijët e moshës prej 4 - 6 vjeç, si dhe të shqyrtohet nevoja e aplikimit të vitit përgatitor të obligueshëm për fëmijët e moshës prej 4 - 6 vjeç.

Duke u nisur nga definimi i këtillë i lëndës, hulumtimi është bazuar në:

1. **Analizën e dokumenteve ligjore nga fusha e edukimit dhe arsimit parashkollor:**
 - ▲ Ligjin e Mbrojtjes së fëmijëve;
 - ▲ Ligjin e Byrosë së zhvillimit të arsimit;
 - ▲ Ligjin e Inspektoratit të arsimit.
2. **Analiza e dokumenteve programore dhe nacionale në të cilat bazohet puna edukativo-arsimore:**
 - ▲ Strategjia për zhvillimin e arsimit 2005-2015;
 - ▲ Projekt - versioni i Strategjisë për zhvillim të arsimit 2007-2020;
 - ▲ Standardet për mësim dhe zhvillim të hershëm për fëmijët prej 0 - 6 vjeç;
 - ▲ Programi për mësim dhe zhvillim të hershëm;
 - ▲ Raportet nga mbikëqyrja profesionale në punën edukativo-arsimore në kopshte;
 - ▲ Qëllimet edukative-arsimore në mësimin e matematikës, shkencave natyrore, arsimit figurativ dhe muzikor në programet muzikore për klasën e parë të shkollimit fillor nëntëvjeçar.
3. **Kontrollimi i qëndrimeve dhe mendimeve të drejtorëve, pedagogëve dhe edukatorëve si pjesëmarrës të drejtpërdrejtë në procesin edukativo-arsimor në entet parashkollore në lidhje me nevojën e rishqyrtimit të Standardeve për mësim dhe zhvillim të hershëm dhe Programit për mësim dhe zhvillim të hershëm, me theks në fushat Gjuhë, komunikim dhe zhvillim të shkrim-leximit dhe arritjen e njohurive të përgjithshme dhe Arti.**

4. Kontrollimi i qëndrimeve dhe mendimeve të drejtorëve, pedagogëve dhe edukatorëve si pjesëmarrës të drejtpërdrejtë në procesin edukativo-arsimor në entet parashkollore në lidhje me ngritjen e cilësisë së punës edukative-arsimore dhe aplikimin e vitit përgatitor për fëmijët e moshës prej 4 deri në 6 vjet.
5. Kontrollimi i qëndrimeve dhe mendimeve të pedagogëve të shkollave dhe mësimdhënësve klasor të cilët realizojnë mësim në klasën e parë në vitin shkollor 2016/2017 në Republikën e Maqedonisë, në lidhje me nevojën e aplikimit të vitit përgatitor të detyrueshëm për fëmijët e moshës prej 4 - 6 vjeç.
6. Kontrollimi i qëndrimeve dhe mendimeve të prindërve në lidhje me nevojën e aplikimit të vitit përgatitor të detyrueshëm për fëmijët e moshës prej 4 - 6 vjeç në drejtim të lidhjes funksionale të edukimit dhe arsimit parashkollor dhe atij shkollor.

2 DEFINIMI I NOCIONEVE THEMELORE TË PËRFSHIRA NË LËNDËN E HULUMTIMIT

Puna edukative-arsimore

Për realizimin me sukses të procesit edukativo-arsimor për të gjitha nivelet e arsimit përgatitet Program për punën edukativo-arsimore. Në rastin konkret bëhet fjalë për Program për mësim dhe zhvillim të hershëm të fëmijëve të enteve parashkollore (çerdhe publike dhe private dhe qendrat për zhvillim të hershëm për fëmijët në entet parashkollore). Programi për mësim dhe zhvillim paraqet dokument me të cilët rregullohet puna e përgjithshme edukativo-arsimore në entet parashkollore (kopshte publike dhe private dhe qendrat për zhvillim të hershëm për fëmijët në entet parashkollore). Programi për mësim dhe zhvillim të hershëm ka qëllime globale që kanë të bëjnë me tërë periudhën e zhvillimit të fëmijës prej 0 - 6 vjeç; qëllime konkrete, të definuar për çdo moshë dhe fushë edukative-arsimore në veçanti, të cilët më tutje operacionalizohen në aktivitete dhe përmbajtje konkrete edukative-arsimore, që planifikohen dhe realizohen nga edukatorët. Qëllimi final është të arrihen rezultatet e pritura nga Programi për mësim dhe zhvillim të hershëm. Varësisht modelit të programit, edukatori planifikon dhe bën përzgjedhje të formave organizative, metodave dhe mjeteve, të cilat më tutje i përdor në punën edukative-arsimore me fëmijët.

Në këtë hulumtim themelor janë nocionet vijuese:

- ▲ Puna edukative-arsimore;
- ▲ Fëmijë të moshës prej 4 - 6 vjeç;
- ▲ Enti parashkollor..

Fëmijët e moshës prej 4 deri 6 vjeç

Për nevojat e këtij hulumtimi nocioni fëmijë i moshës prej 4 deri 6 vjeç do të sqarohet si fëmijë të cilët janë inkuadruar në sistemin e organizuar të edukimit parashkollor dhe arsimit në entet parashkollore (kopshte publike dhe private dhe qendrat për zhvillim të hershëm për fëmijët në entet parashkollore) edhe atë prej moshës 4 vjeçare deri në fillimin e shkollës.

Enti parashkollor

Enti parashkollor është nocion shumë i njohur dhe shënon organizatë për kujdes, edukim dhe arsimim të fëmijëve të moshës parashkollore. Ai paraqet institucion me veprimtari të interesit të veçantë shoqëror.

Në atë zhvillohet procesi i vazhdueshëm edukativo-arsimor, varësisht bazave programore, moshës së fëmijëve dhe nevojave të tyre si dhe natyrës së zhvillimit të tyre psikofizik. Detyra themelore e entit parashkollor është në pajtim me njohuritë shkencore të zhvillimit dhe mësimin, të gjithë fëmijëve t'iu mundësohet plotësimi i nevojave aktuale, fitimin e njohurive, përvojave dhe shkathtësive për adaptim dhe shkollim të mëtutjeshëm në arsimin fillor.

3 QËLLIMI DHE KARAKTERI I HULUMTIMIT

Qëllimi i hulumtimit

Qëllimi themelor i hulumtimit është të përcaktohet se si planifikohet dhe realizohet puna edukative – arsimore në institucionet parashkollore (analiza e Standardeve për mësimin e hershëm dhe zhvillimin e Programit për mësimin dhe zhvillimin e hershëm) që janë dobësi eventuale dhe sfida, dhe të jep rekomandime në lidhje me ndryshimet e nevojshme për përmirësimin e cilësisë së Standardeve për mësimin e hershëm dhe zhvillimin e fëmijëve prej moshës 0 deri më 6 vjeç. Programi për mësimin e hershëm dhe zhvillimin e fëmijëve të moshës parashkollore, me theks të veçantë të fëmijëve prej moshës 4 - 6 vjeç, si dhe të shqyrtohet nevoja e aplikimit të vitit përgatitor të detyrueshëm për fëmijët e moshës prej 4 - 6 vjeç.

Karakteri i hulumtimit

Sipas karakterit ky hulumtim është:

- ▲ **bashkëkohorë**, meqë merret me problemin aktual dhe kompleks për praktikën pedagogjike, por edhe me progresin e tërësishëm shoqëror;
- ▲ **empirik**, meqë problemi analizohet me hulumtimin e drejtpërdrejtë të gjendjes momentale dhe ndikimit të institucioneve kompetente mbi planifikimin dhe realizimin e procesit edukativo – arsimor në institucionet parashkollore;
- ▲ **deskriptive, cilësore dhe sasiore**, meqë realizohet me zbatimin e qasjes cilësore dhe kuantitative dhe teknikat adekuate të hulumtimit, që mundëson fitimin e të dhënave adekuate për lëndën e hulumtimit me qëllim studimin e saj më të detajuar sasiore.

4 DETYRAT E HULUMTIMIT

Qëllimi i hulumtimit është konkret përmes detyrave **vijuete**:

- ▲ analiza e rregullativës ekzistuese dhe dokumentet programore në të cilët bazohet puna edukative arsimore në institucionet parashkollore në Republikën e Maqedonisë;
- ▲ analiza e qëllimeve edukative – arsimore në programet mësimore në matematikë, shkencat natyrore, arsim figurativ dhe arsim muzikor për klasën I në arsimin fillor nëntëvjeçarë;
- ▲ hulumtimi i mendimit të edukatorëve dhe pedagogëve në lidhje me standardet dhe indikatorët e dhënë për secilin aspekt të zhvillimit, të parapara me dokumentin Standardet për mësimin e hershëm dhe zhvillimin të fëmijët prej moshës 0 deri më 6 vjet;
- ▲ vëzhgimet e nevojës për përmirësimin e cilësisë së programit për mësimin e hershëm dhe zhvillimin e punës edukative arsimore me fëmijët e moshës prej 4 - 6 vjeç me theks të veçantë në lëmin e gjuhës, komunikimi dhe zhvillimi i shkrim – leximit, zhvillimi kognitiv dhe të arriturat e njohurive të përgjithshme dhe Arti;
- ▲ konfirmimi i mendimit të edukatorëve dhe pedagogëve për nevojën e cilësisë së evidencës aktuale pedagogjike dhe dokumentacioni;
- ▲ shqyrtimi i nevojave për aftësimin profesional të edukatorëve dhe pedagogëve nga institucionet parashkollore dhe nevoja konkrete e përkrahjes profesionale – këshillëdhënëse nga ana e këshilltarëve të BZHA;
- ▲ shqyrtimi i mendimit të edukatorëve dhe pedagogëve në lidhje me arsyet që e vështirësojnë realizimin e qëllimeve të Programit për mësimin e hershëm dhe zhvillimin për fëmijët prej moshës 4 deri në moshën 6 vjeçare;
- ▲ shqyrtimi i mendimeve dhe qëndrimeve të pedagogëve dhe mësimeve klasor në lidhje me nevojën e aplikimit të vitit detyrues përgatitor;
- ▲ konfirmimi se vallë ekziston dallimi i mendimeve të edukatorëve dhe mësimeve klasor nga shkollat fillore në raport me përgatitjen e fëmijëve për kalimin e suksesshëm nga institucioni parashkollor në shkollë fillore;
- ▲ analiza e qëndrimeve dhe mendimeve të prindërve për nevojën e aplikimit të vitit të detyrueshëm përgatitor për fëmijët e moshës prej 4 deri 6 vjeç dhe ndërlihdhja funksionale e edukimit dhe arsimit parashkollor me arsimin fillor.

5 HIPOTEZAT E HULUMTIMIT

Hipoteza e përgjithshme

Praktikantët në entet parashkollore mendojnë se Standardet për mësim dhe zhvillim të hershëm janë të ngarkuara me mangësi, kurse realizimi i punës edukativo-arsimore me fëmijët e moshës parashkollore, me theks të veçantë në moshën prej 4 - 6 vjeç, e pengojnë më tepër faktor dhe shkaktarë.

Hipotezat e veçanta

1. Ekziston nevoja për aprovimin e ligjit për edukim dhe arsim parashkollor në Republikën e Maqedonisë, në funksion të avancimit të cilësisë të veprimtarisë edukativo-arsimore në entet parashkollore dhe sigurimin e lidhjes funksionale me shkollimin fillor.
2. Nuk ekziston përputhshmëri e plot e qëllimeve në Programin për mësim dhe zhvillim të hershëm (Gjuhë, komunikim dhe zhvillim të shkrim-leximit, Zhvillimi kognitiv dhe fitimi i njohurive të përgjithshme, arti) dhe qëllimeve në programin mësimor nga matematika, shkencat natyrore, arsimit figurativ dhe muzikor për klasën e parë të shkollimit fillor nëntëvjeçar.
3. Ekziston nevoja për rishqyrtimin e Standardeve për mësim dhe zhvillim të fëmijët prej 0 deri në moshën 6 vjeçare.
4. Ekziston nevoja për përmirësimin e Programit për mësim dhe zhvillim të hershëm të bazuar në Standardet për mësim dhe zhvillim të hershëm në drejtim të përputhshmërisë së qëllimeve në dokumentin programor për moshën më të madhe parashkollore dhe qëllimet në programet mësimore në klasë të parë.
5. Ekziston nevoja për rishqyrtimin e evidencës dhe dokumentacionit pedagogjik aktual në entet parashkollore.
6. Pedagogët dhe edukatorët kanë nevojë për përkrahje të vazhdueshme profesional-këshilluese nga ana e këshilltarëve të Byrosë së zhvillimit të arsimit.
7. Pedagogët dhe edukatorët kanë qëndrim se eksitojnë më tepër shkaqe që e pengojnë realizimin e qëllimeve të Programit për mësim dhe zhvillim të hershëm.
8. Nuk ekziston dallimi i madh statistikor në qëndrimet dhe mendimet e edukatorëve në kopshte dhe arsimtarëve klasor në lidhje me aplikimin e vitit përgatitor të obligueshëm.
9. Ekziston dallim në mendimet e edukatorëve nga entet parashkollore dhe arsimtarët klasor në relacion me pritshmëritë e tyre për përgatitjen e fëmijëve për kalim të suksesshëm nga enti parashkollor në shkollën fillore.
10. Prindërit kanë mendim pozitiv në lidhje me aplikimin e vitit përgatitor për fëmijët e moshës prej 4 deri në 6 vjeç në drejtim të lidhjes funksionale të edukimit dhe arsimit parashkollor me atë shkollor.

6 VARIABLAT E HULUMTIMIT

Në këtë hulumtim si variabla të pavarura paraqiten:

Standardet për mësim dhe zhvillim të hershëm të fëmijët prej 0 deri në 6 vjeç, Programi për mësim dhe zhvillim të hershëm, dokumentet ligjore dhe nacionale nga fusha e edukimit dhe shkollimit parashkollor dhe karakteristikat individuale të drejtorëve, pedagogëve dhe prindërve të fëmijëve nga entet parashkollore, si dhe karakteristikat individuale të pedagogëve dhe arsimtarëve klasor të shkollimit fillor.

Variabla të ndryshueshme në këtë hulumtim janë:

Qëndrimet dhe mendimet e drejtorëve, pedagogëve, edukatorëve dhe prindërve të fëmijëve nga entet parashkollore në lidhje me Standardet për mësim dhe zhvillim të hershëm të fëmijët prej 0 deri në 6 vjet, Programi për mësim dhe zhvillim të hershëm, si dhe në lidhje me mënyrën e planifikimit dhe realizimit të punës edukativo-arsimore dhe nevojës për aplikimin e vitit përgatitor të obligueshëm, respektivisht qëndrimet dhe mendimet e

edukatorëve dhe arsimtarëve klasor nga shkollat fillor në relacion me përgatitjen e fëmijëve për kalim të suksesshëm nga enti parashkollor në shkollë fillore, si dhe qëndrimet dhe mendimet e prindërve të fëmijëve për nevojën e aplikimit e vitit përgatitor të obligueshëm për fëmijët e moshës nga 4 deri në 6 vjeç dhe lidhje funksionale e edukimit dhe shkollimit parashkollor me atë shkollorë.

7 METODAT, TEKNIKAT DHE INSTRUMENTET E HULUMTIMIT

7.1. Metodatat e hulumtimit

Me qëllim që të sigurohen njohuri shkencore kualitative, në këtë hulumtim, janë aplikuar metoda e analizës teorike, metoda komparative dhe deskriptive.

Duke u nisur nga lënda e hulumtimit, qëllimit, detyrave dhe hipotezave, me tendencë të fitohen të dhëna relevante janë përdorur teknikat dhe instrumentet vijuese:

7.2. Teknikat hulumtuese

- ▲ analiza e dokumentacionit;
- ▲ anketimi;
- ▲ fokus grupet;

Analiza e dokumentacionit

Gjatë hulumtimit është bërë analizë e më tepër dokumenteve pedagogjike, më konkretisht:

- ▲ Analiza e dokumenteve ligjore dhe strategjike arsimore të cilat e trajtojnë problematikën e punës edukative-arsimore në entet parashkollore;
- ▲ Analiza e standardeve dhe indikatorëve të aspekteve të zhvillimit (domenit) në *Standardin për mësim dhe zhvillim të hershëm të fëmijët prej 0 deri në 6 vjeç*;
- ▲ Analiza e qëllimeve të Programit për mësim dhe zhvillim të hershëm;

- ▲ Analiza e qëllimeve edukative-arsimore në mësimin nga matematika, shkencat natyrore, arsimit figurativ dhe muzikor në programet mësimor për klasën e parë të shkollimit fillor nëntëvjeçar.

Anketa

Në hulumtim është përdorur teknika e anketimit, me qëllim që të njihen qëndrimet dhe mendimet e edukatorëve, prindërve, pedagogëve nga entet parashkollore dhe mësimdhënësit klasor dhe pedagogët nga shkollat fillore, në lidhje me nevojën për rishqyrtimin e Programit për mësim dhe zhvillim të hershëm, përcaktimin e arsyeve që e pengojnë realizimin e qëllimeve të Programit për mësim dhe zhvillim të hershëm, si dhe nevojën për aplikimin e vitit përgatitor të obligueshëm për lidhjen funksionale të programeve për arsim parashkollor dhe shkollor.

Fokus grupet

Gjatë hulumtimit disa nga të dhënat janë fituar edhe përmes organizimit të fokus grupeve me edukatorë.

Temat themelore për të cilat bëhej debat në fokus grupet:

- ▲ nevoja e rishqyrtimit të Standardeve për mësim dhe zhvillim të hershëm dhe Programit për mësim dhe zhvillim të hershëm;

- ▲ planifikimi dhe mbajtja e evidencës dhe dokumentacionit pedagogjik – kushtet dhe pengesat për realizimin kualitativ të punës edukativo-arsimore në çerdhet publike;
- ▲ shkaqet që e pengojnë realizimin e qëllimeve të Programit për mësim dhe zhvillim të hershëm;
- ▲ aftësimi profesional i edukatorëve për realizimin e Programit për mësim dhe zhvillim të hershëm, implementimi i drejtë i Standardeve për mësim dhe zhvillim të hershëm, si dhe aftësimi i edukatorëve për ndjekje të të arriturave të fëmijëve, si bazë për planifikim të mëtutjeshëm, e bazuar në nevojat, interesat dhe mundësit e fëmijëve të moshës parashkollore;
- ▲ nevoja e ofrimit të përkrahjes së vazhdueshme profesional-këshilluese të edukatorëve nga ana e këshilltarëve të Byrosë së Zhvillimit të Arsimit me qëllim të avancimit të punës edukativo-arsimore në entet parashkollore.

8 EKZEMPLARI I HULUMTIMIT

Për nevojat e hulumtimit në drejtim të analizës gjithëpërfshirëse dhe të detajuar janë përfshirë më tepër lloje të ekzemplarëve: *Ekzemplarë të enteve parashkollore (çerdhe dhe qendra për zhvillim të hershëm të fëmijëve), ekzemplarë të drejtorëve, ekzemplarë të pedagogëve, ekzemplarë të mësimeve në klasor dhe pedagog në shkollat fillore.* Kjo është me rëndësi që të mund të trajtohen paralelisht më tepër propozime dhe sugjerime në drejtim të përmirësimit të cilësisë të edukimit dhe arsimit parashkollor në Republikën e Maqedonisë.

Ekzemplari është konstruktuar sipas zgjedhjes së rastit dhe paraqet kornizë të shkëlqyeshme fillestare për përgjithësimin e të dhënave.

Struktura e ekzemplarëve të përmendur është prezantuar në disa tabela.

Ekzemplar i enteve parashkollore – kopshte/ Qendra për zhvillim të hershëm të fëmijëve

Ekzemplari i enteve parashkollore është përcaktuar në bazë të zgjedhjes së rastit dhe janë zgjedhur 20 ente parashkollore-çerdhe nga njëmbëdhjetë qytete në Republikën e Maqedonisë, në mjedise me shkallë të ndryshme të zhvillimit, me të vetmin qëllim- të fitohen të dhëna relevante për lëndën e hulumtimit.

TABELA 7: STRUKTURA E EKZEMPLARIT TË KOPSHTEVE SIPAS QYTETEVE

Enti parashkollor	Vendi	Komuna
„Orce Nikolov“	Shkup	Karposh
„Majski Cvet“	Shkup	Karposh
„Rosica“	Shkup	Gjorçe Petrov
„Detska radost,,	Shkup	Gazi Babë
„25 Maji “	Shkup	Gazi Babë
„Srnička“	Shkup	Aerodrom
„Veseli cvetovi “	Shkup	Kisella Vodë
„Fidani“	Shkup	Çair
„Borëbardha“	Shkup	Çair
„Rade J. Korçagin“	Shkup	Qendër
„Mlladost“	Tetovë	Tetovë
„Prolet“	Gostivar	Gostivar
„Jasna Risteska“	Ohër	Ohër
„Nasha idnina“	Prilep	Prilep
„Estera O. Maja“	Manastir	Manastir
„Dimçe Mirçev“	Veles	Veles
„Angel Shajçe“	Kumanovë	Kumanovë
„Astibo“	Shtip	Shtip
„23 Gusht“	Berovë	Berovë
„Detska radost“	Gjevgjeli	Gjevgjeli

Ekzemplari i enteve parashkollore-qendrat për zhvillim të hershëm të fëmijëve

Ekzemplari i qendrave për zhvillim të hershëm të fëmijëve është, gjithashtu, i

përcaktuar sipas zgjedhjes së rastit. Atë e përbëjnë katër qendra për zhvillim të hershëm të fëmijës nga Shkupi dhe nga qytete tjera të Republikës së Maqedonisë.

Struktura e ekzemplarit është paraqitur në tabelën vijuese.

TABELA 8: STRUKTURA E EKZEMPLARIT E QENDRAVE PËR ZHVILLIM TË HERSHËM TË FËMIJËVE SIPAS QYTETEVE

Qendra për zhvillimin e hershëm të fëmijës	Komuna	Vendi
Detska radost	Gostivar	Fshati Debresh
Mlladost	Tetovë	Fshati Falishtë
Angel Shajçe	Kumanovë	SHF „11 Tetori“
Astibo	Shtip	Lagjja „Radinski Pat“

Ekzemplari i pedagogëve

Në drejtim të shqyrtimit të plotë dhe real të situatës aktuale në entet parashkollore, me hulumtimin do të përfshihen 15 pedagog nga çerdhet.

Ekzemplari i edukatorëve

Ekzemplarin për anketim të edukatorëve e përbëjnë 207 edukatorë të punësuar në entet parashkollore të përmendura më parë në territorin e Republikës së Maqedonisë.

TABELA 9: STRUKTURA THEMELORE E EKZEMPLARIT TË EDUKATORËVE TË PUNËSUAR NË ÇERDHET DHE QENDRAT PËR ZHVILLIM TË HERSHËM TË FËMIJËVE NË SHKUP

Kopshti	Vendi	Komuna	Edukatorë
„Orce Nikolov“	Shkup	Karposh	10
„Majski Cvet“	Shkup	Karposh	10
„Rosica“	Shkup	Gjorçe Petrov	11
„Detska radost,“	Shkup	Gazi Babë	9
„25 Maji“	Shkup	Gazi Babë	8
„Srniçka“	Shkup	Aerodrom	9
„Veseli Cvetovi “	Shkup	Kisella Voda	8
„Fidani“	Shkup	Çair	16
„Snezhana“	Shkup	Çair	7
„Rade J. Korçagin“	Shkup	Qendër	8
Gjithsej			96

**TABELA 10: STRUKTURA THEMELORE
E EKZEMPLARIT TË EDUKATORËVE TË
PUNËSUAR NË KOPSHTË DHE QENDRAT PËR
ZHVILLIM TË HERSHËM TË FËMIJËVE NË
QYTETET NË BRENDINË E REPUBLIKËS**

Kopshti	Vendi	Komuna	Edukatorë
„Mladost“	Tetovë	Tetovë	10
„Prolet“	Gostivar	Gostivar	9
„Jasna Risteska“	Ohër	Ohër	17
„Nasha idnina“	Prilep	Prilep	9
„Estera O. Maja“	Manastir	Manastir	10
„Dimçe Mirçev“	Veles	Veles	10
„Angel Shajçe“	Kumanovë	Kumanovë	16
„Astibo“	Shtip	Shtip	10
„Pavlina Veljanova“	Koçan	Koçan	10
„Detska radost“	Gjevgjeli	Gjevgjeli	10
Gjithsej:			111

Ekzemplarin e fokus grupeve e përbëjnë 200 edukatorë, drejtorët dhe pedagogët e punësuar në çerdhe dhe qendrat për zhvillim të hershëm të fëmijëve të përfshirë në hulumtim.

Ekzemplarin e prindërve e përbëjnë gjithsej 208 prindër të zgjedhur sipas zgjedhjes së rastit nga çdonjëri ent parashkollor (çerdhe, qendër për zhvillim të hershëm të fëmijëve) që kanë marrë pjesë në hulumtim. Me rëndësi është të

potencohet se gjatë zgjedhjes së prindërve kemi pasur parasysh të përfshihen numër i barabartë nga të gjitha rajonet e shtetit.

Ekzemplar të shkollave fillore

Ekzemplari i shkollave fillore është fituar në bazë të zgjedhjes së rastit dhe janë zgjedhur 20 shkolla fillore nga mjedise me shkallë të ndryshme të zhvillimit nga të cilët 10 nga Shkupi dhe 10 nga vendet tjera të Republikës.

TABELA 11: STRUKTURA E EKZEMPLARIT TË SHKOLLAVE FILLORE SIPAS QYTETEVE

Shkollave fillore	Vendi	Komuna
„Vojdan Çernodrinski“	Karposh	Shkup
„Petar Pop Arsov“	Karposh	Shkup
„Dimitar P.Gj.Berovski“	Gjorçe Petrov	Shkup
„Stiv Naumov“	Gazi Babë	Shkup
„Krstev Misirkov“	Gazi Babë	Shkup
„Luben Lape“	Aerodrom	Shkup
„Kuzman Josifovski-Pitu“	Kisella Voda	Shkup
„Jane Sandanski“	Çair	Shkup
„Rajko Zhinzifov“	Çair	Shkup
„Dimitar Milladinov“	Qendër	Shkup
„Goce Delçev“	Tetovë	Tetovë
„Bratstvo edinstvo“	Gostivar	Gostivar
„Grigor Prliçev“	Ohër	Ohër
„Kliment Ohridski“	Prilep	Prilep
„Kole Kaninski“	Manastir	Manastir
„Blazhe Koneski“	Veles	Veles
„Toli Zordumis“	Kumanovë	Kumanovë
„Vanço Prke“	Shtip	Shtip
„Dedo Ilo Maleshevski“	Berovë	Berovë
„Vlado Kantarxhiev“	Gjevergjeli	Gjevergjeli

Ekzemplarë të pedagogëve shkollor

Ekzemplarin për anketim të pedagogëve shkollor e përbëjnë 193 pedagog të punësuar në shkollat fillore më parë të përmendura.

Ekzemplarë të mësimeve klasor

Ekzemplarin për anketim e përbëjnë 137 mësime klasor, nga 10 prej çdo shkolle fillore të përfshirë në hulumtimin.

9 PËRPUNIMI I TË DHËNAVE NGA HULUMTIMI

Duke u nisur nga karakteri i hulumtimit, karakteristikat e ekzemplarit dhe instrumenteve dhe teknikave hulumtuese të parapara, në këtë hulumtim është aplikuar përpunimi cilësor dhe sasior i të dhënave të fituara.

Me cilësi kryesisht, interpretohen të dhënat e fituara nga analiza e rregullativës legjislative dhe dokumenteve të tjera strategjike për problemin hulumtues. Gjithashtu, analiza cilësore është përdorur edhe te pjesa e të dhënave të cilat janë fituar përmes realizimit të fokus grupeve me edukatorët.

Në mënyrë sasimore janë përpunuar të dhënat e fituara me aplikimin e teknikës së anketimit të pedagogëve, edukatorëve dhe prindërve, si dhe të dhënat e fituara nga anketimi i pedagogëve shkollor dhe mësimeve klasor të shkollimit

fillor. Gjithashtu, me qëllim të realizimit më efikas, pjesë nga të dhënat e nevojshme për këtë hulumtim janë mbledhur dhe u përpunuan në mënyrë elektronike me aplikimin e „survey monkey”.


Për analizimin e rezultateve të fituara janë përdorur edhe procedurat statistikore në vijim:

Përcaktimi i shpërndarjes së frekuencave (f), përqindje (%). Hipotezat janë testuar me ndihmën e testit Hi-kuadrati me qëllim që të përcaktohet rëndësia e dallimit midis disa variablave të përfshira me hulumtimin dhe prezantimin e përfundimit adekuat.

10 ORGANIZIMI DHE VIJIMI I HULUMTIMIT

Hulumtimi u realizua në periudhën mars deri në shtator të vitit 2017 sipas kësaj që vijon:

- ▲ përpilimi i planit aksionar për hulumtim;
- ▲ takimi me ekipin hulumtues dhe ndarja e detyrave;
- ▲ analiza e dokumenteve ligjvënëse dhe strategjike të cilët e trajtojnë problematikën e punës edukative arsimore në institucionet parashkollore;
- ▲ analiza e literaturës shkencore, kompatible me problemin hulumtues;
- ▲ elaborimi teorik i problemit hulumtues;
- ▲ përgatitja e instrumenteve hulumtuese;
- ▲ kërkesa për pëlqim për realizimin e hulumtimit nga drejtori i Byrosë së zhvillimit të arsimit;
- ▲ informimi i kopshteve për hulumtim;
- ▲ hulumtim i terrenit në njëmbëdhjetë qytete të Republikës së Maqedonisë;
- ▲ përpunimi kualitativ dhe kuantitativ i të dhënave të fituara;
- ▲ analiza dhe interpretimi i rezultateve të fituara nga hulumtimi;
- ▲ njohuri përfundimtare;
- ▲ përgatitja e raportit nga hulumtimi dhe dorëzimin e tij deri te institucionet relevante.



PJESA III

ANALIZA DHE INTERPRETIMI I REZULTATEVE NGA HULUMTIMI

Në këtë pjesë të punimit vëmendje të veçantë i kushtohet analizës dhe interpretimit të rezultateve të fituara nga hulumtimet empirike. Interpretimi i rezultateve është në drejtim të dhënies së përgjigjes në detyrat paraprakisht të dhëna dhe hipotezat e dhëna të hulumtimit.

...the first of these is the fact that the ...

...the second of these is the fact that the ...

...the third of these is the fact that the ...

...the fourth of these is the fact that the ...

...the fifth of these is the fact that the ...

...the sixth of these is the fact that the ...

...the seventh of these is the fact that the ...

...the eighth of these is the fact that the ...

...the ninth of these is the fact that the ...

...the tenth of these is the fact that the ...

...the eleventh of these is the fact that the ...

...the twelfth of these is the fact that the ...

...the thirteenth of these is the fact that the ...

...the fourteenth of these is the fact that the ...

...the fifteenth of these is the fact that the ...

...the sixteenth of these is the fact that the ...

...the seventeenth of these is the fact that the ...

...the eighteenth of these is the fact that the ...

1 RREGULLIMI LIGJOR I EDUKIMIT DHE ARSIMIT PARASHKOLLOR NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË

Për vërtetimin e hipotezës së parë të hulumtimit e cila thotë „Ekziston nevoja për miratimin e ligjit për edukim dhe arsim parashkollor në Republikën e Maqedonisë, në funksion të avancimit të kualitetit të veprimtarisë edukativo-arsimore në entet parashkollore dhe sigurimin e lidhjes funksionale me shkollimin fillor“, në pjesën e mëtutjeshme të punimit të dhënat e fituara interpretohen në bazë të analizës së bërë të rregullativës ligjore për edukimin dhe arsimin parashkollor në Republikën e Maqedonisë krahasuar me rregullativën ligjore të këtij nënsistemi në shtetet tjera evropiane, si dhe në bazë të analizës kualitative të të dhënave nga realizimi i fokus grupeve me edukatorët, pedagogët dhe drejtorët e çerdheve dhe qendrave për mësim dhe zhvillim të hershëm.

Analiza e bërë e rregullativës ligjore me fëmijët e moshës parashkollore në Republikën e Maqedonisë është e rregulluar me Ligjin për mbrojtjen e fëmijëve. Në nenin 54 të ligjit të lartpërmendur qëndron „Kujdesi dhe edukata e fëmijëve në shkollimin parashkollor është formë e mbrojtjes së fëmijëve, e cila si veprimtari, organizohet për kujdes, qëndrim, kultivim, ushqim, aktivitete edukativo-arsimor, aktivitete rekreative-sportive dhe kulturore-zbavitës, masa dhe aktivitete për përmirësimin dhe mbrojtjen e shëndetësisë dhe nxitjen e

zhvillimit intelektual, emocional, mental dhe social të fëmijës të moshës gjashtë vjeçare, respektivisht deri në hyrjen në shkollimin fillor“.¹⁷ Në nenin 57 të të njëjtit ligj qëndron se, „veprimtaria e cila bëhet në kuadër të kujdesit dhe edukimit të fëmijëve të moshës parashkollore mund të realizohet në kopshte (çerdhe publike dhe çerdhe në pronësi private)“¹⁸. Më tutje në nenin 63 qëndron se veprimtaria e çerdheve realizohet sipas programeve për realizimin e veprimtarisë në pajtim me nenin 168 sipas së cilit, „edukimi parashkollor si pjesë integrale e sistemit për kujdesin dhe edukimin e fëmijëve të moshës parashkollore realizohet përmes programit vjetore për punën e enteve për fëmijë të cilët bëjnë punë të lidhura me kujdesin dhe edukimin e fëmijëve të moshës parashkollore“.

Kompetencat ligjore në raport me edukimin dhe arsimin parashkollor i ka edhe Byroja e zhvillimit të arsimit. Në nenin 5 të Ligjit të Byrosë së zhvillimit të arsimit qëndron se „Byroja e zhvillimit të arsimit është kompetente për ndjekjen mbikëqyrjen profesionale, hulumtimin, avancimin dhe zhvillimin e arsimit parashkollor...“. Më tej në ligjin e njëjtë qëndron se në realizimin e kompetencave të veta Byroja e zhvillimit të

¹⁷ Ligji për mbrojtjen e fëmijëve (tekst i konsoliduar), faqe. 14

¹⁸ Njëjtë faqe. 14

arsimit i propozon ministrit të Arsimit dhe Shkencës koncepte për zhvillimin e sistemit edukativo-arsimor, programe mësimore për edukim dhe arsim parashkollor, organizon dhe realizon aktivitete për zhvillim profesional të kuadrove edukativo-arsimore, bën dhe organizon hulumtime në fushën e arsimit, bën punë këshilluese arsimore për përmirësimin e kualitetit të enteve edukativo-arsimore, përpunon analiza dhe në bazë të tyre e vërteton nevojën për zhvillim profesional të kuadrove edukativo-arsimore dhe udhëheqëse, organizon debate tematike në lidhje me zhvillimin profesional të kuadrove edukativo-arsimore dhe kuadrove udhëheqëse, përpilon plan afatgjatë për nevojën për trajnim të kuadrove edukativo-arsimore, përpilon plan afatgjatë dhe plan vjetor të aktiviteteve për trajnim të kuadrove edukativo-arsimore, bën bashkimin e planeve dhe kërkesave për aktivitete për trajnim të kuadrove edukativo-arsimore; i realizon procedurat për akreditim për sigurimin e shërbimeve në lidhje me implementimin e programit për trajnim të kuadrove edukativo-arsimor; nënshkruan marrëveshje me entet e akredituara, institucionet dhe personat tjerë juridik për implementimin e trajnimit të kuadrove edukativo-arsimore; e ndjek realizimin e shërbimeve të enteve të akredituara, institucioneve dhe personave tjerë juridik sipas afateve; mbledh informata nga kuadrot edukativo-arsimore dhe kuadri udhëheqës në lidhje me programet për trajnim; siguron kualitet përmes evalvimit të programeve për trajnim të kuadrove në entet edukativo-arsimor në bashkëpunim me Inspektoratin Shtetëror Arsimit dhe jep informata për gjërat e konstatuara të zhvillimit profesional të kuadrit edukativo-arsimor dhe kuadrit udhëheqës deri te shkollat dhe entet tjera, nxjerr doracak dhe literaturë

tjetër për edukatorët, arsimtarët dhe bashkëpunëtorët profesional dhe shpalljen e tyre në faqen zyrtare të Internetit në ministri, propozon formular për evidencë dhe dokumentacion pedagogjik “.

Për dallim nga Ligji për Byronë e zhvillimit të arsimit, në nenin 202 të Ligjit për mbrojtjen e fëmijëve qëndron se „ Mbi punën profesionale në veprimtarin e mbrojtjes së fëmijëve bëhet mbikëqyrje profesionale. Mbikëqyrjen e punës profesionale në realizimin, kujdesin, edukimin, qëndrimin, kultivimin, ushqimin, si dhe masat dhe aktivitet e përcaktuara me këtë ligj dhe pushimin dhe rekreacionin, e bën Ministria e Punës dhe Politikës Sociale, mbi realizimin e punës arsimore Ministria e Arsimit dhe Shkencës, kurse mbi mbrojtjen shëndetësore Ministria e Shëndetësisë“. Ndarja e këtyre të ingerencave shpesh sjell deri në paqartësi dhe përzjerje të ndërsjellë të tyre, që ndikon në zvogëlimin e kualitetit të edukimit dhe arsimit parashkollor.

Kur flasim për edukimin dhe arsimimin e fëmijëve të moshës parashkollore në Republikën e Maqedonisë mund të konstatohet se në pajtim me ligjin aktual për mbrojtjen e fëmijëve ekziston mbivlerësimi i veprimtarisë edukative-kujdesore, në llogari të lënies pas dore të veprimtarisë arsimore, respektivisht, është evidente mospërfillja e rëndësisë për mësim të hershëm të fëmijët e moshës parashkollore, që është në kundërshtim me të arriturat më të reja shkencore dhe hulumtimet për rolin dhe rëndësinë e mësimin të hershëm në zhvillimin e tërësishëm të personalitetit.

Sipas kësaj, në bazë të shembujve pozitiv të vendeve evropiane dhe vendeve tjera të zhvilluara në botë, vetvetiu paraqitet nevoja për sjelljen e ligjit për edukim dhe

arsimim parashkollor dhe transferim të plotë të ingerencave në raport me edukimin dhe arsimimin në kuadër të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës. Analiza e nënsistemit në edukimin dhe arsimimin parashkollor në kontekst evropian dhe botëror, e dhënë në pjesën teorike të këtij hulumtimi, vërteton se çdo vend, pa përjashtim, edukimi dhe arsimimi parashkollor është nënsistemi i parë në kuadër të sistemit të tërë të edukimit dhe arsimimit dhe ai është në kompetencë të Ministrisë së Arsimit dhe të Shkencës.

Në lidhje me nevojën për aprovimin e ligjit për edukim dhe arsimim parashkollor në Republikën e Maqedonisë na interesojnë qëndrimet dhe mendimet e edukatorëve dhe pedagogëve në kopshtet dhe qendrat për zhvillimin e hershëm të përfshirë në fokus grupet e realizuara gjatë vizitave tona në çerdhet.

Është parashtruar pyetja „Vallë supozoni se veprimtaria duhet rregulluar me ligjin për edukimin dhe arsimin parashkollor?“ Nga përgjigjet e fituara mund të konstatohet se të gjithë hulumtuesit janë përgjigjur se edukimi dhe arsimimi parashkollor së pari dhe nënsistem më i rëndësishëm, duhet të rregullohet me ligjin për edukimin dhe arsimin parashkollor. Me miratimin e Ligjit për edukimin dhe arsimin parashkollor dhe sigurimin e transferimit të tërësishëm të integrameve në kuadër të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, edukimi dhe arsimi parashkollor edhe zyrtarisht do të bëhet edhe pjesë integrale e sistemit edukativo - arsimor, do të sigurohet cilësi më e madhe në punën edukative – arsimore me fëmijët e moshës parashkollore dhe moshës së hershme shkollore dhe do të mundësohet kompatibilitet më i madh i Programit për mësim të hershëm dhe zhvillim si dhe programet mësimore në klasën e parë në edukimin dhe arsimin fillor parashkollor.

Nga ana tjetër, në pajtim me Standardet Ndërkombëtare për kualifikimet e arsimit (ISCED 2011), kjo do na shpie edhe në pajtim me kriteret arsimore me evropiane.

Në bazë të asaj që u tha më lartë mund të konstatojmë se tërësisht vërtetohet hipoteza e parë nga hulumtimi, përkatësisht se ekziston nevoja për miratimin e Ligjit për edukimin dhe arsimin parashkollor në Republikën e Maqedonisë në funksionin e përparimit të cilësisë së veprimtarisë edukative - arsimore në institucionet parashkollore dhe siguria e ndërlidhjes me arsimin fillor.

2 ANALIZA E QËLLIMEVE NË PROGRAMIN PËR MËSIM DHE ZHVILLIM TË HERSHËM NË PROGRAMET MËSIMORE TË MATEMATIKËS, SHKENCAVE NATYRORE, ARSIMIT FIGURATIV DHE MUZIKOR PËR KLASËN E PARË NË ARSIMIN FILLOR NËNTËVJEÇAR

Në funksion të dëshmisë së hipotezës së dytë nga hulumtimi jonë i cili është: *nuk ekziston përputhshmëri e plotë e qëllimeve të Programit për mësim dhe zhvillim të hershëm (Gjuhë, Komunikimi dhe zhvillimi i shkrim-leximit, Zhvillimi kognitiv dhe arritja e njohurive të përgjithshme, Arti) dhe qëllimet në programet mësimore të matematikës, shkencave natyrore, artit figurativ dhe muzikë për klasën e parë të arsimit fillor nëntëvjeçarë, në pjesën e mëtutjeshme të punës janë interpretuar të dhënat të cilat janë fituar në bazë të analizës së bërë për qëllimet e Programit për mësim dhe zhvillim të hershëm, me theks të veçantë të qëllimeve për fëmijët e moshës nga 4 deri në 6 vjeç, mbi të cilat duhet të vendosen themelet e programeve nga gjuha shqipe, matematika, shkencat natyrore, arsimit figurativ dhe muzikor në periudhën e parë zhvillimore të arsimit fillor nëntëvjeçar.*

Kjo çështje është me rëndësi sidomos nëse nisemi nga fakti se kualiteti i të mësuarit (puna edukativo-arsimore) dhe përvojat të cilat fëmijët i arrijnë në moshën parashkollore janë themeli në të cilin bazohet sukcesi i mëtutjeshëm i tyre në shkollë dhe në jetë. Kështu, fushat edukativo-arsimore dhe qëllimet në Programin për mësim dhe zhvillim të hershëm të pasaktësuara dhe jo të qarta

mund të paraqesim arsye e cila ndikon në planifikimin dhe programimin efikas dhe kualitativ të punës së edukatorit në çerdhe, që nga ana tjetër reflektohet me zvogëlimin e cilësisë të punës edukativo-arsimore me fëmijët e moshës parashkollore.

2.1. Fusha, komunikimi dhe zhvillimi i shkrim-leximit në Programin për mësim dhe zhvillim të hershëm të fëmijët e moshës 4 deri në 6 vjeç

Fusha (edukativo-arsimore) Gjuha, Komunikimi dhe zhvillimi i shkrim-leximit të nxënësit e moshës 4 deri në 6 vjet në Programin për mësim dhe zhvillim të hershëm përfshin numër të madh të standardeve, qëllime globale dhe konkrete, shembuj të aktiviteteve dhe rezultatet e pritura. Për realizimin më të lehtë të tyre, ata janë ndarë në tre nënfusha dhe katër fusha programore. Gjithashtu, në Program janë dhënë udhëzime didaktike për çdo moshë, në funksion të sigurimit të realizimit pa pengesë të qëllimeve të programit.

Ashtu, në Programin për mësim dhe zhvillim të hershëm dhe në kuadër të fushës Gjuhë, komunikim dhe zhvillim të shkrim-leximit dallohen tre nënfusha kryesore me standardet vijuese:

- I. Komunikim** – me ndihmën e së cilës fëmija përgjigjet në mënyrë adekuate në gjuhën popullore, fillon ta kuptoj, duke demonstruar shkathtësi komunikimi me mjedisin.

Standarde – fëmija mund ta dëgjoj dhe ta kuptoj gjuhën popullore; mund të fol dhe të komunikoj; fëmija mund ta pasuroj fjalorin dhe të tregoj përparim në të folurit e drejtë.

- II. Lexim** – me ndihmën e së cilës zhvillohet interesi ndaj simboleve dhe shkronjave të shtypit dhe njohjes së tyre.

Standarde – fëmija tregon interes ndaj materialeve të shtypit, mund të njoh simbole dhe shkronja të shkruara.

- III. Të shkruarit** – me ndihmën e së cilës fëmija nis aktivitetet (shkarravitje, vizatim) të cilat më tutje zhvillohen në aftësi për shkrim përmes së cilës tregohen disa qëllime.

Standarde – fëmija mund të përfshihet në aktivitete të lidhura me të shkruarit, i tregon idetë e veta përmes të shkruarit së simboleve dhe shkronjave.

Për mësimin dhe avancimin pa pengesë të fëmijës, sidomos në fushën e zhvillimi të gjuhës, shkrim-leximit dhe komunikimit e nevojshëm është të theksohet se te fëmijët ka disa aspekte nga rritja dhe zhvillimi të cilat duhet të jenë në nivel adekuat të zhvillimit dhe në korrelacion me këtë aspekt të zhvillimit. Respektivisht, në periudhën prej 4 deri në moshën 6 vjeçare sipas rezultateve të pritura në Programin për mësim dhe zhvillim të hershëm -Zhvillim të bukur motorik fëmija vetëm se shfrytëzon dorën dominuese në aktivitetet e përditshme (mbajtjen e lapsit, prerjen e letrës me gërshërë) sipas zhvillimit emocional të fëmijës është e

mundur tu kushtohet aktiviteteve të dhëna, por gjithashtu në kuadër të fushës Qasja ndaj mësim, nënfusha – Kreativiteti dhe qëndrueshmëria, fëmija përdor metoda të veta për shprehjen e ideve të veta, ajo tregon dhe vizaton.

Sipas qëllimeve globale të Programit për mësim dhe zhvillim të hershëm, në kuadër të aspektit Zhvillimi i gjuhës, shkrim-leximit dhe komunikimi te fëmija duhet: të zhvillohet aftësia për dëgjim dhe kuptimin e të folurit, të zhvillohet aftësia për të folurit e drejtë dhe elokuent; të zhvillohen aftësitë gjuhësore si bazë për zhvillimin e identitetit të vet nacional dhe kulturor; të zhvillohet aftësia për dëgjim, kuptim dhe përjetim të gjuhës; të zhvillohen aftësitë komunikative; të zhvillohet aftësia për shprehjen e mendimeve të veta në mënyrë të vetëdijshme dhe gramatikusht drejtë; të kultivohet dashuria dhe raporti pozitiv ndaj librave; të nxitet dhe zhvillohet interesi për lexim të librave; të nxitet dhe zhvillohet interesi për shprehje me shkrim; të nxitet krijimtaria; të zhvillohet ndjenja e ekzistimit të dallimeve gjuhësore dhe kulturore; të vendosen dhe të njihen bazat e gjuhës së shkruar.

Në kuadër të këtij aspekti, në Programin për mësim dhe zhvillim të hershëm janë dhënë edhe më tepër fusha programore me qëllimet dhe rezultatet e pritura si vijon.

2.1.1. Fusha programore–Komunikimi dhe kultura mediale

Qëllimet	Rezultatet e pritura
Periudha zhvillimore prej 4 deri 5 vjeç	
<ul style="list-style-type: none"> ▲ Fëmija të aftësohet dhe mësohet drejtë të merr frymë me qëllim që të flet mirë; ▲ të zhvillohet funksionim i drejtë i aparatit folës; ▲ të zhvillohet aftësia për dëgjim me kujdes (aftësi për të dëgjuar të folurit dhe zërave nga të cilët përbëhet); të dëgjuarit fonematik (dallimet e zërave në të folur); ▲ të avancohet aftësia për të folurit e qartë të pothuajse të gjitha zërave; ▲ të nxitet dhe të aftësohet për tregimin e ideve të veta në më tepër mënyra; ▲ të nxitet dhe zhvillohet aftësia për komunikim të ndërsjellë dhe nxitjen e fëmijës për bisedë me moshatarët; ▲ të aftësohet për tregimin e përvojës personale ose përjetimit; ▲ të zhvillohen aftësitë për recitim të qartë të vjershave me ndryshimin e intonacionit të zërit; ▲ të aftësohet për njohjen e fjalëve të cilat janë ndryshe nga gjuha amtare; ▲ të nxitet për pjesëmarrje në dramatizime dhe ndaj dëshirës për pranimin e lojës së roleve. 	<ul style="list-style-type: none"> ▲ Fëmija mundet drejtë ti shqiptoj pothuajse të gjitha zërat. ▲ I tregon idetë e veta në më tepër mënyra. ▲ Me lehtësim tregon përralla ose ndonjë ngjarje të cilën e ka përjetuar. ▲ Bisedon me moshatarët për ndonjë ngjarje (si ka kaluar në ditëlindje, në shëtitje...). ▲ Përdor intonacion të ndryshëm të zërit që të tregoj ndonjë ngjarje. ▲ Reciton vjershë me imitim ose ndryshim të intonimit të zërit. ▲ Mundet të imitoj dhe të aktroj diçka. ▲ Fëmija kupton komunikim të thjeshtë joverbal, joverbalisht tregon gjeste dhe mënyra të ecjes dhe sjelljes te të rriturit të cilët i njeh. ▲ Mundet të parashtrij pyetjet: kur?, si? Dhe shkurt të përgjigjet për sende në rrethinën e afërt (Çka është ajo dhe prej çka është e përbërë?). ▲ Në mënyrë adekuate i përdor fjalët: urdhëro, faleminderit, ju lutem. ▲ Bisedon me person të rritur ose shok dhe sillet konform marrëveshjes ose detyrës së tij(p.sh. i mbledh katrorët dhe i renditë në kuti etj.).

Periudha zhvillimore prej 5 deri 6 vjeç

- ▲ Fëmija të nxitet për përdorimin e të folurit si mjet për njohje dhe të kuptuarit e ndërsjellë;
- ▲ të vendoset përdorimi i të folurit si mjet për shprehjen e mendimeve, ndjenjave dhe përjetimeve të veta;
- ▲ të vendoset të dëgjuarit në të kuptuarit e të folurit të tjerëve;
- ▲ të vendoset të folurit e drejtë dhe të kuptuarit e të folurit me forcë mesatare dhe ritëm të zërit;
- ▲ të aftësohet t'i përputhë foljet sipas kohës, të shprehet qartë dhe me fjali drejtë të përbëra;
- ▲ të nxitet drejt ballafaqimit me dallimet mes të folurit letrar dhe joletrar;
- ▲ të nxitet për artikulum të drejtë dhe diskriminim të zërave;
- ▲ t'i zhvillojë në vazhdimësi organet e të folurit në funksion të diskriminimit të drejtë dhe artikulimit të të folurit;
- ▲ të vendosen lojëra tradicionale të të folurit (numëratore, gjëgjëza, lojëra me numra);
- ▲ të zhvillohet aftësia për komunikim të ndërsjellë dhe nxitjen e fëmijës për bisedë me moshatarët e vet;
- ▲ Fëmija e tregon emrin e vet dhe adresën e banimit.
- ▲ Fëmija mund të vetëshprehet.
- ▲ Mundet në mënyrë adekuate të reagoj në udhëzimin verbale të dhënë nga të rriturit.
- ▲ Fëmija kyçet në bisedë, e kupton atë që e dëgjon dhe në mënyrë adekuate reagon.
- ▲ E di domethënien e fjalëve specifike (p.sh. Aktor, shkrimtar, gazetar,, stomatolog-mjek për dhëmbë...).
- ▲ Flet me forcë dhe ritëm të matur të zërit.
- ▲ Qartë pyet për atë që nuk e di.
- ▲ Mund t'i sqaroj rregullat e lojës dhe rregullat e sjelljes në grup.
- ▲ Mund të flet me zë të matur.
- ▲ Përdor intonacion të ndryshëm të zërit që ta tregoj ndonjë ngjarje.
- ▲ Reciton vjersha me imitim ose ndryshimin e intonacionit të zërit.
- ▲ I njeh fjalët të cilat janë të ndryshme nga gjuha amtare.
- ▲ E di kuptimin e kundërt të disa fjalëve.

Periudha zhvillimore prej 5 deri 6 vjeç

- ▲ të përkrahet me shprehje të qartë, rrjedhshëm dhe me theks gjatë paraqitjeve publike para moshatarëve dhe të rriturve;
 - ▲ të nxitet të jep sqarime për veprimet e veta në disa situata;
 - ▲ të aftësohet për njohjen e fjalive të cilat janë ndryshe nga gjuha amtare; të aprovoj dhe zbatoj sjellje kulturore në komunikimin me të rriturit dhe me moshatarët (Ju faleminderit, Ju lutem, Më falni);
 - ▲ të mund ti respektojë nevojat dhe dëshirat e të tjerëve, të bëj kompromis, të mund të bëj marrëveshje;
 - ▲ të nxitet për pjesëmarrje në dramatizime dhe nxitje të dëshirës për pranimin e lojës së roleve;
 - ▲ të nxitet drejt zhvillimit të aftësisë për komunikim joverbal me ndihmën e gjesteve, mimikave dhe pantomimave;
 - ▲ të çlirohet nga ndjenja e frikës, presionit dhe pasigurisë në bisedë;
 - ▲ të njihet me llojet e ndryshme të emisioneve televizive dhe të radios;
 - ▲ të fitoj njohuri elementare për teatrin, artin dramatik dhe muzikor;
 - ▲ të njihet me revistat për fëmijë.
- ▲ Merr pjesë në lojëra fjalësh – gjëgjëza dhe saktë përgjigjet.
 - ▲ Mund të imitojë dhe aktojë diçka
 - ▲ Mund me fjalë dhe lëvizje ta paraqes personazhin të cilin e aktron.

2.1.2. Fusha programore–Lexim dhe pasurim të fjalorit

Qëllimet	Rezultatet e pritura
Periudha zhvillimore pre 4 deri 5 vjeç	
<ul style="list-style-type: none"> ▲ Të nxitet dhe zhvillohet aftësia e fëmijës për të shikuar librat me ilustrime ose material tjetër të shtypur, duke e mbajtur librin në pozitë të duhur; ▲ Të zhvillohet aftësia për tregimin e ngjarjeve sipas fotografive që kanë ndonjë rend; ▲ Të zhvillohet aftësia për përdorimin e librave ose librave me ilustrime; ▲ Të zhvillohet aftësia për lidhjen e zërit me ndonjë shkronjë; ▲ Të zhvillohen aftësitë për dëgjim, kuptim dhe përjetim të përmbajtjes së veprave letrare – njohje me vepra të zgjedhura poetike dhe prozaike të letërsisë artistike dhe popullore; ▲ Të kultivohet dhe të respektohet bukuria e gjuhës amtare; ▲ Të dëgjohen të gjitha llojet e ndryshme letrare; ▲ Të kultivohet aftësia për vëzhgim dhe përjetim të zërit dhe ritmit të gjuhës poetike, motivim për mbamendje të vjershave; ▲ Të aftësohet për formimin e fjalëve të cilat tregojnë shumësin, si dhe fjalë deminutive dhe augmentive, për ndryshimin e fjalëve dhe përputhjen e tyre sipas rendit dhe numrit për përputhje të foljeve sipas kohës (e tashme, e kaluar dhe e ardhshme), si dhe lidhjen e tyre me fjali; ▲ Të pasurohet fjalori me fjalë të cilat tregojnë terme të përgjithshme. 	<ul style="list-style-type: none"> ▲ E mban librin me ilustrime ose librin në pozitë të duhur dhe me interes e shikon një kohë më të gjatë. ▲ Di të tregoj ngjarje sipas disa fotografive të cilat për herë të parë i sheh. ▲ Përdor libër që të fitoj ndonjë informatë. ▲ Ti të lidh zërin me ndonjë shkronjë. ▲ Fëmija paraqet interes të merr libër me ilustrime ose libër tjetër nga raftet e bibliotekës, me kujdes e shikon dhe e kthen në vend të vet. ▲ Mundet të tregojë tregim të shkurtër. ▲ Mundet t'i identifikoj personazhet kryesore dhe vendin e ngjarjes. ▲ Mundet për fjalë të thjeshta të dhëna (p.sh. E madhe, e hollë, e bardhë) të tregojë fjalë me kuptim të kundërt. ▲ Në të folurit me gojë përveç përemrave vetor i përdor edhe përemrat tjerë. ▲ Mund të ritregoj me fjalë të veta tregim të shkurtër. ▲ Në mënyrë adekuate i përdorë fjalët e mira: mirëdita, mirupafshim, faleminderit etj. ▲ Në aktivitetet e përditshme e përdor fondin e vet të fjalëve (1 500 deri 1 800 fjalë).

Periudha zhvillimore prej moshës 5 deri në 6 vjeç

- ▲ Fëmija të nxitet për zhvillimin e interesit, dashurisë dhe nevojës për shikim të librit me ilustrime ose ndonjë material tjetër të shkruar, duke e mbajtur librin në pozitë të duhur;
- ▲ të vendoset literaturë për fëmijë;
- ▲ ta zhvillojë aftësinë për dëgjim, kuptim dhe përjetim të përmbajtjes së veprave letrare;
- ▲ të njihet me vepra të zgjedhura poetike dhe prozaike të letërsisë artistike dhe popullore;
- ▲ të zhvillohet përdorimi i librave dhe librave me ilustrime si burim i informatave;
- ▲ të dëgjojë literaturë të llojeve të ndryshme dhe ti dallojë ngjashmëritë dhe dallimet mes tyre;
- ▲ të nxitet aftësia për vlerësim elementar të karakteristikave të trimave nga veprat artistike dhe veprimet e tyre;
- ▲ ta pasuroj fjalorin me futjen e shprehjeve të bukura nga veprat letrare;
- ▲ të motivohet ta ushtrojë të mbajturit mend përmes recitimit shprehës të vjershës, gjëgjzës para publikut;
- ▲ të njihet me disa poetë, shkrimtarë, aktorë dhe ta kultivojë respektin ndaj tyre;
- ▲ të fitojë njohuri elementare për librin si vepër letrare, si dhe për atë se ajo ka titull, autor dhe ilustrime;
- ▲ të fitoj njohuri elementare për dallimet mes ilustrimeve dhe tekstit;
- ▲ të aftësohet për njohje vizuale, respektivisht „leximin“ e fjalive dhe simboleve të plota që i sheh më shpesh.
- ▲ E mban librin me ilustrime në pozicion të duhur dhe me interes e sheh një kohë më të gjatë.
- ▲ Di të tregoj ngjarje sipas disa fotografive që për herë të parë i sheh.
- ▲ Di që libri ka titull dhe e shkruan autori.
- ▲ Tregon informatë që fëmija e ka marrë kur dikush i ka lexuar libër, enciklopedi etj.
- ▲ E njeh emrin e vet të shkruar në letër.
- ▲ Mund të numërojë personazhe nga libri me ilustrime i lexuar, tregime etj.
- ▲ Mund me fjalë të veta ta përshkruaj dallimin midisi ilustrimit dhe tekstit.

2.1.3. Fusha programore - Të shkruarit

Qëllimet	Rezultatet e pritura
Periudha zhvillimore prej 4 - 5 vjeç	
<ul style="list-style-type: none"> ▲ Të zhvillohet aftësia për të shkruar ose vizatuar forma të ndryshme me më shumë lëvizje; ▲ Të zhvillohet aftësia për shkrimin e shkronjës së dhënë duke parë shembull (kopjim). 	<ul style="list-style-type: none"> ▲ Mund të shkruajë ose të vizatojë forma të ndryshme me më tepër lëvizje. ▲ Mund të shkruajë ose të vizatojë elemente të ndonjë shkronje ose formë më të ndërlikuar.
Periudha zhvillimore prej 5 - 6 vjeç	
<ul style="list-style-type: none"> ▲ Fëmija të nxitet të vendos koordinimin sy-dorë; ▲ Të njihet me materiale të ndryshme dhe mjete për të shkruar; ▲ Të aftësohet për lëvizje të drejtë të lapsit; ▲ Të zhvillojë aftësinë për të shkruar ose vizatuar forma të ndryshme me më tepër lëvizje; ▲ Të nxitet zhvillimi i interesit për të shkruar; ▲ të nxitet me përdorimin e laramanisë, vizatimeve dhe shkarravitjeve të shkruaj ndonjë mesazh. 	<ul style="list-style-type: none"> ▲ Fëmija mund të vizatoj vija dhe forma të ndryshme me më tepër lëvizje. ▲ Mund të vizatoj vija dhe shkarravitje të tjera që u ngjajnë shkronjave. ▲ E mban lapsin në pozitë të duhur. ▲ Fëmija mund „të shkruaj” mesazh përmes vizatimit të simboleve.

**2.1.4. Fusha programore –
Krijimtaria e të folurit**

Qëllimet	Rezultatet e pritshme
Periudha zhvillimore prej 4 - 5 vjeç	
<ul style="list-style-type: none"> ▲ Të zhvillohen aftësitë për shpjegim të lidhur në të cilën përshkruhen sendet dhe dukurit në mjedisin e afërt; ▲ të njihen me lojërat tradicionale e të folurit (gjëgjëza, numëratore, lojëra me fjalë, lojëra me mendjemprehtësi etj.) dhe kultivimin e shkathtësive për përdorimin e tyre si model kreativ; ▲ të nxiten për treguar shaka, shprehje të pazakonta, të folurit qesharak; ▲ të nxiten për të menduar gjëgjëza, tekste për dramatizim. 	<ul style="list-style-type: none"> ▲ Fëmija mundet me disa fjali ta përshkruajë pamjen e jashtme të ndonjë sendi (madhësinë, ngjyrën, formën). ▲ Mundet të tregojë tregim individual sipas fotografisë konkrete.
Periudha zhvillimore prej 5 - 6 vjeç	
<ul style="list-style-type: none"> ▲ Fëmija të nxitet për krijimtari; ▲ ta zhvilloj fantazinë përmes krijimit të ideve të reja dhe vendimeve origjinal; ▲ të kyçet në përshkrim, shpjegim dhe ritregim; ▲ të nxitet dhe të aftësohet për shpjegimin e ngjarjeve me lehtësim, pas kujtesës me përdorim të fjalëve adekuate; ▲ të fitoj aftësi elementare për përshkrimin e sendeve dhe dukurive në momentin kur ata nuk janë prezent; ▲ të nxitet klasifikimi mendor dhe seritë mendore përmes krijimtarisë së të folurit; ▲ të inkurajohet dhe të nxitet për pjesëmarrje në lojërat e të folurit (plotësoje fjalinë, vazhdo fjalinë); ▲ të aftësohet për tregim të ngjarjeve sipas fotografive të cilat kanë ndonjë rend. 	<ul style="list-style-type: none"> ▲ Fëmija shpjegon tregim ose ndonjë ngjarje që e ka përjetuar. ▲ I tregon idetë e veta në më tepër mënyra. ▲ Flet me moshatarët e vet për ndonjë ngjarje (si ka kaluar në ditëlindje, në shëtitje...). ▲ Tregon përvojën individuale ose përjetimin.

2.1.5. Analiza e qëllimeve të Programit mësimor nga gjuha shqipe për klasën e parë

Lënda e gjuhës shqipe në arsimin fillor përfshin në fushën e saj të interesit numër të madhe të qëllimeve të ndryshme, përmbajtjeve, termeve dhe aktiviteteve. Për mësimin e tyre më lehtë, ata janë ndarë në fusha programore. Përveç qëllimeve të propozuara, përmbajtjeve dhe aktiviteteve për çdo fushë programore ekzistojnë edhe rekomandime didaktike për numrin e orëve të cilët janë të nevojshme për realizimin e përmbajtjeve dhe aktiviteteve si dhe mundësisë për fleksibilitet për shkak ngjarjeve të nevojshme në kushte dhe mjedis të caktuar. Në mes tjerash, programi

mësimor jep rekomandime për qasje individuale në punë, kyçje të metodave bashkëkohore dhe aktive të punës me përdorimin e mjeteve mësimore adekuate, softuer arsimor kompjuterik dhe literaturë për fëmijë në pajtim me moshën.¹⁹

Lënda e gjuhës shqipe nga klasa e parë deri në klasën e tretë mësohet me fond javor prej 6 orëve/ respektivisht për çdo klasë fondi vjetor është 216 orë të shpërndara në disa fusha.²⁰

Pasqyra e fushave të programit mësimor nga gjuha shqipe në periudhën e parë arsimore

Klasa e parë	Klasa e dytë	Klasa e tretë	Vërejtje
Të dëgjuarit dhe të folurit	Lexim fillestar dhe të shkruarit	Lexim fillestar dhe të shkruarit (alfabeti)	Fushat në tre klasat e para janë të ngjashme në titujt e tyre, mirëpo në ata ka gradacione që ndiqet përmes përmbajtjeve.
Letërsi	Gjuhë	Gjuhë	Qëllimet dhe aktivitetet në klasë të parë më së shumti janë të orientuara drejt zhvillimit të të folurit dhe përgatitjes së shkrim-leximit, kurse klasa e dytë dhe e tretë janë dedikuar për shkrim-lexim të alfabetit, kurse pastaj futet fusha e Gjuhës për mësimin e temave nga gramatika dhe drejtshkrimi.
Shprehje dhe krijimtari	Letërsi	Lexim, letërsi dhe lektyra	
Kulturë mediatike	Shprehje dhe krijimtari	Shprehje dhe krijimtari	
Përgatitje për lexim fillestar dhe të shkruarit	Kulturë mediatike	Kulturë mediatike	

19 2007, Programi mësimor nga gjuha maqedonase për klasën e parë, të dytë dhe të tretë, Byroja e zhvillimit të arsimit, Shkup.

20 Njëjtë.

Gjuhë maqedonase për klasën e parë

Në kuadër të fushës programore *Të dëgjuarit dhe të folurit* nxënësit njihen mes vete, mësojnë t'i shprehin ndjenjat, mendimet, përjetimet e tyre. Mësojnë mënyra për qasje personale në situata konkrete (autobus, ashensor, bibliotekë etj), gjatë së cilës aprovohen fraza të zakonshme për tu drejtuar dhe sjellje kulturore me persona të njohur dhe të panjohur, si dhe për bisedë adekuate në telefon.²¹

Nxënësit, gjithashtu, mësojnë për pyetjet dhe përgjigjet, d.m.th, si të parashtrojnë pyetje dhe si të përgjigjen në pyetjen e parashtruar. Qëllimi i të mësuarit janë edhe fjalitë me të cilat tregohet diçka, bëhet pyetje, vërtetohet ose mohohet diçka. Nxënësit e zgjerojnë fjalorin e tyre përmes zbatimit të fjalëve dhe termeve të ndonjë fushe të caktuar, si dhe nocione të cilat emërtojnë, p.sh. dukuri, veprime, persona, festa etj. Në kuadër të kësaj fushe nxënësit përmes aktiviteteve i njohin tingujt nga zërat, kurse aftësohen edhe për diskriminimin dhe artikulin e një pjese të bashkëtingëlloreve të sistemit të zërave.

Në pjesën *Letërsi* nxënësit fitojnë njohuri për: tregimet, fabulat, përrallat, vjershat, tekstin dramatik, gjëegjëza, përgjigjeve të shpejta. Gjatë vitit shkollor njohin më tepër shembuj nga të gjitha format e numëruar letrare. Vëmendje të veçantë i kushtohet tregimit si krijimtari letrare që nxënësit e kanë më të kapshme për ta kuptuar, iu lexohen tregime shqiptare, por edhe tregime të kulturave tjera. Përveç përmbytjes, që parashihet nxënësit ta tregojnë, për çdo krijimtari prozaike që e mësojnë hapet debat për atë kur

dhe ku ka ndodhur ngjarja/et, kush janë personazhet dhe cila është renditja e ngjarjeve. Nxënësit mësojnë edhe vjersha, gjëegjëza dhe përgjigjeve të shpejta të cilat i interpretojnë. Ata njihen me librat me ilustrime, libra dhe enciklopedi, me qëllim të zhvillimit të interesit për librin.

Në fushën e *Shprehjes dhe krijimtarisë* nxënësit aftësohen të tregojnë, ritregojnë, përshkruajnë, shpjegojnë dhe i përshkruajnë sipas kujtesës, krijojnë vepra fëmijërore, plotësojnë dhe trillojnë tregime. Në përmbytjet për përpunim në këtë fushë janë edhe lojërat tradicionale me të folur.

Kultura mediale – nxënësit i njohin dhe zbatojnë nocionet TV-lajme, TV-reklama, TV-emisione për fëmijë dhe emisione të radios për fëmijë që dalin nga përmbytjet: emisione televizive dhe të radios. Nxënësit aftësohen të dallojnë film të animuar nga filmi për fëmijë, si dhe serial për fëmijë, dhe gjithashtu duhet të dallojnë shfaqje të kukullave dhe teatrale. Nxënësit njihen me bibliotekën dhe rolin e saj dhe nxiten të përdorin libra nga leximorja e bibliotekës. Gjithashtu, njihen edhe me revistat për fëmijë.

Fusha programore *Përgatitje për leximin fillestar dhe të shkruarit* përmban më shumë qëllime dhe përmbytje mësimore; nxënësit ti dallojnë ilustrimet në tekst, ti njohin fjalinë, fjalën, zërin si elemente të veçanta të gjuhës. Këto elemente të gjuhës nxënësit i njohin, por nuk i definojnë. Nxënësit i shohin dallimet të shkronjat e mëdha dhe të vogla, tërësitë në tekst, kurse njihen se shkruajnë nga e majta në të djathtë. Nxënësit në mënyrë vizuale lexojnë, respektivisht njohin disa terme të cilat më së shpeshti i shohin si p.sh.,

21 Horvatović, V. (2015), Trajtimi i zhvillimit të folurit dhe shkathtësitë komunikuese të fëmijët e moshës parashkollore dhe shkollore. Shkup: Disertacioni i doktoraturës, Instituti i pedagogjisë, Fakulteti pedagogjik, fq.33.

reklama, mbishkrime, etiketa, emrin e vet etj. Nxënësit i dallojnë shkronjat e mëdha të shtypit.

Për realizimin e qëllimeve të programit ekzistojnë aktivitete të parapara dhe ata duhet të kuptohen si shembull i mirë për realizimin e qëllimeve të mësimin. Në nëntitullin *Aktivitete dhe metoda* ka numër të madh të lojërave dhe shembuj për pjesëmarrje aktive në procesin mësimor.²²

2.2. Fusha e zhvillimit kognitiv në Programin për mësim dhe zhvillim të hershëm të fëmijët e moshës 4 deri 6 vjeç

Zhvillimi kognitiv i bashkon disa elemente si: dallimin, përpunimin, organizimin dhe përdorimin adekuat të informatës së dhënë. Procesi i zhvillimit kognitiv përfshin kompleksin e aktiviteteve mendore si hulumtimin, zbulimin, prezantimin, seleksionimin, klasifikimin dhe memorimin, zhvillimin e imagjinatës. Mirëpo, ndikimin ndaj zhvillimit kognitiv fokusohet në nxitjen e të menduarit logjik të fëmijët, zhvillimin e funksioneve mendore (analiza, sinteza, përgjithësimi, konkluzioni, vlerësimi, lidhshmëria), të përvetësimit dhe përdorimit të operacioneve të lehta matematikore dhe numrave, si dhe qasjes shkencore në situatat jetësore, njohjen dhe të kuptuarit e mjedisit, të njerëzve tjerë, botën e gjallë dhe jo të gjallë, pastaj zhvillimin e shkathtësive për përdorimin e perceptcionit shqisor për zhvillimin e procesit të funksioneve mendore në mësim, zbulimin, lidhjen dhe kuptimin. Zhvillimi kognitiv e përfshin edhe ndikimin ndaj aftësive intelektuale të fëmijës, si dhe aftësive interpersonale dhe intrapersonale të fëmijës dhe sipas Programit për mësim dhe zhvillim të hershëm realizohet përmes aspekteve vijuese:

- ▲ logjika dhe të menduarit;
- ▲ matematika;
- ▲ shkenca - njohja dhe të kuptuarit e mjedisit;
- ▲ arti - arsimit figurativ dhe muzikor.

Në Programin për mësim dhe zhvillim të hershëm në kuadër të aspektit njohja kognitive dhe të arriturit e njohurive të përgjithshme, janë definuar qëllimet globale vijuese: të zhvillohen aftësitë për të menduarit; të zhvillohen aftësitë për fitimin dhe përdorimin e informatave të reja; të zhvillohen aftësitë për zgjedhjen aktive të problemeve në pajtim me karakteristikat zhvillimore dhe individuale; të zhvillohen aftësitë për të menduarit kritik; të formohen shprehitë e punës; të zhvillohet pavarësia, kujdesi dhe qëndrueshmëria; fëmijët të aftësohen për përdorimin e procesit të deperceptimit në mësim dhe në të kuptuarit; të aftësohen për përdorimin e nocioneve dhe shfaqjeve të reja dhe lidhjen e tyre në sistemin e njohurive; të pasurohet përvoja si bazë për fitimin e njohurive të reja, shkathtësive dhe mundësive; të nxitet dhe zhvillohet të menduarit logjik. Në drejtim të sigurimit të kompatibilitetit më të madh të Programit për mësim dhe zhvillim të hershëm si dhe programeve mësimore në klasën e parë, në tekstin e mëturshëm do të përqendrohemi në analizën e qëllimeve të matematikës, shkencës/shkencat natyrore, arsimit figurativ dhe muzikor në programet e lartpërmendura. Në bazë të të dhënave të fituara nga fokus grupet me edukatorët mund të konstatohet se pyetja e përputhshmërisë së qëllimeve sipas të gjitha fushave edukative arsimore/lëndët mësimore në këto dy programe është kyçe për sigurimin e kualitetit të punës edukative-arsimore, si dhe sigurimin e përgatitjes së plotë të

22 Njëjtë.

fëmijës të nis në shkollë, në përputhje me standardet ndërkombëtare për mësim dhe zhvillim të hershëm. Sipas mendimit të edukatorëve i patjetërsueshëm është avancimi i Programit për mësim dhe zhvillim të hershëm në drejtim të sigurimit të përputhshmërisë së qëllimeve në kuadër të Gjuhës, komunikimit dhe zhvillimit të shkrim-leximit, Matematikës, Shkencave natyrore, Arsimit figurativ dhe Arsimit muzikor me qëllimet e Programeve mësimore në klasë të parë të arsimit nëntëvjeçar. Gjithashtu, ata e theksojnë nevojën e konkretizimit më të madh të qëllimeve në Programin për mësim dhe zhvillim të hershëm për çdo aspekt të zhvillimit dhe të gjitha periudhave zhvillimore të fëmijët e moshës prej 4 deri në 6 vjet.

2.2.1. Analiza e qëllimeve të fushës programore – Matematikë në Programin për mësim dhe zhvillim të hershëm të fëmijët prej 4 deri në 6 vjeç

Për aplikimin e matematikës të fëmijët e moshës prej 4 deri në 6 vjeç në Programin për mësim dhe zhvillim të hershëm janë definuar standardet vijuese: fëmija demonstroi njohuri për masën, numrat dhe numërimin si dhe fëmija demonstroi aftësi për klasifikim dhe serializim.

Gjithashtu, në program janë dhënë edhe qëllimet konkrete dhe rezultatet e pritshme. Për qartësi më të madhe të qëllimeve dhe rezultateve të pritshme nga matematika për fëmijët e moshës prej 4 deri në 6 vjet, të njëjtat i paraqesim në mënyrë tabelore.

Qëllimet	Rezultatet e pritura
Periudha zhvillimore prej 4 - 5 vjeç	
<ul style="list-style-type: none"> ▲ te fëmija të nxiten aftësitë për perceptim vizual dhe emërtim të disa numrave (që janë jashtë vargut); ▲ të nxitet revirzibiliteti në përdorimin e operacioneve të thjeshta matematikore; ▲ të zhvillohen aftësitë për orientim në hapësirë dhe paraqitje verbale të relacioneve - vërejtjen e relacioneve në raport me veten (para-pas; lartë-poshtë,nën,afër-larg, në-të); ▲ të nxiten aftësitë për vërejtjen dhe identifikimin e relacioneve të pjesëve nga tërësia; ▲ të nxiten aftësitë për emërtimin e elementeve dhe relacioneve të sendeve jashtë shqisore (sende të cilat nuk i sheh; ▲ të nxiten aftësitë për lidhje të sasive me simbolet e numrave (shifra); ▲ të zhvillohen aftësitë për përcaktimin dhe dallimin e relacioneve kohore (pjesë të ditës- mëngjes- drekë, darkë-ditë-natë, sot); ▲ të nxiten aftësitë për përdorimin e termeve dhe operacioneve matematikore në mjedis; ▲ të zhvillohen aftësitë për vërejtjen dhe krahasimin e dallimeve te sendet; ▲ të zhvillohen aftësitë për krahasimin e shpejtësisë; ▲ të nxitet përdorimi i masave standarde dhe jo standarde për matje dhe krahasim të sendeve; ▲ të zhvillohen aftësitë për klasifikim, krahasim dhe seriacion sipas ngjyrës, formës, madhësisë, llojit dhe gjinisë; ▲ të zhvillohet vetëdija për sasinë e numrave (deri në 5); ▲ të nxitet përjetimi i matematikës si përvojë e mirë; ▲ të nxitet formimi i iniciativës, durimit, qëndrueshmërisë, kureshtjes, precizitetit si cilësi të personalitetit. 	<ul style="list-style-type: none"> ▲ fëmija tregon dhe emërton çka ka para-pas tij, lartë-poshtë, në-të, afër-larg tij. ▲ përdorë nocione të kundërta: gjerë; shkurt-më shkurtë- shumë shkurtë; e madhe-më e madhe-shumë e madhe; e vogël-më e vogël-shumë e vogël; e shkurtë- e gjatë, e ulur- e lartë; e ngushtë- e gjerë. ▲ i rendit sendet sipas një cilësie sipas serisë së rritjes ose sipas serisë së zvogëlimit. ▲ i klasifikon sendet sipas karakteristikave të dukshme(ngjyra, forma, madhësia, lloji, gjinia). ▲ i klasifikon sendet funksioneve të njohura dhe të praktikuara (për lojë, për lexim, për ngrënie...). ▲ i përdor operacionet matematikore në situata praktike - i ndanë lojërat sipas numrit të fëmijëve (çdonjërit nga një, dy, tre...). ▲ grupon sende sipas karakteristikave të kërkuara. ▲ përdor dhe lidh numrin e elementeve në shumës të shifrave adekuate (p.sh. nga 1 deri në 5. ▲ numëron deri në 10. ▲ i dallon simbolet grafike (shifrat) të numrave deri në 10. ▲ i lidh numrat (shifrat) me sasinë. ▲ i dallon monedhat prej 1,2,5, 10 denarë. ▲ e kupton vlerën e monedhave dhe bankënotave prej 10 denarë. ▲ dallon largësinë dhe shpejtësinë në mes dy ose tre sendeve në lëvizje. ▲ përdorë instrumente për matjen e masës dhe gjatësisë me masa standarde dhe jo standarde për matje. ▲ dallon pjesë të ditës, i di karakteristikat dhe i lidh me obligimet e veta.

Periudha zhvillimore prej 5 deri në 6 vjeç

- ▲ të aftësohet për perceptim vizual dhe emërtimin e disa numrave (të cilët janë në ose jashtë serisë);
- ▲ të aplikohet reverzibilitet në përdorimin e proceseve të thjeshta matematikore;
- ▲ të aftësohet për orientim hapësinor dhe prezantim verbal të relacioneve mes sendeve (vërejtje të relacioneve në raport me veten para-pas; lartë-poshtë, mbi-nën, afër -larg, përskaj);
- ▲ të aftësohet për orientim hapësinor dhe prezantim verbale të relacioneve mes sendeve (vërejtjen e relacioneve në raport me sendet tjera: para-pas; lartë-poshtë, mbi-nën, afër-larg, përskaj);
- ▲ të zhvilloj aftësi për vërejtjen dhe identifikimin e pjesëve nga tërësia;
- ▲ të aftësohet për dallimin e shifrave prej një deri në pesë;
- ▲ të aplikohet për aprovimi termi për sasinë (numri i elementeve);
- ▲ të nxitet aftësia për lidhjen e sasisë (numrit të elementeve) me simbolet e numrave (shifrave);
- ▲ të aftësohet për përcaktimin dhe njohjen e relacioneve kohore (pjesë të ditës: mëngjes- drekë-darkë, ditë-natë, sot);
- ▲ të nxitet në përdorimin e termeve matematikore në rrethinë;
- ▲ të aftësohet për vërejtje dhe krahasim të dallimeve të sendet;
- ▲ të zhvilloj aftësi për krahasimin e shpejtësisë;
- ▲ të nxitet në përdorimin e masave standarde dhe jostandarde për matjen e gjatësisë;
- ▲ të nxitet për vlerësimin e sasisë dhe gjatësisë dhe atë ta kontrolloj me matje dhe numërim;
- ▲ të aftësohet për vërejtje vizuale më precize dhe prezantim verbal të dallimeve në madhësi dhe gjatësi të disa objekte dhe sende;
- ▲ të aftësohet për klasifikim dhe radhitje sipas ngjyrës, formës, madhësisë, llojit dhe gjinisë;
- ▲ të nxitet për vërejtje, dallim dhe emërtim të rrethit, katrorit, trekëndëshit, topit dhe kuadrit;
- ▲ të nxitet për përjetimin e matematikës si përvojë e mirë;
- ▲ të nxitet formimi i cilësive të personalitetit: iniciativës, durimit, qëndrueshmërisë, kureshtjes, precizitetit.
- ▲ tregon orientim hapësinor për pozicionet para-pas, lartë-poshtë, në-të, afër-larg.
- ▲ tregon dhe emërton send që është larg dhe afër në raport veten.
- ▲ përdor terme të kundërta: shkurtë-gjatë, ulët-lartë.
- ▲ krahason dhe emërton sende sipas gjatësisë dhe madhësisë: shkurtë-më shkurtë-shumë shkurtë; e madhe- më e madhe- shumë e madhe; e vogël, më e vogël-shumë e vogël etj.
- ▲ rendit sende në bazë të një cilësie sipas serisë së rritjes ose serisë së zvogëlimit.
- ▲ i klasifikon sendet sipas karakteristikave të dukshme (ngjyra, forma, madhësia, lloji, gjinia).
- ▲ i klasifikon sendet sipas funksioneve të njohura dhe të praktikuara (për lojë, për ndenje, për ngrënie...).
- ▲ i përdor operacionet matematikore në situata praktike – i ndanë lojërat sipas numrit të fëmijëve (çdonjërit nga një, dy, tre...).
- ▲ i kupton dhe mundet ti grupojë sendet sipas karakteristikave të kërkuara.
- ▲ mundet të përdor dhe ti lidh numrin e elementeve me shifra adekuate (p.sh. prej 1 deri në 5).
- ▲ di të numëroj deri në 10.
- ▲ i dallon simbolet grafike (shifrat) të numrave deri në 5.
- ▲ i njeh monedhat prej 1, 2, 5, denarë.
- ▲ dallon dhe vlerëson largësi dhe shpejtësi në mes dy sendeve në lëvizje.
- ▲ përdor masa standarde dhe jostandarde për matjen e gjatësisë në mjedis.
- ▲ dallon pjesë të ditës, di karakteristikat dhe i lidh me obligimet e veta.
- ▲ përshkruan një ngjarje që ka ndodhur në mëngjes, drekë dhe darkë.
- ▲ tregon dhe emërton rreth, katror, trekëndësh, top dhe kub në mjedisin e afërt.

2.2.2. Analiza e qëllimeve të Programit mësimor në Matematikë për klasën e parë

Sipas planit mësimor për klasën e parë, lëndë e Matematikës detyrimisht mësohet me 5 orë në javë.

Programi mësimor nga Matematika e klasës së parë të arsimit nëntëvjeçar është program i përpiluar nga Qendra ndërkombëtare për programe mësimore Kembrixh (Cambridge International Examination) dhe e adaptuar nga ana e Byrosë për Zhvillimin e Arsimit. Ajo përmban qëllime mësimore zhvillimore të lëndës së matematikës. Në mënyrë të detajuar përshkruhet çka duhet të di ose çka mund të bëjë nxënësi në klasë të parë në shkollimin fillor. Qëllimet mësimore sigurojnë strukturë për mësim dhe rekomandime se cilat aftësi dhe njohuri të nxënësit mund të kontrollohen.

Programi mësimor nga matematika është e ndarë në pesë fusha: *Numërimi/ Operacione matematikore, Gjeometri, Matje, Puna me të dhëna dhe Zgjidhja e problemeve*. Katër fushat e para janë të mbuluara me nënfushën Zgjidhja e problemeve, në të cilën janë përshkruar teknikat, shkathtësitë dhe aplikimi i njohurive dhe strategjive në zgjidhjen e problemeve. Strategjitë ideore janë, gjithashtu, pjesë kyçe e nënfushës Numrat. Ky program mësimor fokusohet në parime, skema, sisteme, funksione dhe raporte ashtu që nxënësit mund ti aplikojnë njohurit matematikore dhe të zhvillojnë të kuptuarit holistik të lëndës. Programi mësimor nga matematika për klasën e parë të shkollimit fillor jep bazë solide të njohurive matematikore të cilat në klasat vijuese do të zgjerohen dhe thellohen.

Në kuadër të temës **Numrat dhe sistemi i numrave** nga nxënësi pritet: të tregoj

numra me radhë (nga 1 deri 100, prapa nga 20 deri 0); të filloj të shkruaj shifra prej 0 deri 9; të lexoj dhe të filloj të shkruaj numra prej 0 deri në 20; të numëroj sende deri në 20 dhe ta lidh sasinë me numër adekuat; të numëroj nga dhjetë prej zero deri në 100 (p.sh. 10, 20, 30....100), të numëroj nga dhjetë deri në 100 ose diçka mbi 100, duke nisur nga numër konkret njëshifror; të numëroj nga dy, nis të dalloj numra çift/tek deri në 20 (p.sh. 2,4,6,... ose 1,3,5...); të nis t'i ndajë numrat dyshifror në dhjetëshe dhe njëshe dhe anasjelltas; të tregoj cili numër është për 1 ose për 10 më i madh ose më i vogël nga cili do qoftë numër i dhënë prej 0 deri në 30; të përdorë termin më i madh ose më i vogël që të krahasojë dy numra deri 30 dhe të tregoj çka gjendet midis tyre; të përdorë terme më shumë ose më pak për krahasim të grupeve të sendeve; ta përdorë shenjën „=" për të treguar barazimin; të bëjë vlerësim të arsyeshëm për disa sende që mund të kontrollohen me numërim deri në 30; të dallojë gjysmën e numrave çift deri në 10, të përgjysmojë format me palosje dhe të dallojë cilat forma janë përgjysmuar.

Në temën **Operacionet matematikore** fëmija duhet: të gjitha çiftet e numrave shuma e të cilave është 10 dhe atë ta lidh me mbledhje/zbritje; të filloj ti mësoj çiftet e numrave shuma e të cilave është 6, 7, 8, 9 dhe 10; të mbledh tre numra njëshifror, gjatë së cilës shuma e dy nga ata është 10, p.sh. $4 + 3 + 6 = 10 + 3$; të filloj ti përdor çiftet e numrave shuma e të cilave është 10 për mbledhje/zbritje deri në 20 (p.sh. që të mblidhet $8 + 3, 8$ i shtohet 2, pastaj shtohet 1); të mbledh mbledhës të njëjtë deri më së paku $5+5$; ti përdor njohurit për mbledhjen e e çifteve të mbledhësve të njëjtë, gjatë mbledhjes së dy mbledhësve të ndryshëm, p.sh. $5 + 6$; të filloj të numëroj nga 2 dhe nga 10; ta kuptoj mbledhjen si numërim

para dhe kombinim të dy madhësive, ta dallojë mbledhjen në situata konkrete; ta kuptoj zbritjen si numërim nga prapa dhe zbritje të një madhësie nga tjetra, ta dallojë zbritjen në situata konkrete; ta kuptoj dallimin midis mbledhjes (edhe sa duhet deri...?) të mbledh/zbrit numra njëshifror me numërim para/prapa; të gjej për dy më shumë ose për dy më pak nga një deri në 20, duke i vërejtur kërcimet në seri të numrave; ta lidh numërimin para dhe prapa nga dhjetë për të gjetur numrat të cilët janë për 10 më të mëdhenj/ më të vogël nga një numër (deri në 100); të filloj ti dallojë shenjat „+“, „-“ dhe „=“ në shprehjet matematikore që kanë të bëjnë me mbledhjen ose zbritjen; të kuptoj se ndryshimi i renditjes së mbledhësve nuk e ndryshon shumën; të mbledh çifte numrash deri në 20 duke nisur nga më i madhi me rinumërim; ta njohë përdorimin e shenjës ■ në vend të numrit të panjohur gjatë mbledhjes/zbritjes, p.sh. $6 + \blacksquare = 10$; $10 - \blacksquare = 6$; të fillojë të mbledhë numra njëshifror me numra njëshifror dhe numra dyshifror me numër njëshifror; ta gjejë gjysmën e numrave çift deri në 10; të mundohet të zbret numra deri 10 që të vërtetoj se cilat numra janë çift, dhe cilët tek; të ndaj sendet në dy grupe të njëjta.

Në kuadër të temës **Gjeometria** nga nxënësi pritet: të emërtojë dhe të dallojë forma të thjeshta 2D (p.sh. radhë, katrorë, drejtkëndësha dhe trekëndësha) duke i dalluar sipas numrit të faqeve, sipas vijave të drejta ose të lakuara; ti përdor për të bërë skema dhe modele; ta njoh vijën themelore të simetrisë; të potencoj dhe të dallojë forma 3D (p.sh. kubi katrori, cilindri, koni dhe topi) duke i dalluar sipas numrit të sipërfaqeve dhe sipas sipërfaqeve të rrashta dhe të rrumbullakuara; ti përdorë për të bërë skema dhe modele; të përdorë shprehje të zakonshme për kahe

dhe largësi, që t'i përshkruajë lëvizjet e sendeve.

Matje – nga nxënësi pritet: t'i njeh të gjitha monedhat; të llogarisë si të paguajë shumën e saktë me përdorimin e monedhave të vogla; *gjatësia, masa dhe vëllimi*; të krahasojë gjatësitë dhe peshat me krahasim të drejtpërdrejtë, pastaj me përdorimin e njësive të zakonshme standarde; të përdorë gjuhë krahasuese, p.sh. më gjatë, më shkurtë, më rëndë, më lehtë; të filloj të kuptoj dhe të përdorë disa njësi për kohën, p.sh., minuta, orë, ditë, javë, muaj dhe vite; ta lexojë kohën (orën) dhe t'i njeh kohët kryesore të ditës; t'i rendit ditët e javës dhe ngjarjet tjera të njohura.

Në temën Puna me të dhëna nga nxënësi pritet: të përgjigjet në pyetje me nxjerrjen dhe organizimin e të dhënave ose lëndëve në mënyra të ndryshme, p.sh. me përdorimin e grafikonëve dhe piktogramëve me mjete praktike; bisedë për rezultatet e vendosura në lista dhe tabela me mjete praktike; bisedë për rezultatet në diagramin e Venit dhe Kerolit me vendosje të kriterëve të ndryshme për grupim të sendeve të njëjta.

Në Programin mësimor nga matematika për klasën e parë, për shkak të rolit dhe rëndësisë së saj në zhvillimin e të menduarit matematikoro-logjik, rëndësi të veçantë i jepet temës **Zgjidhja e problemeve**. Përmes realizimit të qëllimeve konkrete nga nxënësi pritet që të mund: të zgjedh dhe të përdor strategji adekuate për llogaritje dhe ta sqaroj procedurën; të zbatoj njohurit në zgjedhjen e problemeve me numra dhe zgjidhjen e enigmave; të gjejë më shumë kombinime, psh. në sa mënyra mund të renditen tre sende të ndryshme; të vendos vallë të përdorë mbledhje ose zbritje për zgjedhjen e problemeve të thjeshta të prezantuara në mënyrë verbale dhe ta

paraqes me përdorimin e sendeve; ta kontrollojnë përgjigjen me mbledhjen e numrave sipas renditjeve të ndryshme; ta kontrolloj përgjigjen e detyrës për zbritje me mbledhje të përgjigjes dhe numrit më të vogël; ta sqaroj dhe ta vazhdoj serinë, siç është numërimi nga dhjetë para dhe pas, p.sh. 90, 80, 70; t'i njeh relacionet e thjeshta mes numrave, p.sh., ky numër është për dhjetë më i madh se ai numër; t'i njohë relacionet e thjeshta mes formave, p.sh., ky top është më i vogël se ai; të bëjë vlerësim të arsyeshëm të llogaritjes dhe ta kontrollojnë të njëjtën.

2.2.3. Analiza e qëllimeve në fushën programore – Shkenca në Programin për mësim dhe zhvillim të hershëm të fëmijët prej 4 - 6 vjeç

Në Programin për mësim dhe zhvillim të hershëm në kuadër të fushës programore Shkencë (Njohja dhe kuptimi i mjedisit) janë definuar standardet vijuese: fëmija fiton informata nga mjedisi përmes vëzhgimit dhe manipulimit; fëmija i vëzhgon dhe i përshkruan karakteristikat e botës së gjallë (bimët dhe shtazët); fëmija i vëzhgon dhe i përshkruan karakteristikat e botës jo të gjallë; fëmija e njeh njeriun si qenie e gjallë dhe shoqërore. Në kuadër të këtij programi, për fëmijët e moshës prej 4 deri në 6 vjet në program janë dhënë edhe qëllimet dhe rezultatet e pritura vijuese.

Qëllimet	Rezultatet e pritura
Periudha zhvillimore prej 4 - 5 vjeç	
<ul style="list-style-type: none"> ▲ Të fitohen njohuri dhe aftësi për përcaktimin e relacioneve kohore (muaj; ditë të javës; ditë-natë; periudha gjatë ditës); ▲ të zhvillohen aftësitë për njohjen dhe klasifikimin e kafshëve sipas vendit ku jetojnë, sipas llojit dhe karakteristikave; ▲ të nxitet interesi dhe dashuria ndaj natyrës; ▲ të nxitet nevoja për përdorimin e hulumtimit si formë e të mësuarit; ▲ të fitohen njohuri dhe aftësi për njohjen dhe klasifikimin e bimëve; ▲ të nxitet procesi i njohjes së disa faktorëve themelorë dhe kushteve për ekzistimin dhe zhvillimin e botës së gjallë; ▲ të nxitet zhvillimi i vetëdijes për rolin individual në përkrahjen e mbijetesës së natyrës; ▲ të zhvillohen aftësitë për njohjen e cilësive themelore të disa elementeve natyrore, dukurive dhe termeve gjeografike nga mjedisi; ▲ të nxitin aftësitë për fitimin e njohurive themelore për njeriun si qenie natyrore dhe sociale; ▲ të zhvillohen aftësitë për njohjen e stinëve të vitit; ▲ të nxitet interesi drejtë qasjes shkencore në studimin dhe njohjen e natyrës, bimëve, kafshëve dhe njeriut; ▲ të nxitin disa shfaqje dhe terme nga fusha e kulturës së komunikacionit dhe teknikës bashkëkohore dhe teknologjisë së komunikimit; ▲ të nxitet fleksibiliteti dhe mendimi divergjent në aspekt të përdorimit dhe kombinimit të mjeteve në dispozicion në hulumtimin e mjedisit; ▲ të nxitet pranimi i ekologjisë si pjesë e mënyrës bashkëkohore të jetesës; ▲ të nxitin aftësitë për përdorimin e hulumtimit dhe vëzhgimit si mjet për njohje dhe mësim. 	<ul style="list-style-type: none"> ▲ i dallon ngjashmëritë të sendet në mjedis sipas ngjyrës, formës, madhësisë. ▲ i klasifikon kafshët që i takon në mjedis dhe përmes tregimeve sipas vendit ku jetojnë, sipas llojit dhe karakteristikave. ▲ tregon kujdes ndaj kafshëve dhe natyrës. ▲ i dallon kushtet për kultivimin e bimëve dhe kafshëve nga mjedisi i afërt. ▲ i njeh dobitë dhe rreziqet nda disa kafshë dhe bimë. ▲ bën dallim midis disa elementeve dhe dukurive natyrore dhe termeve gjeografike nga mjedisi i afërt. ▲ përshkruan disa karakteristika të njeriut si qenie natyrore dhe sociale. ▲ përshkruan dhe emërton disa karakteristika të stinëve të vitit. ▲ përdor sende standarde për hulumtim. ▲ eksperimenton dhe përdor materiale të ndryshme të sigurta dhe sende nga mjedisi (baltë, rërë, letër, ujë, avull etj.). ▲ Dallon mjete teknike elementare për komunikim të përditshëm. ▲ dallon dhe merr pjesë në aktivitete për aplikimin e kulturës ekologjike.

Periudha zhvillimore prej 5 - 6 vjeç

- ▲ Fëmija të aftësohet për njohjen e mjedisit, karakteristikat, veçoritë e vendit ku jeton, çerdhes;
- ▲ të njihet me mjedisin shoqëror në të cilin jeton, si dhe me disa institucione shoqërore dhe dedikim e tyre;
- ▲ të njihet me simbolet shtetërore, ekzistimin e të drejtave të fëmijëve, si parime të jetesës demokratike;
- ▲ të aftësohet për përcaktimin e relacioneve kohore (muaj; ditë të javës; ditë - natë; periudha të ditës);
- ▲ të nxitet për njohje dhe zbulim të cilësive të trupave dhe sendeve (tredimensionaliteti, gjendja agregate, fortësia, nxehtësia, aroma, tërheqja etj.);
- ▲ të nxitet drejt njohjes dhe zbulimit të cilësive, rëndësisë dhe aplikimin e ujit, ajrit, tokës, dritës, zërit;
- ▲ të fitojë njohje elementare për planetin Tokë;
- ▲ të aftësohet për njohjen e disa termeve gjeografike nga mjedisi;
- ▲ të njihet me dukurit meteorologjike dhe raste atmosferike nga mjedisi i afërt;
- ▲ të aftësohet për njohjen dhe prezantimin verbal të karakteristikave të stinëve të vitit;
- ▲ të aftësohet për njohjen dhe klasifikimin e kafshëve sipas vendit dhe kushteve të jetesës; karakteristikat, dobia nga ata, si dhe mënyrat e sjelljes së sigurt;
- ▲ të nxitet interesi dhe dashuria ndaj natyrës dhe sigurimi i përkrahjes së kureshtjes të shprehjes së pyetjeve fëmijërore;
- ▲ të aftësohet për përdorimin e hulumtimit si formë e mësimi;
- ▲ të aftësohet për njohjen dhe klasifikimin e bimëve, disa lloje, karakteristikat e tyre, kushtet për rritje, zhvillim, përdorim, zbatim dhe rëndësinë për mbijetesën e përgjithshme në planetin Tokë;
- ▲ të aftësohet për zbulimin dhe respektimin e faktorëve themelor dhe kushtet për mbijetesë dhe për zhvillimin e botës së gjallë;
- ▲ të nxitet drejt vetëdijes për rolin individual në përkrahjen e mbijetesës së natyrës;
- ▲ të nxitet për raport të drejtë ndaj vlerave materiale (ushqimi, uji, energjia) dhe zhvillimin e sjelljes së përgjegjshme;
- ▲ të aftësohet për fitimin e njohurive themelore për njeriun si qenie natyrore dhe sociale;
- ▲ të zhvillojë vetëdije për përkatësi dhe varësi të ndërsjellë në mbijetesën e natyrës së gjallë;
- ▲ të krijojë interes ndaj qasjes shkencore në studimin dhe njohjen e natyrës, bimëve, shtazëve dhe njeriut;
- ▲ të nxitet drejtë zhvillimit të kulturës së komunikacionit dhe aplikimin e teknikave bashkëkohore dhe teknologjisë së komunikimit;
- ▲ të aftësohet për mendim fleksibil dhe divergjent në procesin e hulumtimit, zbulimit dhe mësimi;
- ▲ të nxitet vetëdija ekologjike dhe pranimi i ekologjisë si pjesë e mënyrës bashkëkohore të jetesës.
- ▲ Njih disa karakteristika, veçori të vendit ku jeton dhe çerdhes.
- ▲ e dallon ditën dhe natën dhe periudhat e ditës (në mëngjes, në drekë, në darkë) si dhe java e muajit.
- ▲ i numëron cilësitë themelore të ujit dhe ajrit.
- ▲ numëron disa karakteristika gjeografike të mjedisit në të cilin jeton (mal, lum, kodër, fushë etj).
- ▲ dallon dhe emërton disa dukuri meteorologjike (shi, borë, erë, brymë etj).
- ▲ mund të përshkruajë dhe emërtojë disa karakteristika të stinëve të vitit.
- ▲ i klasifikon shtazët të cilat i takon në mjedis dhe përmes tregimeve sipas vendit të jetesës, sipas karakteristikave, dobitë nga ata.
- ▲ numëron disa mënyra për raport të kujdesshëm ndaj shtazëve dhe natyrës.
- ▲ i njeh kushtet për kultivimin e bimëve dhe shtazëve të mjedisit të afërt.
- ▲ emërton dhe dallon disa karakteristika, lloje, përdorim dhe dobitë nga bimët.
- ▲ njih ndonjë nga dobitë, rreziqet nga disa shtazë dhe bimë.
- ▲ numëron ngjashmëritë midis qenieve të gjalla (rritet, zhvillohet, ushqehet, pranon ujë, merr frymë etj.).
- ▲ përdor disa mjete gjatë aktiviteteve hulumtuese (xham zmadhues, magnet, dylbi, termometër etj.).
- ▲ mundet të përshkruajë disa karakteristika të njeriut si qenie natyrore dhe sociale.
- ▲ mundet të përshkruaj disa shembuj të qasjes së drejtë ndaj vlerave materiale (përdorimin e ushqimit, energjisë dhe materialeve në çerdhe).
- ▲ mund të numërojë disa cilësi të njeriut si qenie e gjallë (lindet, rritet, ushqehet, shumohet, plaket, vdes).
- ▲ mund të numëroj disa nga kushtet për mirëmbajtjen e shëndetit (higjiena personale, ajri i pastër, uji, ushqimi i shëndetshëm, veshja dhe sjellje adekuate në kushte të ndryshme klimatike etj).
- ▲ mundet të përdor materiale të ndryshme të sigurta dhe sende nga mjedisi (baltë, rërë, letër, uji, avull etj.).
- ▲ mundet të njih mjete elementare për komunikim të përditshëm (telefon, kompjuter, TV etj).
- ▲ numëron pesë deri gjashtë mjete të komunikacionit.
- ▲ e përshkruan semaforin dhe potencon çka do të thonë dritat.
- ▲ Në qilimin e komunikacionit tregon se si duhet drejtë dhe me kulturë të lëvizet këmbësori, ku dhe si të kalohet rruga.
- ▲ njih dhe merr pjesë në aktivitetet për aplikimin e rregullave për kulturën ekologjike.

2.2.4. Analiza e qëllimeve të lëndës shkencat natyrore në Programin mësimor për klasën e parë

Qëllimet e lëndës mësimore Shkencat natyrore grupohen në gjashtë njësi tematike të cilat janë dhënë sipas një renditje, por mund të realizohen me nxënësit ashtu siç diktojnë kushtet lokale, mjetet dhe materialet për mësim. Qëllimet e hulumtimit shkencor përsëriten, paraqiten në çdo temë dhe si të tilla përmenden veçmas në fillim të secilës temë. Në Programin mësimor për klasën e parë ka gjashtë tema të cilat mundësojnë klasifikimin në mësimin e përmbajtjeve mësimore të biologjisë, kimisë dhe fizikës. Aktivitetet dhe resurset (mjetet dhe materialit) janë propozuar sipas qëllimeve të dhëna në mësim, që të tregojnë metoda dhe aktivitete të mundshme për realizim të suksesshëm në program.

Në kuadër të fushës **Hulumtimi shkencor** - Ide dhe fakte nga nxënësi pritet: të mundohet të përgjigjet në pyetjet me mbledhjen e argumenteve përmes vëzhgimit. Përmes planifikimit të punës hulumtuese nga nxënësi pritet: të parashtrijë pyetje dhe të merr pjesë në debat që të vij deri te përgjigja; të parasheh; të vendos çka të bëjë që të përgjigjet në pyetjen shkencore. Në këtë fushë programore përmes mbledhjes dhe prezantimit të argumenteve nga nxënësi pritet: të hulumtoj, të vëzhgojë dhe të mbledh argumente (matje dhe vëzhgim) që të përgjigjet në pyetjet; të propozojë ide dhe ti ndjek rekomandimet; të evidentoj faza në punë: Nga nxënësi pritet edhe t'i shqyrtojë argumentet; të bëjë krahasime; t'i krahasoj parashikimet me rezultatet e fituara; të krijoj ide dhe të diskutoj për ata me qëllim që t'i ndajë, sqarojë dhe zhvillojë.

Në kuadër të temës në **Biologji** nxënësit mësojnë për bimët, njerëzit dhe shtazët. Realizimi i qëllimeve të kësaj teme duhet të mundësojnë që nxënësi: të dijë se bimët janë të gjalla; të dijë se ekzistojnë gjëra të gjalla dhe gjëra të cilat asnjëherë s'kanë qenë të gjalla; të hulumtojë mënyra në të cilat shtazë dhe bimë të ndryshme i popullojnë mjediset jetësore lokale; të emërtojë pjesët kryesore të bimës, duke vëzhguar bimë të vërteta dhe modele; të dijë se bimëve iu duhet dritë dhe ujë për rritje; të hulumtojë se si prej farave zhvillohen bimët; të njeh dallimet dhe ngjashmëritë; të njeh dhe të emërtojë pjesë kryesore të jashtme të trupit; të dijë për nevojën e ushqimit të shëndetshëm, i cili përfshin ushqim të ndryshëm dhe ujë të pastër; të hulumtojë si përmes shqisave njerëzit dhe shtazët bëhen të vetëdijshëm për botën rreth tyre; të dijë se edhe njerëzit dhe shtazët krijojnë pasardhës të rinj të cilët pastaj rriten.

Në kuadër të temës në **Kimi** nxënësi njihet me cilësitë e materialeve. Gjatë asaj nga ai pritet: t'i përdorë shqisat që të hulumtojë dhe të sqarojë për materialet e ndryshme; t'i identifikojë karakteristikat e materialeve të ndryshme; të njeh dhe të emërtojë materiale nga jeta e përditshme; të seleksionojë sende në grupe në bazë të cilësive të materialeve nga të cilat janë bërë.

Duke e mësuar temën **Fizika** nxënësi fiton njohuri themelore për fuqinë dhe zërin. Gjatë asaj pritet: të hulumtoj, bisedoj dhe përshkruaj lëvizjet e gjërave të njohura; të njeh fuqinë e shtyrjes dhe tërheqjes; të njeh se kur gjërat shpejtohen, ngadalësohen ose e ndërrojnë kahun, ekziston arsye për atë; të identifikojë më tepër burime të zërave; të dijë se dëgjojmë kur zëri hyn në veshin tonë; të njeh se zëri më pak dëgjohet kur largohemi nga burimi.

Në kuadër të fushës programore **Arti**, në Programin për mësimin dhe zhvillimin e hershëm, janë bashkuar arsimit figurativ dhe muzikor. Për realizimin e tyre janë definuar standardet vijuese: fëmija demonstroi aftësi për pjesëmarrje në aktivitetin muzikor; fëmija demonstroi interes për pjesëmarrje në forma të ndryshme të kreativitetit vizual. Në tabelën në vijim janë prezantuar qëllimet dhe rezultatet e pritura në fushën programore **Arti** për fëmijë të moshës prej 4 deri në 6 vjeç.

Qëllimet	Rezultatet e pritura
Periudha zhvillimore prej 4 deri në 5 vjeç	
<ul style="list-style-type: none"> ▲ Të nxitet aftësia e fëmijës për hulumtim, krahasim, emërtimin e ngjyrave, teksturës hapësirë, format, format e sendeve në dy ose tre dimensione; ▲ të zhvillohet aftësia për përdorimin e drejtë të materialit figurativ; ▲ të aftësohet për vështrimin dhe zgjedhjen e materialeve nga mjedisi i afërt për shprehje figurative; ▲ të nxitet interesi ndaj modelimit, formave më të ndërlikuara të sendeve, shtazëve, njeriut; ▲ të zhvillohen aftësi për hulumtim dhe zbulimin e materialeve dhe teknikave të ndryshme figurative, kombinimet e tyre; ▲ të zhvillohen aftësitë për krijimtari figurative vetanake, tandemë dhe kolektive; ▲ të zhvillohen aftësitë për hulumtim dhe dallimin e disa tingujve, zërave, zhurmë, lëvizje; ▲ të zhvillohen aftësitë për këndim individual dhe këndim në korr; ▲ të zhvillohen aftësitë për perceptim, këndim të melodive të thjeshta me ritëm dhe ecuri të ndryshme; ▲ të zhvillohen aftësitë për dëgjim aktiv të muzikës; ▲ të nxitin aftësitë për observim, dëgjim dhe imagjinatë sipas përjetimeve përmes aktiviteteve muzikore; ▲ të njih dhe të emërtojë disa instrumente muzikore të fëmijëve dhe tjera; ▲ të nxitin aftësitë e krijimtarisë muzikore; ▲ të zhvillohen aftësitë për reagim sipas shqisave për shikim, dëgjim, shije, prekje si dhe sipas përvojave dhe përjetimeve; ▲ të zhvillohen aftësitë për përdorimin e materialeve të ndryshme, instrumenteve, sendeve dhe resurseve tjera të kapshme për hulumtim të ideve dhe ndjenjave personale kreative; ▲ të nxitet interesi deh dashuria për vallëzim dhe shprehje kreative përmes lëvizjes së trupit; ▲ të nxitet interesi për pjesëmarrje në aktivitet muzikore dhe figurative; ▲ të zhvillohet interesi dhe dashuria për muzikën popullore tradicionale dhe valleve popullore tradicionale; ▲ të zhvillohen aftësitë për përjetim estetik të mjedisit; ▲ të nxitet senzibiliteti në raport të përdorimit selektiv të llojeve të ndryshme të shprehjes muzikore dhe figurative; ▲ të nxitet zhvillimi i vlerave personale përmes përdorimit të arsimit figurativ dhe muzikore. 	<ul style="list-style-type: none"> ▲ Vizaton forma të thjeshta. ▲ Vizaton dhe pikturon me material të ndryshëm figurativ. ▲ Dallon dhe emërton ngjyra themelore dhe disa ngjyra sekondare. ▲ Emërton dhe përdor disa materiale figurative, mjete. ▲ Merr pjesë në hulumtimin e mënyrave të ndryshme të shprehjes figurative (përdor gishta në vend të brushës, materiale të ndryshme, pajisje, sende të natyrave të ndryshme dhe me dedikim të ndryshëm). ▲ Dallon dhe emërton disa materiale me të cilat mund të formësohet. ▲ Formëson forma të thjeshta dhe konstruktive sipas dëshirës së vet. ▲ Përmes modelimit i tregon karakteristikat themelore të formave të ndryshme (sende, njerëz, shtazë). ▲ Në mënyrë të pavarur zgjedh materiale, i hulumton cilësitë e tyre dhe i përdor në procesin krijues. ▲ Tregon interes për përpunimin e sendeve të ndryshme dhe shprehje figurative të pavarur. ▲ Pavarësisht këndon këngë dhe njih ritmet e ndryshme muzikore. ▲ Njih dhe dallon këngë fëmijësh prej këngëve tjera. ▲ Këndon me përcjellje instrumentale. ▲ E dallon muzikën vokale nga ajo instrumentale ▲ Njih dhe emërton disa instrumente të fëmijëve dhe instrumente tjera. ▲ Tregon interes për dëgjim të muzikës dhe këndon në vete gjatë kryerjes së ndonjë aktiviteti tjetër. ▲ Dallon fjalë të këngëve të pëlqyera dhe imiton lëvizje të këngëtarëve, valltarëve që i pëlqen. ▲ Tregon pavarësi më të madhe gjatë zgjedhjes së këngës, muzikës të cilën dëshiron ta dëgjoj. ▲ Tregon interes për përdorimin e instrumenteve të ndryshme muzikore, përdorimin e sendeve jostandarde dhe natyrore për prodhimin e zërave të ndryshëm. ▲ Bën lëvizje të thjeshta me koreografi paraprakisht të përcaktuar. ▲ Tregon interes për pjesëmarrje në aktivitete të ndryshme vallëzuese.

Periudha zhvillimore prej moshës 5 deri në 6 vjeç

- ▲ të nxitet fëmija drejt përdorimit të shprehjeve artistike në funksion të vendosjes së vlerave personale jetësore;
- ▲ të nxitet drejt përjetimit estetik të mjedisit;
- ▲ të aftësohet për hulumtim dhe krahasim të toneve, zërave dhe zhurmave të ndryshme;
- ▲ të aftësohet për observim, dëgjim dhe imagjinim sipas përjetimeve përmes aktiviteteve muzikore;
- ▲ të aftësohet ti përputhë lëvizjet me karakterin e muzikës;
- ▲ të aftësohet për përdorimin e materialeve të ndryshme, pajisje, instrumente, sende dhe resurse tjera të kapshme për shprehje muzikore të ideve dhe ndjenjave personale kreative;
- ▲ të nxitet interesi dhe dashuria për vallëzim dhe shprehje kreative përmes lëvizjeve të trupit;
- ▲ të njihet me folklorin popullor;
- ▲ të njihet me instrumentet muzikore për fëmijë: barabani, shkopinjë, pjatat, trekëndëshi, zilet-kambanat, defi, kastanjetat;
- ▲ të nxitet për njohje dhe dallim të llojeve të shprehjeve të ndryshme muzikore;
- ▲ të fitojë sensitivitet për njohjen dhe dallimin e zërave të këndshëm dhe jo të këndshëm;
- ▲ të aftësohet të dëgjojë dhe riprodhojë këngë të ndryshme sipas përmbajtjes dhe karakterit (nga 6 deri në 8 këngë në vit);
- ▲ të nxitet për këndim të pavarur, këndim në grup, në korr dhe në duet;
- ▲ të aftësohet për përdorimin e materialeve të ndryshme, pajisjeve, instrumenteve, sendeve dhe resurseve tjera të kapshme për shprehje figurative në shprehjen e ideve dhe ndjenjave individuale kreative;
- ▲ të aftësohet për krijimtari gjatë vëzhgimit, përdorimit, kombinimit dhe hulumtimit me materiale të ndryshme krijuese figurative dhe jo figurative;
- ▲ të aftësohet për hulumtimin dhe krahasim të ngjyrave, hapësirës, formave, teksturës dhe formës së sendeve në dy ose tre dimensione;
- ▲ të aplikohet në teknikat: vizatimi, pikturimi, modelimi dhe formësimi përmes ushtrimeve të ndryshme dhe lojës;
- ▲ të fitojë shkathtësi figurative për kontroll dhe koordinim të lëvizjeve të dorës gjatë përdorimit të pajisjeve për teknikat e ndryshme figurative;
- ▲ të aftësohet për dallim dhe emërtim të drejtë të materialeve për vizatim dhe pikturim (laps, ngjyra të drurit/ temperë/ të ujit, shkumësa me ngjyra etj.);
- ▲ të nxitet për shprehje grafike dhe figurative të përjetimeve, emocioneve dhe nevojave;
- ▲ të nxitet përmes përdorimit të teknikave figurative për të shpreh mendimet dhe ndjenjat e veta.
- ▲ të aplikohet dhe të njihet me cilësitë e ndryshme të teknikave dhe materialeve të ndryshëm për modelim (brumë, plastelinë, argjilë dhe glinë etj.);
- ▲ të fitojë shkathtësi për përdorimin e procedurave të ndryshme figurative (ndrydhje, shtrydhje, prerje, ngjitje, copëtim etj.)
- ▲ pavarësisht këndon këngë dhe një lloje të ndryshme të ritmeve muzikore;
- ▲ dallon fjalë të këngëve të pëlqyera dhe imiton lëvizjet e këngëtarëve, valltarëve që i pëlqen;
- ▲ tregon interes për dëgjim të muzikës dhe këndim në vete gjatë kryerjes së ndonjë aktiviteti tjetër;
- ▲ dëgjon dhe një zëra në natyrë;
- ▲ dallon dhe emërton zëra të këndshëm dhe jo të këndshëm;
- ▲ e dallon dhe emërton karakterin e muzikës (gazmore, të dhimbshme);
- ▲ emëron disa instrumente muzikore;
- ▲ përdor sende të ndryshme jo standarde dhe natyrore për prodhimin e disa zërave;
- ▲ përdor ngjyra të ndryshme, brusha, materiale për shprehje figurative (vizatim, formëzim, dekorim);
- ▲ pavarësisht punon sende të ndryshme për shprehje figurative;
- ▲ dallon, emërton dhe përdor teknika të ndryshme të shprehjes figurative;
- ▲ merr pjesë në hulumtimin e mënyrave të ndryshme figurative (përdorimi i gishtave në vend të brushës, materiale të ndryshme, pajisje, sende të natyrave dhe dedikimeve të ndryshme);
- ▲ kyçet në manifestime të ndryshme muzikore dhe figurative;
- ▲ dallon dhe emërton drejtë më tepër materiale për vizatim, pikturim dhe modelim;
- ▲ drejtë i përdorë gërrshërët, ngjitësen dhe material tjetër gjatë krahasimit të sendeve, elementeve dhe ambalazheve;
- ▲ tregon pavarësi në ilustrimin figurativ të tregimeve, të para dhe ngjarjeve të përjetuara.

2.2.5. Analiza e qëllimeve në Programin mësimor nga Arsimi muzikor për klasën e parë

Arsimi muzikor ka rëndësi të veçantë në zhvillimin e fëmijës, në fitimin e kulturës së sjelljes, si dhe në nxitjen e shprehjes muzikore. Lënda e Arsimit muzikor në planin mësimor është e përfshirë me nga dy orë në javë, respektivisht 72 orë në vit për nxënësit e klasës së parë. Përmbajtjet mësimore të lëndës realizohen përmes temave vijuese: Këndimi, Muzika dhe lëvizjet, Dëgjimi muzikë, Ekzekutim në instrumentet muzikore për fëmijë, bazat e shkrim-leximit muzikor, Bazat e shprehjes dhe krijimit muzikor. Në pajtim me qëllimet dhe nevojat e nxënësve, përmbajtjet mësimore nga Gjuha amtare, Matematika, Gjuha angleze dhe Arsimi fizik dhe shëndetësor, por gjithashtu jepet mundësi për planifikimin e brendshëm të integruar.

Të mësuarit e muzikës, nga mosha më e hershme e zhvillimit të fëmijës, është ideale për veprimin kompleksiv pozitiv në personalitetin e fëmijës, për nxitje të emocioneve pozitive, kreativitetit, pavarësisë, punës ekipore dhe përgjegjësisë.

Sipas qëllimeve të Programit mësimor nga arsimi muzikor për klasën e parë nxënësi duhet të mësoj: të zhvilloj qëndrim këndues (ulje e drejtë, mbajtje të trupit, frymëmarrje); të zhvilloj shprehi për këndim të kultivuar (këndim i matur, pa grimasa, ngitje të shpatullave dhe bërtitje); të këndoij këngë me vija të ndryshme melodiko-ritmike; të aftësohet për dëgjim aktiv të muzikës; të dallojë muzikën vokale nga ajo instrumentale; t'i mësojë lëvizjet në aktivitetet ritmiko-muzikore; të stimulohet për zhvillimin e orientimit në hapësirë; të zhvillohet ndjenjë për ritëm; të njihet me disa instrumente muzikore për fëmijë

dhe të mundohet ti përdorë ato; të zhvilloj interes për realizim të disa efekteve të zërit, improvizime spontane në motive të shkurta muzikore etj, të bëj dallim mes llojeve themelore të ritmeve (ngadalë-shpejtë); të bëjë dallim mes llojeve themelore të dinamikës (fortë- heshtur); të aplikohet krijimtaria muzikore; të nxitet për shprehje individuale muzikore.

2.2.6. Analiza e qëllimeve në Programin mësimor të Arsimit figurativ për klasën e parë

Sipas Planit mësimor për klasën e parë, lënda e Arsimit figurativ mësohet si lëndë e obligueshme me nga dy orë në javë, respektivisht 72 orë në vit, përmes temave vijuese: Vizatim, Pikturim, Vulosje, Modelim dhe Formësim, Aktivitete hulumtuese figurative.

Sipas qëllimeve në programin mësimor për klasën e parë nxënësi duhet: të zhvilloj interes për punë figurative dhe krijim; të zhvilloj shkathtësi për aplikimin e materialeve dhe teknikave të ndryshme për vizatim, pikturim, modelim dhe ndërtim të shprehjes figurative; ta zbuloj dhe njoh gjuhën figurative - elementet figurative: vija, ngjyra, forma, sipërfaqe dhe përdorimin e tyre në krijimtarinë figurative; ti tregoj pavarësisht dhe lirishtë njohurit e veta, përjetimet dhe përshtypjet, mendimet dhe fantazinë me ndihmën e gjuhës figurative dhe krijimtarisë (me dush, gërvishtje, spërkatje, tufëzim etj.); të zhvilloj aftësi grafomotorike dhe koordinim sy -dorë; të aftësohet të vëzhgojë dhe krahasojë dhe të përcaktojë ngjashmëritë dhe dallimet midis sendeve dhe dukurive; t'i aplikojë shkathtësitë e fituara figurative; të zhvilloj teknikat higjiene-kulturore dhe shprehi pune për mbajtjen e higjiens personale dhe higjiens së mjeteve të

punës; të zhvilloj nevojën për rruajtjen dhe pasurimin e klasës së vet; të mund në mënyrë verbale ta sqarojë krijimtarinë e vet figurative dhe të njihet me teknikat kompjuterike për vizatim dhe ngjyrosje të sipërfaqeve.

Në bazë të lartshënuarës dhe analizës komparative e bërë për qëllimet e Programit për mësim dhe zhvillim të hershëm me theks të veçantë në qëllimet e programit për fëmijët e moshës prej 4 deri në 6 vjet, me qëllimet në programin mësimor në klasë të parë, mund të konstatohet se vërtetohet hipoteza e dytë nga hulumtimi e cila është: *Nuk ekziston pajtueshmëri e plotë e qëllimeve të Programit për mësim dhe zhvillim të hershëm (Gjuhë, komunikim dhe zhvillim të shkrim-leximit, Zhvillimi kognitiv dhe fitimi i njohurve të reja, Arti) me qëllimet në programin mësimor nga matematika, shkencat natyrore, arsimit figurativ dhe arsimit muzikor për klasën e parë në arsimin fillor nëntëvjeçarë.*

3 TË DHËNAT E FITUARA NGA ANKETIMI I EDUKATORËVE NË KOPSHTET E FËMIJËVE

Në hulumtim kanë marrë pjesë 207 edukatorë prej të cilëve 96 nga Shkupi, kurse 111 nga vendet tjera të Republikës së Maqedonisë.

**TABELA 11: STRUKTURA E EKZEMPLARIT
TË EDUKATORIT SIPAS PËRGATITJES/
SHKALLËS SË ARSIMIT INICIAL**

KATEGORIA E PËRGJIGJEVE									
ARSIM I LARTË		ARSIM SIPËROR		MAGJISTËR		DOKTOR SHKENCE		GJITHSEJ	
f	%	f	%	f	%	f	%	f	%
48	23,19	153	73,91	6	2,9	0	0	207	100

Me arsim të lartë janë 48 edukatorë, me arsim sipëror- 153 edukatorë dhe 6 janë magjistra.

**TABELA 12: STRUKTURA E EKZEMPLARIT
EDUKATORË SIPAS LLOJIT
TË ARSIMIT TË KRYER**

KATEGORIA E PËRGJIGJEVE							
FAKULTETI FILOZOFIK		FAKULTETI PEDAGOGJIK		SHKOLLIM TJETËR		GJITHSEJ	
f	%	f	%	f	%	f	%
43	20,78	154	74,39	10	4,83	207	100

Nga gjithsej 207 edukatorë 43 janë me Fakultet Filozofik të mbaruar, 154 me Fakultet Pedagogjik, kurse 10 me shkollim tjetër (8 edukatorë me akademi pedagogjike, një edukatorë me Fakultet Filologjik dhe një edukatorë me Institut për letërsi maqedonase.

**TABELA 13: STRUKTURA E EKZEMPLARIT
SIPAS PËRVOJËS SË PUNË TË EDUKATORIT**

KATEGORIA E PËRGJIGJEVE									
Deri 10 vjet		Deri 20 vjet		Deri 30 vjet		Mbi 30 vjet		Gjithsej	
f	%	f	%	f	%	f	%	f	%
96	46,37	48	23,19	20	9,67	43	20,77	207	100

Nga 207 edukatorë, përvojë pune deri 10 vjet kanë 96 edukatorë, përvojë pune deri 20 vjet kanë 48 edukatorë, përvojë pune deri 30 vjet kanë 20 edukatorë, kurse 43 edukatorë kanë përvojë pune mbi 30 vjet.

**TABELA 14: STRUKTURA E EKZEMPLARIT TË
EDUKATORËVE SIPAS PËRKATËSISË GJINORE**

KATEGORIA E PËRGJIGJEVE					
Gjinia mashkullore		Gjinia femërore		Gjithsej	
f	%	f	%	f	%
0	0	207	100	207	100,00

Të gjithë edukatorët e anketuar janë të gjinisë femërore.

**TABELA 15: QËNDRIMET E EDUKATORËVE NË
LIDHJE ME TRAJNIMIN E TYRE PËR IMPLEMENTIMIN
E STANDARDIT PËR MËSIM DHE ZHVILLIM TË
HERSHËM TE FËMIJËT E MOSHËS 0 DERI 6 VJET**

KATEGORIA E PËRGJIGJEVE							
Po		Pjesërisht		Jo		Gjithsej	
f	%	f	%	f	%	f	%
120	57,97	77	37,20	10	4,83	207	100,00

**TABELA 16: QËNDRIME TË EDUKATORËVE NË
LIDHJE ME TRAJNIMIN E TYRE PËR IMPLEMENTIMIN
E PROGRAMIT PËR MËSIM DHE ZHVILLIM TË HERSHËM**

KATEGORIA E PËRGJIGJEVE							
Po		Pjesërisht		Jo		Gjithsej	
f	%	f	%	f	%	f	%
118	57,00	77	33,20	12	5,80	207	100,00

TABELA 17: MENDIMET E EDUKATORËVE NË LIDHJE ME ARSYET QË E PENGOJNË REALIZIMIN E PROGRAMIT PËR MËSIM DHE ZHVILLIM TË HERSHËM

KATEGORIA E PËRGJIGJEVE	f	Rangu
a) Trajnimi jo i mjaftueshëm për implementimin e drejtë të Standardeve për mësim dhe zhvillim të hershëm në punën edukativo-arsimore me fëmijët e moshës parashkollore.	39	6
b) Shumë të përgjithshme janë Standardet për mësim dhe zhvillim të hershëm në punën edukativo-arsimore me fëmijët e moshës parashkollore.	65	3
c) Realizimi i aktiviteteve të shumta projektuese obligative të rregulluara me Ligjin për mbrojtjen e fëmijëve.	113	2
ç) Qëllimet jo mjaftueshëm të konkretizuara në Programin për mësim dhe zhvillim të hershëm.	54	5
d) Puna e madhe administrative.	166	1
dh) Kushte joadekuade për punë në kopshte.	65	3
e) Njohuri të pamjaftueshme gjatë studimeve, të nevojshme për realizimin e suksesshëm të punës edukativo-arsimore.	9	7
ë) Trajnimi jo i mjaftueshëm për implementimin e evidencës dhe dokumentacionit të ri pedagogjik.	56	4
f) Tjetër (thekso çka)	0	8

Në lidhje me trajnimin e edukatorëve për implementimin e Standardeve për mësim dhe zhvillim të hershëm te fëmijët e moshës 0 deri 6 vjeç dhe për implementimin e Programit për mësim dhe zhvillim të hershëm rezultatet janë të ngjashme dhe nuk janë të kënaqshme. Kështu, më tepër se gjysma e edukatorëve (57,97 %) janë trajnuar për implementimin e Standardeve për mësim dhe zhvillim të hershëm, kurse 57,00 % e edukatorëve janë trajnuar për implementimin e Programit për mësim dhe zhvillim të hershëm.

Sipas numrit më të madh të edukatorëve (166) puna e madhe administrative iu shkakton pengesa të mëdha gjatë realizimit të Programit për mësim dhe zhvillim të hershëm, kurse më tepër se gjysma e edukatorëve (113) arsyet i gjejnë në kërkesën e Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale të realizojnë aktivitete të shumta projektuese obligative, të rregulluara me Ligjin për mbrojtjen e fëmijëve. Një e treta e edukatorëve përmendin edhe arsye tjera që e pengojnë realizimin e Programit për mësim dhe zhvillim të hershëm: Standardet për mësim dhe zhvillim të hershëm te fëmijët e moshës 0 deri 6 vjeç janë shumë të përgjithshme ose kushtet për punë

në çerdhe janë joadekuade, trajnimi i pamjaftueshëm për implementimin e evidencës dhe dokumentacionit të ri pedagogjik, qëllimet jo qartë të konkretizuara në Programin për mësim dhe zhvillim të hershëm dhe trajnim jo i mjaftueshëm për implementimin e Standardeve për mësim dhe zhvillim të hershëm të fëmijët e moshës 0 deri 6 vjeç. Për numrin më të vogël të të edukatorëve të anketuar pengesat për realizimin e Programit për mësim dhe zhvillim të hershëm paraqiten për shkak: njohurive të pamjaftueshme gjatë studimeve të nevojshme për realizimin e suksesshëm të

punës edukativo-arsimore, numri i madh i fëmijëve në grupet edukuese, mbajtja e dy ditarëve për grupin edukues (me shkrim dhe elektronik), edukatorët e trajnuar për mbajtjen e evidencës dhe dokumentacionit pedagogjik dhe planifikimin e aktiviteteve edukativo-arsimore jo qartë i kanë bartur njohurit e tyre nga trajnimi deri te koleget në çerdhe, mosekzistimi i korrelacionit midis Standardeve për mësim dhe zhvillim të hershëm të fëmijët e moshës 0 deri 6 vjeç dhe indikatorët, si dhe bashkëpunimi jo i mjaftueshëm me këshilltarët e Byrosë së Zhvillimit të Arsimit.

TABELA 18: QËNDRIME DHE MENDIME TË EDUKATORËVE NË LIDHJE ME DOKUMENTIN STANDARDI PËR MËSIM DHE ZHVILLIM TË HERSHËM TE FËMIJËT E MOSHËS 0 - 6 VJEÇ.

KATEGORIA E PËRGJIGJEVE							
Plotësisht pajtohem		Pjesërisht pajtohem		Aspak nuk pajtohem		Gjithsej	
f	%	f	%	f	%	f	%
62	29,95	131	63,28	14	6,77	207	100,00

TABELA 19: MENDIME TË EDUKATORËVE NË LIDHJE ME ATË SE CILAT ASPEKTE TË ZHVILLIMIT TË FËMIJËS DUHET TË DOMINOJNË GJATË RISHQYRTIMIT TË STANDARDEVE DHE INDIKATORËVE PËR MËSIM DHE ZHVILLIM TË HERSHËM.

KATEGORIA E PËRGJIGJEVE									
Shëndeti fizik dhe zhvillimi motorik		Zhvillimi socio-emocional		Zhvillimi i qasjes drejtë mësimi		Zhvillimi i gjuhës, shkrim-leximit dhe komunikimit		Zhvillimi kognitiv dhe të arriturat e njohurive të përgjithshme	
f	%	f	%	f	%	f	%	f	%
50	24,15	53	25,60	80	38,64	57	27,53	131	63,28

TABELA 20: MENDIMET E EDUKATORËVE NË LIDHJE ME ATË SE VALLË EKZISTON NEVOJA PËR RISHQYRTIMIT E INDIKATORËVE QË DALIN NGA STANDARDET PËR MËSIM DHE ZHVILLIMIN E HERSHËM TE FËMIJËT E MOSHËS 0 DERI 6 VJET.

KATEGORIA E PËRGJIGJEVE							
Plotësisht pajtohem		Pjesërisht pajtohem		Aspak nuk pajtohem		Gjithsej	
f	%	f	%	f	%	f	%
67	32,37	111	53,63	29	14,00	207	100,00

TABELA 21: MENDIMET E EDUKATORËVE NË LIDHJE ME ATË SE CILËT INDIKATORË NË STANDARDET PËR MËSIM DHE ZHVILLIM TË HERSHËM DUHET TË RISHQYRTOHEN

KATEGORIA E PËRGJIGJEVE									
Shëndeti fizik dhe zhvillimi motorik		Zhvillimi socio-emocional		Zhvillimi i qasjes drejtë mësimit		Zhvillimi i gjuhës, shkrim-leximit dhe komunikimit		Zhvillimi kognitiv dhe të arriturat e njohurive të përgjithshme	
f	%	f	%	f	%	f	%	f	%
63	30,43	59	28,50	87	42,02	71	34,29	117	56,54

Sipas numrit më të madh të edukatorëve të anketuar Standardi për mësim dhe zhvillim të hershëm të fëmijët e moshës 0 - 6 vjeç duhet pjesërisht (63,28 %) ose plotësisht (30,43 %) të rishqyrtohen. Rishqyrtimi i Standardeve për mësim dhe zhvillim të hershëm të fëmijët e moshës 0 deri në 6 vjet duhet tu takojë aspekteve vijuese të zhvillimit të fëmijës: Zhvillimi kognitiv dhe të arriturat e njohurive (53,31 % nga edukatorët), Zhvillimi i gjuhës, shkrim-leximit dhe komunikimit (27,55 %), Zhvillimi socio-emocional (25,63 %) dhe Shëndeti fizik dhe zhvillimi motorik (50 ose 24,12 %). Sipas 80 (38,64 %) edukatorëve duhet të rishqyrtohen edhe pjesa e standardit i emëruar si zhvillimi i qasjes ndaj mësimit.

Pjesa më e madhe e edukatorëve të anketuar (86 %) mendojnë se pjesërisht ose plotësisht duhet të rishqyrtohen indikatorët që dalin nga Standardi për mësim dhe zhvillim të hershëm të fëmijët e moshës 0 deri në 6 vjeç. Edukatorët e anketuar theksojnë se duhet të rishqyrtohen indikatorët që dalin nga: Zhvillimi kognitiv dhe të arriturat e njohurive (56,54 %), Zhvillimi i qasjes ndaj mësimit (42,02 %), Zhvillimi i gjuhës, shkrim-leximi dhe komunikimi (34,29 %), Shëndeti fizik dhe zhvillimi motorik (30,43 %) dhe Zhvillimi socio-emocional (28,50 %). Numër më i vogël i edukatorëve mendojnë se duhet të zmadhohet numri i indikatorëve.

TABELA 21: QËNDRIMET DHE MENDIMET E EDUKATORËVE NË LIDHJE ME NEVOJËN E AVANCIMIT TË QËLLIMEVE NË PROGRAMIN PËR MËSIM DHE ZHVILLIM TË HERSHËM PËR MOSHËN MË TË VJETËR PARASHKOLLORE ME QËLLIM TË LIDHJES FUNKSIONALE ME QËLLIMET E PROGRAMIT MËSIMORE NË KLASËN E PARË

KATEGORIA E PËRGJIGJEVE							
Plotësisht pajtohem		Pjesërisht pajtohem		Aspak nuk pajtohem		Gjithsej	
f	%	f	%	f	%	f	%
90	43,48	101	48,79	16	7,73	207	100,00

TABELA 22: PËRGJIGJET EDUKATORËVE NË LIDHJE ME ATË SE NË CILAT PJESË TË PROGRAMIT PËR MËSIM DHE ZHVILLIM TË HERSHËM MË TEPËR DUHET TË BËHEN NDRYSHIME.

KATEGORIA E PËRGJIGJEVE													
Matematikë		Shkenca natyrore		Arsimi figurativ		Arsimi muzikor		Gjuhë amtare		Shoqëri		Tjetër	
f	%	f	%	f	%	f	%	f	%	f	%	f	%
137	66,18	61	29,46	31	14,97	36	17,39	66	31,88	35	16,90	0	0,00

Në lidhje me nevojën e përmirësimit të Programit për mësim dhe zhvillim të hershëm i bazuar në Standardin për mësim dhe zhvillim të hershëm në drejtim të harmonizimit të qëllimeve të dokumentit programor dhe qëllimet e programeve mësimore në klasën e parë, numër më i madh i edukatorëve të anketuar (92,5 %) mendojnë se pjesërisht ose plotësisht është e nevojshme të harmonizohen qëllimet e Programit për mësim dhe zhvillim të hershëm për grup moshën më të vjetër të parashkollorëve me qëllim të lidhjes funksionale me qëllimet e programeve arsimore në klasë të parë. Edukatorët e anketuar

propozojnë ndryshimet të bëhen në pjesët vijuese të programit: Matematika (66,18 % të anketuarve), Gjuhë amtare (31,88 %), Shkencat natyrore (29,46 %), Arsimi muzikor (17,39 %), Shoqëri (16,90 %) dhe Arsimi figurativ (14,97 %). Gjithashtu, në bazë të përvojës praktike të veçantë, edukatorët e anketuar mendojnë se mund të bëhen ndryshimet vijuese në Programin për mësim dhe zhvillim të hershëm: të ketë më tepër shembuj të aktiviteteve, arsimi figurativ dhe muzikor të ndahen nga domeni kognitiv, të vendoset theksi më i madh te arsimi figurativ dhe arsimi muzikor, të ketë më tepër operacionalizim të qëllimeve sipas

grupeve të ndryshme edukuese, të ketë më tepër shembuj të aktiviteteve që dalin dhe janë të lidhura me situatat e përditshëm jetësore, të merren më shumë qëllime, bile të shfletohet komplet dokumenti i mëparshëm programor nga 2007, të ofrohen aktivitete për fëmijët e talentuar, përputhshmëri më e madhe e Programit për mësim dhe zhvillim të hershëm me

programit mësimor të klasës së parë të arsimit fillor. Për fat të keq, numër më i vogël i edukatorëve nuk bëjnë dallim midis Standardit për mësim dhe zhvillim të hershëm të fëmijët e moshës 0 deri në 6 vjet dhe Programit për mësim dhe zhvillim të hershëm.

TABELA 23: QËNDRIMET DHE MENDIMET E EDUKATORËVE NË LIDHJE ME EVIDENCËN DHE DOKUMENTACIONIN PEDAGOGJIK E CILA MBAHET NË ENTET PËR FËMIJË NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË

KATEGORIA E PËRGJIGJEVE							
Po, plotësisht korresponдон me kërkesat bashkëkohore për planifikim dhe realizim të punës edukative-arsimore, gjatë së cilës fëmija është në fokus të vëmendjes		Pjesërisht korresponдон		Jo, aspak nuk korresponдон me kërkesat bashkëkohore për planifikim dhe realizim të punës edukative-arsimore, gjatë së cilës fëmija është në fokus të vëmendjes		Gjithsej	
f	%	f	%	f	%	f	%
50	24,15	125	60,39	32	15,46	207	100

TABELA 24: MENDIMET E EDUKATORËVE NË LIDHJE ME NEVOJËN E RISHQYRTIMI TË EVIDENCËS DHE DOKUMENTACIONIT PEDAGOGJIK AKTUAL NË KOPSHTË/QZHSH

KATEGORIA E PËRGJIGJEVE					
Po		Jo		Gjithsej	
f	%	f	%	f	%
168	81,16	39	18,84	207	100,00

Pjesa më e madhe e edukatorëve të anketuar mendojnë se evidenca dhe dokumentacioni pedagogjik aktual pjesërisht (60,39 %) dhe plotësisht (24,15 %) nuk korrespondon me kërkesat bashkëkohore për planifikim dhe zhvillim të punës edukative - arsimore, duke e vendosur fëmijën në fokus të vëmendjes. Për këtë, pjesa më e madhe e edukatorëve të anketuar (81,16 %) mendojnë se evidenca dhe dokumentacioni pedagogjik aktual në çerdhe/qendrat për zhvillim të hershëm të fëmijës duhet të rishqyrtohen. Propozimet e edukatorëve për përmirësimin e evidencës dhe dokumentacionit pedagogjik janë si vijon: „ Të mos mbahet ditari për punën e grupit edukues në formë të shkruar dhe elektronike“; „Mjafton evidenca në formë të shkruar“; „Evidenca pedagogjike të thjeshtësohet“; „Të mos mbahet evidenca dhe dokumentacioni pedagogjik në periudhën verore“; „Vendosja e më tepër faqeve për detyra globale. Ndryshim në renditjen e planifikimeve të shkurtra ditore, shtimi i më tepër faqeve “; „Qëllimet më konkrete, shkurtim dhe të caktohet ditari ose vetëm në formë të shkruar ose vetëm në formë elektronike, gjithë kjo shndërrohet në kopjim. Më i mirë ishte ditari „Hap pas

hapi“; „Të ndryshohet dosja e fëmijës. Të bëhen ndryshime në vet ditarin.“; „Zgjerimi i pjesës së planifikimit vjetor, planifikimi ditari të del nga qëllimet, jo nga standardi“; „Në evidencë më të rëndësishme janë qëllimet që duhet të rishqyrtohen, kurse në dokumentacion nuk ka nevojë për numër të madh të të dhënave të cilat përsëriten“; „Standardet mos të shkruhen në ditar, në planifikim dhe të shkruhet vetëm një ditar. Mungon kaptina për evidentimin e avancimit profesional“; „Të thjeshtësohet dhe të shkurtohet dosja e fëmijës, të largohet pjesa që ka të bëjë me gjendjen shëndetësore të fëmijës, sepse bëhet fjalë për evidencë dhe dokumentacion pedagogjik“; „Dosja e fëmijës nuk korrespondon me udhëzimet për përdorim në pjesën e shënimeve anekdotike“; „Dosjet e fëmijëve janë jofunksionale pas shkuarjes në shkollë të fëmijës, duhet të dorëzohen në shkollë“; „Të ketë më tepër bashkëpunim mes çerdhes dhe shkollës, trajnime të përbashkëta të edukatorëve dhe mësueseve, vizita të mësueseve në çerdhe dhe kontakte personale me fëmijët-nxënës të ardhshëm të klasës së parë, lojëra në të cilat do të marrin pjesë edhe fëmijët e çerdhes edhe fëmijët e shkollës“.

TABELA 25: QËNDRIME DHE MENDIME TË EDUKATORËVE NË LIDHJE ME NEVOJËN E VENDOSJES SË VITIT PËRGATITOR TË OBLIGUESHËM PARA NISJES NË SHKOLLË

KATEGORIA E PËRGJIGJEVE							
Plotësisht pajtohem		Pjesërisht pajtohem		Aspak nuk pajtohem		Gjithsej	
f	%	f	%	f	%	f	%
123	59,42	57	27,54	27	13,04	207	100,00

Sipas edukatorëve të anketuar numri më i madh i tyre mendojnë se duhet të vendoset vit përgatitor i obligueshëm para nisjes në shkollë për fëmijët nga 4 deri në 6 vjet.

TABELA 26: QËNDRIME DHE MENDIME TË EDUKATORËVE NGA ENTET PARASHKOLLORE NË RAPORT ME PRITSHMËRINË E TYRE PËR PËRGATITJEN E FËMIJËVE PËR KALIM TË SUKSESSHËM NGA ENTI PARASHKOLLOR NË SHKOLLË FILLORE

KATEGORIA E PËRGJIGJEVE							
Po		Pjesërisht		Jo		Gjithsej	
f	%	f	%	f	%	f	%
101	48,79	101	48,79	5	2,42	207	100,00

Sipas 97 % të edukatorëve të anketuar me realizimin e qëllimeve të Programit për mësim dhe zhvillim të hershëm fëmijët përgatiten për fillim të suksesshëm në klasën e parë të shkollimit fillor, që shkon në interes të propozimit për vendosjen e vitit përgatitor të detyrueshëm para nisjes në shkollë.

TABELA 27: QËNDRIME DHE MENDIMET E EDUKATORËVE NGA ENTET PARASHKOLLORE NË LIDHJE ME NEVOJËN E PËRKRAHJES PROFESIONALE - KËSHILLUESE NË VAZHDIMËSI

KATEGORIA E PËRGJIGJEVE					
Po		Jo		Gjithsej	
f	%	f	%	f	%
166	80,20	41	19,80	207	100,00

**TABELA 28: PËRGJIGJET E EDUKATORËVE
NË LIDHJE ME NEVOJËN E TRAJNIMEVE TË
REALIZUARA NGA PERSONA PROFESIONAL TË
BYROSË SË ZHVILLIMIT TË ARSIMIT**

KATEGORIA E PËRGJIGJEVE					
Po		Jo		Gjithsej	
f	%	f	%	f	%
159	76,81	48	23,19	207	100,00

**TABELA 29: PËRGJIGJET E EDUKATORËVE
NË LIDHJE ME NEVOJËN E PËRKRAHJES
PROFESIONALE-KËSHILLUESE NË VAZHDIMËSI
NGA KËSHILLTARËT E BYROSË SË ZHVILLIMI TË
ARSIMIT PËR IMPLEMENTIMIN E SUKSESSHËM
TË PUNËS EDUKATIVO-ARSIMORE**

KATEGORIA E PËRGJIGJEVE					
Po		Jo		Gjithsej	
f	%	f	%	f	%
173	83,57	34	16,43	207	100,00

Edukatorët e anketuar nga entet parashkollore janë të vetëdijshëm se me avancimet e tyre profesionale në vazhdimësi do të arrijnë rezultate më të mira në punë, me çka do të zmadhohet cilësia e punës edukativo-arsimore në kopshtet e fëmijëve dhe qendrat për zhvillim të hershëm të fëmijëve. Më konkretisht, pjesa më e madhe e edukatorëve të anketuar (80,20 %) u përgjigjen se kanë nevojë për avancim profesional permanent me qëllim të realizimit të suksesshëm të punës edukativo-arsimore në kopshte/CRDR. Pothuajse i njëjtë është numri i edukatorëve të anketuar (76,81 %) të cilët u përgjigjen se kanë nevojë për trajnime të realizuara nga persona profesional të Byrosë së zhvillimit të arsimit. Në pyetjen

se për cilën temë kanë nevojë për trajnim nga ana e personave profesional të Byrosë së zhvillimit të arsimit, edukatorët e anketuar i përmendën këto tema: „Korrelacioni dhe bashkëpunimi me prindërit“; „Gjithë përfshirja dhe dialogu me fëmijët me nevoja të veçanta“; „Teknologjia dhe kompjuteri“; „Plotësimi i drejtë i ditarit të grupit edukues“; „Metoda të nevojshme për mësim të fëmijëve në zhvillim“; „Standardet për mësim dhe zhvillim të hershëm“; „Program për mësim dhe zhvillim të hershëm“; „Edukimi kompjuterik i të gjithë edukatorëve“; „Risitë bashkëkohore në edukimin parashkollor dhe arsimin në korniza botërore“; „Kahe praktike për realizimin e Programit për mësim dhe zhvillim të hershëm“; „Qëllimet e punës edukative - arsimore“; „Trajnimet

duhet të jenë për socializimin e fëmijëve dhe edukatës familjare dhe respektit“; „Implementimin i programit – për të gjitha temat“; „Trajnim për punë ekipore“; „Trajnim për qasje të fëmijëve me nevoja të posaçme arsimore“; „Trajnim për edukimin e edukatorëve të rinj pa përvojë pune“.

Pjesa më e madhe e edukatorëve të anketuar (83,57 %) mendojnë se përkrahja e vazhdueshme profesionale - këshilluese e edukatorëve nga këshilltarët e Byrosë së zhvillimit të arsimit do të jep kontribut në implementimin e suksesshëm të punës edukativo-arsimore.

Mendimet dhe sugjerimet e edukatorëve për avancimin e punës edukativo - arsimore në kopshte

Eduktorët e anketuar i kanë dorëzuar propozimet vijuese për avancimin e punës edukativo-arsimore në kopshte: „Eduktorët e luajnë rolin kryesor në sigurimin e mësimi kualitativ të fëmijës dhe për atë avancimi i tij duhet patjetër të ndiqet me trajnime dhe përkrahje për avancim nga baza e personave profesionale-këshilluese dhe këshilltarë për zhvillim të arsimit “; „Bashkëpunimi dhe implementimi i edukatorëve në përgatitjen e programit. Debate të hapura, tribuna, këmbim mendimesh dhe përvojave. Përgatitja profesionale, respektivisht trajnimet për çdo ndryshim që do të ndodh, kurse duhet të zbatohet në praktikë. Ju faleminderit që kam mundësi ta shpreh mendimin tim dhe shpresoj se gjithë kjo më sipër shënuar do të ndikojë për hap para. Shkoni para, por mos e harroni programin e vjetër nacional, ai është themeli kryesor i punës sonë. Ndryshimet nuk ndodhin brenda natës, bëni ata, miratoni programe të reja dhe mëson mësimin si ti mësoj fëmijët, sepse pa trajnim vetëm endet“;

„Numri i fëmijëve në grupet edukuese të jetë më i vogël, trajnime dhe seminare të përditshme të cilat do të mundësojnë të kemi bashkëpunëtorë profesional kompetent me shkollim sipëror, rishqyrtimin e standardeve për mësim dhe zhvillim të hershëm të fëmijëve dhe evidence pedagogjike. Të mos humbet relacioni edukator-fëmijë. Shmangien e punës së dyfishtë (elektronike) te evidenca dhe dokumentacioni pedagogjik. Të vendoset theksi në programin për zhvillim të hershëm të fëmijës në arsimin muzikor, fizik, figurativ dhe matematik (në grupet e mëdha, por edhe në të mesmet)“; „T'i kushtohet vëmendje më shumë pjesës edukative - arsimore të punës në kopshte dhe para se gjithash, lojës“; „Pasurimi me material didaktik dhe të lojës“; „Punësimin e defektologut për punën me fëmijët me nevoja të veçanta“; „Zgjedhje me kujdes të personave të punësuar në kopshte“; „Të sigurohet laptop për çdo edukator, kur kërkohet të mbahet evidencë dhe dokumentacion pedagogjik në formë elektronike“; „Na jepni shembuj për aktivitete- konkrete në Programin për punën edukativo-arsimore“; „Të rritet numri i qëllimeve për edukim figurative dhe muzikor në Programin për punën edukativo-arsimore dhe të rishqyrtohen indikatorët për zhvillim motorik në standardet“; „Stimulimi me rrogë më të lartë, materiale të ndryshme për punë dhe lojë“; „Dorëzimin e dosjes së fëmijës në shkollën fillore“; „I nevojshëm është bashkëpunimi me çerdhet tjera në Republikën e Maqedonisë, si dhe me çerdhet tjera nga shtetet tjera, këmbimi i përvojave, avancimi i kuadrit edukues“; „Viti i obligueshëm para nisjes në shkollë për të gjithë fëmijët“; „Rishqyrtimi i programit për punë 2) Plotësimin e qëllimeve dhe indikatorëve, 3) Për fëmijët me pengesa në zhvillim të ketë asistent, nëse janë përfshi

në grup“; „Kthimin e periodizimit të vjetër me vit përgatitor, 2) Zvogëlimin e numrit të fëmijëve sipas grupeve edukuese, 3) Përpilimin e programit për realizimin e punës edukativo-arsimore, 4) kthimin e viti shkollor shtator- 10 qershor“; „ Rishqyrtimi i programit për punën edukative-arsimore. Nxitjen dhe avancimin e fëmijëve të talentuar. Gjatë gjithë përfshirjes së fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore të ketë asistent në çdo grup veç e veç; „Ka standard të cilat nuk u përgjigjen aktiviteteve dhe ata nuk mundet askund të vendosen. Për shumë qëllime nuk ka indikator adekuat. Për shkak se ky program nuk i paraprin Programit Kembrixh i cili për momentin është aktual në klasë të parë. Të përgatitet doracak për punë ashtu siç në shkollë ka libra. Pse mbahen dosje për fëmijë kur shkollat nuk i marrin (nuk iu duhen)? Qëllimet, indikatorët, titujt e Standardeve plotësisht të rishqyrtohen. Pse aq vëmendje SRDR kur në kopshte nuk ka punë arsimore, por kujdes? Pse çerdhet nuk janë nën Ministrinë e Arsimit?“

„Zvogëlimin e projekteve, aplikimin e më tepër indikatorëve dhe qëllimeve, zvogëlimin e punës administrative dhe konkretizimin e pyetjes vallë jemi personel për kujdes arsimor“; „Të kthehet titulli paraprak se edukatori bën punë edukativo-arsimore, dhe jo se ofron shërbimet“; „Vëmendje më të madhe veprimtarisë edukativo-arsimor“; „Më pak aktivitete projektuese“; „Unë jam profesor i arsimit parashkollor, dhe kam statusin e ofruesit të shërbimeve. Bëj veprimtari edukative-arsimore dhe kërkoj të vlerësohem dhe shpërblehem, d.m.th. të paguhemi sa mësueset në shkollimin fillor“; „Të kthehet emri i mëparshëm se edukatori bën punë edukativo-arsimore“; „Në grupe të mëdha dy edukatorë „kurse në të vogla dy përkëdhelës. Të ndryshohet Normativi për mjetet didaktike, materialeve, lojërave

të modernizohen. Të largohet njëri ditari, me të dytë humbet kohë e cila duhet t’iu kushtohet fëmijëve. Fleksibilitet më të madh në zgjedhjen e temave, qasja në aktivitete të jep mundësi për realizimin e interesave të fëmijës“; „Të ketë për edukatorin më tepër mjete për mbikëqyrje (libra, libra me ilustrime, aplikacione, mjete të botuara mbikëqyrëse)“.

4 TË DHËNAT E FITUARA NGA ANKETIMI I PEDAGOGËVE NË KOPSHTET PËR FËMIJË

Në hulumtim morën pjesë 15 pedagogë të institucioneve parashkollore prej të cilëve 10 janë nga Shkupi, ndërsa 5 të tjerët nga vendet e ndryshme të Republikës së Maqedonisë.

TABELA 30: STRUKTURA E EKZEMPLARIT TË PEDAGOGËVE NË KOPSHTET PËR FËMIJË SIPAS PËRGATITJES INICIALE/SHKALLËS SË ARSIMIT

KATEGORIA E PËRGJIGJEVE	Vendi		Gjithsej	
	Shkup	Nga brendia e Republikës së Maqedonisë	f	%
Arsim sipëror	8	5	13	86,67
Magjistër	2	0	2	13,33
Doktor shkence	0	0	0	0
Gjithsej	10	5	15	100

Në hulumtim morën pjesë 15 pedagogë, prej të cilëve 13 janë me arsim sipëror përkatës, ndërsa 2 janë magjistra.

TABELA 31: STRUKTURA E EKZEMPLARIT SIPAS PËRVOJËS SË PUNËS SI PEDAGOG

KATEGORIA E PËRGJIGJEVE	Pedagogë	
	f	%
Deri 10 vjet	6	40,00
Deri 20 vjet	1	6,66
Deri 30 vjet	2	13,34
Mbi 30 vjet	6	40,00
Gjithsej:	15	100

**TABELA 32: STRUKTURA E EKZEMPLARIT
SIPAS PËRKATËSISË GJINORE**

KATEGORIA E PËRGJIGJEVE					
Gjinia mashkullore		Gjinia femërore		Gjithsej	
f	%	f	%	f	%
0	0	15	100	15	100

Dy të tretat nga pedagogët e anketuar (10) të gjithë të gjinisë mashkullore, ndërsa një e treta (%) të gjinisë femërore.

**TABELA 33: MENDIMI I PEDAGOGËVE NË LIDHJE
ME NJOHJEN E STANDARDEVE PËR MËSIM TË
HERSHËM DHE ZHVILLIM TE FËMIJËT PREJ
MOSHËS 0 DERI 6 VJEÇ DHE ME PROGRAMIN
PËR MËSIM TË HERSHËM DHE ZHVILLIM NË TË
CILËN BAZOHET REALIZIMI I PUNËS EDUKATIVE
ARSIMORE NË KOPSHT**

KATEGORIA E PËRGJIGJEVE					
Plotësisht jam i/e njoftuar		Pjesërisht jam i/e njoftuar		Në përgjithësi nuk jam i/e njoftuar	
f	%	f	%	f	%
15	100	0	0	0	0

Të gjithë pedagogët e anketuar janë deklaruar se në përgjithësi janë të njoftuar me Standardet e mësimit të hershëm dhe zhvillimit të fëmijët prej moshës 0 - 6 vjeç dhe me Programin për zhvillim të hershëm në të cilën bazohet realizimi i punës edukative-arsimore në kopsht.

**TABELA 34: PËRGJIGJET E PEDAGOGËVE
SA I PËRKET SHKAQEVE TË CILAT E
VËSHTRËSOJNË REALIZIMIN E PROGRAMIT
PËR MËSIM TË HERSHËM DHE ZHVILLIM**

KATEGORIA E PËRGJIGJEVE	f	Rangu
a) Trajnim i pamjaftueshëm për një implementim të rregullt të Standardeve për mësim të hershëm dhe zhvillim në punën edukative-arsimore me fëmijët e moshës parashkollore.	0	6
b) Janë teje të përgjithshme Standardet për mësim të hershëm dhe zhvillim në punën edukative-arsimore me fëmijët e moshës parashkollore.	8	2
c) Realizimi i shumë aktiviteteve projektuese të detyrueshme të rregulluara me Ligjin për mbrojtjen e fëmijëve.	12	1
ç) Qëllimet e pamjaftueshme të pa konkretizuara në Programin për mësim të hershëm dhe zhvillim.	6	3
d) Punë e madhe administrative.	6	3
dh) Kushte joadekuade për punë në kopsht.	1	5
e) Njohuri të pamjaftueshme të fituara gjatë kohës të studimeve, të nevojshme për realizim të suksesshëm të punës edukative-arsimore.	2	4
ë) Trajnim i pamjaftueshëm për aplikimin e evidencës pedagogjike dhe dokumentacionit.	2	4
f) Tjetër (theksoni çka).	1	5

Rang-listën të cilën e morëm në bazë të mendimeve nga të anketuarit tregon se ekzistojnë shumë arsye të cilat e vështirësojnë realizimin e qëllimeve nga Programi për mësim të hershëm dhe zhvillim, në mesin e të cilave si më frekvente paraqiten: realizimi i një numri të madh të aktiviteteve projektuese të detyrueshme të rregulluara me Ligjin për mbrojtjen e fëmijëve, Standardet shumë të përgjithshme për mësim të hershëm dhe zhvillim në punën edukative-arsimore me fëmijët e moshës parashkollore, qëllimet e pamjaftueshme të përcaktuara në Programin për mësim të hershëm dhe zhvillim, puna e madhe administrative, njohuria e pamjaftueshme e fituar

gjatë studimeve, nevojat për realizimin e suksesshëm të punës edukative-arsimore, trajnimi i pamjaftueshëm për aplikimin e evidencës së re pedagogjike dhe dokumentacionit, kushtet jo të mjaftueshme për punë në kopsht. Gjithashtu, si njëra nga shkaqet theksohen edhe kushtet jopërkatese për punë në kopsht dhe numri i madh i fëmijëve në grupe (mbi normativin e caktuar).

TABELA 35: MENDIMET E PEDAGOGËVE PËR NEVOJËN NGA RISHQYRTIMI I STANDARDEVE PËR MËSIM TË HERSHËM DHE ZHVILLIM TE FËMIJËT PREJ MOSHËS 0 - 6 VJEÇ

KATEGORIA E PËRGJIGJEVE							
Plotësisht pajtohem		Pjesërisht pajtohem		Nuk pajtohem aspak		Gjithsej	
f	%	f	%	f	%	f	%
5	33,33	9	60,00	1	6,67	15	99,99

TABELA 36: PËRGJIGJET E PEDAGOGËVE NË LIDHJE ME ATË SE CILAT ASPEKTE TË ZHVILLIMIT TË FËMIJËS DUHET TË JENË DOMINUESE GJATË RISHQYRTIMIT TË STANDARDEVE DHE INDIKATORËVE PËR MËSIM TË HERSHËM DHE ZHVILLIM

KATEGORIA E PËRGJIGJEVE									
Shëndeti fizik dhe zhvillimi motorik		Zhvillimi socio-emocional		Zhvillimi i qasjes ndaj mësimimit		Zhvillimi i gjuhës, shkrim-leximi dhe komunikimi		Zhvillimi kognitiv dhe marrja e njohurive të përgjithshme	
f	%	f	%	f	%	f	%	f	%
3	10	3	10	10	33,33	6	20	8	26,67

Një numër i madh i pedagogëve të anketuar (93,33 %) mendojnë se Standardet për mësim të hershëm dhe zhvillim të fëmijët prej moshës 0 deri në moshën 6 vjeçare pjesërisht ose tërësisht duhet të rishikohen. Sipas numrit të madh të pedagogëve të anketuar rishikimi i Standardeve për mësim të hershëm dhe zhvillim të fëmijët prej moshës 0 deri në moshën 6 vjeçare duhet të punohet në pjesën e Standardeve të emërtuara si Zhvillim të qasjes ndaj mësimimit, më shumë se gjysma e pedagogëve të anketuar propozojnë që rishikimi t'i qaset zhvillimit

kognitiv dhe arritjes së njohurive të përgjithshme, disa më pak se gjysma e pedagogëve të anketuar propozojnë rishikimin e zhvillimit të gjuhës, shkrim-leximin dhe komunikimin, ndërsa një pjesë e vogël e tyre propozojnë rishikimin e aspekteve që kanë të bëjnë me zhvillimin socio-emocional, shëndetin fizik dhe zhvillimin motorik.

TABELA 37: MENDIMET E PEDAGOGËVE NË LIDHJE ME NEVOJËN E AVANCIMIT TË QËLLIMEVE NË PROGRAMIN PËR MËSIM TË HERSHËM DHE ZHVILLIM PËR MOSHËN MË TË RRITUR PARASHKOLLORE ME QËLLIM TË NDËRLIDHJES FUNKSIONALE ME QËLLIMET E PROGRAMEVE MËSIMORE NË KLASËN E PARË

KATEGORIA E PËRGJIGJEVE							
Plotësisht pajtohem		Pjesërisht pajtohem		Nuk pajtohem aspak		Gjithsej	
f	%	f	%	f	%	f	%
11	73,34	2	13,33	2	13,33	15	100

TABELA 38: PËRGJIGJET E EDUKATORËVE SA I PËRKET SE NË CILAT PJESË TË PROGRAMIT PËR MËSIM TË HERSHËM DHE ZHVILLIM DUHET BËRË NDRYSHIMET

KATEGORIA E PËRGJIGJEVE													
Matematikë		Shkencat natyrore		Edukimi figurativ		Edukimi muzikor		Gjuhë amtare		Shoqëri		Tjetër	
f	%	f	%	f	%	f	%	f	%	f	%	f	%
0	0	8	22,85	12	34,28	6	17,14	6	17,14	1	2,86	2	5,71

Një numër i madh i pedagogëve të anketuar (73,34 %) mendojnë se është e nevojshme në tërësi (73,34 %) ose pjesërisht (13,33 %) avancimi i qëllimeve të Programit për mësim të hershëm dhe zhvillim për moshën më të rritur parashkollore, me qëllim të ndërlidhjes funksionale të qëllimeve në programet mësimore në klasë të parë. Pedagogët e anketuar mendojnë se ndryshimet duhet bërë në pjesët vijuese të programit: Edukimi figurativ (34,28 %), Shkencat natyrore (22,85 %), Gjuhë

amtare (17,14 %), Edukim muzikor (17,14 %), Shoqëri (2,86 %), ndërsa dy pedagogë propozojnë ndryshimin dhe konkretizimin e të gjitha qëllimeve edukative-arsimore në Programin për mësim të hershëm dhe zhvillim.

TABELA 39: QËNDRIMET DHE MENDIMET E PEDAGOGËVE NË LIDHJE ME EVIDENCE PEDAGOGJIKE DHE DOKUMENTACIONIN I CILI UDHËHIQET NË INSTITUCIONET PËR FËMIJË NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË

KATEGORIA E PËRGJIGJEVE							
Po, përputhet me kërkesat bashkëkohore për planifikimin dhe realizimin e punës edukative-arsimore, ku fëmija është në qendër të vëmendjes		Pjesërisht përputhet		Jo, në tërësi nuk përputhet me kërkesat bashkëkohore për planifikimin dhe realizimin e punës edukative-arsimore, ku fëmija është në qendër të vëmendjes		Gjithsej	
f	%	f	%	f	%	f	%
4	26,67	10	66,67	1	6,66	15	100

TABELA 40: QËNDRIMET E EDUKATORËVE NË LIDHJE ME ATË SE VALLË EVIDENCA PEDAGOGJIKE AKTUALE DHE DOKUMENTACIONI NË KOPSHTE/ RTRP DUHET TË RISHIKOHET

KATEGORIA E PËRGJIGJEVE					
Po		Jo		Gjithsej	
f	%	f	%	f	%
14	93,33	1	6,67	15	100

Një numër i madh i pedagogëve të anketuar (93,4 %) mendojnë se evidence pedagogjike ekzistuese dhe dokumentacioni pjesërisht ose tërësisht nuk përputhet me kërkesat bashkëkohore për planifikimin dhe realizimin e punës edukative-arsimore, duke e vënë fëmijën në qendër të vëmendjes, (93,33 %) mendojnë se evidence pedagogjike

aktuale dhe dokumentacioni në kopshte/ qendrat për zhvillim të hershëm duhet të rishikohen. Propozimet e pedagogëve për përmirësimin e evidencës pedagogjike dhe dokumentacionit ka të bëjë me sa vijon: „Të mos shkruhen çdo ditë standardet, ato të ekzistojnë në planifikimin vjetor“; „Në planifikim të theksohen qendrat për mësim“ dhe „Të ketë pjesë ku do të planifikohet bashkëpunimi me familjen“.

TABELA 41: QËNDRIMET DHE MENDIMET E PEDAGOGËVE NË LIDHJE ME NEVOJËN E APLIKIMIT TË VITIT PËRGATITOR TË DETYRUESHËM PARA NISJES NË SHKOLLË

KATEGORIA E PËRGJIGJEVE							
Plotësisht pajtohem		Pjesërisht pajtohem		Nuk pajtohem aspak		Gjithsej	
f	%	f	%	f	%	f	%
7	46,67	7	46,67	1	6,66	15	100

Një numër i madh i pedagogëve të anketuar (93,34 %) tërësisht ose pjesërisht pajtohen se është e nevojshme të aplikohet viti përgatitor i detyrueshëm para shkuarjes në shkollë.

TABELA 42: QËNDRIMET DHE MENDIMET E PEDAGOGËVE NGA INSTITUCIONET PARASHKOLLORE NË LIDHJE ME TË PRITURAT E TYRE PËR PËRGATITJEN E FËMIJËVE PËR KALIM TË SUKSESSHËM NGA INSTITUCIONI PARASHKOLLOR NË SHKOLLË FILLORE

KATEGORIA E PËRGJIGJEVE							
Po		Pjesërisht		Jo		Gjithsej	
f	%	f	%	f	%	f	%
2	13,33	13	86,67	0	0	15	100

Sipas një numri të madh të pedagogëve të anketuar (86,67 %) me realizimin e qëllimeve të Programit për mësim të hershëm dhe zhvillim, fëmijët pjesërisht janë të përgatitur, ndërsa sipas 13,33 % prej tyre në tërësi janë të përgatitur për fillim të suksesshëm në klasë të parë në shkollë fillore.

TABELA 43: PËRGJIGJET E PEDAGOGËVE NGA INSTITUCIONET PARASHKOLLORE NË LIDHJE ME NEVOJËN E TRAJNIMEVE TË REALIZUARA NGA NËPUNËSIT PROFESIONISTË TË BYROSË SË ZHVILLIMIT TË ARSIMIT

KATEGORIA E PËRGJIGJEVE			
Po		Jo	
f	%	f	%
15	100	0	0

TABELA 44: PËRGJIGJET E PEDAGOGËVE NË LIDHJE ME ATË VALLË KANË NEVOJË PËR MBËSHTETJE TË VAZHDUESHME PROFESIONALE-KËSHILLËDHËNËSE NGA KËSHILLTARËT E BYROSË SË ZHVILLIMIT TË ARSIMIT

KATEGORIA E PËRGJIGJEVE			
Po		Jo	
f	%	f	%
15	100	0	0

Pedagogët e anketuar në institucionet parashkollore janë të vetëdijshëm se me përsosjen personale të vazhdueshme do të arrijnë rezultate më të mira në punë, me çka do të rritet cilësia e punës edukative-arsimore në kopshtet për fëmijë dhe qendrat për zhvillim të hershëm. Më konkretisht, të gjithë pedagogët e anketuar u përgjigjën se kanë nevojë për trajnim të realizuar nga nëpunësit profesionistë të Byrosë së Zhvillimit të Arsimit. Në pyetjen se për cilën temë iu nevojiten trajnimet edukatorëve nga ana e nëpunësve profesionistë të Byrosë së zhvillimit të arsimit, pedagogët e anketuar i theksuan temat në vijim: „Si duhet të jetë dukja (pamja) e edukatores?“, „Njohja me hulumtimet më të reja nga fusha e mësimi të hershëm dhe zhvillimit të fëmijëve“; „Planifikimi i punës edukative-arsimore“; „Mënyra e udhëheqjes të evidencës pedagogjike dhe dokumentacioni“; „Normat etike dhe morale në procesin e edukimit“; Aplikimi i Standardeve për MHZH“; „Kompetencat e edukatorëve për punë me fëmijët me nevoja të posaçme“; „Metodat dhe format bashkëkohore për punë me fëmijët e moshës parashkollore“ „Punë me fëmijët e talentuar“ „Përmirësimi i procesit edukativo-arsimor“ „Përvoja

nga puna edukative-arsimore në edukimin parashkollor dhe arsimit në diasporë“.

Të gjithë pedagogët e anketuar mendojnë në mbështetjen e vazhdueshme profesionale-këshillëdhënëse ndaj edukatorëve nga këshilltarët e Byrosë së zhvillimit të arsimit sepse: „Kemi nevojë për përkryerje profesionale të vazhdueshme“; „Njohuria teorike dhe praktike e kolegëve nga Byroja e Zhvillimit të Arsimit çdo herë është një nxitje për diçka të re dhe krijuese“; „Këshilltarët japin udhëzime konkrete për përmirësimin e cilësisë së punës edukative-arsimore“; „Komunikimi dhe bashkëpunimi reciprok do të kontribuojë ndaj avancimit të punës edukative-arsimore“; Informimi për risitë në punën edukative-arsimore“; „Puna këshillëdhënëse çdo herë është e

mirëseardhur në pjesën e planifikimit dhe realizimit të punës edukative-arsimore dhe udhëheqjes së evidencës pedagogjike dhe dokumentacionit“; „Të kemi mundësinë nga afër të këmbëjmë nevojat, problemet dhe sfidat me qëllim që të gjithë të përparojmë“.

Mendimet dhe sugjerimet e pedagogëve për avancimin e punës edukative-arsimore në kopshtet për fëmijë

Pedagogët e anketuar i parashtruan këto mendime dhe sugjerime: „Të bëhemi pjesë e MASH sepse ne jemi vendi i vetëm në botë me edukim parashkollor në MPPS“; „Rishikimi i gjithë Programit për mësim të hershëm dhe zhvillim me qëllim të sigurohet vazhdimësia dhe kompatibiliteti me programin shkollor“; „Program i ri për punën edukative-arsimore përgatitur nga personat e autorizuar të Byrosë së Zhvillimit të Arsimit dhe prezantimi i tyre përmes trajnimeve përkatëse në të cilat do të përfshihen të gjithë edukatorët“; „Përgatitja e bazave për programimin e punës ndaj të gjithë punonjësve profesionistë dhe bashkëpunëtorëve në kopsht“; „Të mbahen trajnime profesionale dhe të jenë në hap me të arriturat bashkëkohore“; „Zvogëlimi i vëllimit të punës administrative. Kompletimi i shërbimit profesional në kopshte“; „Dosja e fëmijës të lirohet nga pjesët e panevojshme (ato të cilat duhet t'i plotësojë mjeku) dhe detyrimisht të përcillet në shkollë“; „Harmonizimi i Programit për mësim të hershëm dhe zhvillim me programin e Kembrixhit, në veçanti në lëmin e Matematikës“; „Respektimi i normativit për numrin e fëmijëve në grupet edukative“; „Evidenca pedagogjike të udhëhiqet ose në letër ose në formë elektronike“; „Të hartohen doracakë me përmbajtje dhe aktivitete si mjet ndihmës për të gjithë edukatorët

dhe përkëdhelëset të cilët paraqiten në rolin e realizuesit të programit“; „Në grupet për fëmijë prej moshës 3 deri 6 vjeçare të punësohen nga dy edukatore dhe të ruhet normativi për numrin e fëmijëve në grup“; Për fëmijët me pengesa në zhvillim të mundësohet shoqërim nga personi profesionist, defektolog gjatë qëndrimit në kopsht“; „Të aprovohet program i posaçëm për punën edukative-arsimore në vitin përgatitor para shkuarjes në shkollë“; Të rishqyrtohet normativi për mjetet didaktike, materialet dhe lodrat dhe vazhdimisht të pasurohet fondi i mjeteve didaktike dhe materialeve në kopshtet për fëmijë“.

5 TË DHËNAT E FITUARA ME FOKUS GRUPET E EDUKATORËVE NË KOPSHTET PËR FËMIJË

Në dhjetë kopshte për fëmijë në Republikën e Maqedonisë janë mbajtur fjalime me edukatorët e fokus grupeve. Anëtarët e ekipit hulumtues incizuan përgjigjet e edukatorëve, e më pas të njëjtat u regjistruan në formë origjinale.

1. Çka mendoni për dokumentin Standardet për mësim të hershëm dhe zhvillim të fëmijët prej moshës 0 - 6 vjeç?

Sa i përket kësaj pyetje, edukatorët që morën pjesë në fokus grupet i parashtruan deklaratat vijuese:

- ▲ „Fëmijët i përmbushin, madje mund të thuhet se i tejkalojnë të gjitha standardet.“
- ▲ „Duhet të ndahet arti kulturor (figurativ dhe muzikor) nga zhvillimi kognitiv.“
- ▲ „Programi ekzistues është shumë i mangët. Mundësitë e fëmijëve janë më të mëdha, ata mundën më shumë dhe për këtë arsye programi duhet të begatohet.“
- ▲ „Midis standardeve nuk ka kufi të mprehtë. Standardet e parashtruara janë shumë të ulët, fëmijët mundën më shumë.“
- ▲ „Standardet nuk janë aq të rëndësishëm, sepse ato janë vetëm një lloj i formës. Mund të shkruajmë se bëhet fjalë për art, por në fakt, të përfshihen edhe të gjitha standardet tjera. Me rëndësi janë qëllimet në program dhe për këtë ato duhet të zgjerohen.“
- ▲ „Standardet nuk mund të ndahen, ato janë të nevojshme vetëm për në dosje.“
- ▲ „Sot, me teknologjinë ekzistuese, koha është moderuar dhe fëmijët janë më inteligjentë. Për këtë fëmijët i tejkalojnë standardet ekzistuese dhe të njëjtat duhet ndryshuar.“
- ▲ „Standardet duhet të zgjerohen definitivisht. Unë i përshëndes risitë, por gjithsesi mendoj se programi i vjetër për punën edukative-arsimore nga viti 2007 është më i miri.“
- ▲ „Standardet janë vetëm tregues me të cilin u tregojmë prindërve se fëmijët e tyre përparojnë në diçka. Standardet nuk përkufizojnë në qasjen individuale ndaj secilit fëmijë. Mendoj se duhet të hartohet një program për fëmijët e talentuar, ndërsa mungon edhe

hapësira përkatëse (llojet e ndryshme të këndeve) ku fëmijët e kishin gjetur veten individualisht. Në vendet e perëndimit, për shembull, sepse ekzistojnë kënde të këtitilla, fëmijët vetë bëjnë përzgjedhjen e këndit të tyre të parapëlqyer dhe edukatori nuk duhet t'i orientojë, por duhet vetëm t'i observojë."

- ▲ „Arti është dhënë i tëri në një, nuk ka fushë për zhvillimin e shprehive higjienike, vetëm është dhënë siguria për shëndetin, nuk ka fushë për bon-ton, për kulturë dhe e vendosim në domenet tjera ku është më i përshtatur.“
- ▲ „Ekziston standard – tregon interesim për pjesëmarrje në forma të ndryshme të krijimit vizual, ndërsa më herët kishim vizatim, kolazh dhe modelim. Arti të ndahet, sepse ekzistojnë teknika të ndryshme të paraqitjes figurative, ndërsa këtu është vetëm ngjyros.“
- ▲ „Nga fusha e zhvillimit kognitiv të ndahet arti.“
- ▲ „Arti figurativ dhe muzikor të jenë të ndara, kur është e ndarë do të ketë më tepër indikatorë, kur do të ketë më tepër indikatorë dhe kur do t'i shkruajmë indikatorët do të dimë dhe do të na japë një pasqyrë se vallë fëmija është më pak ose më shumë i talentuar.“
- ▲ „Të zgjerohet tema për krijimin vizual dhe aktivitetin muzikor.“
- ▲ „Arti të ndahet në art muzikor dhe art figurativ. Nga hapi i parë përmes lojës është përfshirë arti, hap kryesor i të gjitha aktiviteteve.“
- ▲ „Në qasjen për mësim dhe zhvillim social nuk mund të gjej aktivitete, ndërsa në zhvillimin kognitiv ekzistojnë shumë aktivitete dhe gjithçka është vendosur këtu. Arti të jetë gjithnjë një fushë e posaçme dhe me standarde të posaçme.“
- ▲ „Problemi qëndron në qasjen e mësimi – është shkruar shkurt. Tema Komunikacioni për grupin e vogël përfshinë vetëm sigurinë në shtëpi, është shkruar në katër fjali (pajisjet elektrike), e jo automobilat, mjetet transportuese, fëmija këmbësor. Nuk mundem t'i zbatoj, as standardin as indikatorët, e as aktivitetet, kam problem me të shkruarën, çka është arritur, në grupin e vogël.“
- ▲ „Nuk kam aq problem me standardet ku është vendosur arti. Standardet janë vendosur shumë të thata, prej-deri, shumë të kufizuara, kam problem me atë që është shkruar, me të arriturat, çka të shkruaj se është arritur, në grupin e vogël.“
- ▲ „Duhet të rishqyrtohen të gjitha standardet, kaluan shumë vite nga aplikimi i tyre.“
- ▲ „Arti të jepet me terminologji tjetër, si fushë e veçantë. Ajo të ndahet nga zhvillimi kognitiv- të mos jetë në një fushë edhe matematika edhe muzika edhe arti ose, megjithatë, vetëm muzika dhe arti të ndahen, të mos jenë të gjitha në një fushë/sferë.“
- ▲ „Të rishqyrtohet – zhvillimi social.“
- ▲ „Nevojitet konkretizim më i madh te standardet në grupet edukative;. P.sh. Disa standarde që janë dhënë kanë të bëjnë në një temë të caktuar dhe janë përkufizuese (p.sh. familja).

2. Çka mendoni për programin për mësim të hershëm dhe zhvillim?

Të gjithë pjesëmarrësit në fokus grupin janë të vetmit në mendimin se Programi për mësim të hershëm dhe zhvillim ka nevojë për konkretizimin e qëllimeve.

- ▲ „Nevoja për konkretizim më të madh të qëllimeve me shembuj në përputhje me mundësitë zhvilluese të fëmijëve, në veçanti për edukatorët me përvojë më të vogël pune.“
- ▲ „Të gjithë në kopshtin tonë e përdorim Programin e vjetër për punë edukative –arsimore nga viti 2007, sepse kishte qëllime të qarta dhe konkrete dhe shumë shembuj të aktiviteteve.“
- ▲ „Programi për mësim të hershëm dhe zhvillim duhet të jetë i ndërlidhur me qëllimet e Programit për klasë të parë, sepse fëmijët duhet të kenë njohuri paraprake – bazë pasi të fillojnë të shkojnë në shkollë, madje edhe gjatë testimit i cili bëhet në shkollë (p.sh. Vitin e kaluar kur e dërgova fëmijën tim në testim në shkollë dëgjova pyetje për të cilat fëmija im nuk ishte i njoftuar) dhe për këtë mendoj se duhet që qëllimet të kenë lidhshmëri kopshti-shkolla.“

3. Vallë keni vështirësi në planifikimin dhe realizimin e qëllimeve nga Programi për mësim të hershëm dhe zhvillim dhe konkretisht për çka bëhet fjalë?

Edukatorët i parashtruan këto hulumtime:

- ▲ „Problemi më i madh i cili e pamundëson realizimin cilësor të Programit dhe arritjen e përgjithshme të qëllimeve është numri shumë i madh i fëmijëve në grupe. Kjo kontribuon

të mos mundemi të kujdesemi për secilin fëmijë, t'i kushtojmë vëmendje përkatëse, sepse për 15 minuta, aq sa maksimalisht është e mundur të mbahet vëmendja e fëmijëve të kësaj moshe, nuk është e mundur të vëzhgosh 30 e më shumë fëmijë. (Një konstatim të këtillë dhanë unanimisht të gjithë pjesëmarrësit e fokus - grupit)“

- ▲ „Në grupet e kombinuara përballemi me vështirësi në realizimin e qëllimeve, sepse në një grup kemi, për shembull, fëmijë prej moshës 2 dhe fëmijë prej moshës 6 vjeçare të cilët asgjë nuk kanë të përbashkët (dy pjesëmarrës).“
- ▲ „Që programi të mund të realizohet në mënyrë më cilësore dhe në tërësi të arrihen qëllimet, në kopshte mungojnë mjetet didaktike dhe ndihmëse, ndërsa ato të cilat i kemi janë në numër të vogël dhe nuk janë të mjaftueshëm për të gjithë fëmijët. Për shembull, nuk kemi vegla për edukatë fizike (zhvillim të drejtë fizik), në qoftë se dëshirojmë të flasim për komunikacion nuk kemi karroca të mjaftueshme për të gjithë fëmijët etj. Kjo mungesë e përkufizon edhe kreativitetin si edukatorë. Ne në të shumtën e rasteve përpiqemi të improvizojmë, megjithatë mendojmë se sigurimi i një pjese të madhe të materialit didaktik, mjete dhe lodra do të jep rezultate më të mira, sepse gjithsesi, fëmijët mësojnë vetëm përmes lojës (të gjithë pjesëmarrës).“
- ▲ „Në planifikimin nuk hasëm në vështirësi të mëdha. (Kështu u përgjigjën të gjithë pjesëmarrësit e fokus-grupit)“
- ▲ „Planifikimi dhe realizimi do të ishte më i mirë nëse ekzistojnë materialet didaktike.“

- ▲ „Programi që realizohet nga praktikantë, tërësisht është i zbrazët, i thatë.“
- ▲ „Edhe këtu jemi shumë të përkufizuar, p.sh. Ekzistojnë, kupton gjuhën e të folurit, kjo asgjë nuk tregon. Po, ka nevojë për konkretizim më të madh të qëllimeve. Shumë përkufizime në qëllimet, p.sh. Nuk ka qëllime për teatër kukullash, dramatizim, p.sh dëgjon dhe kupton gjuhën e të folurit.“
- ▲ „Me që punoj në grup të vogël e gjej aktivitetin (p.sh. Teatër kukullash, dramatizim) dhe e përfshijë atë. Shfaqja me kukulla mund të jetë në drejtim të zhvillimit emocional, të lirohet fëmija nga frika dhe shqetësimi.“
- ▲ „Nuk kam vështirësi gjatë planifikimit dhe realizimit të qëllimeve nga Programi. P.sh., Shfaqjen me kukulla mund ta përfshijë edhe në zhvillimin emocional dhe në qasjen ndaj mësimi.“
- ▲ „Nisem nga qëllimet dhe nuk hasi në probleme, e zbatoj edhe Programin e vitit 2007.“
- ▲ „Probleme gjatë planifikimit kishim në fillim.“
- ▲ „Disa projekte kërkojnë njohuri më të madhe të asaj sfere.“
- ▲ „Nga aktivitetet projektuese absolutisht nuk ka asnjë nevojë sepse shumë prej tyre realizojmë në programin e rregullt për çdo ditë. Për shembull, nuk ka nevojë për projektin „Bon-ton“ sepse aktivitetet në lidhje me sjelljen e fëmijëve e zbatojmë vazhdimisht. Gjithashtu, temën „Familja“ e kemi përveç mësimi të rregullt edhe sikur aktivitet projektues. Nuk ka nevojë edhe për projektin „Multikulturalizëm“ „Qyteti përmes syve të fëmijëve.“
- ▲ „Të gjitha projektet janë të pranishëm edhe në mësimin e rregullt dhe mendoj se nuk ka nevojë për të njëjtat sepse plotësisht i stërngarkojmë fëmijët, madje edhe neve si edukatorë.“
- ▲ „Në kopshtet rurale kemi vështirësi më të madhe në realizimin e projekteve sepse ne edukatorët bashkërisht me përkëdhelëset e realizojmë punën e përgjithshme (pastrojmë, përgatisim, realizojmë programin me fëmijët prej 9 muaj deri në moshën 6 vjeçare etj.) kështu, pothuajse është e pamundur të realizohen edhe aktivitetet projektuese të parashikuara.“
- ▲ „Detyrimisht aktivitetet projektuese të ndërlidhen me projekt.“
- ▲ Të gjitha projektet që i realizojmë në të cilat janë planifikuar dhe duhet të realizohen – jo secila temë e cila realizohet, mundet për çdo ditë (p.sh. kopshti - më të organizuar, vëmendje të hollësishme – mbjellje, fidanishte, por nuk duhet të jenë në formë të atillë të detyrueshme, sepse aktivitetet në përditshmëri japin shumë më tepër nga ajo që është shkruar, ndonjëherë realizohet shumë më tepër nga ajo që e shkruajmë (p.sh. higjiena, bontoni etj.)“

4. Cilat janë qëndrimet Tuaja për aktivitetet projektuese të detyrueshme të cilat i realizoni me fëmijët në grup?

Edukatorët i parashtruan këto deklarime:

- ▲ „Kemi tepër projekte dhe ndonjëherë na marrin shumë kohë për t'i realizuar sepse punojmë me një numër shumë të madh fëmijësh. (Të gjithë pjesëmarrësit u pajtuan me konstatimin e tillë.)“

- ▲ „Duhet të ndahet diçka – është tepër vështirë kur duhet të formulohet si, kur është përfshirë në aktivitet, ndërsa duhesh ta ndash si pjesë të veçantë.“
- ▲ „Projektet janë tepër të zgjeruara dhe nuk janë për fëmijët e edukimit parashkollor. Në qoftë se mbeten si të detyrueshme mendoj se do të duhet të jenë më të shkurtë.“
- ▲ „Fëmijët janë ende të vegjël që me ato të mund të realizohen të gjitha këto projekte. Përqendrimin e tyre është e pamundshme ta mbash më shumë se 15 minuta“
- ▲ „Për çdo projekt duhet të na sigurohen edhe mjetet e nevojshme për realizim“
- ▲ „Përgatisim programin vjetor sipas temave që realizohen, poashtu realizohen edhe projektet.“
- ▲ „Të jem e sinqertë, projektet janë të panevojshme në programin tonë, poashtu jam bashkërenduese e projektit dhe nënbashkërenduese e projektit tjetër, këto janë aktivitete/ obligime plotësuese në lidhje me përgatitjen e raporteve elektronike, gjetjen e materialeve për realizimin e projekteve. Pse dikush të jetë bashkërendues dhe të shkojë te koleget e të kërkojë aktivitete. Familja, kopshti, bon-toni çdo herë i kemi pasur në program“
- ▲ „Të panevojshme janë projektet, këtë e kemi në planet vjetore, në temat“
- ▲ „Vështirë realizohen me të gjitha grupet më të rritura“
- ▲ „Pak më ndryshe të realizohen aktivitetet projektuese, për shembull: nëse nevojitet të vizatohet Teatri popullor, si do të vizatohet pa e parë edhe atë për një periudhë të shkurtë kohore. Nevojitet kuptimësimi i aktiviteteve projektuese, ato të jenë konkrete dhe të realizueshme.“
- ▲ „P.sh, vizatoni përmendoren e Itar Pejës, Kuzman Josifoskit, ndërsa fëmijët paraprakisht të kenë dëgjuar për ata. Kjo vlen për projektin „Qyteti në sytë e fëmijëve.“
- ▲ „Ndoshta nuk janë të nevojshëm aktivitetet projektuese, por janë shumë në numër. Një pjesë e tyre implementohen në punën e rregullt me fëmijët. Nuk është e domosdoshme të gjitha projektet të realizohen.“
- ▲ „Duhet kohë që të realizohen, ndërsa grupet janë të mëdha. Në aktivitetin projektues nuk mund të përfshihet gjithë grupi, madje nëse janë të përfshirë vetëm gjysma problem është se çka do të bëjnë fëmijët tjerë.“
- ▲ „Nuk ka mjete ndihmëse për punë. Nuk ka resurse tjera të mjaftueshme për realizimin e aktiviteteve.“
- ▲ „Jam bashkërendues i projektit: „Kopshti në kopshtet për fëmijë“, nuk ka resurse për realizimin e kompletuar, fara, lopatë, shatë etj., madje duhet kopsht, në secilin objekt të kemi kopsht.“
- ▲ „Mund aktivitetet projektuese të përshtaten në kushtet ekzistuese për punë në kopshtet dhe në atë mënyrë të jenë efektive.“
- ▲ „Aktivitetet projektuese duhet materialisht të përkrahen, u përkrahën materialisht për gjithë përfshirjen dhe për multikulturalizëm. Për ato kishte nevojë dhe fëmijët mund të përfshihen. Lojërat tradicionale çdo herë realizohen.“

5. Kur realizohen (në cilën periudhë ditore) programet fakultative me fëmijët e grupit Tuaj?

- ▲ „Pas orës 14:00 pas përfundimit të pushimit pasiv. Ky termin ka të bëjë në nivelin e të gjitha kopshteve që janë pjesë e këtij institucioni.“
- ▲ „Kemi vetëm gjuhë angleze, fëmijët vizitojnë dy herë në javë edhe atë vetëm paradite prej orës 9:30 dhe orës 10:30 (të hënën dhe të mërkurën). Fëmijët shkojnë në orë para punës ose në mes të aktivitetit.“
- ▲ „Ndonjëherë pengojnë në realizimin e programit, veçanërisht para shfaqjes.“
- ▲ „Nuk ka hapësirë të posaçme për realizimin e aktiviteteve fakultative. Hapësirë nuk ka dhe mbahen në tryezë. Nuk ka hapësirë të posaçme, ka zhurmë, nuk ka kushte.“
- ▲ „Shmangim aktivitetet tjera që të realizohen programet fakultative.“
- ▲ „Nuk duhet bërë kompromis midis punës së rregullt edukative-arsimore dhe programit fakultativ.“
- ▲ „Nuk duhet pasur programe fakultative. Prindërit vetë duhet të vendosin se ku do t'i inkuadrojnë fëmijët gjatë kohës së lirë.“
- ▲ „Fëmijët i lëshojnë aktivitetet tona. Propozim që pasdite të mbahen lëndët fakultative, p.sh, prej orës 15.00 deri në orën 15.30 ose prej 15.00 deri në orën 16.00.“
- ▲ „Nuk është dhënë koha kur do të realizohen lëndët fakultative.“
- ▲ „Në grupin e vogël nuk kemi gjuhë angleze, ndërsa si edukator i fëmijëve vërej se merret fëmija, pa i kryer aktivitetet e rregullta. Kjo duhet të bëhet pasdite.“

- ▲ „Pse duhet pasur lëndë fakultative, lëshojnë nga aktivitetet tona për gjuhë angleze, atëherë mund të ketë xhudo, gjimnastikë etj.“
- ▲ „Nuk duhet t'i kemi.“
- ▲ „Realizimi (i gjuhës angleze, folklori dhe vallëzimi) pas pushimit, pas gjumit.“

6. Cilat janë qëndrimet Tuaja për evidencën pedagogjike dhe dokumentacionin të cilin e udhëhiqni në mënyrë të detyrueshme?

Edukatorët i parashtruan këto deklarime:

- ▲ „Pa nevojë udhëhiqet evidencë e dyfishtë (ditari dhe ditari elektronik). Mjafton vetëm njëri ose tjetri. Shpenzojmë tepër kohë për evidencë në vend të se vëmendjen ta përqendrojmë te fëmijët (të gjithë pjesëmarrësit).“
- ▲ „Jemi të stërngarkuar me punë administrative. Kjo kontribuon në zvogëlimin e cilësisë së punës si edukatorë, e që është primare.“
- ▲ „Ditarët nuk parafytyrojnë ditarët e vërtetë, por në fletore të thjeshta. Mendoj se duhet të përpilohen ditarë më cilësor.“
- ▲ „Ditarët e vjetër të „Hap pas hapi“ ishin shembullorë, mendoj se përsëri duhet të kthehen të njëjtë.“
- ▲ „Mendoj se ditarët, d.m.th., grafat në ditar duhet të jenë më ndryshe dhe më praktik. Për shembull, të jenë duke nënvizuar ose me të rrethuar paraprakisht standardet e theksuara, vendi i realizimit të aktiviteteve dhe ngjashëm. Në atë mënyrë nuk do të ishte e detyrueshme për çdo ditë t'i shkruajmë të njëjtat standarde dhe kështu do të kursenim kohë.“

- ▲ „Kemi vështirësi gjatë udhëheqjes të ditareve elektronik sepse nuk kemi kompjuterë të mjaftueshëm, d.m.th., kemi vetëm dy kompjuterë. Përderisa kërkohet nga ne të udhëhiqet ditari elektronik, duhet të na sigurohen edhe mjetet përkatëse dhe kushtet për kuptohet.“
- ▲ „Nuk duhet të udhëhiqet dosje në formë të shkruar, sepse në to nuk jemi objektiv. P.sh., nëse vërejmë se ndonjë fëmijë është me nevoja të posaçme, e për këtë prindërit nuk kanë sjellë asnjë dokument dëshmues, dhe nuk dëshirojnë ta shohin këtë, ne nuk e shënojmë në dosje, sepse nuk dëshirojmë ne ta shënojmë si të tillë.“
- ▲ „Dosje udhëheqim për çdo fëmijë, ndërsa në shkollë fillore askush nuk e shikon atë.“
- ▲ „Edukatorët të mos sjellin të dhëna për gjendjen shëndetësore të fëmijëve, diagnozën dhe të mos japin diagnoza për nevoja të veçanta të fëmijës.“
- ▲ „Nëse dëshirojnë që në mënyrë elektronike të udhëhiqet evidenca, duhet të na sigurohen laptopë.“
- ▲ „Në rregull është që të udhëhiqet evidenca pedagogjike, por të jetë ose në formë elektronike ose ditari i zakonshëm. Në shtëpi e bëj këtë çdo herë.“
- ▲ „Një evidencë është e mjaftueshme, ky nuk është arsim fillor. Ju mos të krahasoni me filloren.“
- ▲ „Nëse udhëhiqet në formën elektronike atëherë të sigurohen kushte për udhëheqje të një evidence të atillë. Nuk ka laptopë, nuk ka Internet.“
- ▲ „Jemi të stërngarkuar. Nuk kemi laptopë. Këtë e punojmë në shtëpi ose mbetemi në punë.“
- ▲ „Tash kërkohet dhe udhëhiqet evidencë gjatë tërë vitit, ndërsa më herët deri më 10 qershor, që ishte e rregullt, sepse prej 10 qershorit fëmijët mblidhen në një kopsht.“
- ▲ „E njëjta shkruhet dy herë.“
- ▲ „Konkluzionet apo përfundimi i kolegjiutit profesionist ishte se evidenca pedagogjike dhe dokumentacioni i cili detyrimisht udhëhiqet duhet të jetë një – ose në formë të shkruar ose ditari elektronik.“
- ▲ „Nuk ka hapësirë të mjaftueshme për të shkruar qëllimet e parashikuara.“
- ▲ „Në kopsht ka vetëm një laptop, madje edhe rrjeti nuk është i qëndrueshëm – shpesh nuk ka Internet. Kemi vërejtje edhe në programin – përkatësisht në faqen ku shënohen të dhënat për fëmijën, në përgjithësi nuk është e siguar. Ne kemi nënshkruar dokument për mbrojtjen e të dhënave të fëmijëve. Të dhënat të cilat janë në versionin e shkruar në letër i ruajmë të mbyllura, përderisa, gjithashtu të dhënat të cilat i fusim në mënyrë elektronike (p.sh. Numri i amzës dhe ngjashëm) nuk janë të siguruara dhe dikush mund të hyjë dhe t'i marr të dhënat e fëmijëve, madje edhe të dhënat tona (të dhënat e punonjësve zyrtarë) dhe të njëjtat mund të keqpërdoren. Megjithatë, edhe kur hymë në vetë faqen qëndron se faqja nuk është e mbrojtur ose sigurt. Për këtë është i informuar „Neokom“ i cili mbante trajnimin, por edhe ai tani më nuk është kompetent për këtë problematikë dhe kështu që jemi lënë më vete.“

7 Vallë mendoni se veprimtaria duhet të rregullohet me ligj të posaçëm për edukimin dhe arsimin parashkollor?

Edukatorët i parashtruan këto qëndrime:

- ▲ „Po (të gjithë pjesëmarrësit)“
- ▲ „Po, ne çdo herë kemi menduar se duhet të jemi nën MASH sepse jemi edhe institucion arsimor. Tani jemi të marginalizuar.“
- ▲ „Edukimi dhe arsimit parashkollor bën pjesë në sistemin e arsimit të ne, madje edhe në shtetet tjera, si në sistemin e parë.“
- ▲ „Ne udhëheqim dosje për secilin fëmijë dhe mendojmë se është e rëndësishme gjatë regjistrimit në shkollë.“
- ▲ „Pikërisht kjo është edhe një ndërlidhje e kopshteve me shkollat fillore.“

8 Vallë në grupin edukativ me moshë parashkollorë më të rritur, duhet të punojnë nga dy edukatorë?

Edukatorët i parashtruan këto qëndrime:

- ▲ „Nuk ka nevojë për dy edukatorë sepse fëmijët e kësaj moshe mjaftë janë të pavarur, kanë shprehur higjienike - kulturore. Fëmijët kanë shprehur kulturore higjienike.“
- ▲ „Po, sepse puna në ekip në çdo rast është më e mira dhe çdo herë jep rezultate më të larta. Mes tjerash, me kolege të profilit të njëjtë asnjëherë nuk është dëm të punohet bashkërisht.“
- ▲ „Po, munden të punojnë nga dy edukatorë, sepse siç thamë, punojmë me grupe tejet të mëdha dhe me dy edukatorë do të ishte një ngarkesë më

e vogël. Mirë do të ishte koleget më të reja të punojnë së bashku me koleget që kanë më shumë përvojë, që të mund të këmbëhet përvoja të koleget më të reja.“

- ▲ „Po, puna edukative-arsimore zgjatë prej orës 06.00 deri në orën 17.30 dhe përderisa fëmija qëndron në kopsht duhet të punojnë dy edukatorë. Më herët të kishit ardhur dhe të kishit pyetur për këtë.“
- ▲ „Jo, dy edukatorë nuk nevojiten, por edukatori dhe përkëdhelësi (vazhdimisht të jenë bashkë).“

9 Çfarë trajnime dhe për cilën temë prisni të realizohen nga këshilltarët e Byrosë së zhvillimit të arsimit?

Edukatorët i parashtruan këto qëndrime:

- ▲ „Do të dëshiroja të aplikohet TIK në kopshte, sepse fëmijët nga mosha më e hershme shprehin dëshirë për kompjuterët. Në qoftë se do të bëhej kjo do të ishte e domosdoshme edhe ndonjë trajnim për ne edukatorët, për të ditur se si ta realizojmë, zbatojmë (katër pjesëmarrëse).“
- ▲ „Aplikimi i softuerëve të caktuar.“
- ▲ „Në qoftë se do të miratohet program i ri do të dëshironim të na mbahet trajnim për të njëjtën.“
- ▲ „Në qoftë se bëhen ndryshime në udhëheqjen e evidencës, e domosdoshme është që të mbahet trajnim për të njëjtën.“
- ▲ „Në qoftë se këto programe mbeten, të pandryshuara, do të dëshiroja të vijë dikush t'i realizojë për të parë se kjo nuk është e mundur.“

- ▲ „Praktikisht të realizohet një ditë pune.“
- ▲ „Trajnime për evidencën pedagogjike nevojiteshin më herët.“
- ▲ „Trajnime për gjithë përfshirjen kishte, por akoma duhet.“
- ▲ „Trajnim për plotësimin e duhur të ditarit elektronik.“
- ▲ „Trajnime për fëmijët me epilepsi, por së bashku me prindërit që të dihet në mënyrë të duhur të veprojnë.“
- ▲ „Trajnime për realizimin e Programit për mësim të hershëm dhe zhvillim të fëmijët. Isha në pushim mjekësor dhe më nevojitet trajnim për aktivitetet udhëzuese të synuara.“
- ▲ „Inkuadrimi i të gjithë edukatorëve në trajnimet për realizimin e aktiviteteve të synuara nga dokumenti.“
- ▲ „Për çdo risi të përfshihen edhe prindërit.“
- ▲ „Për programin e ri, për ato të sapopunësuarit iu nevojitet trajnim, madje edhe të gjithëve.“
- ▲ „Trajnime të reja. Ligjërata si p.sh. Nga Ranko Rajoviq, të jemi në rrjedha me ndodhitë në botë. Të ketë punëtori, e jo sot do ta mësojmë vjershën.“
- ▲ „Nevojitet ndihmë për trajnime nga BZHA, madje të përkujtohemi edhe në disa gjëra, Motesori ose diçka tjetër të re çka ndodhë në botë etj.“
- ▲ „Trajnim për të gjithë për udhëheqje të dokumentacionit pedagogjik.“

10. Propozime të tjera dhe sugjerime

Edukatorët i parashtruan këto propozime:

- ▲ „Duhet të harmonizohen programet e parashkollores me ato të arsimit fillor.“
- ▲ „Arsimi parashkollor dhe ai fillor duhet të jenë nën ministrinë e njëjtë.“
- ▲ „Edukatorët nuk kanë mundësi të përparojnë në karrierë, d.m.th., nuk kanë mundësi për zhvillim profesional. Kjo do të duhej t’iu sigurohej ashtu sikurse mësimdhënësve.“
- ▲ „Propozimi im është që mos të merren programe nga jashtë sepse atje punohet me një numër më të vogël të fëmijëve në grupe dhe programet e tyre është e pamundur të realizohen tek ne.“
- ▲ „Vallë duhet gjatë gjithë vitit kalendarik të udhëhiqet ditari ose udhëheqje të detyrueshme do të ketë vetëm deri më 10.06 në vitin aktual?“
- ▲ „Tani udhëhiqet evidencë gjatë gjithë vitit, ndërsa më herët deri më 10 qershor.“
- ▲ „Në cilën ministri/resor bëjnë pjesë realizuesit e kësaj veprimtarie në kopshte?“
- ▲ „Të ketë punësime të reja në vendet e zbrazëta me pensionimin, në veçanti punëtorë të higjienës, sepse tani më ne edukatorët vetë po bëjmë pastrimin e hapësirave në kopsht.“
- ▲ „Orari i punës i edukatorëve të jetë më pak se tetë orë ose orar me kohëzgjatje prej shtatë orësh në kopshte. Ne i kemi detyrat e njëjta të punës sikurse edhe mësimdhënësit në shkollat fillore me qëndrim tërditor.“

6 TË DHËNAT E FITUARA SIPAS ANKETIMIT TË PEDAGOGËVE NË SHKOLLAT FILLORE

Në hulumtim morën pjesë 193 pedagogë të shkollave fillore në Republikën e Maqedonisë.

TABELA 45: STRUKTURA E EKZEMPLARIT TË PEDAGOGËVE TË SHKOLLAVE FILLORE SIPAS PËRGATITJES INICIALE/SHKALLËS SË ARSIMIT


KATEGORIA E PËRGJIGJEVE							
ARSIM SIPËROR		MAGJISTËR		DOKTOR SHKENCE		GJITHSEJ	
f	%	f	%	f	%	f	%
174	90,15	18	9,33	1	0,52	193	100

TABELA 46: STRUKTURA E EKZEMPLARIT SIPAS PËRVOJËS SË PUNËS SI PEDAGOG

KATEGORIA E PËRGJIGJEVE									
Deri në 10 vjet		Deri në 20 vjet		Deri në 30 vjet		Mbi 30 vjet		Gjithsej	
f	%	f	%	f	%	f	%	f	%
93	48,18	47	24,35	37	19,17	16	8,30	193	100

PARAQITJA SKEMATIKE 4: STRUKTURA E EKZEMPLARIT TË PEDAGOGËVE SIPAS GJINISË


Struktura e ekzemplarit sipas gjinisë



Sipas pedagogëve të anketuar në vitin shkollor 2016/2017 në shkollat e tyre fillore janë regjistruar gjithsej 16.124 nxënës në klasë të parë.

PARAQITJA SKEMATIKE 5: NUMRI I NXËNËSVE TË REGJISTRUAR NË KLASË TË PARË TË CILËT KANË NDJEKUR KOPSHTIN PËR FËMIJË

Paraqitje grafike për numrin e nxënësve në klasë të parë të cilët kanë ndjekur kopshtin për fëmijë



Nga numri i përgjithshëm janë regjistruar 16.124 nxënës në klasë të parë, 5.827 prej tyre kanë ndjekur punën edukative-arsimore të organizuar në kopshtet për fëmijë.


Pedagogëve të anketuar iu parashtrua pyetja se vallë kanë qenë anëtarë të komisionit për regjistrimin e nxënësve në klasë të parë në shkollë në vitin 2017, ndërsa sipas përgjigjeve vetëm tetë pedagogë nuk kanë qenë anëtarë të komisionit.

Mendimet e pedagogëve të anketuar në lidhje me njohuritë paraprake të fëmijëve të cilët kanë ndjekur kopshtin për fëmijë dhe adaptimi i tyre në klasë të parë

Pedagogët e anketuar të cilët kanë marrë pjesë në komisionin për regjistrimin e nxënësve në shkollë në klasë të parë kanë vërejtur dallimet në lidhje me sjelljen në hapësirë, mënyrën e komunikimit me fëmijët dhe me moshatarët, vetëbesimi, të folurit dhe njohuritë paraprake të fëmijët të cilët kanë qenë të përfshirë në punën edukative-arsimore në kopsht, krahasuar me ato të cilët nuk kanë ndjekur asnjë lloj forme të punës edukative-arsimore para shkuarjes në shkollë. Më konkretisht, dallime të këtylla janë vërejtur te një numër i madh i nxënësve të regjistruar në 115 shkolla fillore, te gjysma e nxënësve të regjistruar në 30 shkolla fillore, te një numër i vogël nga nxënësit e regjistruar në 32 shkolla fillore, vetëm në 17 shkolla fillore nuk ka pasur dallime në sjelljen në hapësirë/klasë, mënyrën e komunikimit me fëmijët dhe me moshatarët, vetëbesimin, të folurit dhe njohuritë paraprake të fëmijët të cilët kanë qenë të përfshirë në punën edukative-arsimore në kopsht, krahasuar me ato të cilët nuk kanë ndjekur asnjë lloj forme të punës edukative-arsimore para shkuarjes në shkollë.


Pedagogëve të anketuar të shkollave fillore iu parashtrua pyetja: „Me çfarë njohurie paraprake vijnë nxënësit në klasë të parë të cilët paraprakisht kanë qenë të përfshirë në punën edukative-arsimore në kopsht?“ Sipas përgjigjeve të pedagogëve të anketuar nxënësit të cilët paraprakisht kanë qenë të përfshirë në punën edukative-arsimore në kopsht kanë: fjalor të pasur dhe shkathtësi të mira të komunikimit (124 nga pedagogët e anketuar), njohuri paraprake nga lëmi i matematikës (97), njohuri paraprake nga lëmi i shkencave natyrore (70), njohuri paraprake nga lëmi i arsimit figurativ dhe muzikor (99) dhe koordinimi i mirë i muskulaturës së madhe dhe muskulaturës së imët të zhvilluar të dorës (57). Sipas 20 pedagogëve të anketuar nuk ka dallim të madh në njohuritë paraprake të këtyre nxënësve në raport me nxënësit të cilët nuk kanë ndjekur asnjë lloj forme të edukimit dhe arsimit parashkollor, ndërsa 12 pedagogë nuk kanë njohuri për këtë problematikë.

PARAQITJA SKEMATIKE 6: MENDIMET E PEDAGOGËVE TË ANKETUAR NË LIDHJE ME ADAPTIMIN E NXËNËSVE TË REGJISTRUAR NË KLASË TË PARË



Sipas numrit më të madh prej 193 pedagogëve të anketuar në shkollat fillore, një numër i madh i fëmijëve të cilët kanë qenë të përfshirë në punën e organizuar edukative-arsimore në kopsht shpejtë janë adaptuar në paralele (138), ndërsa gjysma tjetër e këtyre fëmijëve shpejtë janë adaptuar në paralele (25).

PARAQITJA SKEMATIKE 7: MENDIMET E PEDAGOGËVE TË ANKETUAR NË LIDHJE ME NJOHJEN E PROGRAMIT PËR MËSIM TË HERSHËM DHE ZHVILLIM



Më shumë se gjysma e pedagogëve të anketuar në shkollat fillore (104) janë deklaruar se pjesërisht e njohin Programin për mësim të hershëm dhe zhvillim në të cilin bazohet realizimi i punës edukative-arsimore në kopsht, 56 prej tyre në përgjithësi nuk e njohin, ndërsa 33 në përgjithësi janë të njoftuar me këtë program.

Qëndrimet e pedagogëve të shkollave fillore për nevojën e ekzistimit të lidhshmërisë të programeve mësimore në klasën e parë dhe Programit për mësim të hershëm dhe zhvillim në bazë të së cilës realizohet puna edukative-arsimore në kopsht

Nga numri i përgjithshëm i pedagogëve të anketuar (106) mendojnë se rëndësi të veçantë ekziston në ndërlidhjen e programeve mësimore në klasën e parë dhe Programin për mësim të hershëm dhe zhvillim në bazë të së cilës realizohet puna edukative-arsimore në kopsht, sipas 46 të anketuarve kjo është shumë e rëndësishme, sipas 36 pedagogëve kjo është e rëndësishme, ndërsa vetëm pesë pedagogë të shkollave fillore mendojnë se nuk është e domosdoshme të ekzistojë lidhshmëria e këtyre dy dokumenteve programore. Pedagogët e anketuar të cilët mendojnë se është e nevojshme lidhshmëria e programeve mësimore në klasë të parë dhe Programit për mësim të hershëm dhe zhvillim tregojnë se është me rëndësi të veçantë lidhshmëria e: *matematikës dhe shkencave natyrore, në veçanti për shkak të programeve të përshtatura të Kembrixhit* (130 pedagogë të anketuar); në pjesën *Gjuhë amtare* (111 pedagogë); edukim fizik dhe shëndetësor (46); arsimit figurativ (42); arsim muzikor (37); në raport me përforcimin e vetëbesimit dhe fotografisë pozitive për vetveten

(124) dhe shoqëri (52). Një numër i vogël i pedagogëve të anketuar tregojnë për nevojën e lidhshmërisë të elementeve vijues: shprehitë mirë të zhvilluara kulturore-higjienike, shprehitë e punës, sjellja kulturore, qëndrueshmëri gjatë realizimit të aktiviteteve dhe zhvillimi i shprehive për sjellje të drejtë dhe respektim të ndërsjellë.

Qëndrimet e pedagogëve të shkollave fillore për nevojën e vitit përgatitor të detyrueshëm para shkuarjes në shkollë për fëmijët prej moshës 4 - 6 vjeç

Pjesa dërmuese e pedagogëve të anketuar (120 prej tyre) në përgjithësi pajtohen se nevojitet viti përgatitor i detyrueshëm para shkuarjes në shkollë për fëmijët prej moshës 4 - 6 vjeç, 57 nga pedagogët e anketuar pjesërisht pajtohen, ndërsa vetëm 16 pedagogë nuk mendojnë se është i nevojshëm viti përgatitor i detyrueshëm.

Në pyetjen e parashtruar: „Çka do të duhet të bëhet që të përfshihen të gjithë fëmijët në Republikën e Maqedonisë me punën edukative-arsimore në kopsht para shkuarjes në shkollë?“ Pedagogët e anketuar janë përgjigjur: zgjerimi i kapaciteteve ekzistuese i institucioneve për përfshirjen e fëmijëve prej moshës parashkollore (111); aplikimi i vitit përgatitor të detyrueshëm për të gjithë fëmijët prej moshës 4 - 6 vjeç, (88) dhe sjellja e ligjit për edukim dhe arsim parashkollor (88).

Qëndrimet e pedagogëve të shkollave fillore për lidhshmërinë funksionale me edukimin dhe arsimin parashkollor me atë fillor

Sa i përket kërkesës me mësimdhënësit klasor të anketuar t'i theksojnë sugjerimet e tyre për lidhshmërinë funksionale të edukimit dhe arsimit parashkollor dhe atij fillor ata konsiderojnë se: „Kjo është veçanërisht e nevojshme në mjediset rurale ku fëmijët nuk kanë mundësi të ndjekin kopshtin për fëmijët“; „Përpilimi i programeve të përbashkëta për vitin përgatitor në kopshte dhe programin për klasën e parë në shkollë“; „Viti përgatitor i detyrueshëm prej moshës 4 deri në moshën 6 vjeçare“; „Harmonizimi dhe koordinimi i programeve mësimore në arsimin parashkollor dhe fillor (programi për klasën e parë). Takime konsultative për lëmi të ndryshme profesionale dhe aktivitete të përbashkëta të edukatorëve dhe mësimdhënësve në arsimin fillor“; „Kthimi i grupeve të foshnjoreve në shkollat fillore“; „Harmonizimi ndërmjet programit parashkollor dhe programit për arsim fillor, përmirësimi i kushteve për punë në kopshte, pajisje më e madhe me materialet didaktike dhe ngjashëm.“; „Organizimi i takimeve me shkollat, vizitave dhe formave tjera të aktiviteteve të përbashkëta“; „Aktivitete për përgatitjen e fëmijëve për shkuarje në shkollë“: „Të gjitha ndryshimet programore të fillojnë nga programet parashkollore që në vazhdimësi të zgjerohen dhe zhvillohen në ciklet arsimore vijuese“; „Zgjerimi i institucioneve për fëmijët e moshës parashkollore“; „Miratimi i detyrueshëm i një ligji për edukim dhe arsim parashkollor“; „Bashkëpunim më i madh i kopshteve dhe shkollave fillore, si dhe mbikëqyrje në të gjitha dosjet e fëmijëve të cilët duhet të regjistrohen në klasë të parë“; „Socializimi i fëmijëve,

vlerësimi më i mirë i njohurive dhe shkathtësive të nxënësve për klasën e parë, si dhe zhvillimi i grafomotorikës së tyre, të shprehurit etj“; „Nxënësit prej klasës së parë të ndjekin mësim nëpër kopshte, por sipas sistemit të orëve sikur në shkollat edhe sipas programit mësimor ekzistues. Grupi i madh ekzistues të jetë i detyrueshëm për të gjithë fëmijët“; „Bashkëpunimi me mësimdhënësit klasor të cilët do t'i pranojnë nxënësit e klasës së parë dhe punonjësit në institucionet parashkollore“; „Nxënësit nga kopshtet rregullisht të mësohen në rendin dhe disiplinën në shkollë“; „Ka nevojë për qarkullim vertikal të informatave dhe lidhshmëri e institucioneve parashkollore me shkollat fillore përmes aplikimit të raportit përshkruar objektiv për fëmijët i cili ka rëndësi të madhe për mësimdhënësit klasor dhe përshtatjes në mjedisin shkollor. Njohuritë paraprake me të cilat vijnë fëmijët në shkollë fillore janë shumë të rëndësishme për më shumë aspekte, madje, para së gjithash, konsideroj se socializmi i fëmijës të moshës parashkollore është kusht kryesor për avancimin e tij në shkollë fillore“; „Vitin e fundit para shkuarjes në klasë të parë fëmijët të mos flenë në kopsht, përkatësisht atje të qëndrojnë deri në orën 11:30 siç ishte më parë foshnjorja“; „Harmonizim dhe lidhshmëri e programeve, në veçanti të gjuhës amtare, matematikës dhe shkencave natyrore“; „Të përfshihen të gjithë fëmijët në kopshte, të zvogëlohet numri i fëmijëve nëpër grupet dhe të ketë numër më të madh të aktiviteteve në natyrë, në terren dhe ngjashëm.“

7 TË DHËNAT E FITUARA NGA ANKETIMI I MËSIMDHËNËSVE KLASOR NË SHKOLLAT FILLORE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË

Në hulumtim morën pjesë 137 mësime të klasorëve të shkollave fillore në Republikën e Maqedonisë.

TABELA 47: STRUKTURA E EKZEMPLARIT TË MËSIMDHËNËSVE KLASOR SIPAS PËRGATITJES INICIALE TË TYRE/SHKALLËS SË ARSIMIT


KATEGORIA E PËRGJIGJEVE									
ARSIMI I LARTË		ARSIMI SIPËROR		MAGJISTËR		DOKTOR SHKENCE		GJITHSEJ	
f	%	f	%	f	%	f	%	f	%
6	4,38	123	89,78	7	5,10	1	0,73	137	100

TABELA 48: STRUKTURA E EKZEMPLARIT SIPAS PËRVOJËS SË PUNËS SI MËSIMDHËNËS KLASOR

KATEGORIA E PËRGJIGJEVE									
Deri në 10 vjet		Deri në 20 vjet		Deri në 30 vjet		Mbi 30 vjet		Gjithsej	
f	%	f	%	f	%	f	%	f	%
48	35,04	54	39,42	27	19,70	8	5,84	137	100

PARAQITJA SKEMATIKE 8: STRUKTURA E MËSIMDHËNËSVE KLASOR SIPAS GJINISË


Struktura e ekzemplarit sipas gjinisë



Pjesa më e madhe e mësimeve klasor të anketuar në shkollat fillore (98) janë deklaruar se pjesërisht e njohin Programin për mësim të hershëm dhe zhvillim në të cilin bazohet realizimi i punës edukative-arsimore në kopshte, 23 prej tyre në përgjithësi janë të njoftuar me këtë program, ndërsa 16 mësime klasor aspak nuk e njohin programin.

Mendimet e mësimeve klasor në lidhje me pyetjen vallë me realizimin e Programit për mësim të hershëm dhe zhvillim në kopshtet për fëmijë me sukses përgatiten fëmijët për ndjekjen e mësimit në klasë të parë

PARAQITJA SKEMATIKE 9: NUMRI I NXËNËSVE TË REGJISTRUAR NË KLASË TË PARË TË CILËT KANË NDJEKUR KOPSHTIN PËR FËMIJË



Një numër i madh i mësimeve klasor të anketuar konsiderojnë se me realizimin e Programit për mësim të hershëm dhe zhvillim në kopshtet për fëmijë pjesërisht (78 mësime) dhe në përgjithësi (54 mësime) me sukses përgatiten për ndjekjen e mësimit në klasë të parë, ndërsa vetëm 5 mësime nuk pajtohen me këtë.

Nga numri i përgjithshëm i mësimeve klasor 32 janë përgjigjur se të gjithë nxënësit e paraleles kanë ndjekur njëri nga format e edukimit dhe arsimit parashkollor, ndërsa 84 mësime janë përgjigjur se një numër i madh i nxënësve kanë qenë të inkuadruar në ndonjëri nga format e edukimit dhe arsimit parashkollor.

**TABELA 49: MENDIMET E MËSIMDHËNËSVE
KLASOR NË LIDHJE ME PYETJEN VALLË ME
REALIZIMIN E PROGRAMIT PËR MËSIM TË
HERSHËM DHE ZHVILLIM NË KOPSHTET PËR
FËMIJË ME SUKSES PËRGATITEN FËMIJËT PËR
NDJEKJEN E MËSIMIT NË KLASË TË PARË**

KATEGORIA E PËRGJIGJEVE							
Po		Pjesërisht		Jo		Gjithsej	
f	%	f	%	f	%	f	%
54	56,93	78	39,41	5	3,64	137	100

Këtë pyetje e shqyrtoam edhe nga aspekti i përgjigjeve të cilat i dhanë edukatorët në kopshtet për fëmijë. Në bazë të rezultateve të fituara nga testi X^2 , mund të konstatohet se nuk ekziston dallimi i rëndësishëm statistikor ndërmjet përgjigjeve të cilat i kanë dhënë edukatorët dhe mësimit në klasë të parë.


**TABELA 50: MENDIMET E EDUKATORËVE NË LIDHJE ME
PYETJEN VALLË ME REALIZIMIN E PROGRAMIT
PËR MËSIM TË HERSHËM DHE ZHVILLIM NË
KOPSHTET PËR FËMIJË ME SUKSES PËRGATITEN
FËMIJËT PËR NDJEKJEN E MËSIMIT NË KLASË TË PARË**

KATEGORIA E PËRGJIGJEVE							
Po		Pjesërisht		Jo		Gjithsej	
f	%	f	%	f	%	f	%
101	48,79	101	48,79	5	2,42	207	100,00

$X^2=3,091$ $df=2$ $p < 0,0298$

Mendimet nga anketimi i mësimeve në klasor në lidhje me njohuritë paraprake të fëmijëve të cilët kanë ndjekur kopshtin për fëmijë


PARAQITJA SKEMATIKE 10: MENDIMET E PEDAGOGËVE TË ANKETUAR NË LIDHJE ME NJOHURITË PARAPRAKE ME TË CILËT VIJNË NXËNËSIT NË KLASË TË PARË, E TË CILËT PARAPRAKISHT KANË QENË TË PËRFSHIRË NË PUNËN EDUKATIVE-ARSIMORE NË KOPSHT.



Sipas përgjigjeve të dhëna nga anketimi i mësimeve në klasor, nxënësit të cilët paraprakisht kanë qenë të përfshirë në punën edukative-arsimore në kopsht kanë: fjalorë të pasur dhe shkathtësi të mira komunikimi, njohuri paraprake nga lëmi i matematikës, njohuri paraprake dhe shkathtësi nga lëmi i arsimit figurativ dhe muzikor, koordinim të mirë të muskulaturës së madhe dhe muskulaturës të vogël të zhvilluar të dorës dhe më pak njohuri paraprake nga lëmi i shkencave natyrore.

Mendimi nga anketimi i mësimeve në klasor në lidhje me përshtatjen e nxënësve të cilët kanë qenë të përfshirë me punën edukative-arsimore në kopsht

PARAQITJA SKEMATIKE 11: MENDIMET NGA ANKETIMI I PEDAGOGËVE NË LIDHJE ME PËRSHTATJEN E NXËNËSVE TË REGJISTRUAR NË KLASËN E PARË



Sipas mësimeve të klasorëve të anketuar në shkollat fillore fëmijët të cilët kanë qenë të përfshirë me punën e organizuar edukative-arsimore në kopsht në pjesë më të madhe shpejtë janë përshtatur në paralele në 110 shkolla fillore, ndërsa gjysma prej tyre shpejtë janë adaptuar në paralelet e 12 shkollave fillore.

Qëndrimet e mësimeve të klasorëve për nevojën e ekzistimit të lidhshmërisë të programeve mësimore në klasën e parë dhe Programin për mësim të hershëm dhe zhvillim në bazë të së cilës realizohet puna edukative-arsimore në kopsht

Nga numri i përgjithshëm i mësimeve të klasorëve të anketuar pjesa më e madhe (83) konsiderojnë se rëndësi të veçantë ka ekzistimi i lidhshmërisë të

programeve mësimore në klasë të parë dhe Programi për mësim të hershëm dhe zhvillim në bazë të së cilës realizohet puna edukative-arsimore në kopsht, sipas 36 mësimeve të klasorëve të anketuar kjo është shumë me rëndësi, ndërsa sipas 28 mësimeve të klasorëve kjo është e rëndësishme. Mësimeve të klasorëve të anketuar konsiderojnë se është e nevojshme ndërlidhja e programeve mësimore në klasën e parë dhe Programi për mësim të hershëm dhe zhvillim tregojnë se ka rëndësi të madhe të ekzistojë lidhshmëria e: matematikës dhe shkencave natyrore, në veçanti për shkak të përshtatjes të programeve të Kembrixhit (100 mësime të klasorëve të anketuar); gjuhë amtare (99 mësime të klasorëve të anketuar); edukim fizik dhe shëndetësor (22); arsim figurativ. (27); arsim muzikor (19); në raport me përfundimin e vetëbesimit dhe pasqyrës pozitive për vetveten (95) dhe shoqëri (32). Një numër më i vogël i mësimeve të klasorëve të anketuar tregojnë në lidhshmërinë e elementeve vijues: shprehitë kulturore-higjienike, shprehitë e punës dhe sjellja kulturore.

Mendimet nga anketimi i mësimeve të klasorëve në raport me atë se cilat aktivitete janë shmangur në punën e deritanishme edukative-arsimore me fëmijët në kopsht me qëllim të përmirësimit të përgatitjes së tyre në shkollë fillore

Sipas anketimit të mësimeve të klasorëve për punën e tyre të deritanishme edukative-arsimore me fëmijët në kopsht më së paku janë lënë pas dore aktivitetet vijuese: pasurimi i fjalorit dhe zhvillimi i aftësive komunikuese të fëmijës (73 mësime të klasorëve); aktivitete matematikore për zhvillimin e mendimit logjik dhe zgjidhjes së problemeve (67 mësime të klasorëve); aktivitetet për përgatitjen e fëmijëve për

hyrje në leximin fillestar dhe të shkruarit (54); aktivitetet hulumtuese (54); aktivitetet edukative-arsimore në natyrë (38); aktivitete për edukimin dhe arsimin fizik të fëmijëve (22) dhe aktivitetet nga edukimi dhe arsimi figurativ dhe muzikor (9).

Qëndrimet e mësimeve klasor për nevojën e vitit përgatitor të detyrueshëm para shkuarjes në shkollë për fëmijët e moshës 4 deri 6 vjeçare

TABELA 51: QËNDRIMET E MËSIMDHËNËSVE KLASOR NË LIDHJE ME NEVOJËN E VITIT PËRGATITOR TË DETYRUESHËM

KATEGORIA E PËRGJIGJEVE							
Plotësisht pajtohem		Pjesërisht pajtohem		Nuk pajtohem aspak		Gjithsej	
f	%	f	%	f	%	f	%
66	48,17	53	38,69	18	13,14	137	100

Në drejtim të dëshmisë të hipotezës së nëntë të hulumtimit, kjo çështje është shqyrtuar edhe nga aspekti i përgjigjeve të cilat i dhanë edukatorët e kopshteve për fëmijë. Në bazë të rezultateve të fituara nga testi X^2 , mund të konstatohet se nuk ekziston statistikisht dallim i rëndësishëm ndërmjet përgjigjeve të cilat

Pjesa më e madhe e mësimeve të anketuar (66) plotësisht pajtohen se është i nevojshëm viti përgatitor i detyrueshëm para shkuarjes në shkollë për fëmijët prej moshës 4 - 6 vjeç, 53 prej tyre pjesërisht pajtohen, ndërsa vetëm 18 nuk mendojnë se është i nevojshëm viti përgatitor i detyrueshëm.

për këtë çështje i dhanë edukatorët dhe mësimeve klasor. Me këtë refuzohet hipoteza e nëntë e hulumtimit e cila thotë: *Ekziston dallimi ndërmjet mendimit të edukatorëve në kopshtet për fëmijë dhe mësimeve klasor në lidhje me nevojën për aplikimin e vitit përgatitor të detyrueshëm.*

TABELA 52: QËNDRIMET E EDUKATORËVE NË LIDHJE ME NEVOJËN PËR APLIKIMIN E VITIT PËRGATITOR TË DETYRUESHËM

KATEGORIA E PËRGJIGJEVE							
Plotësisht pajtohem		Pjesërisht pajtohem		Nuk pajtohem aspak		Gjithsej	
f	%	f	%	f	%	f	%
123	59,42	57	27,54	27	13,04	207	100,00

$X^2 = 5,103$ $df = 2$ $p < 0,077$

Në pyetjen e parashtruar: „Çka do të duhej të bëhej që të përfshihen të gjithë fëmijët në Republikën e Maqedonisë me punën e detyrueshme edukative - arsimore në kopshtin para shkuarjes në shkollë?“ Mësimdhënësit klasor të anketuar janë përgjigjur: ligjërisht të aplikohet viti përgatitor i detyrueshëm në kopshte për t'i përgatitur fëmijët për atë që i pret në klasë të parë (45 mësimdhënës); sjellja e ligjit për vitin përgatitor të detyrueshëm (15 mësimdhënës); të kthehet grupi i foshnjores në shkolla (12 mësimdhënës); të informohen prindërit – popullata për rëndësinë e shkuarjes së fëmijëve në institucionin parashkollor, të hapen grupe parashkollore në vendet më të vogla ose të organizohet transport deri te institucioni parashkollor më i afërt (8); të sigurohet rregullimi përkatës i infrastrukturës së shkollës në të gjitha mjediset (5); me rajonizimin dhe ftesave të informohen dhe përfshihen të gjithë fëmijët - nxënësit e moshës prej 4 deri në moshën 6 vjeçare (3); të gjithë fëmijët prej moshës 4 vjeçare të ndjekin përgatitjen parashkollore (2); të punojnë në dy ndërrime; të hapen më shumë kopshte etj.

Qëndrimet e mësimdhënësve klasor për lidhshmërinë funksionale të edukimit dhe arsimit parashkollor me atë fillor

Në raport me kërkesën e mësimdhënësve klasor të anketuar që t'i theksojnë sugjerimet e tyre për ndërlidhjen funksionale të edukimit dhe arsimit parashkollor dhe atë fillor ato e theksuan këtë në vijim: programet e arsimit shkollor të jenë bazë mbi të cilën do të përpilohen programet për fëmijët parashkollor, kështu që do të ketë vazhdimësi, sistematizim, përmbushje dhe përgjërime i njohurive; të ekzistojë harmonizimi i programit për arsimin parashkollor me atë në edukimin

dhe arsimin fillor; bashkëpunimi më i madh i kopshteve dhe shkollave, vizitat e shpeshta, projektet e përbashkëta në nivel lokal; të përcillen dosjet e fëmijëve nga kopshti në shkollë; bashkëpunimi i kopshteve dhe shkollave; detyrimisht mësimi/njohja e numrave deri në 20 për shkak të programit të Kembrixhit në klasën e parë; vizita në seminare të përbashkëta për vitin përgatitor; bashkëpunimi i edukatorëve dhe mësimdhënësve përmes llojeve të ndryshme të takimeve, të paktën 3-5 herë gjatë vitit shkollor, fjalime të ndryshme, këmbimi i përvojave, hulumtime, anketimi i nxënësve, prindërve; bashkëpunimi me shkollat fillore, manifestimi i festave në mënyrë të përbashkët, takime individuale me edukatorët dhe mësimdhënësit, me qëllim të njohjes së karakteristikave/tipareve të fëmijëve dhe këmbimi i përvojave në lidhje me planifikimin dhe programimin e përmbajtjeve për realizimin e punës edukative-arsimore dhe ngjashëm.

8 MENDIMET E PRINDËRVE SA I PËRKET NEVOJËS PËR APLIKIMIN E VITIT PËRGATITOR TË DETYRUESHËM PËR FËMIJËT E MOSHËS 4 - 6 VJEÇ NË DREJTIM TË LIDHSHMËRISË FUNKSIONALE TË EDUKIMIT DHE ARSIMIT PARASHKOLLOR ME ATË FILLOR

Bashkëpunimi i vazhdueshëm i kopshtit me prindërit ka një rol kryesor në realizimin e punës edukative-arsimore me fëmijët e moshës parashkollore. Bashkëpunimi i kopshtit me prindërit kontribuon për zhvillimin e fëmijës, avancimin e punës të edukatorëve dhe zhvillimin e rolit prindëror.

Hapi i parë në planifikimin e bashkëpunimit fillon me kontrollimin/pasqyrimin e mundësive, nevojave dhe të priturat të cilat i posedojnë prindërit nga kopshti.

Në këtë hulumtim na interesojnë qëndrimet dhe mendimet e prindërve në lidhje me nevojën e aplikimit të vitit përgatitor të detyrueshëm për fëmijët prej moshës 4

deri në moshën 6 vjeçare në drejtim të ndërlidhjes funksionale të edukimit dhe arsimit parashkollor me atë fillor. Hipoteza e parashtruar thotë: *Prindërit kanë mendim pozitiv në lidhje me aplikimin e vitit përgatitor të detyrueshëm për fëmijët prej moshës 4 deri në moshën 6 vjeçare në drejtim të ndërlidhjes funksionale të edukimit dhe arsimit parashkollor me atë fillor.*

Nevojat e nevojshme për këtë hipotezë janë marrë përmes përgjigjeve nga prindërit e anketuar në pyetje të caktuara në fletën anketuese. Të dhënat e fituara, për shkak të kontrollimit më të madh, janë paraqitur në tabela dhe grafikone.

TABELA 53: EKZEMPLARI I PRINDËRVE/ TUTORËVE NGA SHKUPI DHE NGA BRENDIA E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

KATEGORIA E PËRGJIGJEVE					
Nga Shkupi		Nga brendia e Republikës së Maqedonisë		Gjithsej	
f	%	f	%	f	%
97	46,64	111	53,36	208	100

Në bazë e të dhënave nga tabela qartë mund të shihet se në këtë hulumtim 46,64 % e prindërve janë nga Shkupi, ndërsa 53,36 % janë nga brendia e shtetit.

PARAQITJA SKEMATIKE 12: STRUKTURA E EKZEMPLARIT SIPAS GJINISË TË PRINDIT/TUTORIT




TABELA 54: STRUKTURA KRYESORE E EKZEMPLARIT SIPAS MOSHËS TË PRINDIT/TUTORIT

KATEGORIA E PËRGJIGJEVE									
deri 20 vjet		prej 20 deri 30 vjet		prej 30 deri 40 vjet		prej 40 deri 50 vjet		mbi 50 vjet	
f	%	f	%	f	%	f	%	f	%
1	0,49	46	22,11	140	67,30	21	10,10	0	0

Përqindje më e madhe, ose 67,30 % nga prindërit e anketuar janë të moshës prej 30 deri 40 vjet, 22,11 % janë në moshë prej 20 deri 30 vjet, 10,10 % janë në moshë prej 40 deri 50 vjet. Vetëm 0,49 % prej tyre janë të moshën prej 20 vjet.

TABELA 55: STRUKTURA E EKZEMPLARIT SIPAS SHKALLËS SË ARSIMIT TË KRYER

KATEGORIA E PËRGJIGJEVE													
ARSIM FILLOR		ARSIM TË MESËM		ARSIM TË LARTË		ARSIM SIPËROR		MAGJISTËR		DOKTOR SHKENCE		GJITHSEJ	
f	%	f	%	f	%	f	%	f	%	f	%	f	%
1	0,49	12	5,77	43	20,67	131	62,98	20	9,61	1	0,49	208	100

PARAQITJA SKEMATIKE 13: STRUKTURA E EKZEMPLARIT TË PRINDËRVE SIPAS SHKALLËS SË ARSIMIT TË KRYER





TABELA 56: QËNDRIMET DHE MENDIMET E PRINDËRVE NË LIDHJE ME FUNKSIONET E KOPSHIT

KATEGORIA E PËRGJIGJEVE											
Kujdesi i fëmijës		Kujdesi, edukimi dhe arsimi i fëmijës		Përgatitja e fëmijës për klasën e parë		Zhvillimi i të folurit, shkathhtësitë e komunikimit, socializimit		Të luajturit në ambient të hapur		Tjetër	
f	%	f	%	f	%	f	%	f	%	f	%
49	10	183	37	72	15	135	28	46	9	5	1

PARAQITJA SKEMATIKE 14: QËNDRIMET DHE MENDIMET E PRINDËRVE NË LIDHJE ME FUNKSIONET E KOPSHIT



Siç mund të vërehet pjesa më e madhe e të anketuarve mendojnë se funksioni më i rëndësishëm i kopshtit është përkujdesja, edukimi dhe arsimi i fëmijës, pastaj zhvillimi i të folurit, shkathtësitë e komunikimit dhe socializimi, dhe si më pak të rëndësishme i konsiderojnë përkujdesi i fëmijës dhe loja në ambient të hapur.

TABELA 57: PËRGJIGJET E PRINDËRVE PËR ATË SE A JENI TË INFORMUAR ME PROGRAMIN PËR MËSIM TË HERSHËM DHE ZHVILLIM NË TË CILIN BAZOHET PUNA EDUKATIVE-ARSIMORE NË KOPSHT

KATEGORIA E PËRGJIGJEVE							
Në përgjithësi jam i/e njoftuar për të gjitha aktivitetet edukative-arsimore të cilat duhet t'i realizojë edukatori		Pjesërisht jam i/e njoftuar me disa aktivitete edukative-arsimore të cilat duhet t'i realizojë edukatori		Jo, në përgjithësi nuk jam i/e njoftuar		Gjithsej	
f	%	f	%	f	%	f	%
139	66,83	55	26,44	14	6,73	208	100

Nga paraqitja tabelore është e evidente se pjesa më e madhe e prindërve ose 66,83 % janë në tërësi të njoftuar me të gjitha aktivitetet edukative-arsimore të cilat duhet t'i realizojë edukatori me fëmijët, 26,44 janë përgjigjur se pjesërisht janë të njoftuar, ndërsa 6,73 % janë përgjigjur se në përgjithësi nuk janë të njoftuar.

TABELA 58: PËRGJIGJET E PRINDËRVE NË LIDHJE ME ATË SE VALLË JANË TË KËNAQUR NGA PUNA EDUKATIVE-ARSIMORE NË KOPSHT


KATEGORIA E PËRGJIGJEVE							
Në përgjithësi jam i/e kënaqur		Pjesërisht jam i/e kënaqur		Nuk jam i/e kënaqur		Gjithsej	
f	%	f	%	f	%	f	%
184	88,46	23	11,05	1	0,49	208	100,00

Pyetjes, vallë jeni të kënaqur nga realizimi i punës edukative-arsimore në kopsht, pjesa më e madhe e të anketuarve ose 88,46 % janë deklaruar se në përgjithësi janë të kënaqur, ndërsa 11,05 % janë përgjigjur se pjesërisht janë të kënaqur.

TABELA 59: PËRGJIGJET E PRINDËRVE NË LIDHJE ME MËNYRËN ME TË CILËN KOPSHTI I INFORMON/NJOFTON ME AKTIVITETET EDUKATIVE-ARSIMORE.

KATEGORIA E PËRGJIGJEVE											
Personalisht nga edukatori		Nga përkëdhelësi		Nga kumtesa e theksuar		Nga prindërit tjerë		Nga fëmija im		Në përgjithësi nuk jam i/e informuar	
f	%	f	%	f	%	f	%	f	%	f	%
197	58	70	21	38	11	7	2	29	8	0	0

PARAQITJA SKEMATIKE 15: PËRGJIGJET E PRINDËRVE NË LIDHJE ME MËNYRËN ME TË CILËN KOPSHTI I NJOFTON/INFORMON ME AKTIVITETET EDUKATIVE-ARSIMORE



Në bazë e të dhënave të prezantuara mund të konstatohet se mënyrat më të shpeshtë me të cilat kopshti i informon/njofton prindërit me aktivitetet edukative-arsimore janë: informatat e fituara personalisht nga edukatori, pastaj vijojnë informatat

e fituara nga fëmija i tyre, diçka më pak nga anketimi i prindërve që janë përgjigjur se marrin informata përmes kumtesave të theksuara, ndërsa më pak prej tyre janë përgjigjur se informatat i marrin nga përkëdhelësi.

TABELA 60: PËRGJIGJET E PRINDËRVE NË LIDHJE ME NEVOJËN E APLIKIMIT TË RISIVE NË PUNËN EDUKATIVE-ARSIMORE NË KOPSHT

KATEGORIA E PËRGJIGJEVE							
Nuk ndjej nevojë, konsideroj se realizohet në nivel të duhur		Po, konsideroj se çdo risi mund ta pasurojë përvojën dhe cilësinë		Nuk e di, nuk kam përgjigje për këtë pyetje		Gjithsej	
f	%	f	%	f	%	f	%
81	38,94	119	57,21	8	3,85	208	100

Pyetjes vallë ju si prindër, duke ndjekur avancimin e fëmijës tuaj, ndjeni nevojë për aplikimin e risive në punën edukative-arsimore në kopsht, 57,21 % nga prindërit e anketuar pajtohen se ka nevojë për aplikimin e risive, sepse çdo risi mund ta pasurojë përvojën dhe cilësinë e punës

edukative-arsimore. 38,94 % nga prindërit janë deklaruar se nuk ndjejnë nevojë dhe mendojnë se puna edukative-arsimore realizohet në nivel të duhur. Nga të dhënat e prezantuara është evidente se 3,85 % e prindërve nuk kanë përgjigje për këtë pyetje.

TABELA 61: MENDIMET E PRINDËRVE NË LIDHJE ME KONTRIBUTIN TË CILIN E POSEDON KOPSHTI NË PËRGATITJEN E FËMIJËVE PËR KALIM MË TË SUKSESSHËM NGA EDUKIMI DHE ARSIMI FILLOR PARASHKOLLOR KAH EDUKIMI DHE ARSIMI FILLOR

KATEGORIA E PËRGJIGJEVE							
Ka kontribut të madh		Ka kontribut të caktuar		Nuk ka kontribut të veçantë		Gjithsej	
f	%	f	%	f	%	f	%
187	89,90	21	10,10	0	0,00	208	100,00

Analiza nga të dhënat e fituara tregon se 89,90 % e prindërve mendojnë se kopshti ka kontribut të madh në përgatitjen e fëmijëve për kalim të suksesshëm nga edukimi dhe arsimit parashkollor kah ai

fillor. Sipas mendimit të 10,10 % e prindërve të anketuar, kopshti ka kontribut të caktuar në përgatitjen e fëmijëve për kalim të suksesshëm nga edukimi dhe arsimit parashkollor në atë fillor.

TABELA 62: QËNDRIMET DHE MENDIMET E PRINDËRVE NË LIDHJE ME NEVOJËN PËR APLIKIMIN E VITIT PËRGATITOR NË DREJTIM TË NDËRLIDHJES FUNKSIONALE TË EDUKIMIT DHE ARSIMIT PARASHKOLLOR ME EDUKIMIN DHE ARSIMIN FILLOR


KATEGORIA E PËRGJIGJEVE					
Po		Jo		Gjithsej	
f	%	f	%	f	%
156	75,00	52	25,00	208	100,00

Në pyetjen: „A mendoni se është i domosdoshëm të aplikohet viti përgatitor i detyrueshëm në drejtim të ndërlidhjes funksionale të edukimit dhe arsimit parashkollor me edukimin dhe arsimin fillor?“ Janë përgjigjur në mënyrë të konfirmuar 75 % e prindërve të anketuar. Megjithatë, sipas mendimit të një numri të vogël të prindërve të përfshirë në këtë hulumtim, ose 25 % prej tyre, deklarohen se nuk ekziston nevoja për aplikimin e vitit përgatitor të detyrueshëm.

PARAQITJA SKEMATIKE 16: QËNDRIMET DHE MENDIMET E PRINDËRVE NË LIDHJE ME AKTIVITETET TË CILAT JANË VENDOSUR NË PUNËN E DERITANISHME ME FËMIJËT NË KOPSHT

dhe të shkruarit. Si më pak aktivitete mospërfillëse i theksojmë aktivitetet matematikore si mjet për mendimin logjik dhe zgjidhja e problemeve dhe aktiviteve të ndërlidhura me pasurimin e fjalorit dhe zhvillimin e aftësive për komunikim të fëmijës.

Në fletët anketuese prindërit kanë mundësi të japin sugjerimet dhe komentet e tyre në drejtim të përmirësimit të punës edukative-arsimore në kopsht. Sipas mendimit të prindërve e domosdoshme është zvogëlimi i numrit të fëmijëve në grupet me qëllim të përmirësimit të cilësisë së punës edukative-arsimore. Rritja e numrit të edukatorëve dhe përkëdhelësve të punësuar në kopsht, aplikimi i vitit përgatitor të detyrueshëm, kompletimi i shërbimit profesionist në kopsht (pedagog,



Sipas mendimit të prindërve më të shpërfillura janë aktivitetet edukative-arsimore në natyrë, aktivitetet hulumtuese, aktivitetet për edukimin dhe arsimin fizik të fëmijëve, aktivitetet për përgatitjen e fëmijëve për hyrje në leximin fillestar

psikolog, logoped, defektolog), punësimi i një profesori të edukimit dhe arsimit fizik në çdo kopsht, pasurimi i vazhdueshëm i kopshtit me mjete përkatëse didaktike dhe materiale për realizim të pandërprerë të punës edukative-arsimore, rregullimi i oborrit të kopshtit për organizimin e lojërave edukative dhe aktiviteteve në ambient të hapur, organizimi i seminareve dhe punëtorive për prindërit, trajnim i posaçëm dhe qasje më senzitive nga ana e edukatorëve ndaj fëmijëve në familjet me një prind, fëmijët me pengesa në zhvillim, duke përfshirë edhe materialin e punës.

Në bazë të asaj që u tha më lartë, si dhe në bazë të dhënave të prezantuara konfirmohet hipoteza e dhjetë e hulumtimit sipas së cilës: *Prindërit kanë mendim pozitiv në lidhje me aplikimin e vitit përgatitor të detyrueshëm për fëmijët e moshës 4 deri në moshën 6 vjeçare në drejtim të ndërlidhjes funksionale të edukimit dhe arsimit parashkollor me atë fillor.*

...the first of these is the fact that the ...

...the second of these is the fact that the ...

...the third of these is the fact that the ...

...the fourth of these is the fact that the ...

...the fifth of these is the fact that the ...

...the sixth of these is the fact that the ...

...the seventh of these is the fact that the ...

...the eighth of these is the fact that the ...

...the ninth of these is the fact that the ...

...the tenth of these is the fact that the ...

...the eleventh of these is the fact that the ...

...the twelfth of these is the fact that the ...

...the thirteenth of these is the fact that the ...

...the fourteenth of these is the fact that the ...

...the fifteenth of these is the fact that the ...

...the sixteenth of these is the fact that the ...

...the seventeenth of these is the fact that the ...

...the eighteenth of these is the fact that the ...

...the nineteenth of these is the fact that the ...

...the twentieth of these is the fact that the ...

PJESA IV

SHQYRTIMET PËRFUNDIMTARE DHE REKOMANDIMET

...the first of these is the fact that the ...

...the second of these is the fact that the ...

...the third of these is the fact that the ...

...the fourth of these is the fact that the ...

...the fifth of these is the fact that the ...

...the sixth of these is the fact that the ...

...the seventh of these is the fact that the ...

...the eighth of these is the fact that the ...

...the ninth of these is the fact that the ...

...the tenth of these is the fact that the ...

...the eleventh of these is the fact that the ...

...the twelfth of these is the fact that the ...

...the thirteenth of these is the fact that the ...

...the fourteenth of these is the fact that the ...

...the fifteenth of these is the fact that the ...

...the sixteenth of these is the fact that the ...

...the seventeenth of these is the fact that the ...

...the eighteenth of these is the fact that the ...

SHQYRTIMET PËRFUNDIMTARE

Sipas rezultateve nga ky hulumtim empirik, përkatësisht nga analiza kualitative dhe kuantitative e të dhënave të fituara mund të shkoqisim më shumë konkluzione, të cilat sipas natyrës së tyre janë më të përfaqësuara.

Përfundimi i përgjithshëm është se *plotësisht është konfirmuar hipoteza e përgjithshme e hulumtimit, d.m.th., praktikantët në institucionet parashkollore konsiderojnë se Standardet për mësim të hershëm dhe zhvillim kanë më shumë mangësi, ndërsa realizimi i punës edukative-arsimore me fëmijët e moshës parashkollore, me theks të veçantë për fëmijët e moshës 4 deri 6 vjeç, e vështirësojnë më shumë faktorë dhe shkaktarë.*

Nga analiza dhe krahasimi i të dhënave të fituara, në lidhje me hipotezat e veçanta të hulumtimit, janë fituar konkluzionet vijuese:

1. Në përpjekjet e institucioneve kompetente për avancimin e cilësisë të punës edukative-arsimore në institucionet parashkollore dhe sigurimin e lidhshmërisë funksionale të edukimit dhe arsimit parashkollor me edukimin dhe arsimin fillor, është shqyrtuar nevoja për sjelljen e ligjit për edukimin dhe arsimin parashkollor. Kjo në veçanti theksohet nga analiza e rregullativës ligjore në Republikën e Maqedonisë me të cilën është rregulluar veprimtaria e edukimit dhe arsimit

parashkollor, krahasimi i nënsistemit tonë për edukimin dhe arsimin parashkollor me nënsistemin e edukimit dhe arsimit parashkollor në vendet evropiane dhe vendet tjera të zhvilluara në botë, si dhe nga të dhënat e fituara nga fokus grupet me edukatorët, me ç'rast të gjithë të anketuarit, pa përjashtim, u përgjigjën se është i domosdoshëm sjellja e një ligji për edukim dhe arsim parashkollor. Gjithashtu, të anketuarit e theksuan nevojën për sigurimin e plotë të marrjes së kompetencave të Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës, sipas shembullit dhe përvojave dhe praktikave pozitive të vendeve në regjionin dhe vendet tjera të zhvilluara në Evropë dhe në botë. Marrja e plotë e ingerencave ishte paraparë, por nuk u realizua edhe me Strategjinë Kombëtare për zhvillim të arsimit 2005 -2015. Sipas mendimit të ekspertëve nacional nga lëmi i edukimit dhe arsimit parashkollor (të përfshirë në këtë hulumtim si konsultues profesionistë), duke siguruar transferimin e plotë të ingerencave në kuadër të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës do të mundësohet ngritja e cilësisë të edukimit dhe arsimit parashkollor, avancimi i lidhjes funksionale me edukimin dhe arsimin fillor dhe harmonizimi i standardeve edukative-arsimore në pajtim me standardet ndërkombëtare për mësim të hershëm dhe zhvillim. Sa i përket kësaj çështje sugjerime për ndërlidhjen funksionale të edukimit dhe arsimit parashkollor kanë edhe mësimdhënësit klasor të cilët i dhanë këto propozime: programet e arsimit shkollor të jenë bazë mbi të cilën do të përpilohen programet për fëmijët parashkollor, kështu që do të ketë vazhdimësi, sistemim, plotësim dhe zgjerim të njohurive; të ekzistojë harmonizim i plotë i programit në arsimin parashkollor me atë në edukimin dhe arsimin fillor; bashkëpunim më i madh ndërmjet kopshteve dhe

shkollave, vizita të shpeshta, projekte të përbashkëta në nivel lokal; të përcillen dosjet e fëmijëve nga kopshti në shkollë; bashkëpunimi i kopshteve dhe shkollave; mësimi, njohja e domosdoshme e numrave deri në 20 për shkak të programit të Kembrixhit për klasën e parë; vizitë në seminare të përbashkëta për vitin përgatitor; bashkëpunimi i mësimdhënësve përmes takimeve të ndryshme, të paktën 3-5 herë gjatë vitit shkollor, prezantime të ndryshme, këmbimi i përvojave, hulumtime, anketimi i nxënësve, prindërve; bashkëpunimi me shkollat fillore, manifestimi i festave në mënyrë të përbashkët, takime individuale me edukatorët dhe mësimdhënësit, në mënyrë që të njihen me karakteristikat individuale të fëmijëve dhe shkëmbimin e përvojave në lidhje me planifikimin dhe programimin e përmbajtjeve për realizimin e punës edukative-arsimore etj. Me këtë konfirmohet hipoteza e parë e hulumtimit.

2. Pjesa më e madhe e qëllimeve në Programin për mësim të hershëm dhe zhvillim, me theks të veçantë në lëmin e edukimit dhe arsimit (gjuhë, komunikimi dhe zhvillimi i arsimit, shkrim-leximit, zhvillimi kognitiv dhe arritja e njohurive të përgjithshme, arti), nuk janë harmonizuar në tërësi me qëllimet në programin mësimor në matematikë, shkenca natyrore, arsim figurativ dhe muzikor për klasën e parë në arsimin fillor nëntëvjeçar. Kjo është shqyrtuar me analizën komparative të qëllimeve globale në Programin për mësim të hershëm dhe zhvillim dhe programet për klasën I, si dhe qëllimet konkrete sipas moshës për çdo aspekt të zhvillimit (lëmi edukativo-arsimore). Në bazë të sipërpërmendurës konfirmohet hipoteza e dytë.


3. Pjesërisht është konfirmuar hipoteza e veçantë se: **Ekziston nevoja për rishqyrtimin e Standardeve për mësim të hershëm dhe zhvillim të fëmijët prej moshës 0 deri në moshën 6 vjeç.** Në lidhje me këtë çështje pjesa më e madhe e të anketuarve janë deklaruar se në shumicën e standardeve dhe indikatorëve në dokumentin **Standardet për mësim të hershëm dhe zhvillim të fëmijët prej moshës 0 deri 6 vjeç veprojnë përkufizime për zhvillimin dhe përparimin e fëmijëve:**

Numri më i madh i edukatorëve të anketuar (63,28 %) konsiderojnë se Standardet për mësim të hershëm dhe zhvillim pjesërisht duhet të rishqyrtohen, një numër më i vogël (29,95 %) janë për rishqyrtimin e përgjithshëm, ndërsa vetëm 14 % e edukatorëve konsiderojnë se nuk ekziston nevoja për rishqyrtim. Një numër i madh i pedagogëve të anketuar (60,00 %) konsiderojnë se Standardet për mësim të hershëm dhe zhvillim pjesërisht duhet të rishqyrtohen, një numër i vogël i pedagogëve (33,33 %) janë për rishqyrtimin e tërësishëm, ndërsa vetëm (6,67 %) nga pedagogët e anketuar konsiderojnë se nuk ekziston nevoja për rishqyrtimin e tyre.


Sipas edukatorëve të anketuar rishqyrtimi i Standardeve për mësim të hershëm dhe zhvillim të fëmijët prej moshës 0 deri në 6 vjeç, ka të bëjë me aspektet vijuese të zhvillimit të fëmijës: zhvillimi kognitiv dhe arritja e njohurive (53,31 %), zhvillimi i gjuhës, shkrim-leximit dhe komunikimit (27,55 %), zhvillimi socio-emocional (25,63 %) dhe shëndeti fizik dhe zhvillimi motorik (24,12 %). Sipas 38,64 % e edukatorëve duhet të rishqyrtohet edhe pjesa e Standardeve emëruar si Zhvillimi i qasjes ndaj mësim.

Sipas numrit më të madh të pedagogëve të anketuar (33 %) rishqyrtimi i Standardeve për mësim të hershëm dhe zhvillim të fëmijët prej moshës 0 deri në moshën 6


EDUKATORËT E ANKETUAR




PEDAGOGËT E ANKETUAR



Sferat në Standardet për mësim të hershëm dhe zhvillim që sipas edukatorëve duhet të ndryshohen.



Sferat në Standardet për mësim të hershëm dhe zhvillim sipas pedagogëve duhet të ndryshohen.





vjeçare duhet pasur kujdes në pjesën e Standardeve emëruar si Zhvillim i qasjes ndaj mësimin. Gjithashtu, sipas tyre duhet të rishqyrtohen: zhvillimi kognitiv dhe arritja e njohurive (27%), zhvillimi i gjuhës, shkrim-leximit dhe komunikimit (20%) zhvillimi socio-emocional, zhvillimi fizik dhe zhvillimi motorik (10%).

Një numër i madh i edukatorëve të anketuar kanë vërejtje te indikatorët në Standardet për mësim të hershëm dhe zhvillim.

Një pjesë e indikatorëve shumë ulët janë parashtruar, të paqarta sa duhet, d.m.th., janë formuluar në mënyrë

jopërkatese, për shkak se paraqitet nevoja për sjelljen e programit të ri për punën edukative-arsimore me fëmijët e moshës parashkollore, me theks të veçantë në sjelljen e programit për punë edukative-arsimore për vitin përgatitor. Më konkretisht, 32 % e pedagogëve të anketuar konsiderojnë se nevojitet rishqyrtimi i plotë i indikatorëve, 54 % prej tyre konsiderojnë se pjesërisht duhet të rishqyrtohen, ndërsa sipas 14 % e edukatorëve të anketuar nuk ekziston nevoja për rishqyrtimin e tyre. Nevoja më e madhe për rishqyrtim paraqitet te ato indikatorë që dalin nga: zhvillimi kognitiv dhe të arriturat e njohurive, zhvillimi i gjuhës, shkrim-leximit dhe komunikimit, shëndeti fizik dhe zhvillimi motorik dhe zhvillimi socio-emocional, për shkak të paqartësive dhe vështirësive në matje.



Nga deklaratimet e edukatorëve në fokus grupet mund të vërehet se Standardet për mësim të hershëm dhe zhvillim janë shumë të përgjithshme, një pjesë e tyre janë shumë të ulëta, madje fëmijët mund të arrijnë edhe më shumë. Pjesa më e madhe e edukatorëve konsiderojnë se Standardet për mësim të hershëm dhe zhvillim janë vetëm një lloj forme, tregues me të cilin iu tregojnë prindërve se fëmijët e tyre në diçka përparojnë, me rëndësi të veçantë janë deklaratimet e edukatorëve se Standardet i përkufizojnë në qasjen individuale ndaj secilit fëmijë.

Nga e tëra që u tha mund të nxjerrim përfundimin se Standardet për mësim të hershëm dhe zhvillim në praktikën e deritanishme edukatorët pjesërisht i kanë përdorur për ndjekjen e fëmijëve, pjesërisht gjatë planifikimit të aktiviteteve edukative-arsimore, disa edukatorë i kanë përshtatur Standardet për mësim të hershëm dhe zhvillim me Programet për mësim të hershëm dhe zhvillim, ato nuk e kanë pasur qëllimin e plotë në veglën profesionale për punë efikase edukative-arsimore me fëmijët në kopshtet për fëmijë, ndërsa nga ana tjetër, pjesërisht edhe e kanë vështirësuar procesin e individualizimit në veprimtarinë e përditshme edukative-arsimore.



Nga këtu del se nuk është i nevojshëm rishqyrtimi, përkatësisht sipas shqyrtimit të gjendjes praktike nga deklaratimet në terren propozojmë në Ligjin për mbrojtjen e fëmijëve të shlyhet dispozita se Programi për mësim të hershëm dhe zhvillim doemos të bazohet në Standardet për mësim të hershëm dhe zhvillim.

4. Vërtetohet hipoteza e katërt, e cila thotë: **Ekziston nevoja për përmirësimin e Programit për mësim të hershëm dhe zhvillim bazuar në Standardet për mësim të hershëm dhe zhvillim në drejtim të**


harmonizimit të qëllimeve në dokumentin programor për moshën më të rritur parashkollore dhe qëllimet në programet mësimore për klasën I.

Një numër i madh i pedagogëve të anketuar (49 %) konsiderojnë se është e nevojshme pjesërisht, ndërsa një numër më i vogël (43 %) i edukatorëve konsiderojnë se është i nevojshëm avancimi i plotë i qëllimeve të Programit për mësim të hershëm dhe zhvillim me qëllim të lidhshmërisë funksionale me qëllimet e programit mësimor në

klasë të parë. Gjithashtu, një numër i madh i pedagogëve të anketuar (73,34 %) konsiderojnë se plotësisht është i nevojshëm, ndërsa një numër më i vogël (13,33 %) i pedagogëve konsiderojnë se pjesërisht është i nevojshëm avancimi i qëllimeve të Programit për mësim të hershëm dhe zhvillim për moshën më të rritur parashkollore me qëllim të lidhshmërisë funksionale të qëllimeve në programet mësimore në klasë të parë.



Pjesë të Programit për mësim të hershëm dhe zhvillim në të cilat janë të nevojshme ndryshimet:



Sipas edukatorëve të anketuar ndryshimet duhet të bëhen në pjesët vijuese të Programit për mësim të hershëm dhe zhvillim: Matematikë (66,18%), Gjuhë amtare (31,88%), Shkencat natyrore (29,46%), Arsimit muzikor (17,39%), Shoqëri (17%) dhe Arsimit figurativ (14,97%), sipas pedagogëve të anketuar në kopshtet për fëmijë ndryshimet duhet të bëhen në pjesët vijuese të programit: Arsimit figurativ (31,00%), Shkencat natyrore (21,00%), Gjuhë amtare (16,00%), Arsimit muzikor (16,00%), Shoqëri (3%), ndërsa dy pedagogë propozojnë ndryshime dhe konkretizimin e të gjithave në punën edukative-arsimore në Programin për mësim të hershëm dhe zhvillim. Duke pasur parasysh atë në pajtim të Ligjit për mbrojtjen e fëmijëve, Programi për mësim të hershëm dhe zhvillim e kishte të domosdoshme të bazohet në

Standardet për mësim të hershëm dhe zhvillim, pritet, edukatorët e anketuar dhe ndryshimet e Standardeve për mësim të hershëm dhe zhvillim i propozojnë edhe në bazë të përmirësimit të Programit për mësim të hershëm dhe zhvillim, kështu ato i propozojnë ndryshimet vijuese: të ketë më shumë shembuj të aktiviteteve, Arsimit figurativ dhe arsimit muzikor të ndahen nga sfera kognitive, të vihet theks më i madh në edukimin figurativ dhe edukimin muzikor. Gjithashtu, në bazë të përvojës së tyre personale propozojnë operacionalizim më të madh të qëllimeve sipas grupeve të ndryshme edukative, të ketë më shumë shembuj të aktiviteteve që dalin dhe janë të ndërlidhura me situatat në përditshmëri, më qartë të definohen rezultatet e pritura, të ndërmerren një numër më i madh i qëllimeve, madje të kthehet në

përgjithësi dokumenti Programor i vitit 2007, të ofrohen aktivitete për fëmijët e talentuar. Pedagogët e anketuar i deklaruan këto mendime dhe sugjerime: „Shqyrtimin e tërë Programit për mësim të hershëm dhe zhvillim me qëllim të sigurohet vazhdimësia dhe kompatibiliteti me programin shkollor“; „Programi i ri për punë edukative-arsimore i përpiluar nga personat kompetent në Byronë e Zhvillimit të Arsimit dhe prezantimi i tij me trajnimet përkatëse në të cilat do të jenë të përfshirë të gjithë edukatorët“; „Harmonizimi i Programit për mësim të hershëm dhe zhvillim me programin e Kembrixhit, në veçanti në lëmin e Matematikës“. Një pjesë e pedagogëve të anketuar e theksuan nevojën për përpilimin e bazave për programimin e punës e të gjithë punëtorëve profesionistë për bashkëpunëtorë në kopsht. Edukatorët e anketuar dhe pedagogët propozojnë rishqyrtimin e dokumentit programor, për shkak të harmonizimit më të madh të Programit për mësim të hershëm dhe zhvillim me programet mësimore për klasën e parë në arsimin fillor.

Në bazë të asaj që theksohet mund të konstatohet se Programi për mësim të hershëm dhe zhvillim duhet të rishqyrtohet, përkatësisht të përpilohet një dokument i ri programor për punën edukative-arsimore, ku duhet të merren parasysh mundësitë zhvilluese dhe interesat e fëmijëve nga secili grup edukativ, të arriturat bashkëkohore shkencore nga edukimi dhe arsimit parashkollor, të harmonizohet një pjesë e terminologjisë me atë të nënsistemit vijues të sistemit arsimor, qëllimet edukative-arsimore të harmonizohen me ato programe mësimore të adaptuara nga matematika dhe nga shkencat natyrore në klasë të parë, maksimalisht


të respektohet parimi i qasjes holistike (tretman të barabartë i të gjitha aspekteve të fëmijëve) ku nuk është e domosdoshme të harmonizohet me Standardet e vjetra për mësim të hershëm dhe zhvillim, më shumë të operacionalizohen qëllimet edukative-arsimore dhe të jepen më shumë shembuj të aktiviteteve. Në këtë mënyrë do të mundësohet ndërlidhja funksionale e qëllimeve në programin e edukimit dhe arsimit parashkollor me qëllimet në programin për klasën e parë. Gjatë përpilimit të dokumentit të ri programor për edukimin dhe arsimin parashkollor duhet të merren parasysh edhe propozimet e mësimdhënësve klasor në raport me njohuritë paraprake të nevojshme të fëmijëve për përfshirjen e suksesshme në mësimin e klasës së parë.

5. Njëra nga hipotezat e posaçme në këtë hulumtim është se ekziston nevoja për rishqyrtimin e evidencës dhe dokumentacionit pedagogjik aktual në institucionet parashkollore, ndërsa në bazë të përgjigjeve të edukatorëve të anketuar mund të konkludohet se ajo është konfirmuar.


Pjesa më e madhe e edukatorëve të anketuar, përkatësisht 24,15% konsiderojnë se evidenca dhe dokumentacioni pedagogjik aktual përputhet, ndërsa 60,39 % se në tërësi nuk përputhet me kërkesat bashkëkohore për planifikimin dhe realizimin e punës edukative-arsimore, duke e vënë fëmijën në qendër të vëmendjes. Njëherësh, 80,99 % nga edukatorët e anketuar konsiderojnë se duhet të rishqyrtohet evidenca dhe dokumentacioni pedagogjik ekzistues në kopshte/qendrat për zhvillim të hershëm të fëmijëve.

Në bazë të pedagogëve të anketuar 66,67 % konsiderojnë se evidenca dhe dokumentacioni pedagogjik aktual

Edukatorë



Pedagogë



pjesërisht përputhen, ndërsa sipas 6,66 % prej tyre ajo në përgjithësi nuk përputhet me kërkesat bashkëkohore për planifikimin dhe realizimin e punës edukative-arsimore, duke e vënë fëmijën në qendër të vëmendjes. Njëherësh, 93,33 % e pedagogëve të anketuar konsiderojnë se duhet të rishqyrtohet evidenca dhe dokumentacioni pedagogjik aktual në kopshte/qendra për zhvillim të hershëm të fëmijëve.

Vërejtja më e madhe për evidencën pedagogjike dhe dokumentacionin nga ana e edukatorëve është obligim ligjor që ajo të udhëhiqet edhe në letër edhe në formë elektronike që, nga njëra anë, iu merr shumë kohë edukatorëve (shkruajnë dy herë tekstin e njëjtë), ndërsa, nga ana tjetër, kopshtet për fëmijë disponojnë me një ose dy kompjuterë. Gjithashtu, një pjesë e madhe e edukatorëve të anketuar theksojnë se ditari i grupit edukativ ka një numër të vogël të grafikëve, nuk ka hapësirë për të shkruar qëllimet (është shumë e rëndësishme), vazhdimisht kërkohet të shkruhet në standarde të njëjta gjatë vitit. Ata shprehin dyshimin se të dhënat e fëmijëve në ditarët elektronik nuk janë të mbrojtura në mënyrë të duhur, ndërsa cilësia teknike e ditarëve nuk është në nivel të lartë dhe propozojnë të përdoren përsëri ditarët

e vjetër të cilët janë përdorur gjatë planifikimit dhe realizimit të Programit për punë edukative-arsimore me fëmijët e moshës parashkollore „Hap pas hapi”. Të gjithë edukatorët të cilët morën pjesë në fokus grupet propozuan që evidenca pedagogjike të udhëhiqet deri më 10 qershor të vitit vijues (sepse ka të bëjë me grupin konkret edukativ), e jo edhe gjatë periudhës verore, sepse pas 10 qershorit fëmijët e grupeve të ndryshme mbledhen në një kopsht dhe atëherë realizohen aktivitetet më relaksuese të lojërave. Edukatorët kanë vërejtje edhe në mënyrën e udhëheqjes të dosjes për fëmijë, përkatësisht se edukatorët nuk duhet të fusin të dhëna për të cilat janë kompetent mjeku ose motra medicinale. Ato propozojnë dosja e fëmijës detyrimisht të dërgohet në shkollë fillore kur fëmija do të regjistrohet në klasë të parë.

Propozimet e pedagogëve për përmirësimin e evidencës pedagogjike dhe dokumentacionit janë me sa vijon: „të mos shkruajnë standardet ditore, ato mbeten në planifikimin vjetor”; „në planifikim të theksohen qendrat për mësim” dhe „të ketë pjesë në të cilën do të planifikohet bashkëpunimi me familjen”; „dosja e fëmijës të lirohet nga pjesët e panevojshme (ato të cilat duhet t'i plotësojë mjeku), si dhe atë se dosja e

fëmijës detyrimisht duhet të ndiqet në shkollë“.

Në bazë të asaj që u theksua mund të konkludohet se evidenca pedagogjike aktuale dhe dokumentacioni duhet të rishqyrtohen (këtë e kërkojnë 81 % e edukatorëve dhe 93,33 % e pedagogëve) dhe kjo në bazë të parimeve në dokumentin e ri programor që do të përgatitet në vitin 2018 dhe përvojat paraprake pozitive për formën dhe mënyrën e udhëheqjes të evidencës pedagogjike dhe dokumentacionit në kopshtet për fëmijë dhe grupet përgatitore në Republikën e Maqedonisë. Duhet të rishqyrtohet edhe nevoja e evidencës pedagogjike dhe dokumentacioni të udhëhiqet edhe në letër edhe në formën elektronike, dhe në qoftë se kërkohet të udhëhiqet në formë elektronike, e domosdoshme është krijimi i kushteve teknike në kopshtet dhe trajnimi përkatës i kuadrit edukativo-arsimor. E domosdoshme është të shkruhet evidenca e posaçme medicinave të cilën do ta udhëheqin mjekët dhe motrat medicinale. Nevojitet të përforcohet bashkëpunimi ndërmjet kopshteve për fëmijë dhe shkollave fillore, ku përveç tjerash duhet të planifikohen takime me edukatorët, mësimdhënësit dhe bashkëpunëtorët profesionist ku do të elaborohen temat profesionale në interes të të gjithëve, do të këmbehen përvojat dhe detyrimisht do të dorëzohen dosjet e fëmijëve nga kopshti në shkollë ku janë regjistruar nxënësit në klasë të parë. Gjithashtu, nga të dhënat e fituara në lidhje me zbatimin e deritanishëm të qasjes në planifikimin e punës edukative-arsimore, ku në planifikimin ditor kërkohet edukatori të fillojë nga Standardet për mësim të hershëm dhe zhvillim, e jo nga qëllimet konkrete sipas moshës për çdo aspekt

në Programin për mësim të hershëm dhe zhvillim, praktikantët e vlerësuan si të gabuar dhe hamendëso, e që kishte ndikim të madh në zvogëlimin e cilësisë të planifikimit dhe realizimit të punës edukative-arsimore me fëmijët e moshës parashkollore. Në bazë të kësaj mund të konstatohet se është e domosdoshme përpilimi i formularëve të ri të evidencës pedagogjike dhe dokumentacionit dhe kaheve për planifikim cilësor të aktiviteteve edukative-arsimore, ku duhet të merren parasysh të gjitha vërejtjet e edukatorëve dhe pedagogëve në kopshtet për fëmijë, mbikëqyrjet nga këshilltarët e Byrosë së zhvillimit të arsimit, si dhe mendimi i profesorëve universitar specializimi i tyre është edukimi dhe arsimi parashkollor. Me këtë konfirmohet hipoteza e pestë.

6. Hipoteza: Pedagogët dhe edukatorët kanë nevojë për përkrahje këshillëdhënëse të vazhdueshme nga këshilltarët e Byrosë së zhvillimit të arsimit, plotësisht vërtetohet. Të gjithë pedagogët e anketuar konsiderojnë se është e nevojshme përkrahja profesionale-këshillëdhënëse nga këshilltarët e Byrosë së zhvillimit të arsimit. Edukatorët u deklaruan se kanë nevojë për përkryerje profesionale të vazhdueshme, përkatësisht nevojë për njohuri teorike dhe praktike nga këshilltarët e Byrosë së Zhvillimit të Arsimit. Ato dëshirojnë të marrin udhëzime për planifikimin cilësor dhe realizimin e punës edukative-arsimore d.m.th., nga afër t'i këmbëjnë me këshilltarët nevojat, problemet dhe sfidat, si dhe si të fitojnë udhëzime konkrete për përmirësimin e cilësisë të punës edukative-arsimore. Të gjithë pedagogët e anketuar janë përgjigjur se kanë nevojë për trajnim të realizuar nga personat kompetent të Byrosë për zhvillimin e arsimit. Në pyetjen se në cilën

temë iu nevojiten trajnimet nga personat kompetent të Byrosë së zhvillimit të arsimit, ata i theksuan këto tema: „Si duhet të jetë një edukator i mirëfilltë?“ „Njohja me hulumtimet më të reja nga lëmi i mësimi të hershëm dhe zhvillimit të fëmijëve“; „Planifikimi i punës edukative-arsimore“; „Mënyra e udhëheqjes së evidencës pedagogjike dhe dokumentacionit“; „Normat etike dhe morale në edukim“; „Kompetencat e edukatorëve për punë me fëmijët me nevoja të posaçme“; „Metodat dhe format bashkëkohore për punë me fëmijët e moshës parashkollore“; „Puna me fëmijët e talentuar“; „Përmirësimi i procesit edukativo-arsimor“; „Përvoja e punës edukative-arsimore në edukimin dhe arsimin parashkollor në diasporë“. Pjesa më e madhe e pedagogëve të anketuar (78,63 %) konsiderojnë se përkrahja e vazhdueshme profesionale-këshillëdhënëse e edukatorëve nga këshilltarët e Byrosë së zhvillimit të arsimit do të kontribuojë për implementimin më të suksesshëm të punës edukative-arsimore.

Edukatorët e anketuar të institucioneve parashkollore janë të vetëdijshëm se me përkryerjen profesionale personale do të arrijnë rezultate më të mira në punë, me çka do të rritet cilësia e punës edukative-arsimore në kopshtet për fëmijë dhe qendrat për zhvillim të hershëm. Konkretisht, 75,53 % e edukatorëve të anketuar janë përgjigjur se kanë nevojë për përkryerje-profesionale permanente me qëllim të realizimit të suksesshëm të punës edukative-arsimore në kopshtin/ QMHZH, ndërsa vetëm 20,46 % e edukatorëve janë përgjigjur negativisht. Pothuajse i njëjtë është numri i edukatorëve të anketuar të cilët janë përgjigjur se kanë nevojë për trajnim realizuar nga personat kompetent nga Byroja e zhvillimit të arsimit – 76 %, edukatorë kundrejt 24 % edukatorëve.

Në pyetjen se për cilën temë iu nevojiten trajnimet nga personat kompetent të Byrosë së zhvillimit të arsimit, edukatorët e anketuar i theksuan këto tema:

„Korrelacioni dhe bashkëpunimi me prindërit“, „Gjithë përfshirja dhe dialogu me fëmijët me nevoja të posaçme“; „Teknologjia dhe kompjuterët“; „Udhëheqja e rregullt e grupit edukativ“; „Metodat e dobishme të mësimi për fëmijët në zhvillim“; Në qoftë se miratohet një program i ri do të dëshironim të mbahej një trajnim i tillë“; „Edukimi kompjuterik i të gjithë edukatorëve“; „Risi në rrjedhat bashkëkohore në edukimin dhe arsimin parashkollor në korniza botërore“; „Qëllimet e punës edukative-arsimore“; „Trajnimet duhet të jenë për socializmin e fëmijëve, edukimi dhe respektimi shtëpiak“; „Trajnim për punë ekipore“; „Trajnim për qasje ndaj fëmijëve me nevoja të posaçme arsimore“; „Trajnim për edukim për edukatorët e ri pa përvojë pune“; „Dëshirojmë të aplikohet TIK edhe në kopshte sepse fëmijët nga mosha më e mitur kanë dëshirë për përdorimin e kompjuterit. Në qoftë se realizohet kjo, do të ishte e domosdoshme edhe ndonjë trajnim i tillë i edukatorëve, që të mund të ketë ndryshime“; „Trajnimi për evidencën dhe dokumentacionin pedagogjik“.

Në bazë të deklarimeve të pedagogëve të anketuar dhe edukatorëve mund të arrihet në përfundim se Byroja e Zhvillimit të Arsimit duhet ta përforcojë përkrahjen profesionale-këshillëdhënëse ndaj kopshteve në Republikën e Maqedonisë. Gjithashtu, nevojitet që të organizohen trajnime për realizuesit e Programit për mësim të hershëm dhe zhvillim dhe bashkëpunëtorët profesional, dhe temat prioritare për trajnimet duhet të jenë ato me interes dhe të propozohen nga pedagogët dhe edukatorët e anketuar.

7. Me këtë hulumtim u hulumtuan edhe shkaqet të cilat e vështirësojnë realizimin e qëllimeve në Programin për mësim të hershëm dhe zhvillim. Nga të dhënat e fituara bëhet e qartë se ekzistojnë më shumë shkaqe të cilat e vështirësojnë realizimin e qëllimeve. Në bazë të kësaj, si më të rëndësishme kemi veçuar:

- ▲ Numri i madh i fëmijëve në grupet edukative, përkatësisht dy deri tre herë më i madh nga numri i paraparë me ligj.
- ▲ Keqkuptimi dhe zbatimi jopraktik i dokumentit Standardet për mësimin e hershëm dhe zhvillimin e fëmijëve nga mosha 0 deri në moshën 6 vjeçare.
- ▲ Të paqarta qëllimet përkufizuese në lëmin edukative-arsimore në Programin për mësim të hershëm dhe zhvillim (Zhvillimi kognitiv dhe arritja e njohurive të përgjithshme, arti) dhe konkretizimi i pamjaftueshëm i qëllimeve në programin sipas moshës për çdo aspekt nga zhvillimi i fëmijës.
- ▲ Numri jo i mjaftueshëm dhe trajnime jopërkatese për implementimin e Programit për mësim të hershëm dhe zhvillim dhe implementimi i Standardeve për mësim të hershëm dhe zhvillim (trajnimi realizohet në ekzemplar të caktuar të edukatorëve, të cilët më pas kanë për detyrë të bëjnë diseminimin në kopsht). Në planifikimin dhe realizimin e këtyre trajnimeve nuk ishin të përfshirë këshilltarët e Byrosë së zhvillimit të arsimit, poashtu nuk ishin të përfshirë edhe profesorë relevant universitar nga Instituti i pedagogjisë dhe Fakultetit të shkencave arsimore. Të anketuarit e përfshirë në këtë hulumtim u deklaruan se gjatë periudhës së trajnimeve janë ballafaquar me një numër të madh paqartësi dhe pyetje për të cilat nuk kanë marrë përgjigje përkatëse. Qasja e këtillë ndaj zhvillimit profesional të edukatorëve, bashkëpunëtorëve profesionistë dhe bashkëpunëtorëve, me përjashtimin e plotë të këshilltarëve të Byrosë së Zhvillimit të Arsimit nga procesi i planifikimit dhe realizimit të trajnimeve, në praktikë rezultoi me zvogëlimin e cilësisë të planifikimit dhe realizimit të punës edukative-arsimore. E njëjta vërehet nga rezultatet e fituara nga fokus grupet me edukatorët, si dhe nga analiza e raporteve të këshilltarëve të Byrosë së Zhvillimit të Arsimit, të bëra gjatë vizitave profesionale-këshillëdhënëse në kopshtet e Republikës së Maqedonisë gjatë vitit 2014-2015.
- ▲ Problem tjetër me të cilat përballen praktikantët është realizimi i një numri të madh i projekteve programore të aktiviteteve të detyrueshme. Ndryshe, në bazë të nenit 168, paragrafi 11 të Ligjit për mbrojtjen e fëmijëve „Në kopshtet publike për fëmijë me qëllim të avancimit të zhvillimit të personalitetit të fëmijës, talentin, aftësitë fizike, krijuese dhe aftësitë tjera, detyrimisht realizohen aktivitetet programore nga lëmi i kulturës, botimit, kujdesit dhe veprimtarisë edukative, ekologjisë, artit, mënyrë së shëndetshme jetësore, aktiviteteve të lira rekreative dhe sport”. Këto programe i miratoi Ministri i Punës dhe Politikës Sociale. Sipas deklarimeve të edukatorëve, këto aktivitete projektuese të detyrueshme nuk kanë asnjë lloj ndikimi në zhvillimin dhe avancimin e fëmijës, sepse janë imponuese dhe nuk dalin nga nevojat, interesat dhe mundësitë e fëmijëve në grup si parime kryesore, në të cilat do të duhet të bazohet planifikimi dhe

realizimi i punës edukative-arsimore me fëmijët e moshës parashkollore, në bazë të hulumtimeve më të reja për zhvillimin e trurit dhe mësimin e hershëm të fëmijëve. Sa i përket kësaj pyetje edukatorët u përgjigjën: „Projektet janë të tepërta në program. Jam bashkërendues i projektit dhe nënbashkërendues i projektit tjetër, këto janë obligime/aktivitete plotësuese në lidhje me përgatitjen e raporteve elektronike, gjetja e materialeve për realizimin e projekteve. Pse dikush të jetë bashkërendues dhe të shkojë te koleget e të kërkojë aktivitete? Familja, kopshti, bon-toni çdo herë i kemi pasur në program. Të tepërta janë projektet, këtë e kemi në planet vjetore, në temat. Vështirë realizohen me të gjitha grupet e moshës së rritur “.

Në këtë nen të Ligjit për mbrojtjen e fëmijëve edhe një herë vërtetohet përzierja e ingerencave në lidhje me arsimin parashkollor ndërmjet Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale dhe Byrosë së zhvillimit të arsimit si institucion kompetent për përpilimin e programeve për punë edukative-arsimore e moshës parashkollore. Këto tre arsye, për shkak të ngritjes së cilësisë të punës edukative-arsimore në kopsht edhe një herë vërtetohet nevoja për sjelljen e ligjit për edukim dhe arsim parashkollor, si dhe nevoja për një transfer të përgjithshëm të kompetencave mbi edukimin dhe arsimin parashkollor në kuadër të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës. Kjo do të kontribuojë në avancimin e cilësisë të punës edukative-arsimore me fëmijët e moshës parashkollore dhe sigurimin më të madh të kompatibilitetit të programeve edukative-arsimore në arsimin parashkollor dhe edukimin dhe arsimin fillor.

- ▲ Problem tjetër i cili e vështirëson realizimin e Programit për mësim të

hershëm dhe zhvillim është evidenca pedagogjike dhe dokumentacioni në kopshtin për fëmijë/qendra për zhvillim të hershëm të fëmijëve i cili nuk i pasqyron problemet reale të edukatorëve për planifikimin dhe realizimin e punës edukative-arsimore. Vështirësi të veçantë paraqet obligimi ligjor për për udhëheqjen e tij të dyfishtë. Njëherit, në nenin 195 të Ligjit për mbrojtjen e fëmijëve është: „Në institucionet për fëmijë udhëhiqet evidenca dhe dokumentacioni. Dokumentacioni pedagogjik në kuptim të këtij ligji e përfshinë Librin kryesor të fëmijëve dhe paraqet dokument me vlerë të përhershme. Evidenca pedagogjike përfshinë ditarin për punë të kopshtit/qendrës për zhvillim të hershëm të fëmijëve, ditar për punë të grupit edukativ, planifikimin dhe përgatitjen e punës edukative-arsimore dhe dosja e fëmijës dhe të njëjtat udhëhiqen në letër dhe formë elektronike” Sa i përket kësaj çështje edukatorët akoma më shumë janë më të zëshëm në lidhje me udhëheqjen e evidencës pedagogjike dhe dokumentacionit në kopsht ka rëndësi të madhe në sigurimin e cilësisë të punës edukative-arsimore me fëmijët e moshës parashkollore. Por, kjo duhet t'i pasqyrojë nevojat reale për planifikimin dhe realizimin e punës edukative-arsimore dhe duhet të udhëhiqet ose në letër ose në versionin elektronik sipas mbikëqyrjeve, nevojave dhe mundësive të kopshtit/qendrës për zhvillim të hershëm të fëmijës. Megjithatë, sipas deklarimeve të një numri të madh të edukatorëve udhëheqja e dyfishtë e evidencës pedagogjike dhe dokumentacionit është e panevojshme dhe paraqet humbje kohë të cilën edukatori do të duhet ta kalojë me

fëmijët e grupit. („Edhe në letër edhe në ditarin elektronik i shënojmë të dhënat e njëjta“, - „E gjithë kjo nuk ka kuptim“- u deklaruan edukatorët).

▲ HKushte joadekuade në kopshtin për përfshirje të përgjithshme të fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe kërkesa joreale të cilat parashtrohen para edukatorit në realizimin e punës edukative-arsimore dhe ndjekja e përparimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara. Edukatorët u deklaruan se gjatë kohës të trajnimeve të cilat u realizuan në lidhje me projektin „Gjithë përfshirja në zhvillimin e hershëm - sfidat dhe perspektivat“ prej tyre u kërkuar nga dosja e fëmijës ta shkruajnë edhe diagnozën e tyre sipas vlerësimit të lirë të bërë nga edukatori, në bazë të vëzhgimit të fëmijës.

▲ Prezenca e vazhdueshme e këshilltarëve të Byrosë së Zhvillimit të Arsimit, gjatë vitit, me qëllim të ofrimit të ndihmës dhe përkrahjes përkatëse profesionale-këshillëdhënëse, në veçanti edukatorëve fillestarë.

Në bazë të së theksuarës në tërësi vërtetohet hipoteza e shtatë e hulumtimit.


8. Me këtë hulumtim u kontrolluan edhe dallimet në qëndrimet dhe mendimet e edukatorëve dhe mësimitdhënësve klasorë në lidhje me nevojën për aplikimin e vitit përgatitor të detyrueshëm. Analiza e përgjigjeve në pyetësorët anketues për edukatorë dhe mësimitdhënës klasorë konfirmon se shumica e edukatorëve në kopshtet për fëmijë/QMHZH dhe mësimitdhënës klasorë në tërësi pajtohen se ekziston nevoja për aplikimin e vitit përgatitor të detyrueshëm.

Nga përgjigjet e mësimitdhënësve klasorë dhe pedagogët e shkollave fillore numri

më i madh i fëmijëve të cilët kanë ndjekur ndonjë formë të edukimit dhe arsimit parashkollor shpejtë adaptohen në fillimin e vitit shkollor në klasën e parë.

Numri më i madh i edukatorëve të anketuar në përgjithësi pajtohen se ekziston nevoja për aplikimin e vitit përgatitor të detyrueshëm para shkuarjes në shkollë.

Ngjashëm me përgjigjet e edukatorëve të anketuar, numri më i madh i pedagogëve të anketuar plotësisht pajtohen se është i nevojshëm aplikimi i vitit përgatitor të detyrueshëm para shkuarjes në shkollë, që nënkupton se është vërtetuar hipoteza e posaçme dhe se nuk ekziston dallimi i rëndësishëm statistikor në qëndrimet dhe mendimet e edukatorëve dhe pedagogëve në kopshtet për fëmijë në lidhje me nevojën për aplikimin e vitit përgatitor. Rëndësia e edukimit dhe arsimit parashkollor për zhvillimin e personalitetit të fëmijës dhe organizimi i njohurive paraprake të përvetësuar nga ana e fëmijëve, në vitin para shkuarjes në shkollë, e imponon nevojën për aplikimin e vitit përgatitor të detyrueshëm para shkuarjes në shkollë (për fëmijët të cilët deri në fund të vitit kalendarik do të mbushin 5 vjet), ndërsa kjo, nga ana tjetër është konfirmuar edhe me qëndrimet e edukatorëve dhe pedagogëve të kopshteve për fëmijë. Në vitet e mëhershme në Republikën e Maqedonisë ka pasur përvojë pozitive në punën edukative-arsimore në vitin përgatitor realizuar në kopshtet për fëmijë (rreth 20 % nga fëmijët e përfshirë) edhe në grupet e foshnjores pranë shkollave fillore (rreth 80 % nga fëmijët e përfshirë). Me rritjen e numrit të fëmijëve të përfshirë me organizimin e edukimit dhe arsimit parashkollor në 81 % nga numri i përgjithshëm i fëmijëve të asaj moshe në Republikën e Maqedonisë, u aplikua viti përgatitor i detyrueshëm dhe në vitin




2005 u përpilua nga Byroja e zhvillimit të arsimit, dokumenti programor Bazat e programit për punën edukative-arsimore në vitin përgatitor i cili u miratua nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës me Vendim nr. 10-746/25 më 27.04.2005. Do të ishte mirë të bëhej një analizë për kushtet hapësinore dhe të kuadrit ekzistues në kopshtet për fëmijë, qendrat për zhvillim të hershëm të fëmijëve dhe edukatorëve të cilët në shkollat fillore realizojnë programin mësimor në klasë të parë, që të konfirmohet ekzistimi i kushteve për aplikimin e vitit përgatitor të detyrueshëm. E nevojshme është që me përpilimin dhe sjelljen e programit të ri për mësim të hershëm dhe zhvillim në vitin 2018 të përpilohet edhe një dokument-program i ri për punën edukative-arsimore në vitin përgatitor, të cilin do ta sjellë me vendim Ministri i Arsimit dhe Shkencës. Gjatë përpilimit të këtij dokumenti duhet të merren parasysh përvojat paraprake të punës edukative-arsimore në vitin

përgatitor në Republikën e Maqedonisë, arritjet e mënyrave bashkëkohore, mendimi teorik nga lëmi i pedagogjisë parashkollore, psikologjia zhvillimore dhe bazat teorike dhe qëllimet edukative-arsimore në programet mësimore në klasë të parë.

9. Hipoteza e nëntë thotë: Ekziston dallimi ndërmjet mendimit të edukatorëve të institucioneve parashkollore dhe mësimdhënësve klasor në raport me të priturat e tyre për gatishmërinë e fëmijëve për kalim të suksesshëm nga institucioni parashkollor në shkollë fillore. Sipas 96,68 % e pedagogëve të anketuar me realizimin e qëllimeve nga Programi për mësim të hershëm dhe zhvillim të fëmijëve plotësisht ose pjesërisht janë të përgatitur për fillim të suksesshëm në klasë të parë në arsimin fillor, ndërsa vetëm 3,32 % prej tyre konsiderojnë se realizimi i qëllimeve të Programit për mësim të hershëm dhe

zhvillim nuk ka ndikim në përgatitjen e fëmijëve për një fillim të suksesshëm në arsimin fillor. Sipas tyre fëmijët të cilët kanë ndjekur institucionet parashkollore para regjistrimit në shkollë fillore vijnë me njohuri paraprake të caktuara:

Të ngjashme janë edhe deklaratimet e pedagogëve të anketuar. Sipas 86,67 % prej



tyre me realizimin e qëllimeve të Programit për mësim të hershëm dhe zhvillim, fëmijët pjesërisht janë të përgatitur për një fillim të suksesshëm në klasë të parë në arsimin fillor, ndërsa sipas 13,33 % e pedagogëve të anketuar, fëmijët plotësisht janë të përgatitur për fillim të suksesshëm në klasë të parë në arsimin fillor. Nga numri i përgjithshëm i pedagogëve të anketuar në shkollat fillore 95,56 % ishin anëtarë të komisionit për regjistrimin e nxënësve në klasën e parë në shkollat e tyre. Si anëtarë të këtij komisioni gjatë vëzhgimit dhe bisedimeve me fëmijët, te pjesa më e madhe e tyre, përkatësisht 72,57 % kanë vërejtur dallime të fëmijët të cilët kanë ndjekur ndonjëherë nga format e edukimit dhe arsimit parashkollor (orientimi në

hapësirë, mënyrën e komunikimit me fëmijët dhe të moshuarit, vetëbesimi, të folurit dhe njohuritë paraprake), sa i përket këtyre fëmijëve të cilët nuk kanë ndjekur asnjë lloj forme të edukimit dhe arsimit parashkollor, ndërsa vetëm te 9,71 % e fëmijëve nuk kanë vërejtur dallime të mëdha të dy grupet e fëmijëve. Kjo edhe një herë e konfirmon nevojën për aplikimin e vitit përgatitor të detyrueshëm.

Në bazë të asaj që theksohet, si dhe në bazë të rezultateve të fituara nga χ^2 testi ($\chi^2=3,091$ $df=2$ $p < 0,0298$), mund të përmbyllet se **$p > 0,05$, përkatësisht se nuk ekziston dallimi i rëndësishëm statistikor.**

10. Rezultatet nga lista anketuese për prindërit shpijnë ndaj asaj se më shumë se gjysma e prindërve të anketuar kanë mendim pozitiv në lidhje me aplikimin e vitit përgatitor të detyrueshëm për fëmijët e moshës 4 deri në 6 vjeçare, në drejtim të ndërlidhjes funksionale të edukimit dhe arsimit parashkollor me atë fillor. Këtë qëndrim me deklaratimet e tyre e konfirmuan 75 % e prindërve të anketuar. Gjithashtu, analiza e të dhënave të fituara tregon se 89,90 % e prindërve konsiderojnë se kopshti ka kontribut të madh në përgatitjen e fëmijëve për kalim të suksesshëm prej edukimit dhe arsimit parashkollor në atë fillor. Në lidhje me pyetjen për nevojën e aplikimit të vitit përgatitor të detyrueshëm për fëmijët prej moshës 4 deri në moshën 6 vjeçare, karakteristike është ajo se u përputhën qëndrimet dhe mendimet e të anketuarve nga të gjitha grupet në këtë hulumtim (edukatorë, pedagogë nga kopshtet për fëmijë, mësuesit dhe prindërit). Nga këtu, e domosdoshme është të bëhet analizë për kushtet hapësinore dhe kadrovike në kopshtet për fëmijë, qendrat për mësim të hershëm dhe zhvillim dhe shkollat fillore dhe ekzistimi i kushteve tjera hapësinore që të mund të përpilojë plan konkret për rregullimin ligjor të vitit përgatitor të detyrueshëm në kuadër të Ministrisë së Arsimit dhe të Shkencës. Me këtë konfirmohet edhe hipoteza e dhjetë e hulumtimit.

REKOMANDIMET PËR IMPLEMENTIMIN E REZULTATEVE NGA HULUMTIMI

Rezultatet nga ky projekt hulumtues, si dhe njohuritë teorike të parashtruara imponojnë propozime të caktuara në funksion të përmirësimit të punës edukative-arsimore në kopshtin për fëmijë dhe avancimi i nënsistemit të edukimit dhe arsimit parashkollor në Republikën e Maqedonisë.

Pikërisht, disa aspekte mund të jenë të avancuara dhe të ndryshuara, e ato janë:

- ▲ Zhvillimi i mëtutjeshëm dhe zgjerimi i rrjetit të institucioneve parashkollore në Republikën e Maqedonisë. Të dhënat për përfshirjen e fëmijëve me edukimin dhe arsimin parashkollor se ekziston nevoja për zgjerimin e rrjetit në institucionet parashkollore në Republikën e Maqedonisë. Sipas të dhënave zyrtare të fituara nga Enti Shtetëror i Statistikës, për momentin përfshirja e fëmijëve me edukimin dhe arsimin parashkollor është në nivel jo të duhur edhe për fëmijët e moshës prej 3 deri në moshën 6 vjeçare është 39 %. Të anketuarit të cilët ishin të përfshirë në këtë hulumtim konsiderojnë se shkak kryesor për përfshirjen e vogël të fëmijëve në kopshte është mospasja e kapacitetit hapësinor për përfshirjen e të gjithë fëmijëve. Tendenca e Komisionit Evropian për Arsim është deri në vitin 2020 me edukimin dhe

arsimin parashkollor që të përfshihen më së paku 95 % e fëmijëve të moshës deri në 6 vjet. Me këtë do të ofrohet mundësia për gjasa të barabarta për arsim të çdo fëmije, e në veçanti për fëmijët e grupeve të marginalizuara. Hulumtimi i fundit i TIMSS, realizuar nga Instituti për hulumtime pedagogjike në Serbi, si dhe hulumtimi në kuadër të projektit „Me lexim deri te liderizmi“, realizuar nga Shoqata e qytetarëve „Hap pas hapi“, tregojnë se arsimimi i hershëm ndikon në rezultatet të cilat nxënësit i arrijnë në klasën e katërt në shkollën fillore.

- ▲ Përpilim dhe miratimi i Konceptit për edukim dhe arsim parashkollor në Republikën e Maqedonisë.
- ▲ Ministria e Arsimit dhe Shkencës të sjell ligj për edukimin dhe arsimin parashkollor. Duke e pasur parasysh faktin se edukimi dhe arsimi parashkollor është i pari dhe nënsistemi më i rëndësishëm në kuadër të sistemit të përgjithshëm të edukimit dhe arsimit, rezultatet nga analiza e nënsistemit tonë të edukimit dhe arsimit parashkollor, duke ndjekur pastaj përvojat pozitive evropiane dhe ato botërore, tregojnë se në Republikën e Maqedonisë ekziston nevoja urgjente për sjelljen e një ligji për edukim dhe

arsim parashkollor në transfer të plotë të kompetencave në kuadër të Ministrisë së Arsimit dhe të Shkencës. Kjo do të mundësojë avancimin e cilësisë të sistemit të edukimit dhe arsimit parashkollor dhe lidhshmërinë funksionale të edukimit dhe arsimit parashkollor me atë fillor.

- ▲ Rritja e numrit të përkëdhelësve, edukatorëve, bashkëpunëtorëve dhe punëtorëve profesionistë në kopshtet për fëmijë.
- ▲ Sjellja e kompetencave kryesore profesionale dhe standardet për përkëdhelëset, edukatorët, punëtorët profesionistë, bashkëpunëtorët profesionistë dhe kuadri udhëheqës në kopshtet për fëmijë /qendrat për zhvillim të hershëm të fëmijëve.
- ▲ Respektimi i normativit të dispozitave ligjore për numrin e fëmijëve në grupet
- ▲ Aplikimi i vitit përgatitor të detyrueshëm për fëmijët e moshës 4 deri në moshën 6 vjeçare. Republika e Maqedonisë duhet t'i arrijë standardet ndërkombëtare sa i përket mësimi dhe zhvillimit të hershëm të fëmijëve të moshës parashkollore dhe rekomandimet e Komisionit Evropian për arsim, sipas së cilës deri në vitin 2020 pritet përfshirja e fëmijëve në edukimin dhe arsimin parashkollor në të gjitha vendet e Evropës të arrijë 95 %, Republika e Maqedonisë nuk ka mjaftueshëm kapacitete hapësinore për përfshirjen e të gjithë fëmijëve prej 0 deri në moshën 6 vjeçare me edukim dhe arsim parashkollor, dhe në drejtim të përmirësimit të gjendjes së këtillë, propozojmë së pari aplikimin e vitit përgatitor të detyrueshëm në kopshtet për fëmijë të moshës prej 4 deri në moshën 6 vjeç. Me këtë do të mundësohet krijimi i mundësive të barabarta për arsim cilësor i edukimit dhe arsimit parashkollor me atë fillor. Duke zbatuar përvojat pozitive të vendeve tjera, supozojmë aplikimin edhe të formave të shkurtra të përfshirjes së fëmijëve në punën edukative-arsimore në vitin përgatitor (më së paku 20 orë në javë).
- ▲ Aplikimi i një programi të ri në vitin 2018, për punën edukative-arsimore me fëmijët e moshës parashkollore, si dhe programi për punën edukative-arsimore për vitin përgatitor, të përpiluara nga Byroja e zhvillimit të arsimit. Ekziston nevoja për një dokument të ri programor, në çka tregojnë të dhënat e fituara me hulumtimin empirik në të cilin 98,18 % e të anketuarve janë deklaruar se qëllimet e dhëna në kuadër të pesë aspekteve të zhvillimit të fëmijës nuk janë të mjaftueshme, d.m.th., se ka nevojë për zgjerimin e tyre dhe konkretizim më të madh veçanërisht në lëmin e matematikës, komunikacionit, edukimit dhe arsimit figurativ dhe muzikor, si dhe në lëmin e gjuhës, komunikimit dhe zhvillimit të shkrim-leximit.
- ▲ Avancimi i evidencës dhe dokumentacionit pedagogjik në kopshtet për fëmijë, me qëllim që të jetë funksionale, d.m.th., t'i pasqyrojë nevojat reale të edukatorit për planifikim dhe realizim të punës edukative-arsimore. Kjo masë njëkohësisht do të mundësojë ngritjen e cilësisë të punës edukative-arsimore me fëmijët e moshës parashkollore. Evidenca pedagogjike ekzistuese në kopshtet për fëmijë përmbledh shumë hamendje dhe vështirësi të edukatorët sa i përket planifikimit dhe realizimit të

procesit edukativo-arsimor. Shumica e edukatorëve konsiderojnë se profili shëndetësor duhet të ndahet nga dosja e fëmijës dhe të mbetet pjesë përbërëse e kartonit shëndetësor të fëmijës të cilin do ta udhëheq mjeku në kopsht. Edukatorët kanë nevojë për trajnime – plotësuese dhe literaturë manuale në funksion të përmirësimit të kompetencave të tyre për udhëheqjen e evidencës pedagogjike në kopsht. Evidenca pedagogjike ekzistuese doemos të rishqyrtohet, ndërsa evidenca e re doemos t'i merr parasysh përvojat pozitive të edukatorëve dhe të bazohet në qasjen holistike në edukimin dhe arsimin e fëmijës dhe trendet bashkëkohore në pedagogjinë parashkollore.

- ▲ Sigurimi i mjeteve financiare për veprimtari të vazhdueshme këshillëdhënëse- instruktive edhe për trajnime për zhvillim profesional të përkëdhelësve, edukatorëve, punëtorët profesionistë dhe bashkëpunëtorë profesionist në kopshtet për fëmijë/qendrat për zhvillim të hershëm të fëmijëve, të cilat duhet të organizohen nga Byroja e zhvillimit të arsimit, në bazë të Ligjit të Byrosë së Zhvillimit të Arsimit.
- ▲ Realizimi i hulumtimit për gjendjen aktuale të arsimit gjithëpërfshirës në kopshtet për fëmijë/qendrat për zhvillim të hershëm të fëmijëve.
- ▲ Organizimi i fushatës për ngritjen e vetëdijes së prindërve në Republikën e Maqedonisë për rëndësinë e mësimin të hershëm dhe zhvillimit, përkatësisht për rëndësinë dhe nevojën e fëmijës të jetë i përfshirë në ndjekjen e programit për edukim dhe arsim parashkollor.

Si përgjigje e nevojave bashkëkohore të dedikuara nga rrjedhat botërore në edukimin dhe arsimin parashkollor, ndërsa nga pikëpamja e rëndësisë së madhe të mësimin të hershëm dhe zhvillimit në jetën e çdo individi, në periudhën vijuese duhet të presim riafirmimin e veprimtarisë në edukimin dhe arsimin parashkollor dhe në tërësi animacion i qasjes humaniste në punën edukative-arsimore me fëmijët e moshës parashkollore, që njëherësh është edhe qëllimi i edukimit dhe arsimit bashkëkohor dhe arsimit në botë.

...the first of these is the fact that the ...

...the second of these is the fact that the ...

...the third of these is the fact that the ...

...the fourth of these is the fact that the ...

...the fifth of these is the fact that the ...

...the sixth of these is the fact that the ...

...the seventh of these is the fact that the ...

...the eighth of these is the fact that the ...

...the ninth of these is the fact that the ...

...the tenth of these is the fact that the ...

...the eleventh of these is the fact that the ...

...the twelfth of these is the fact that the ...

...the thirteenth of these is the fact that the ...

...the fourteenth of these is the fact that the ...

...the fifteenth of these is the fact that the ...

...the sixteenth of these is the fact that the ...

...the seventeenth of these is the fact that the ...

...the eighteenth of these is the fact that the ...

...the nineteenth of these is the fact that the ...

...the twentieth of these is the fact that the ...

PJESA V

LITERATURA E
SHFRYTËZUAR

...the first of these is the fact that the ...

...the second of these is the fact that the ...

...the third of these is the fact that the ...

...the fourth of these is the fact that the ...

...the fifth of these is the fact that the ...

...the sixth of these is the fact that the ...

...the seventh of these is the fact that the ...

...the eighth of these is the fact that the ...

...the ninth of these is the fact that the ...

...the tenth of these is the fact that the ...

...the eleventh of these is the fact that the ...

...the twelfth of these is the fact that the ...

...the thirteenth of these is the fact that the ...

...the fourteenth of these is the fact that the ...

...the fifteenth of these is the fact that the ...

...the sixteenth of these is the fact that the ...

...the seventeenth of these is the fact that the ...

...the eighteenth of these is the fact that the ...

...the nineteenth of these is the fact that the ...

...the twentieth of these is the fact that the ...

- Ангелоска-Галевска, Н. (1998). *Квалитативни истражувања во воспитанието и образованието*. Битола: Кио Дандаро.
- Дамовска, Л. (1997). *Хуманистичката тенденција-основа за иновирање и трансформирање на потсистемот на предучилишното воспитание и образование*. Скопје: Годишен зборник на Филозофскиот факултет, кн. 24(50).
- Дамовска, Л. (2001). *Компактибилноста на предучилишното со основното воспитание и образование*. Скопје: Круг 92.
- Дамовска, Л. (2012). *Нови практики во детските градинки. Базирани на стандардите за рано учење и развој кај децата од 0 до 6 години*. Скопје: Темпора веритас.
- Дамовска, Л. и др. (2004). *Стандарди за рано учење и развој на децата од 0 до 6 години*, Скопје: Министерство за труд и социјална политика.
- Закон за воспитување и образование на децата од предучилишна возраст (1974). Скопје: („Службен весник на Социјалистичка Република Македонија“) бр. 45.
- Закон за заштита на децата (2000). Скопје: („Службен весник на Социјалистичка Република Македонија“) бр. 98.
- Закон за заштита на децата (2013). Скопје: („Службен весник на Република Македонија“) бр. 23.
- Закон за предучилишно и основно воспитание и образование (1983). Скопје: („Службен весник на Социјалистичка Република Македонија“).
- Извештај од истражувањето: „Позитивните влијанија на воспитно-образовната работа во детските градинки врз успехот на учениците во совладувањето на наставните програми во прво одделение“, (2012). Биро за развој на образованието, Скопје,
- Институт за педагогија (2000). *Предучилишното воспитание и образование во Република Македонија (развој, состојби и перспективи)*. Скопје: Филозофски факултет.
- Камберски, К. (1994). *Од буквар до универзитет*. Скопје: Просветно дело.
- Koncepti për edukimin dhe arsimit fillor nëntëvjeçar (2007). Shkup: Vyroja e zhvillimit të arsimit.*
- Dr Christine Stephen (2006), *Institute of Education, University of Stirling ISSN 1478-6796.*
- Национална програма за развој на образованието во Република Македонија 2005-2015 со придружни програмски документи (2006). Скопје: Министерство за образование и наука на Република Македонија.*
- Programi nacional për zhvillimin e arsimit në Republikën e Maqedonisë 2005-2015 me dokumentet programore bashkëngjitëse (2006). Shkup: Ministria e Arsimit dhe Shkencës në Republikën e Maqedonisë.*
- Програма за рано учење и развој*. Министерство за труд и социјална политика на РМ, („Службен весник на РМ“) бр. 46 од 06.03.2014.
- Prirucnik za diversifikaciju programa predskolskog vaspitanja i obrazovanja, (2013), Ministarstvo prosvete, nauke i tehnoloskog razvoja Republike Srbije.*
- Хорватовиќ, В. (2015), *Третманот на говорниот развој и комуникациските вештини кај децата од предучилишна и рана училишна возраст*. Скопје: Докторска дисертација, Институт за педагогија, Филозофски факултет.
- Agency for Healthcare Research and Quality. (2016). Table 3: Total expenses and percent distribution for selected conditions by type of service: United States, 2013. *Medical Expenditure Panel Survey Household Component Data*. Generated interactively: http://meps.ahrq.gov/mepsweb/survey_comp/household.jsp.
- Center on the Developing Child at Harvard University (2016). Adapted from Rogers, E.M. (2003). *Diffusions of Innovation*. New York, NY: Free Press.
- Fox, S.E., Levitt, P., & Nelson, C.A. (2010). How the timing and quality of early experiences influence the development of brain architecture. *Child Development, 81*(1), 28-40.
- Grantham-McGregor, S., Cheung, Y.B., Cueto, S., Glewwe, P., Richter, L., Strupp, B., & the International.

Meaney, M.J. (2010). Epigenetics Shonkoff, J.P., & Phillips, D. (Eds.) (2000). *From neurons to neighborhoods: The science of early childhood development*. Committee on Integrating the Science of Early Childhood Development. Washington, DC: National Academy Press.

Measuring the quality of early learning programs (2016), Gidiance Note, ELP.

Promising Approaches in Early Childhood Development. March 2017. Early Childhood Development interventions from Around World., World Bank Group.

Proposal for key principles of a Quality Framework for Early Childhood Education and Care. Report of the Working Group on Early Childhood Education and Care under the auspices of the European Commission. (2014), European Commission.

Reardon, S.F. (2011). The widening academic achievement gap between the rich and poor: New evidence and possible explanations. In G. Duncan & R. Murnane (Eds.), *Whither Opportunity? Rising Inequality, Schools, and Children's Life Chances* (pp. 91-116). New York, NY: Russell Sage Press.

Sylva, K., Melhuish, E., Sammons, P., Siraj-Blatchford, I. and Taggart, B. (Eds.) (2010). *Early childhood matters: evidence from the Effective Preschool and Primary Education Project*. Oxford: Routledge

The American Enterprise Institute for Public Policy Research and the Brookings Institution (2015). *Opportunity, Responsibility, and Security: A Consensus Plan for Reducing Poverty and Restoring the American Dream*.

The Federal Interagency Forum on Child and Family Statistics. (2015). *America's Children: Key National Indicators of Well-Being*. Retrieved from <http://www.childstats.gov/>.

UNESCO Institute for Statistics, *International Classification of Education ISCED 2011*: Montreal, Canada, 2012, p.63

Web literature

<http://public.mzos.hr>

<http://teacher.scholastic.com/professional/bruceperry/curiosity.htm>

<http://www.confereo.ep.liu.se/issues/2014/v2/i1/140616/confero14v2i1a.pdf>

<http://www.ers.usda.gov/publications/fanrr-food-assistance-nutrition-research-program/fanrr5.aspx>.

(<http://eacea.ec.europa.eu/education/eurydice>)

<http://www.etf.europa.eu>

<http://www.naeyc.org/academy/primary/aboutoverview>

<http://www.researchconnections.org/>

https://www.naeyc.org/files/naeyc/file/positions/position_statement.pdf

www.britanica.com

www.developingchild.harvard.edu/library/

www.great-ideas.org/30.htm

www.infed.org/biblio/holisticeducation.htm#holistic%20education

www.PathsOfLearning.net

www.socsci.com

Insight 28: Early Years Education: Perspectives From a Review of the...

PJESA VI

SHTOJCAT

...the first of these is the fact that the ...

...the second of these is the fact that the ...

...the third of these is the fact that the ...

...the fourth of these is the fact that the ...

...the fifth of these is the fact that the ...

...the sixth of these is the fact that the ...

...the seventh of these is the fact that the ...

...the eighth of these is the fact that the ...

...the ninth of these is the fact that the ...

...the tenth of these is the fact that the ...

...the eleventh of these is the fact that the ...

...the twelfth of these is the fact that the ...

...the thirteenth of these is the fact that the ...

...the fourteenth of these is the fact that the ...

...the fifteenth of these is the fact that the ...

...the sixteenth of these is the fact that the ...

...the seventeenth of these is the fact that the ...

...the eighteenth of these is the fact that the ...

Shtojca 1

BYROJA E ZHVILLIMIT TË ARSIMIT
Sektori për hulumtim në arsim

FLETË ANKETUESE PËR PEDAGOGË

I/e nderuar,

Byroja e Zhvillimit të Arsimit realizon hulumtim në kopshtet për fëmijë në Republikën e Maqedonisë me qëllim të marrjes të informatave të besueshme për gjendjet dhe nevojat dhe marrja e hapave konkret për ndryshime sistemore cilësore në edukimin dhe arsimin parashkollor për fëmijët prej moshës 4 deri 6 vjeçare.

Fleta anketuese përmban pyetje të cilave duhet t'iu përgjigjeni duke rrethuar, përkatësisht duke dhënë komente, mendime dhe sugjerime alternative. Informatat e fituara do të shfrytëzohen kryesisht për qëllimet e këtij hulumtimi.

Përzgjedhja është bërë sipas parimeve të rastësishme, ndërsa pjesëmarrja është anonime.

Ju falënderohemi për bashkëpunimin!

Kopshti për fëmijë _____

Komuna _____

Qyteti _____

TË DHËNAT E PËRGJITHSHME

Përgatitja iniciale/shkalla e arsimit:

a) arsimit sipëror b) magjistër c) doktor shkence

— Përvoja e punës si pedagog:

- a) deri 10 vjet b) deri 20 vjet
c) deri 30 vjet ç) mbi 30 vjet

— Në fletën anketuese përgjigjet pedagog:

- a) gjinisë mashkullore
b) gjinisë femërore

1. Vallë jeni të njoftuar me Standardet për mësim të hershëm dhe zhvillim të fëmijët prej moshës 0 deri në 6 vjeçare dhe me Programin për mësim të hershëm dhe zhvillim në të cilën bazohet realizimi i punës edukative- arsimore në kopsht?

- a) Në përgjithësi jam i/e informuar.
b) Pjesërisht jam i/e informuar.
c) Aspak nuk jam i/e informuar.

2. Vështirësitë me të cilat ballafaqohen pedagogët në kopsht gjatë implementimit të Programit për mësim të hershëm dhe zhvillim janë:

- a) trajnimi jo i mjaftueshëm për implementimin e Standardeve për mësim të hershëm dhe zhvillim në punën edukative arsimore me fëmijët e moshës parashkollore.
b) për së tepërmi janë të përgjithshme Standardet për mësim të hershëm dhe zhvillim në punën edukative- arsimore me fëmijët e moshës parashkollore.
c) realizimi i aktiviteteve të shumta projektuese të rregulluara me Ligj për mbrojtjen e fëmijëve.
ç) nuk janë konkretizuar mjaftueshëm qëllimet në Programin për mësim të hershëm dhe zhvillim.
d) vëllimi i madh i punës administrative.

- dh) kushtet joadekuate për punë në kopsht.
- e) arritjet e pamjaftueshme gjatë studimeve, të nevojshme për realizimin e suksesshëm në punën edukative arsimore.
- ë) trajnimi jo i mjaftueshëm për zbatimin e ri të evidencës dhe dokumentacionit pedagogjik
- f) tjetër (shkruani çka) _____

3. Vallë mendoni se ekziston nevoja për rishqyrtimin e Standardeve për mësim të hershëm dhe zhvillim të fëmijët prej moshës 0 deri 6 vjeçare?

- a) Plotësisht pajtohem.
- b) Pjesërisht pajtohem.
- c) Aspak nuk pajtohem.

4. Në qoftë se pyetjes paraprake iu jeni përgjigjur nën a ose b, rrethoni cilat aspekte nga zhvillimi i fëmijës duhet të jenë dominuese gjatë rishqyrtimit të Standardeve dhe indikatorëve për mësim të hershëm dhe zhvillim?

- a) Shëndeti fizik dhe zhvillimi motorik.
- b) Zhvillimi socio-emocional.
- c) Zhvillimi i qasjes ndaj mësimi.
- ç) Zhvillimi i gjuhës, arsimimi dhe komunikimi.
- d) Zhvillimi kognitiv dhe arritja e njohurive.

5. Vallë me realizimin e qëllimeve nga Programi aktual për mësim të hershëm dhe zhvillim fëmijët janë të përgatitur për fillim të suksesshëm në klasë të parë?

- a) Po b) Pjesërisht c) Jo

6. Vallë ekziston nevoja për aplikimin e vitit përgatitor të detyrueshëm?

- a) Plotësisht pajtohem.
- b) Pjesërisht pajtohem.
- c) Aspak nuk pajtohem.

7. Duke pasur parasysh përvojën Tuaj praktike në ndjekjen e realizimit të Programit për mësim të hershëm dhe zhvillim, çfarë ndryshime duhet të bëhen në këtë program?

8. Vallë është i nevojshëm avancimi i qëllimeve në Programin për mësim të hershëm dhe zhvillim për moshën më të rritur parashkollore me qëllim të lidhshmërisë funksionale me qëllimet në programet mësimore në klasën e parë?

- a) Plotësisht pajtohem.
- b) Pjesërisht pajtohem.
- c) Aspak nuk pajtohem.

9. Në qoftë se pyetjes paraprake u jeni përgjigjur nën a ose b, në cilat pjesë të Programit për mësim të hershëm dhe zhvillim më së shumti duhet të bëhen ndryshime?

- a) Matematikë.
- b) Shkencat natyrore.
- c) Arsim figurativ.
- ç) Arsim muzikor.
- d) Gjuhë amtare.
- dh) Shoqëri.
- ë) Tjetër _____

10. Vallë evidenca dhe dokumentacioni pedagogjik aktual në kopshte/QMHZH i pasqyron nevojat reale të edukatorit për planifikim dhe realizim të suksesshëm të punës edukative arsimore, duke vënë fëmijën në qendër të vëmendjes?

- a) Po, në tërësi përshtatet me kërkesat bashkëkohore për planifikimin dhe realizimin e punës edukative arsimore, ku fëmija është në qendër të vëmendjes.
- b) Pjesërisht përshtatet.
- c) Jo, në përgjithësi nuk përshtatet me kërkesat bashkëkohore për planifikimin dhe realizimin e punës edukative arsimore ku fëmija është në qendër të vëmendjes.

11. Vallë mendoni se evidenca dhe dokumentacioni pedagogjik aktual në kopshte / QMHZH duhet të rishqyrtohet?

- a) Po
- b) Jo

12. Nëse pyetjes paraprake i jeni përgjigjur me Po, theksoni sugjerimet dhe propozimet Tuaja për avancimin e saj.

13. Vallë keni nevojë për trajnim nga persona profesionistë nga Byroja e zhvillimit të arsimit?

a) Po

b) Jo

14. Në qoftë se në pyetjen paraprake keni rrethuar nën a, me cilën temë duhet të jenë trajnimet?

15. Vallë keni nevojë për përkrahje të vazhdueshme profesionale-këshillëdhënëse nga këshilltarët e Byrosë së Zhvillimit të Arsimit për një implementim më të suksesshëm të punës edukative-arsimore?

a) Po, sepse -----

b) Jo, sepse -----

16. Theksoni sugjerimet Tuaja përderisa mendoni se do ta avancojnë punën edukative-arsimore në kopshtin për fëmijë.

Shtojca 2

BYROJA E ZHVILLIMIT TË ARSIMIT Sektori për hulumtim në arsim

FLETË ANKETUESE PËR EDUKATORË

I/e nderuar,

Byroja e Zhvillimit të Arsimit realizon hulumtim në kopshtet për fëmijë në Republikën e Maqedonisë me qëllim të marrjes së informatave të besueshme për gjendjet dhe nevojat dhe marrja e hapave konkret për ndryshime sistemore cilësore në edukimin dhe arsimin parashkollor për fëmijët prej moshës 4 deri 6 vjeçare.

Fleta anketuese përmban pyetje të cilave duhet t'iu përgjigjeni duke rrethuar, përkatësisht duke dhënë komente, mendime dhe sugjerime alternative. Informatat e fituara do të shfrytëzohen kryesisht për qëllimet e këtij hulumtimi.

Përzgjedhja është bërë sipas parimeve të rastësishme, ndërsa pjesëmarrja është anonime.

Ju falënderohemi për bashkëpunimin!

TË DHËNAT E PËRGJITHSHME

Kopshti për fëmijë_____

Qendra për mësim të hershëm dhe zhvillim _____

Komuna _____

Qyteti _____

Përgatitja iniciale/shkalla e arsimit:

a) arsimit sipëror b) magjistër c) doktor shkence

— Shkalla e arsimit e edukatorit:

- a) arsim i lartë b) arsim sipëror
c) magjistër ç) doktor shkence

— Lloji i arsimit sipëror të kryer

- a) Fakulteti Filozofik
b) Fakulteti Pedagogjik
c) Arsimit tjetër (shkruani)_____

— Përvoja e punës si edukator:

- a) deri 10 vjet b) deri 20 vjet
c) deri 30 vjet ç) mbi 30 vjet

— Pyetësit i përgjigjet edukator:

- a) gjinisë mashkullore
b) gjinisë femërore

1. Vallë mendoni se jeni trajnuar mjaftueshëm për zbatimin e Standardeve për mësim të hershëm dhe zhvillim?

- a) Po
b) Pjesërisht
c) Jo

2. Vallë mendoni se jeni trajnuar mjaftueshëm për zbatimin e Programit për mësim të hershëm dhe zhvillim?

- a) Po
- b) Pjesërisht
- c) Jo

3. Vështirësitë gjatë implementimit të Programit për mësim të hershëm dhe zhvillim janë:

- a) trajnimi jo i mjaftueshëm për implementimin e Standardeve për mësim të hershëm dhe zhvillim në punën edukative-arsimore me fëmijët e moshës parashkollore.
- b) për së tepërmi janë të përgjithshme Standardet për mësim të hershëm dhe zhvillim në punën edukative- arsimore me fëmijët e moshës parashkollore.
- c) realizimi i aktiviteteve të shumta projektuese të rregulluara me Ligj për mbrojtjen e fëmijëve.
- ç) nuk janë konkretizuar mjaftueshëm qëllimet në Programin për mësim të hershëm dhe zhvillim.
- d) vëllimi i madh i punës administrative.
- dh) kushtet joadekuate për punë në kopsht.
- e) arritjet e pamjaftueshme gjatë studimeve, të nevojshme për realizimin e suksesshëm në punën edukative arsimore.
- ë) trajnimi jo i mjaftueshëm për zbatimin e ri të evidencës dhe dokumentacionit pedagogjik
- f) tjetër (shkruani çka)_____

4. Vallë mendoni se ekziston nevoja për rishqyrtimin e Standardeve për mësim të hershëm dhe zhvillim te fëmijët prej moshës 0 deri 6 vjeç?

- a) Plotësisht pajtohem.
- b) Pjesërisht pajtohem.
- c) Aspak nuk pajtohem.

5. Në qoftë se pyetjes paraprake i jeni përgjigjur nën a ose b, rrethoni cilat aspekte nga zhvillimi i fëmijës duhet të jenë të rishqyrtuara në Standardet për mësim të hershëm dhe zhvillim?

- a) Shëndeti fizik dhe zhvillimi motorik.
- b) Zhvillimi socio-emocional.
- c) Zhvillimi i qasjes ndaj mësimet.

- ç) Zhvillimi i gjuhës, arsimimi dhe komunikimi.
- d) Zhvillimi kognitiv dhe arritja e njohurive.

6. Vallë mendoni se ekziston nevoja për rishqyrtimin e indikatorëve që dalin nga Standardet për mësim të hershëm dhe zhvillim te fëmijët prej moshës 0 deri 6 vjeçare?

- a) Plotësisht pajtohem.
- b) Pjesërisht pajtohem.
- c) Aspak nuk pajtohem.

7. Në qoftë se pyetjes paraprake i jeni përgjigjur nën a ose b, rrethoni cilët indikatorë në Standardet për mësim të hershëm dhe zhvillim duhet të rishqyrtohen?

- a) Shëndeti fizik dhe zhvillimi motorik.
- b) Zhvillimi socio-emocional.
- c) Zhvillimi i qasjes ndaj mësimi.
- ç) Zhvillimi i gjuhës, arsimimi dhe komunikimi.
- d) Zhvillimi kognitiv dhe arritja e njohurive.

8. Duke pasur parasysh përvojën Tuaj praktike, çka do të kishit ndryshuar në Programin për mësim të hershëm dhe zhvillim?

9. Vallë me realizimin e qëllimeve nga Programi aktual për mësim të hershëm dhe zhvillim fëmijët janë të përgatitur për fillim të suksesshëm në klasë të parë?

- a) Po
- b) Pjesërisht
- c) Jo

10. Vallë mendoni se është e nevojshme avancimi i qëllimeve në Programin për mësim të hershëm dhe zhvillim për moshën më të vjetër parashkollore me qëllim të ndërlihdjes funksionale me qëllimet në programet mësimore në klasën e parë?

- a) Plotësisht pajtohem.
- b) Pjesërisht pajtohem.
- c) Aspak nuk pajtohem.

11. Në qoftë se pyetjes paraprake i jeni përgjigjur nën a ose b, në cilat pjesë të Programit për mësim të hershëm dhe zhvillim më së shumti duhet të bëhen ndryshime?

- a) Matematikë
- b) Shkenca natyrore
- c) Arsimit figurativ
- ç) Arsimit muzikor
- d) Gjuhë amtare
- dh) Shoqëri
- e) Tjetër _____

12. Vallë ekziston nevoja për aplikimin e vitit përgatitor të detyrueshëm?

- a) Plotësisht pajtohem.
- b) Pjesërisht pajtohem.
- c) Aspak nuk pajtohem.

13. Vallë evidenca dhe dokumentacioni pedagogjik aktual në kopshte/QMHZH i pasqyron nevojat reale të edukatorit për planifikim dhe realizim të suksesshëm të punës edukative- arsimore, duke vënë fëmijën në qendër të vëmendjes?

- a) Po, në tërësi përshtatet me kërkesat bashkëkohore për planifikimin dhe realizimin e punës edukative arsimore, ku fëmija është në qendër të vëmendjes
- b) Pjesërisht përshtatet
- c) Jo, në përgjithësi nuk përshtatet me kërkesat bashkëkohore për planifikimin dhe realizimin e punës edukative arsimore ku fëmija është në qendër të vëmendjes.

14. Vallë mendoni se evidenca dhe dokumentacioni pedagogjik aktual në kopshte / QMHZH duhet të rishqyrtohen?

- a) Po
- b) Jo

15. Në qoftë se pyetjes paraprake u jeni përgjigjur me Po, atëherë theksoni sugjerimet dh propozimet Tuaja për avancimin e tyre.

16. Vallë keni nevojë për përkryerje permanente profesionale me qëllim të realizimit të suksesshëm të punës edukative- arsimore në kopsht/ QMHZH?

a) Po

b) Jo

17. Vallë keni nevojë për trajnim realizuar nga persona profesionistë të Byrosë së zhvillimit të arsimit?

a) Po

b) Jo

18. Në qoftë se në pyetjen paraprake keni rrethuar nën a, me cilën temë duhet të jenë trajnimet?

19. Për implementimin e suksesshëm të punës edukative- arsimore, vallë keni nevojë për përkrahje të vazhdueshme profesionale-këshillëdhënëse nga këshilltarët e Byrosë së zhvillimit të arsimit?

a) Po, sepse _____

b) Jo, sepse _____

20. Theksoni sugjerimet Tuaja përderisa mendoni se do ta avancojnë punën edukative- arsimore në kopshtin për fëmijë.

Shtojca 3

BYROJA E ZHVILLIMIT TË ARSIMIT Sektori për hulumtim në arsim

FLETË ANKETUESE PËR PRINDËR/TUTORË

Të nderuar,

Byroja e Zhvillimit të Arsimit realizon hulumtim në kopshtet për fëmijë në Republikën e Maqedonisë me qëllim të marrjes të informatave të besueshme për gjendjet dhe nevojat dhe marrja e hapave konkret për ndryshime sistemore cilësore në edukimin dhe arsimin parashkollor për fëmijët prej moshës 4 deri 6 vjeçare.

Fleta anketuese përmban pyetje të cilave duhet t'iu përgjigjeni duke rrethuar, përkatësisht duke dhënë komente, mendime dhe sugjerime alternative. Informatat e fituara do të shfrytëzohen kryesisht për qëllimet e këtij hulumtimi.

Përzgjedhja është bërë sipas parimeve të rastësishme, ndërsa pjesëmarrja është anonime.

Ju falënderohemi për bashkëpunimin!

1. Fletës anketuese i përgjigjet prindi /tutori::

- a) nga Shkupi
- b) nga brendia e Republikës së Maqedonisë

2. Gjinia e prindit/tutorit i cili e plotëson fletën anketuese:

- a) gjinia mashkullore
- b) gjinia femërore

3. Mosha e prindit/tutorit:

- a) deri në 20 vjet
- b) prej 20 deri në 30
- c) prej 30 deri në 40
- ç) prej 40 deri në 50 vjet
- d) mbi 50 vjet

4. Shkalla e arsimit të mbaruar të prindit/tutorit:

- a) arsimi fillor
- b) arsimi i lartë
- c) arsimi sipëror
- ç) magjistër
- d) doktor shkence

5. Cili sipas radhës është fëmija Juaj në kopsht?

- a) I parë
- b) I dytë
- c) I tretë
- ç) I katërt

6. Cilët prej këtyre funksioneve në kopsht janë më të rëndësishme për Ju?**(rrethoni së paku tre)**

- a) Kujdesi i fëmijës.
- b) Kujdesi, edukimi dhe arsimiti i fëmijës.
- c) Përgatitja e fëmijës për klasën e parë.
- ç) Zhvillimi i të folurit, shkathtësitë komunikative dhe socializimi.
- d) Luajtja në hapësirë.
- dh) E tjerë (theksoni çka)_____

7. Vallë jeni të informuar/a me Programin për mësim të hershëm dhe zhvillim në të cilin bazohet realizimi i punës edukative – arsimore në kopsht?

- a) Plotësisht jam i/e informuar me të gjitha aktivitetet edukative- arsimore të cilat duhet t'i realizojë edukatori në grupin në të cilin shkon fëmija im.
- b) Pjesërisht jam i/e informuar me disa aktivitete edukative-arsimore të cilat duhet ti realizojë edukatori.
- c) Jo, aspak nuk jam i/e informuar.

8. Vallë jeni i/e kënaqur nga realizimi i punës edukative – arsimore në kopshtin ku shkon fëmija Juaj?

- a) Plotësisht jam i/e kënaqur
- b) Pjesërisht jam i/e kënaqur
- c) Nuk jam i/e kënaqur, sepse_____

9. Në cilën mënyrë kopshti Ju informon/njofton me aktivitetet edukative-arsimore që realizohen?

- a) Personalisht nga edukatori.
- b) Nga përkëdhelësi.
- c) Nga informimi i theksuar.
- ç) Nga prindërit tjerë.
- d) Nga fëmija im.
- dh) Aspak nuk jam i/e informuar.

10. Vallë si prind/tutor duke e përcjell përparimin e fëmijës tënd, keni nevojë për aplikimin e risive në punën edukative – arsimore në kopsht?

- a) Nuk ndjej nevojë, supozoj se puna edukative – arsimore në kopsht realizohet në nivel të duhur.
- b) Po, mendoj se secila risi mund ta pasurojë përvojën dhe cilësinë e punës edukative – arsimore.
- c) Nuk e di, nuk kam përgjigje për këtë pyetje.

11. Çfarë kontributi ka kopshti në përgatitjen e fëmijëve për kalimin e suksesshëm prej edukimit dhe arsimimit parashkollor në edukimin dhe arsimin fillor?

- a) Ka kontribut të madh.
- b) Ka kontribut të caktuar.
- c) Nuk ka kontribut të caktuar.

12. Vallë mendoni se është e nevojshme të aplikohet viti përgatitor i detyrueshëm në drejtim të ndërlidhjes funksionale të parashkollores me edukimin dhe arsimin fillor?

- a) Po
- b) Jo

13. Cilat aktiviteti janë shpërfillur në punën e deritanishme me fëmijët në kopsht, ndërsa mendoni se janë të rëndësishme për zhvillimin e mëtutjeshëm të edukimit dhe arsimit?

(Mund të përzgjidhni më tepër se një përgjigje)

- a) Aktivitete për arsimin fizik dhe shëndetësor të fëmijëve.
- b) Aktivitete për pasurimin e fjalorit dhe zhvillimin e karakteristikave komunikative të fëmijës.
- c) Aktivitete për përgatitjen e fëmijëve për aplikimin e shkrim - leximit fillestar.
- ç) Aktivitete matematikore si mjet për të menduarit logjik dhe zgjidhja e problemeve.
- d) Aktivitetet e edukimit dhe arsimit figurativ dhe muzikor.
- dh) Aktivitetet hulumtuese.
- e) Aktivitetet edukative – arsimore në natyrë.
- ë) Tjetër (theksoni çka)_____

14. Propozime dhe komente tjera

Shtojca 4

BYROJA E ZHVILLIMIT TË ARSIMIT Sektori për hulumtim në arsim

FLETË ANKETUESE PËR EDUKATORË

FOKUS GRUPI

1. Çka mendoni për dokumentin Standardet për mësim të hershëm dhe zhvillim të fëmijët prej moshës 0 deri në moshën 6 vjeçare?
 - Vallë nevojitet të bëhet ndonjë ndarje e sferave (p.sh, arti)?
2. Çka mendoni për Programin për mësim të hershëm dhe zhvillim?
 - Vallë keni nevojë për konkretizim më të madh të qëllimeve?
 - Vallë keni vështirësi në planifikimin dhe realizimin e qëllimeve në Programin për mësim të hershëm dhe zhvillim dhe për çka kanë të bëjnë ato?
3. Cilat janë qëndrimet Tuaja për aktivitetet projektuese të detyrueshme të cilat i realizoni me fëmijët në grup?
4. Kur realizohen (në cilën periudhë të ditës) programet fakultative me fëmijët e grupit Tuaj?
5. Cilat janë qëndrimet Tuaja për evidencën pedagogjike dhe dokumentacionin që detyrimisht e udhëhiqni?
6. Vallë mendoni se veprimtaria duhet të rregullohet me ligj të posaçëm për edukimin dhe arsimin parashkollor?
7. Vallë mendoni se duhet të punojnë nga dy edukatorë në grupin edukativ me moshën e fëmijëve më të rritur?
8. Çfarë trajnime dhe për cilën temë prisni të realizohen nga këshilltarët e Byrosë së zhvillimit të arsimit?

Shtojca 5

BYROJA E ZHVILLIMIT TË ARSIMIT
Sektori për hulumtim në arsim

FLETË ANKETUESE PËR PEDAGOGË NË SHKOLLAT FILLORE

I/e nderuar,

Byroja e Zhvillimit të Arsimit realizon hulumtim në kopshtet për fëmijë në Republikën e Maqedonisë me qëllim të marrjes të informatave të besueshme për gjendjet dhe nevojat dhe marrja e hapave konkrete për ndryshime sistemore cilësore në edukimin dhe arsimin parashkollor për fëmijët prej moshës 4 deri 6 vjeçare.

Në fletën anketuese mund të përgjigjeni duke rrethuar, përkatësisht duke dhënë mendimin, komentin ose sugjerimet tuaja. Të dhënat e marra nga kjo fletë anketuese do të shfrytëzohen kryesisht për qëllimet e këtij hulumtimi.

Përzgjedhja është bërë sipas parimeve të rastësishme, ndërsa pjesëmarrja është anonime.

Ju falënderohemi për bashkëpunimin!

TË DHËNAT E PËRGJITHSHME

Kopshti për fëmijë _____

Komuna _____

Qyteti _____

— Shkalla e arsimit:

a) arsim sipëror b) magjistër c) doktor shkence

— Përvoja e punës si pedagog:

a) deri 10 vjet b) deri 20 vjet

c) deri 30 vjet ç) mbi 30 vjet

— Në fletën anketuese përgjigjet pedagog:

a) gjinisë mashkullore

b) gjinisë femërore

1. Sa nxënës janë regjistruar në klasën e parë në shkollën Tuaj në vitin shkollor 2016/2017?

2. Sa nga nxënësit e regjistruar në klasën e parë në shkollën Tuaj në vitin shkollor 2016/2017 kanë qenë të përfshirë me punën edukative arsimore në kopshtet për fëmijë?

3. A keni qenë anëtar i komisionit për regjistrimin e nxënësve në klasën e parë në shkollën Tuaj për këtë vit shkollor?

a) Po

b) Jo

4. Në qoftë se në pyetjen paraprake jeni përgjigjur me PO, vallë gjatë vëzhgimit dhe bisedave me fëmijët keni vërejtur dallime të fëmijët të cilët kanë qenë të përfshirë në punën edukative-arsimore në kopsht krahasuar me ata të cilët nuk kanë ndjekur asnjë lloj forme të punës edukative-arsimore para shkuarjes në shkollë, sa i përket sjelljes në hapësirë, mënyrës së komunikimit me fëmijët dhe me të rriturit, vetëbesimi, të folurit dhe njohuritë paraprake?

- a) Po, te numri më i madh i nxënësve të cilët kanë qenë të përfshirë në punën edukative-arsimore në kopsht.
- b) Po, te gjysma e fëmijëve të cilët kanë qenë të përfshirë në punën edukative-arsimore në kopsht.
- c) Po, te një numër i vogël i fëmijëve të cilët kanë qenë të përfshirë në punën edukative-arsimore në kopsht.
- ç) Jo, nuk ka dallime.

5. Në qoftë se e ndiqni përparimin e nxënësve në klasën e parë, si është adaptimi i fëmijëve të cilët kanë qenë të përfshirë me punën edukative-arsimore në kopsht?

- a) Numri më i madh i fëmijëve të cilët kanë qenë të përfshirë në punën edukative-arsimore në kopsht më shpejtë adaptohen se sa fëmijët të cilët nuk kanë ndjekur asnjë lloj forme të punës edukative-arsimore para shkuarjes në shkollë.
- b) Gjysma e fëmijëve të cilët kanë qenë të përfshirë në punën edukative-arsimore në kopsht më shpejtë adaptohen se sa fëmijët të cilët nuk kanë ndjekur asnjë lloj forme të punës edukative-arsimore para shkuarjes në shkollë.
- c) Një numër i vogël të cilët kanë qenë të përfshirë në punën edukative-arsimore në kopsht më shpejtë adaptohen se sa fëmijët të cilët nuk kanë ndjekur asnjë lloj forme të punës edukative-arsimore para shkuarjes në shkollë.
- ç) Nuk ka dallim sa i përket adaptimit të fëmijët të cilët kanë qenë të përfshirë në punën edukative-arsimore në kopsht dhe ato fëmijë të cilët nuk kanë ndjekur asnjë lloj forme të punës edukative-arsimore para shkuarjes në shkollë.

6. Çfarë njohuri keni për njohuritë paraprake të nxënësve në klasën e parë të cilët paraprakisht kanë qenë të përfshirë në punën edukative-arsimore në kopsht?

- a) Këta nxënës kanë fjalor të pasur dhe shkathtësi të mira komunikimi.
- b) Këta nxënës kanë njohuri paraprake nga lëmi i matematikës.
- c) Këta nxënës kanë njohuri paraprake nga lëmi i shkencave natyrore.
- ç) Këta nxënës kanë njohuri paraprake dhe shkathtësi nga lëmi i arsimit muzikor dhe figurativ.
- d) Këta nxënës kanë koordinim të mirë të muskulaturës së madhe dhe kanë të zhvilluar muskulaturën e imët të dorës.

dh) Nuk ka dallim të madh sa i përket njohurive paraprake të këtyre nxënësve të cilët nuk kanë vizituar asnjë lloj forme të edukimit dhe arsimit parashkollor.

e) Nuk ka njohuri.

(Mund të përzgjidhni më shumë se një përgjigje.)

7. Vallë jeni të njoftuar me Programin për mësim të hershëm dhe zhvillim në të cilin bazohet realizimi i punës edukative-arsimore në kopsht?

a) Po, tërësisht.

b) Po, pjesërisht.

c) Jo.

8. Vallë mendoni se është me rëndësi të ekzistojë lidhshmëri midis programeve mësimore në klasën e parë dhe Programit për mësim të hershëm dhe zhvillim në bazë të së cilës realizohet puna edukative- arsimore në kopsht?

a) Po, me rëndësi të veçantë.

b) Po, shumë me rëndësi.

c) Po, me rëndësi është.

ç) Nuk është e domosdoshme të ketë lidhshmëri midis dy programeve

9. Në qoftë se në pyetjen paraprake jeni përgjigjur me a, b ose c, mendoni se rëndësi të posaçme ka ekzistimi i harmonizimit midis këtyre dy programeve në raport me:

a) matematikën dhe shkencat natyrore, në veçanti për shkak të programeve të adaptuara të Kembrixhit.

b) gjuhën amtare.

c) edukimin fizik dhe shëndetësor.

ç) arsimin figurativ.

d) arsimin muzikor.

dh) përforcimin e vetëbesimit dhe imazhit pozitiv për vetveten.

e) shoqërinë.

ë) tjetër _____

(Mund të përzgjidhni më shumë se një përgjigje.)

10. Vallë ekziston nevoja për aplikimin e vitit përgatitor të detyrueshëm para shkuarjes në shkollë të fëmijët prej moshës 4 deri 6 vjeçare?

- a) Plotësisht pajtohem.
- b) Pjesërisht pajtohem.
- c) Nuk pajtohem.

11. Çka duhet të bëhet që të përfshihen të gjithë fëmijët në Republikën e Maqedonisë me punë të detyrueshme edukative- arsimore në vitin para shkuarjes në shkollë?

(Mund të përzgjidhni më shumë se një përgjigje.)

- a) Zgjerimin e kapaciteteve ekzistuese të institucioneve për përfshirjen e fëmijëve të moshës parashkollore.
 - b) Aplikimin e vitit përgatitor të detyrueshëm për të gjithë fëmijët prej moshës 4 deri 6 vjeçare.
 - c) Sjellja e ligjit për edukim dhe arsim parashkollor.
 - ç) Tjetër (shkruani çka)
-
-

12. Theksoni sugjerimet Tuaja në qoftë se mendoni se do ta avanconi lidhshmërinë funksionale të edukimit parashkollor me edukimin dhe arsimin fillor.

Shtojca 6

BYROJA E ZHVILLIMIT TË ARSIMIT Sektori për hulumtim në arsim

FLETË ANKETUESE PËR MËSIMDHËNËS KLASOR

I/e nderuar,

Byroja e zhvillimit të arsimit organizon hulumtim me temë: „Puna edukative- arsimore për fëmijët e moshës prej 4 deri 6 vjeçare në institucionet parashkollore në Republikën e Maqedonisë”, me qëllim të shqyrtimit të gjendjes aktuale, nevojës dhe mënyrave të ndërlidhjes funksionale ndërmjet edukimit dhe arsimit fillor me atë parashkollor.

Fleta anketuese është përpiluar me qëllim që të marrim qëndrimet Tuaja si informata të besueshme për gjendjen sa i përket përgatitjes së fëmijëve për në shkollë pas regjistrimit të tyre në klasë të parë, si dhe nevoja dhe mënyrat e ndërlidhjes funksionale të programit për punën edukative- arsimore në kopshtet për fëmijë dhe programet mësimore për klasën e parë.

Në fletën anketuese mund të përgjigjeni duke rrethuar, si dhe duke shkruar mendimin, komentin ose sugjerimet tuaja. Të dhënat e marra nga kjo fletë anketuese do të shfrytëzohen kryesisht për qëllimet e këtij hulumtimi.

Anketimi është anonim, ndërsa përzgjedhja është e rastësishme.

Ju falënderohemi për bashkëpunimin!

TË DHËNAT E PËRGJITHSHME:

Shkolla fillore _____

Komuna _____

Qyteti _____

— **Shkalla e arsimimit të mësimdhënësit:**

- a) arsim i lartë b) arsim sipëror
- c) magjistër ç) doktor shkence

— **Lloji i mbarimit të arsimimit sipëror**

- a) Fakulteti Filozofik
- b) Fakulteti Pedagogjik
- c) Arsimim tjetër (theksojeni) _____

— **Përvoja e punës si mësimdhënës klasor:**

- a) deri 10 vjet b) deri 20 vjet
- c) deri 30 vjet ç) mbi 30 vjet

— **Pyetësorit i përgjigjet mësimdhënësi klasor i:**

- a) gjinisë mashkullore
- b) gjinisë femërore

1. Vallë jeni të njoftuar me Programin për mësim të hershëm dhe zhvillim sipas të cilit realizohet puna edukative- arsimore në kopshtet për fëmijë?

- a) Po, tërësisht
- b) Po, pjesërisht
- c) Jo

2. Sa nxënës nga paralelja Juaj paraprakisht kanë ndjekur ndonjërin nga format për edukim dhe arsim parashkollor?

- a) Të gjithë nxënësit.
- b) Një numër i madh i nxënësve.
- c) Një numër i vogël i nxënësve.
- ç) Asnjëri nga nxënësit.

3. Sipas Juve, vallë me realizimin e Programit për mësim të hershëm dhe zhvillim në kopshtet për fëmijë me sukses përgatiten fëmijët për ndjekjen e mësimin në klasën e parë?

- a) Po b) Pjesërisht c) Jo

4. Vallë mendoni se është i nevojshëm avancimi i qëllimeve në Programin për mësim të hershëm dhe zhvillim për moshën më të rritur parashkollore me qëllim të ndërlikimit funksionale të qëllimeve në programet mësimore për klasën e parë?

- a) Plotësisht pajtohem.
b) Pjesërisht pajtohem.
c) Aspak nuk pajtohem.

5. Sipas mendimit Tuaj, vallë ekziston nevoja për aplikimin e vitit përgatitor?

- a) Plotësisht pajtohem.
b) Pjesërisht pajtohem.
c) Aspak nuk pajtohem.

6. Cilat aktiviteti janë lënë pas dore në punën e deritanishme edukative- arsimore me fëmijët në kopsht me qëllim të përgatitjes më të mirë të fëmijës për të shkuar në shkollë fillore?

- a) Aktivitetet për arsimin fizik dhe shëndetësor të fëmijëve.
b) Aktivitetet për pasurimin e fjalorit dhe zhvillimin e karakteristikave komunikative të fëmijës.
c) Aktivitetet për përgatitjen e fëmijëve për aplikimin e shkrim- leximin fillestar dhe të shkruarit.
ç) Aktivitetet matematikore si mjet për të menduarit logjik dhe zgjidhja e problemeve.
d) Aktivitetet e arsimit artistik dhe edukimit muzikor.
dh) Aktivitetet hulumtuese.
e) Aktivitetet edukative – arsimore në natyrë.
ë) Tjetër (theksoni çka) _____

7. Çka sipas Juve, do ta avancojë lidhshmërinë funksionale të edukimit dhe arsimit parashkollor me edukimin dhe arsimin fillor.



...the first of these is the fact that the ...

...the second of these is the fact that the ...

...the third of these is the fact that the ...

...the fourth of these is the fact that the ...

...the fifth of these is the fact that the ...

...the sixth of these is the fact that the ...

...the seventh of these is the fact that the ...

...the eighth of these is the fact that the ...

...the ninth of these is the fact that the ...

...the tenth of these is the fact that the ...

...the eleventh of these is the fact that the ...

...the twelfth of these is the fact that the ...

...the thirteenth of these is the fact that the ...

...the fourteenth of these is the fact that the ...

...the fifteenth of these is the fact that the ...

...the sixteenth of these is the fact that the ...

...the seventeenth of these is the fact that the ...

...the eighteenth of these is the fact that the ...